



REVOLUCIONI I DASH-URISË

JOYCE MEYER



REVOLUCIONI I DASH-URISË

JOYCE MEYER



JOYCE MEYER
MINISTRIES

Revolucioni i Dashurisë
Joyce Meyer

Citimet Biblike janë përkthyer nga The Amplified® Bible. E drejta e autorit © 1954, 1962, 1965, 1987 nga Lockman Foundation. Përdorur me leje.

Në raste të tjera citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS. E drejta e autorit © 2002 nga Albanian Bible Society. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përdorur me leje.

Botim i FaithWords
© 2009 nga Joyce Meyer
Life in The Word, Inc.
P.O.Box 655
Fenton, Missouri 63026

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç rasteve të lejuara në ligjin mbi të drejtat e autorit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të shpërndahet, apo të transmetohet në asnjë formë apo mjet, apo të ruhet në një bazë të dhënash ose sistem rrikthimi kompjuterik, pa pasur më parë miratimin e shkruar të publikuesit.

FaithWords
Hachette Book Group
237 Park Avenue
New York, NY 10017

Vizitoni faqen tonë të internetit www.faithwords.com.

Përktheu Sedika Fushekati
Redaktuan: Iva Çipuri dhe Hervin Fushekati

Shtypur në

Botimi i parë nga Joyce Meyer Ministries: Shtator 2009.

FaithWords është një sektor i Hachette Book Group, Inc.

Emri dhe logoja e FaithWords janë shenja dalluese me të drejta ekskluzive të Hachette Book Group, Inc.

ISBN 978-0-446-53859-6

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
1. Çfarë Nuk Shkon në Këtë Botë??	11
2. Rrënja e Problemit	34
3. Asgjë e Mirë Nuk Ndodh Rastësisht	47
4. I Ndërprerë nga Perëndia	66
5. Dashuria e Gjen Një Rrugë	78
6. Të Mposhtësh të Keqen me të Mirë	90
7. Drejtësi për të Shtypurit	107
8. Dashuria Është Përfshirëse, Jo Përjashtuese	134
9. Bëjini Njerëzit të Ndihen të Vlefshëm	154
10. Vepra Agresive Mirësie	175
11. Dallo se Çfarë Nevoje Kanë Njerëzit dhe Bëhu Pjesë e Zgjidhjes	188
12. Dashuria Pa kushte	198

13.	Dashuria Nuk Mban Shënim Gabimet	208
14.	Mënyra Praktike për të Treguar Dashurinë	217
15.	A Kemi nevojë për rizgjim apo për revolucion?	242
	Shënime	255

Shkrimtarë të Ftuar "Revolucionarë të Dashurisë"

Darlene Zschech	24
Martin Smith	125
Pastor Paul Scanlon	145
John C. Maxwell	165
Pastor Tommy Barnett	232

HYRJE

Revolucion. Vetë fjala nxit shpresë, ndez pasion dhe frymëzon besnikëri si asnjë fjalë tjetër në fjalorin njerëzor. Përgjatë gjithë historisë, ideja e një revolucioni ka derdhur benzinë mbi zemërzjarrtët dhe ka injektuar kurajo tek të frikësuarit. Revolucioni ka mbledhur njerëz që janë në kërkim të një kauze më të madhe se vetja e tyre dhe u ka dhënë burrave dhe grave që më parë s'kishin qëllime në jetë një kauzë për të cilën ishin gati të vdisnin. Revolucionet kanë lindur udhëheqës të mëdhenj dhe kanë rritur ndjekës të mëdhenj; ato e kanë ndryshuar botën me të vërtetë.

Revolucioni është një ndryshim i papritur, rrënjësor dhe tërësor nga mënyra se si bëhen gjërat normalisht. Zakonisht, revolucionet nisin nga një person apo nga një grup shumë i vogël njerëzish të cilët nuk duan të jetojnë më siç kanë jetuar në të kaluarën. Ata besojnë se diçka *mund* dhe *duhet* të ndryshojë, kështu që vazhdojnë t'i promovojnë idetë e tyre derisa të fillojë një dallgëzim që do të ndryshojë përfundimisht situatën, shpesh në mënyrë rrënjësore.

Bota ka përjetuar shumë revolucione, si për shembull ato të përmbysjes së qeverive shfrytëzuese. Kjo gjë ka ndodhur në Revolucionin Amerikan, Revolucionin Francez dhe në atë Rus (i njohur edhe si Revolucioni Bolshevik). Revolucionet kanë zëvendësuar sistemet e vjetëruara dhe të paefektshme, ku mënyrat e vjetra të të menduarit i kanë lënë vend ideve të reja (si në rastin e Revolucionit Shkencor ose Revolucionit Industrial). Thomas Jefferson

ka thënë: "Çdo brez ka nevojë për një revolucion të ri" dhe unë besoj se ka ardhur koha për revolucionin tjetër botëror, më të madhin e të gjithëve. Ne nuk na duhen po ato revolucione që kanë shënuar tablonë e historisë botërore në brezat e kaluar; nuk na duhet një revolucion i mbështetur në politikë, ekonomi apo teknologji. Çfarë na duhet është një Revolucion Dashurie.

Ne duhet t'i japim fund mbizotërimit të egoizmit dhe jetesës së përqendruar në vetveten. Asgjë nuk do të ndryshojë në këtë botë nëse secili prej nesh nuk është i gatshëm të ndryshojë. Shpesh herë ne dëshirojmë që bota të ndryshojë, por pa u ndalur për të kuptuar se gjendja e kësaj bote sot është rezultat i mënyrës se si i jetojmë jetët tona individuale dhe i zgjedhjeve që bëjmë çdo ditë.

Nëse çdo njeri i planetit do të dinte të pranonte dhe të dhuronte dashuri, bota jonë do të ishte një vend tërësisht ndryshe. Mendoj se të gjithë e dimë se ka diçka që nuk shkon në shoqërinë tonë dhe se ajo duhet rregulluar, por askush nuk duket se di çfarë duhet bërë apo si të fillojë të sjellë ndryshime. Reagimi ynë ndaj një bote jashtë kontrollit është të ankohe mi dhe të mendojmë: *Dikush duhet të bëjë diçka*. Mendojmë dhe themi se ndoshta Perëndia, qeveria apo dikush tjetër në autoritet duhet të ndër marrë ndonjë veprim. Por e vërteta është se çdokush prej nesh duhet të bëjë diçka. Duhet të mësojmë ta jetojmë jetën në një këndvështrim tërësisht ndryshe nga më parë. Duhet të jemi të gatshëm të mësojmë, të ndryshojmë dhe të pranojmë se jemi pjesë e problemit.

Ne nuk mund të rregullojmë diçka që nuk e kuptojmë, prandaj detyra jonë parësore është të përcaktojmë rrënjën e problemit. Pse shumica e njerëzve janë të trishtuar? Pse ka kaq shumë dhunë në familje, nëpër lagje, qytete dhe kombe? Pse njerëzit janë kaq të zemëruar? Ju mund të mendoni se këto gjëra kanë ndodhur për shkak të mëkatit. Mund të thoni: "Njerëzit janë mëkatarë. Ky është problemi." Teorikisht jam dakord, por dëshiroj t'i drejtohem këtij problemi nga një këndvështrim praktik me të cilin të gjithë

ndeshemi çdo ditë. Unë besoj vendosmërisht se rrënja e këtyre çështjeve dhe e shumë të tjerave është egoizmi. Natyrisht, egoizmi është vepër e mëkatit. Kur një person thotë: "Dua të kem atë që dua dhe do të bëj gjithçka që duhet për ta marrë". Mëkati ekziston sa herë që një person shkon kundër Perëndisë dhe rrugëve të Tij.

Ne priremi të jetojmë "mbrapsht" - tamam në të kundërtën e mënyrës se si duhet të jetojmë. Jetojmë për veten tonë e megjithatë asnjëherë nuk duket të kemi atë që na kënaq. Ne duhet të jetojmë për të tjerët dhe të mësojmë sekretin e mrekullueshëm se kur japim, ajo që japim na kthehet e shumëfishuar. Më pëlqen mënyra se si e përshkroi këtë gjë një doktor i njohur, i quajtur Luka: "Jepeni jetën; do të shikoni se jeta do t'ju jepet përsëri, por jo thjesht përsëri - e dhënë përsëri me tepricë dhe bekim. Dhënia, jo marrja, kjo është rruga. Bujaria sjell bujari" (Luka 6:38, përkthim nga versioni *The Message* i Biblës).

Në shumë shoqëri, zotërimi, fitimi dhe kontrolli janë kthyer në qëllimin numër një të njerëzve. Të gjithë duan të jenë "numri një", gjë që automatikisht tregon se shumë të tjerë do të jenë të zhgënjyer, sepse vetëm një person mund të jetë njëshi në një kohë dhe vend të caktuar. Vetëm një person mund të jetë vrapuesi numër një në botë; vetëm një person mund të jetë presidenti i kompanisë ose aktori/aktorja më e mirë në skenë apo ekran. Vetëm një person mund të jetë autori më i mirë ose piktori më i mirë në botë. Ndonëse besoj se të gjithë duhet të udhëhiqemi nga qëllimi dhe të përpiqemi të arrijmë më të mirën, nuk besoj se duhet të kërkojmë gjithçka për vete dhe të mos t'ia dimë fare për të tjerët.

Unë kam jetuar gjashtëdhjetë e pesë vjet deri tani që po shkruaj këtë libër dhe mendoj se kjo gjë më kualifikon të kem njohuri mbi disa gjëra. Të paktën kam jetuar aq sa të provoj disa mënyra për të qenë e lumtur dhe kam zbuluar me anë të parimit të eliminimit se çfarë funksionon dhe çfarë jo. Egoizmi nuk e bën jetën të funksionojë në mënyrën që duhet të funksionojë dhe pa dyshim

që nuk është vullneti i Perëndisë për njerëzimin. Unë besoj se, mund të vërtetoj në këtë libër që egoizmi është me të vërtetë problemi madhor me të cilin përballemi në botë dhe se një lëvizje agresive për ta eliminuar atë, është përgjigjja jonë. Ne duhet t'i shpallim luftë egoizmit. Ne kemi nevojë për një Revolucion Dashurie.

Dashuria duhet të jetë më shumë se një teori apo një fjalë; duhet të jetë veprim. Ajo duhet të shihet dhe të ndihet. Perëndia është dashuri! Dashuria është dhe gjithmonë ka qenë ideja e Tij. Ai erdhi për të na dashur, për të na mësuar si ta duam Atë, veten tonë dhe të tjerët.

Kur e bëjmë këtë gjë, jeta është e bukur; kur nuk e bëjmë, asgjë nuk funksionon siç duhet. Dashuria është përgjigjja kundër egoizmit sepse dashuria jep, ndërsa egoizmi merr. Ne duhet të çlirohemi nga vetvetja dhe Jezusi erdhi pikërisht për këtë qëllim, siç shikojmë tek 2 Korintasve 5:15: "Dhe (Ai) vdiq për të gjithë, me qëllim që ata të cilët jetojnë, të mos jetojnë më për veten e tyre, por për atë që vdiq e u ringjall për ta".

Kohët e fundit, ndërsa po mendoja për gjithë problemet e tmerrshme të botës, si për mijëra fëmijë të uritur, SIDA-n, luftërat, shtypjen, trafikimin e qenieve njerëzore, incestin dhe shumë të tjera, e pyeta Perëndinë: "Si mund të durosh të shikosh gjithçka që po ndodh në botë dhe të mos bësh asgjë?". E dëgjova Perëndinë të më thoshte në frymë: "Unë veproj nëpërmjet njerëzve. Po pres që njerëzit e Mi të ngrihen dhe të bëjnë diçka".

Ju mund të mendoni ashtu si edhe miliona të tjerë: "*e di se bota ka probleme, por ato janë kaq të mëdha, e çfarë mund të bëj unë që të sjell ndonjë ndryshim?*" Pikërisht kjo mënyrë e të menduarit na ka mbajtur të paralizuar ndërsa ligësia ka vazhduar të triumfojë. Ne duhet të ndalojmë së menduari për gjërat që nuk mund të bëjmë dhe të fillojmë të bëjmë ato gjëra që mundemi. Në këtë libër, unë dhe disa shkrimtarë të tjerë që i kam ftuar të bashkohen me mua, do të

ndajmë me ju shumë ide dhe mënyra se si ju mund të bëheni pjesë e një lëvizjeje të re që ka aftësinë të sjellë ndryshim pozitiv radikal.

Unë refuzoj të vazhdoj të rri mënjanë duke mos bërë asgjë ndërkohë që bota ka marrë të tatëpjetën. Ndoshta nuk do të mund t'i zgjidh të gjitha problemet që shikoj, por do të bëj atë që mundem. Lutja ime është që ju të bashkoheni me mua, të mbani qëndrim ndaj padrejtësisë dhe të jeni të gatshëm të ndërmerrni një ndryshim rrënjësor në mënyrën se si i drejtoheni jetës. Jeta nuk mund të jetë më mbi çfarë të tjerët mund të bëjnë për ne, por përkundrazi, çfarë ne mund të bëjmë për ta.

Çdo lëvizje ka nevojë për një moto ose një kredo për të cilën jeton. Ne, tek Shërbesa Joyce Meyer, jemi përkushtuar të jetojmë sipas një besëlidhjeje që e kemi gdhendur me lutje. A do bashkoheni me ne?

Unë marr përsipër dhembshurinë dhe
dorëzoj justifikimet e mia.

Unë qëndroj kundër padrejtësisë
dhe **përkushtohem** të vë në jetë veprime
të thjeshta të dashurisë së Perëndisë.

Refuzoj të rri duarkryq. Ky është vendimi im.

UNË JAM REVOLUCIONI I DASHURISË

Lutem që këto fjalë do të bëhen gjithashtu kredoja juaj - standardi i ri me të cilin do të jetoni. Mos pritni të shikoni se çfarë dikush tjetër zgjedh për të bërë dhe mos rrezikoni të prisni nëse lëvizja bëhet popullore. Ky është një vendim që duhet ta merrni vetë, një përkushtim që vetëm ju duhet ta merrni. Bëjini vetes këtë pyetje: "A do të vazhdoj të jem pjesë e problemit apo pjesë e zgjidhjes?". Unë kam vendosur të jem pjesë e zgjidhjes. Dashuria do të jetë tema qendrore e jetës sime.

Bëjini vetes këtë pyetje: "A do të vazhdoj të jem pjesë e problemit apo pjesë e zgjidhjes?". Unë kam vendosur të jem pjesë e zgjidhjes. Dashuria do të jetë tema qendrore e jetës sime.

Po ju? A do t'i përjetësoni problemet e botës sot? A do t'i shpërfillni apo do të hiqeni sikur ato nuk ekzistojnë? Apo do të bashkoheni me Revolucionin e Dashurisë?



KAPITULLI

1

Unë jam vetëm një, e megjithatë jam një, nuk mund të bëj gjithçka, por mund të bëj diçka dhe për shkak se nuk mund të bëj gjithçka, nuk do të refuzoj të bëj diçka që mund ta bëj.

Edward Everett Hale

Ndërsa ulem dhe pi kafen e mëngjesit, duke parë pamjen e bukur jashtë dritares sime, 963 milionë njerëz janë të uritur.

Më shumë se një miliardë njerëz fitojnë më pak se një dollar në ditë.

Tridhjetë mijë fëmijë do të vdesin sot për shkak të varfërisë. Ata vdesin në disa prej fshatrave më të varfra të Tokës - shumë larg ndërgjegjes së botës. Kjo do të thotë se 210,000 vdesin çdo javë-11 milionë çdo vit-dhe shumica e tyre janë nën pesë vjeç.

Nga 2.2 miliardë fëmijë që ka bota, 640 milionë nuk kanë strehë të përshtatshme, 400 milionë janë pa ujë të pijshëm dhe 270 milionë pa asnjë mundësi të ndonjë shërbimi mjekësor.

A janë këto statistika po aq tronditëse për ju sa janë për mua? Shpresoj që po. Këto janë fakte të qarta e trullosëse të jetës në

botën që jetojmë. Këto po ndodhin në planetin tonë dhe gjatë turnit tonë të jetës. E kuptoj se statistikën që sapo keni lexuar ndoshta nuk kanë të bëjnë me qytetin apo vendin ku jetoni, por sot më shumë se kurrë, ne të gjithë jemi qytetarë të botës. Jemi pjesë e komunitetit botëror ku anëtarë të familjes sonë njerëzore po vuajnë në mënyra të patreguara dhe të papërfytyrueshme.

Unë besoj se ka ardhur koha për një thirrje zgjimi mbarëbotëror-thirrje që do të na shkulë nga vetëkënaqësia, padija e anashkalimi i vështirësive, dhe do të na ngrejë kundër dhimbjes e varfërisë, humbjes e skamjes, padrejtësisë e shtypjes dhe kundër kushteve të jetesës që nuk mbështesin një jetë të shëndetshme apo dinjitet minimal. Me të vërtetë ka ardhur koha për një Revolucion Dashurie.

Gjatë një fushate për ndihme mjekësore të Shërbesës Joyce Meyer në Kamboxhia, një dentist vullnetar, i hoqi një fëmijë të vogël njëzet e një dhëmbë; gjashtë prej të cilëve me qelb. Kur mendoj për këtë situatë torturuese më kujtohet se një herë, ndërsa po udhëtonim drejt Australisë, burri im kishte një dhimbje të keqe dhëmbi. Ai ishte krejtësisht i mjeruar sepse ishte në aeroplan dhe nuk qetësohej dot. Sapo u ulëm, në orën dhjetë të natës, dikush e shoqëroi tek dentisti dhe kështu arriti të merrte ndihmë. Po vajza e vogël dhe mijëra të tjerë si ajo që durojnë dhimbje çdo ditë pasi nuk kanë asnjë mundësi për të marrë ndihmë mjekësore? Mendoni pak për këtë. Si do të ndjeheshit të kishit njëzet e një dhëmbë të prishur që pulsonin nga dhimbja?

Kjo lloj vuajtje e paimagjinueshme ekziston; ndodh çdo ditë, tek njerëz të vërtetë në vende të largëta të botës. Shumica prej nesh ose nuk dinë asgjë për ta, ose në rastin më të mirë, mund të shohin pamjet e disa prej tyre në televizor. Dhe themi: "Sa turp! Dikush

me të vërtetë duhet të bëjë diçka për këtë" dhe pastaj vazhdojmë të pimë kafën e mëngjesit dhe shijojmë pamjen nga dritarja.

Aty ku Mbeturina Është Thesar

Një vajzë e vogël dhjetë vjeçare, e quajtur Gchi, jeton tek vendi i grumbullimit të plehrave në Kamboxhia. Ajo shkoi të jetojë atje kur ishte katër vjeç. Prindërit nuk mund ta ushqenin dot më ndaj i kërkuan motrës së saj të madhe ta merrte me vete. E vetmja mënyrë se si dy motrat mund të mbijetonin ishte duke punuar tek plehrat. Gchi kalon shtatë ditë të javës duke gërmuar në plehra me një shkop metalik ose me duar, duke kërkuar për mbetje ushqimore ose sende plastike apo shishe që mund t'i shesë për pak para për ushqime. Ajo ka jetuar në këtë vend për gjashtë vjet; shumë të tjerë kanë qenë aty për një kohë akoma dhe më të gjatë.

Është jetësore të kuptoni se ky është *qyteti plehrave* dhe se çdo natë që makinat e plehrave vijnë aty për të hedhur mbeturinat e jetëve të njerëzve të tjerë rreth e qark vendit. Fëmijët punojnë natën, në errësirë, duke vënë në kokë kaska me dritë, sepse mbeturina më e mirë mund të gjendet kur sapo vjen e "freskët".

Pas vizitës sime në atë vend mbeturinash, një intervistues më pyeti se çfarë mendoja për këtë situatë. Ndërsa po mundohesha të artikuloja mendimet, kuptova se situata ishte kaq e tmerrshme, saqë nuk dija çfarë duhej të mendoja. Mendja ime thjesht nuk arrinte të perceptonte thellësinë e degjenerimit në atë masë sa ta shprehte me fjalë. Por vendosa të përpiqesha të bëja diçka për këtë gjë.

U desh rreth një vit përpjekje që disa njerëz ta adresonin këtë çështje dhe të kërkonim donacione nga partnerët e shërbesës sonë, si edhe disa prej financave personale nga Dave-i dhe unë. Kështu arritëm të transformonim dy autobusë të mëdhenj në restorante

lëvizës. Autobusët shkojnë në vendin ku hidhen plehrat; fëmijët hipin në të, ulen për një vakt të këndshëm dhe madje marrin edhe disa mësimë leximi e matematike që të përgatiten për një të ardhme më të mirë. Natyrisht, ne ndajmë dashurinë e Jezusit me ta, por nuk u *themi* thatë se i duam; ne ua *tregojmë* dashurinë duke ua plotësuar nevojat praktike të jetës së përditshme.

Qëllimet e Mira Nuk Mjaftojnë

Kam dëgjuar një histori për një njeri që vajti në Rusi me qëllimin e mirë për t'u treguar njerëzve për dashurinë e Jezu Krishtit. Gjatë vizitës së tij, shumë njerëz po vdisnin urie. Kur gjeti një radhë njerëzish që po prisnin me shpresë për të marrë bukën e ditës, ai iu drejtua me trakte ungjillizuese në dorë dhe filloi të ecte përgjatë radhës duke u thënë se Jezusi i donte dhe duke u dhënë trakte me mesazhin e shpëtimit. Sigurisht që po përpiqej t'i ndihmonte, por një grua e pa në sy dhe i tha me hidhërim: "Fjalët e tua janë të këndshme, por ato nuk e mbushin stomakun tim të uritur".

Kam kuptuar se disa njerëz janë tepër të lënduar për të dëgjuar lajmin e mirë se Perëndia i do; ata duhet ta përjetojnë këtë dashuri, dhe një nga mënyrat më të mira që kjo të ndodhë është që ne përveç se t'i themi se i duam, t'u plotësojmë edhe nevojat praktike.

Ne duhet të jemi të kujdesshëm kur mendojmë se fjalët janë të mjaftueshme. Pa dyshim që Jezusi e predikoi lajmin e mirë, por Ai

Ne duhet të jemi të kujdesshëm kur mendojmë
se fjalët janë të mjaftueshme.

gjithashtu bëri të mira dhe shëroi të gjithë ata që ishin të shtypur (shih Vep. 10:38). Të flasësh nuk kushton dhe as nuk kërkon shumë përpjekje, por dashuria e vërtetë është e kushtueshme. Ajo i kushtoi

Perëndisë birin e Tij të vetëm dhe, nëse e lejojmë dashurinë e vërtetë të rrjedhë nëpërmjet nesh, do të na kushtojë edhe ne. Ndoshta do të na duhet të investojmë kohë, para, përpjekje ose prona-por do të na kushtojë!

Perëndia Pret prej Nesh

Pas pak, do të largohem nga shtëpia për të pirë kafe me bashkëshortin tim dhe më pas do të shkojmë së bashku për të ngrënë drekë. Do të largohemi për rreth dy orë dhe gjatë kësaj kohe rreth 240 fëmijë do të jenë rrëmbyer për t'u përdorur në industrinë e trafikimit seksual. Kjo do të thotë se nëse nuk bëjmë asgjë, në çdo minutë që kalon, dy fëmijëve do t'u shkatërrohet jeta përshkak të egoizmit dhe lakmisë së dikujt. Çfarë mund të bëjmë? Ne mund të shqetësohemi; mund të informohemi; mund të lutemi dhe mund të ndërmarrim veprime. Ne mund të përkrahim shërbesa dhe organizata që kanë vërtetuar se shpëtojnë fëmijë dhe gra nga kjo gjendje e tmerrshme. Nëse Perëndia na e kërkon, ne edhe mund të zgjedhim të punojmë në arena të tilla. Nëse puna me kohë të plotë nuk është e mundur, mund të konsiderojmë të bëjmë diçka në baza projektesh ose me anë të udhëtimeve misionare afat-shkurtra.

Sklavëria e Seksit

Ndërsa ecni në rrugicën e errët, shenjat e degradimit dhe të shkatërrimit depërtojnë errësirën. Copëzat metalike dhe rrjetat e telit mbajnë së bashku ndërtesat e rrënuara prej guri. Ajri kutërbon erë mbeturinash të prishura dhe papastërti njerëzish. Prapa fasadave të dëmtuara, dëgjoni qarjet vajtuese të një

fëmije, ulërimat e mbytura të zemërimit dhe tërbimit dhe piskamën e mprehtë të një prej shumë qenve endacakë që endet në këto rrugë mizore.

Më shumë se çdo ndjenjë tjetër, ju jeni të sigurt për atë që ndjeni. Nuk ka dyshim . . . ky vend është i lig. Pavarësisht sa e vështirë është ta imagjini, ky është një vend i krijuar nga njerëz të ligj dhe imoralë të cilët i shesin fëmijët për seks.

Ky ferr i gjallë u bë shtëpia e Samrauorkës kur ishte vetëm shtatë vjeç. Kur u shpëtua në stacionin e autobusit në moshën dymbëdhjetë vjeçare, ajo ishte shndërruar në një skelet pa jetë të një vajze të vogël; kockë e lëkurë, emocionalisht e vdekur dhe me sy të zgavërt e pa jetë. Për pesë vjet me radhë ajo ishte viktimë e epshit të perversëve të cilët paguanin një çmim më të lartë për të patur privilegjin të dhunonin trupin e saj të vogël. Ata paguanin tre dollarë në vend të një dollari për shkak të moshës së saj të re.

Dëmtimi i organeve të saj femërore ishte kaq i rëndë, sa që asaj i duheshin rregullime të shumta kirurgjikale që të mund të jetonte një jetë normale. Por dëmtimet e saj fizike nuk mund të krahasoheshin me ato shpirtërore dhe emocionale.

Samrauork është diagnostikuar me virusin HIV. Ajo është jetime dhe nuk ka asnjë kujtim të prindërve të saj. Si shumë të tjerë, ajo ka ngecur në errësirën e një të keqeje të paimagjinueshme.

Statistikat¹ thonë se:

- 1.2 milionë fëmijë trafikohen çdo vit; kjo shifër u shtohet milionave të tjerë që mbahen tashmë si robër nga trafikimi.
- Çdo dy minuta një fëmijë përgatitet për shfrytëzim seksual.
- Afërsisht 30 milionë fëmijë kanë humbur fëmijërinë e tyre nga shfrytëzimi seksual gjatë tridhjetë viteve të fundit.

Dentisti që ju përmenda më parë në këtë kapitull, mori pjesë në një prej shërbesave tona mjekësore të cilat bëhen në vendet e botës së tretë. Stafi i tyre përbëhet prej pak njerëzish me pagesë, ndërkohë që shumica janë vullnetarë të mrekullueshëm që marrin pushimet vjetore nga puna dhe i paguajnë vetë shpenzimet e tyre për të ardhur me ne. Ata punojnë dymbëdhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë orë në ditë, zakonisht në vende ku temperaturat janë shumë të larta, pa ajër të kondicionuar dhe ndoshta edhe pa freskuese. Ata punojnë në fshatra të largëta, në tenda, dhe arrijnë të ndihmojnë njerëz të cilët mund të mos kenë marrë kurrë më parë përkujdesje mjekësore. Ne mund t'u japim ilaçe qetësuese për dhimbjet dhe jetë-shpëtuese. U japim vitamina, i ushqejmë dhe u bëjmë të ditur se Jezusi i do me të vërtetë. Secilit prej tyre i jepet mundësia për të pranuar Jezusin dhe shumë prej tyre zgjedhin ta pranojnë. Përlotem kur kujtoj doktorë, dentistë, infermiere dhe ndihmës të tjerë mjekësorë që na kanë treguar me emocione të forta se si këto udhëtime u kanë ndryshuar jetën përgjithmonë. Ne përpiqemi t'i falënderojmë, por janë ata që na falënderojnë se ndihmuam të shihnin cili është kuptimi i vërtetë i jetës.

Ne morëm një llogaritare, e cila punon për shërbesën tonë, në një udhëtim në Kamboxhia dhe ndonëse ajo shpesh i shikon prezantimet televizive rreth shërbesave tona, jeta e saj u prek realisht nga çfarë pa me sytë e saj. Ajo tha: "Ndjehem sikur gjithë jetën kam jetuar brenda një flluske". Çfarë dëshironte të thoshte ishte se kishte qenë e izoluar nga realiteti dhe mendoj se shumë prej nesh janë kështu. E kuptoj se jo të gjithë do të mund të shkojnë në një vend të botës së tretë për të parë me sytë e tyre se në ç'gjendje jetojnë njerëzit atje. Por të paktën mund të përpiqemi të kujtojmë, kur lexojmë apo i shikojmë ata në televizor, se ajo që po shikojmë, vërtetë po i ndodh dikujt-madje shumë njerëzve. Perëndia i do ata dhe Ai po mbështetet në ne për të bërë diçka për këtë gjë.

Kequshqyerja

Mehrete e shikon botën nga një këndvështrim tjetër. Në Angaç, një fshat i vogël i Etiopisë, ajo bën gjithçka mundet për të qenë si fëmijët e tjerë, por ajo nuk është si gjithë të tjerët.

Mehrete u lind e shëndetshme por çdo ditë kequshqyerja ia treti trupin, ia kërrusi shpinën duke e bërë të vështirë ecjen e të pamundur vrapimin dhe lojën me shokët. Gjithashtu i shkaktoi një gungë të madhe në anën e djathtë të shpinës; tepër e madhe për t'u fshehur dhe tepër e dhimbshme për t'u injoruar. Kockat e saj janë të dobëta dhe kështu ndjehet edhe ajo.

Nëse ka njeri që e njeh mirë dhimbjen e Mehret-es, ai është babai i saj, Abeba. Gjëja që ai do më shumë se çdo gjë tjetër, është të ushqejë fëmijët e tij . . . dhe ta shërojë vajzën e tij të çmuar. Nëse Mehret mund të fillojë të marrë ushqimin e nevojshëm, procesi i shtrembërimit mund të ndalojë. Por tani për tani, ajo nuk sheh asnjë shpresë.

Ditë pas dite, Abeba lufton me ndjenjën e fajit se nuk mund t'i ushqejë të vegjlit e tij. Ai e di gjithashtu se, nëse asgjë nuk ndryshon, gjendja e Mehret-es vetëm do të përkeqësohet. Shumë shpejt ajo nuk do të jetë në gjendje të ecë dhe përfundimisht do të vdesë.

Sot, Mehretja e njeh dhimbjen e të qenit e uritur . . . dhe dhimbjen e të qenit ndryshe nga gjithë të tjerët. Ajo e di se çdo ditë e re do të jetë pak më e vështirë se e mëparshmja.

Në partneritet me International Crisis Aid, Joyce Meyer Ministries ka filluar t'i sigurojë Mehretes ushqimin e nevojshëm për të jetuar dhe për të ndaluar shtrembërimin e mëtejshëm të shpinës. Por ka kaq shumë fëmijë të tjerë të çmuar . . .

shumë të tjerë si Mehretja . . . të cilët kanë nevojë për ndihmën tonë për të fituar këtë luftë kundër kequshqyerjes.

Statistikat² thonë se:

- Sot, rreth 963 milionë njerëz në botë janë të uritur.
- Çdo ditë, pothuajse 16,000 fëmijë vdesin nga shkaqe të lidhura me urinë-një fëmijë për çdo pesë sekonda.
- Në 2006, rreth 9.7 milionë fëmijë vdiqën para se të arrinin ditëlindjen e tyre të pestë. Pothuajse të gjitha këto vdekje kanë ndodhur në vende në zhvillim-katër të pestat e tyre në Afrikën sub-Saharane dhe në Azinë Jugore; dy rajonet që vuajnë gjithashtu nga përqindjet më të larta të njerëzve të uritur dhe të kequshqyer.

Një Krisje në Themelet e Botës

Mua më duket se sistemi botëror ka një krisje në themelet e tij dhe të gjithë ne jemi ulur me përtaci dhe po shohim se si po shkatërrohet. Nëse dëgjoni me kujdes, do t'i dëgjosh njerëzit kudo të thonë: "Bota po shkatërrohet". E dëgjojmë tek lajmet dhe në biseda të përgjithshme. Duket se të gjithë flasin për padrejtësinë në botë. Por bisedat pa veprime nuk zgjidhin asgjë. Pyetja ime është: "Kush do të revoltohet kundër padrejtësisë dhe t'i kthejë për mirë gjërat e gabuara?" Unë kam vendosur të jem e tillë. Njoh mijëra të tjerë që kanë vendosur të bëjnë të njëjtën gjë, por me ne duhet të bashkohen qindra mijëra në mënyrë që të përmbushim këtë detyrë.

Çfarëdo që Mund të Bëni ia Vlen të Bëhet

Ju mund të jeni duke menduar, Joyce, *ajo që unë mund të bëj nuk do të lërë asnjë gjurmë në problemet që kemi në botë*. E di si ndjeheni sepse edhe unë kam ndjerë të njëjtën gjë dikur. Por, nëse të gjithë mendojmë ashtu, askush nuk do të bëjë gjë dhe asgjë nuk do të ndryshojë. Ndonëse përpjekjet tona individuale mund të mos i zgjidhin problemet, së bashku ne mund të bëjmë një ndryshim madhor. Perëndia nuk do të na mbajë përgjegjës për çfarë nuk mund të bënim, por Ai do të na mbajë përgjegjës për gjërat që mund të kishim bërë.

Sapo isha kthyer nga një udhëtim nga India dhe isha në palestër kur një grua që e shoh shpesh atje, më pyeti se nëse me të vërtetë besoja se të gjitha përpjekjet që duheshin për këto udhëtime po zgjidhnin ndonjë gjë sepse miliona njerëz vazhdonin të vuanin nga uria pavarësisht sa shumë ne ushqenim. Unë ndava me të çfarë Perëndia kishte vënë në zemrën time-diçka që e kishte rregulluar përgjithnjë këtë çështje për mua. Nëse ju apo unë do të ishim të uritur sepse nuk kishim ngrënë për tre ditë dhe dikush të na ofronte një vakt që do të na lehtësonte dhimbjen e stomakut për një ditë, a do ta merrnim dhe a do të gëzoheshim? Natyrisht që po. Kështu ndihen edhe njerëzit që ne ndihmojmë. Ne jemi në gjendje të ngremë programe të vazhdueshme përkujdesëse për shumë prej tyre, por gjithmonë do të ketë nga ata njerëz që do të mund t'i ndihmojmë vetëm një ose dy herë. Por, megjithatë, unë e di se këto shërbesa janë të vlefshme. Nëse mund t'i japim një fëmijë të uritur një vakt, ia vlen. Nëse mund të ndihmojmë një person t'i largohet dhimbja për një ditë, ia vlen. Unë kam vendosur që gjithmonë të bëj atë që kam mundësi të bëj dhe të kujtoj atë që Perëndia më ka thënë: "Nëse mund t'ia largosh dhimbjen dikujt, një herë, për një orë, përsëri ia vlen".

Bota Ka Humbur Shijen e Saj

Mendoj se është e saktë të themi se shumica e asaj që bota ofron është pa shije-dhe nuk po flas për ushqime. Për shembull, shumica e filmave që prodhon Hollywood-i janë krejtësisht pa shije. Një pjesë e mirë e dialogëve dhe shumë prej imazheve vizuale janë me shije të dobët. Zakonisht, kur shohim ndonjë lloj sjelljeje që ka shije të dobët, jemi të shpejtë të fajësojmë "botën". Mund të themi "Ku ka përfunduar kjo botë?". Megjithatë termi "botë" thjesht nënkupton njerëzit që jetojnë në të. Nëse bota e ka humbur shijen, kjo ka ndodhur sepse njerëzit nuk kanë më shije në qëndrimet dhe veprimet e tyre. Jezusi tha se ne jemi kripa e botës, por nëse kripa e humb shijen (fuqinë dhe cilësinë), nuk është e mirë për asgjë (shih Mt. 5:13). Ai gjithashtu tha se ne jemi drita e botës dhe se nuk duhet ta fshehim këtë dritë (shih Mt. 5:14).

Mendojeni në këtë mënyrë: Çdo ditë, ndërsa e lini shtëpinë për të shkuar në një botë të errët dhe pa shije, ju mund të jeni drita dhe shija për të cilën bota ka nevojë. Ju mund të sillni gëzim në vendin tuaj të punës duke qenë të vendosur të mbani vazhdimisht një qëndrim të perëndishëm. Nëpërmjet gjërave të thjeshta si: duke qenë mirënjohës dhe jo ankues siç bëjnë shumica e njerëzve, duke qenë të duruar, të mëshirshëm, të shpejtë për të falur fyerjet, të dashur dhe inkurajues. Edhe thjesht buzëqeshja dhe të qenit miqësor është një mënyrë për të sjellë shije në një shoqëri pa shije.

Nuk e di për ju, por mua nuk më pëlqejnë ushqimet pa kripë. Bashkëshorti im pati një herë probleme me stomakun dhe doktori e vuri në një dietë pa kripë për disa ditë. Me sa mbaj mend, ai nuk e priste fare me qejf ushqimin. Dave nuk është ankues, por në çdo vakt, e dëgjoja të thoshte vazhdimisht: "S'ka pikë shije!" I duhej pak kripë, pak erëza-dhe kjo është pikërisht ajo për të cilën bota ka nevojë.

Pa dashurinë dhe gjithë cilësitë e saj e mrekullueshme, jeta është

pa shije dhe nuk ia vlen të jetohet. Dua që ju të provoni një eksperiment. Thjesht mendoni: *Sot, do të dal në botë dhe do t'i hedh erëza gjërave*. Pastaj, ndajeni mendjen para se të dilni nga dera se ju po dilni si ambasador i Perëndisë dhe se qëllimi juaj është të jepni, t'i doni njerëzit dhe t'i shtoni shije jetës së tyre. Mund të filloni duke u buzëqeshur njerëzve që takoni gjatë ditës. Buzëqeshja është simbol i pranimit dhe aprovimit, gjë për të cilën kanë nevojë shumica e njerëzve në botë. Dorëzojani veten Perëndisë dhe besoni se Ai do të kujdeset për ju ndërsa mbillni farën e mirë kudo që shkoni duke marrë vendime që janë bekime për të tjerët.

Ndryshimi Fillon me Ju

Unë e kuptoj se ju nuk mund të bëni gjithçka; nuk e vë fare në dyshim. Duhet t'i thoni jo disa gjërave, ndryshe jeta juaj do të jetë mbushur me stres. Unë nuk jam e aftë të dal vullnetare për të mbikëqyrur fëmijët apo të ndaj ushqim për të moshuarit, por po bëj shumë gjëra të tjera për të sjellë një ndryshim pozitiv në botë. Mendoj se pyetja që gjithsecili prej nesh duhet t'i përgjigjet është "Çfarë po bëj për të përmirësuar jetën e dikujt tjetër?" Ndoshta një pyetje më e mirë është "Çfarë kam bërë sot për të përmirësuar jetën e dikujt tjetër?"

Me raste, ky libër mund të jetë i vështirë për t'u lexuar sepse shpresojmë të ngrejë çështje të parehatshme. Por këto çështje duhen

Asgjë e mirë nuk ndodh rastësisht. Nëse duam të jemi pjesë e një revolucioni, kjo do të thotë se gjërat duhet të ndryshojnë, dhe gjërat nuk mund të ndryshojnë nëse njerëzit nuk ndryshojnë. Secili prej nesh duhet të thotë:

Ndryshimi fillon me mua!

trajtuar prej gjithsecilit prej nesh. Asgjë e mirë nuk ndodh rastësisht. Nëse duam të jemi pjesë e një revolucioni, kjo do të thotë se gjërat duhet të ndryshojnë, dhe gjërat nuk mund të ndryshojnë nëse njerëzit nuk ndryshojnë. Secili prej nesh duhet të thotë: Ndryshimi fillon me mua!

REVOLUCIONARIA E DASHURISË

Darlene Zschech

Udhëtimi i zemrës është një prej mistereve më të ndërlikuara që ekziston. Ngazëllimi dhe hidhërimi, shpresa dhe pritja, momentet e larta dhe ato të ulëta ... dhe mjerisht për shumë njerëz, zhgënjimi i patreguar e çon zemrën në atë pikë ku ajo rreh por nuk dëshiron të ndjejë më asgjë. Kur dikush nuk e kupton dashurinë madhështore të Perëndisë, në të cilën mund të mbështetet dhe të gjejë forcë, atëherë zemra e tij gjen një mënyrë tjetër për të përballuar, administruar dhe mbijetuar edhe realitetet më të ashpra. Dhe kjo është pika ku një numër i madh njerëzish e gjejnë veten sot, nga më i pasuri tek më i varfri, sepse varfëria e zemrës nuk diskriminon vendin ku ajo zgjedh ta ngrejë folenë.

Profeti Isaia foli për një revolucion rrënjësor dashurie tek Isaia 6:11. Aty Fjala përshkruan ditën kur dashuria do të duket tek njerëzit ndërsa ata gjejnë drejtësinë e tyre të nevojshme ... dhe Jezusin që hap një rrugë përmes shkretëtirës. "Prandaj [me siguri], ashtu si toka bën që të rritet bimësia e saj dhe kopshti bën që të mbijë atë që është mbjellë, po kështu [me siguri] Zoti, Zoti, do të bëjë që të mbijë drejtësia dhe lëvdimi përpara tërë kombeve [nëpërmjet fuqisë vetë-përmbushëse të fjalës së Tij]."

Një Revolucion Dashurie nuk është vetëm një ide madhështore, por një koncept urgjence të plotë ... sidomos nëse besojmë se do të shohim që padrejtësitë tragjike që ndodhin sot në Tokë do të përmbysen krejtësisht ... duke përfshirë dhe tragjedinë më të rëndë, tragjedinë e zemrës së thyer të njerëzimit.

Zemërthyerja na tërheq vëmendjen vazhdimisht si në imazhet e një nëne të re që ushqen me gji foshnjën e saj, ndërkohë që trupi i

saj është i sëmurë dhe i rrënuar nga HIV/SIDA. Ajo po bën më të mirën e mundëshme por përballet me zgjedhjen ... a ta ushqejë fëmijën dhe me vetëdije ta infektojë atë me këtë sëmundje vdekjeprurëse, apo ta shohë fëmijën të vdesë urie nga mungesa e ushqimit alternativ? Zemra e kësaj nëne është tejet e thyer. Ajo është një nënë tamam si unë, e mbushur me kënaqësi kur i jepet mundësia të shohë fëmijën të lulëzojë nën kujdesin e saj.

Të shohësh burra dhe gra të reja që qëndrojnë rreth e qark, pa ushqim, pa ujë, që s'kanë ku të shkojnë dhe asgjë për të bërë, është zemër-thyes në kulm dhe i mbush zemrërat me zhgënjim të vazhdueshëm. Zemrat dhe mendjet e tyre janë plot me ëndrra të panumërta, por ah sikur të mund të gjenin një mënyrë për të vazhduar shkollën dhe për të blerë diçka për të ngrënë.

Është e mahnitshme se si dëshpërimi i shtyn njerëzit të veprojnë, duke shkaktuar lëndime të mëtejshme dhe dhunë ekstreme ndaj njëri-tjetrit ... sa pa vlerë u duket jeta e një njeriu kur përballen me varfëri ekstreme të vazhdueshme. Por vjen një pikë kur zemra nuk mund të mbajë më.

Një djalë katërmëdhjetë vjeçar po rrit vëllain, motrën dhe nipin e tij, të tre më të vegjël se ai vetë, në një kasolle të vogël të mbuluar me teneqe, të cilën e quajnë shtëpi, në Afrikën e Saharasë së Poshtme. Ai punon gjithë ditën në një fermë të vogël drithërash duke u përpjekur në mënyrë të dëshpëruar t'i çojë të gjithë në shkollë, duke përfshirë edhe veten e tij, si dhe të gjejë diçka për të ngrënë për të gjithë. Prindërit e tij vdiqën për shkak të HIV dhe qyteti i përjashtoi fëmijët nga frika se edhe ata mund të kishin të njëjtën sëmundje. Shanset janë të larta dhe ata akoma duhen testuar. Ky katërmëdhjetë vjeçar, jashtëzakonisht i guximshëm në zemër, sa vjen e bëhet më i brishtë për shkak të punës së rëndë, sëmundjes dhe pasigurisë së pamëshirshme.

Një nënë e re në Sindej të Australisë, që e ia ka përkushtuar jetën bashkëshortit dhe fëmijëve, zbuloi se bashkëshorti kishte muaj

të tërë që e tradhtonte dhe dëshiron të martohet me "tjetrën". Kjo grua ndjehet e izoluar, e zhvlerësuar, e poshtëruar dhe tani i duhet të përballlet me një të ardhme jo vetëm pa bashkëshortin por edhe shumë ditë pa fëmijët, sepse ai po lufton për të drejtat e tij të kujdestarisë. Zemra e saj është kaq e thyer saqë mezi merr frymë dhe nuk mund të shohë rrugën përpara.

Më kujtohet njëherë kur isha ulur në periferi të Ugandës me një drejtuese të jashtëzakonshme të një prej programeve të mrekullueshëm të sponsorizimit të fëmijëve, dhe ndërsa flisnim, ajo filloi të tregonte se ndonëse po bëhej shumë për të shpëtuar jetimët në atë rajon, numri i fëmijëve që gjenin pa mjete mbijetese ishte dërrmues. U ngrita dhe fillova t'i bëj masazh shpatullave të saj të lodhura ndërsa vazhdonte të fliste për zemrën e thyer dhe stresin e saj të madh dhe shumë shpejt fjalët u kthyen në dënësë. Vite të tëra të jetuari duke shtrydhur çdo fije energjie e leku në maksimum e prapë të shihte e dëgjonte se si fëmijët vazhdonin të shkonin në shtrat të uritur dhe të vetmuar ia kishin rraskapitur shpirtin.

Historitë mund të vazhdojnë që këtu e deri në përjetësi, për njerëz që luftojnë për të mbijetuar, nga thellësitë e Afrikës deri tek Azia e mbipopulluar, nga SHBA deri në Oz. Duket se kudo që hedh sytë, gjenden mure të mëdha zemërthyerjeje të pakapërcyeshme, që madje megjithë kamionët e mbushur me pako ushqimore dhe vaksina imunizimi, me këshillues dhe mbështetje nga komuniteti, ne kemi nevojë për shumë më tepër për të thyer këtë cikël të pabesë. Një REVOLUVION DASHURIE ... këtu e gjejmë misionin e jetës sonë.

Luka 4 dërgon një mesazh, fortë dhe qartë:

Fryma e Zotit është mbi mua, SEPSE

Ai më vajosi për të ungjillëzuar të varfrit;

Ai më dërgoi për të shëruar ata që e kanë zemrën të thyer,
për të shpallur çlirimin e të burgosurve dhe kthimin e të parit

të verbërve, për të dërguar në liri të shtypurit, dhe për të predikuar vitin e pranueshëm të Zotit (shih Luka 4:18-19).

Sa herë që e lexoj dhe rilexoj këtë pasazh, kujtohem të jem e përqendruar dhe e qartë në përpjekjet tona për të ngritur jetët e të tjerëve ... nga gjesti më i vogël deri në skemat më të mëdha ... sepse kjo është koha jonë për t'u ngritur, për të dalë nga gjendja ekzistuese, nga jeta tërësisht e rehatshme për veten për të bërë ç'është e mundur për vëllezërit dhe motrat tona në nevojë përqark tokës.

Ka një fjalë madhështore që është vërtetë një prej fjalëve më të fuqishme që dashuria sjell në jetë ... dhe kjo fjalë është SHPRESE. Fjala thotë ... kjo shpresë që ne kemi është si një spirancë e sigurt dhe e patundur për shpirtin (shih Heb. 6:19) ... dhe Psalmi 39:7 thotë ... "Por tani, o Zot, çfarë pres? Shpresa ime është te ti". Shpresa është gjithmonë e gjallë edhe kur situata është e zymtë ose në dukje e pamundur. Misioni ynë është t'ua sjellim këtë shpresë, së bashku me besimin dhe dashurinë, njerëzve të lënduar.

Zemra ime është tendosur dhe sfiduar deri në rraskapitje duke u përpjekur të gjejë përgjigje për ata që janë në mes të disa prej mjediseve më të keqguditura nga varfëria, por mrekullisht, ndërsa uleni midis atyre që nuk kanë asgjë dhe ku situatat duken të pashpresa, ndjeni një prani të fuqishme të hirit të PERËNDISË që gjendet tamam mes këtyre njerëzve të mrekullueshëm. Edhe ndërsa luftojnë dhe sforcohen të vazhdojnë udhëtimin e mbijetesës, Perëndia shkëlqen përsëri përpara. Unë kam gjetur shumë "të burgosur të shpresës" siç thotë Zakaria 9:12 (MË PËLQEN SHUMË KY MENDIM) ... që shumë thjeshtë por me gjithë zemër besojnë dhe e DINË se vetëm Perëndia është përgjigjja dhe siguresi i tyre.

Objekti im, për ta dashur Zotin dhe për ta adhuruar Atë me gjithë jetën time, është prioriteti më i lartë në jetën time frymërore ... ta kërkosh, ta duash dhe t'i shërbesh Atij. Të mësosh rëndësinë e

jetës në adhurim, vlerën e pranisë së Tij dhe hirin e Tij të mrekullueshëm është një dhuratë e papërshkrueshme dhe me siguri do të duhet e gjithë përjetësia për të shprehur një FALENDERIM të përshtatshëm për gjithçka që Ai ka bërë dhe vazhdon të bëjë. Një prej mësimëve më të mëdha që jam përpjekur të rrënoj në thellësi të zemrës është disiplina e stërvitur për të patur një këngë besimi dhe lartësim për Jezusin në mes të betejës. Por, mësimi i vazhdueshëm është të kuptoj se çfarë më tepër kërkon Zoti nëpërmjet adhurimit. Vazhdimisht dëgjoj rrahjen e zemrës së Tij nëpër Shkrime që na mëson se adhurimi është shumë më tepër se këngët që këndojmë; janë jetët që derdhen para tij, të zjarra për të qenë duart dhe këmbët e Tij në planet.

Shumë vite më parë, vizitova disa fëmijë të bukur afrikanë në një strehë për të sëmurët nga SIDA. Ata ishin të gjithë jetimë, e megjithatë ishin të mbushur me entuziazmin e njerëzve që kanë SHPREË. Ata u ngritën dhe kënduan për mua këngën ... GJITHÇKA ËSHTË E MUNDUR, këngë e cila më sfidoi dhe më frymëzoi ndërsa zërat e tyre të vegjël e mbushën atmosferën me jetë dhe me gëzim. Ishte një moment i paharrueshëm dhe një kujtesë e paharrueshme mbi fuqinë e FJALËS së Perëndisë në jetët tona.

Hebrenjtë 13:15 thotë: "Me anë të Jezusit, pra, le t'i ofrojmë vazhdimisht Perëndisë një flijim lavdie, domethënë frytin e buzëve që rrëfejnë emrin e tij". Vargu 16 vazhdon duke thënë: "Dhe mos harroni të bëni bamirësi dhe t'u jepni ndihmë të tjerëve, sepse Perëndisë i pëlqejnë flijime të tilla".

Të këndosh një këngë të perëndishme, të bashkohesh në himnin madhështor të përjetësisë, është një prej gëzimeve më të mëdha këtu në Tokë. Duke u fuqizuar, ne mbushemi në praninë e Tij për të jetuar Urdhërimin e Madh ... mbushemi me duart zgjatur drejt qiellit ... atëherë në një pozicion të gatshëm për të ndihmuar me duart tona. Ashtu si ka thënë Augustini: "Jetët tona duhet të jenë HALELUJA, NGA KOKA DERI TEK KËMBËT".

Megjithatë, adhurimi me këngë është vetëm një pikë fillimi kur bëhet fjalë për atë që krijuesi i qiellit dhe i Tokës kërkon. Ne udhëzohemi mbi dyzet herë të këndojmë këngë të reja, madje akoma më shumë ftohemi të sjellim oferta dhe bindje të kushtueshme para Zotit. Por, ka rreth 2000 referenca për t'u përfshirë aktivisht ndërsa JETËT tona paraqiten si ofertë, duke u kujdesur për ata që vuajnë në fusha të ndryshme të jetës. Sidoqoftë, është mirë të kujtohesh se pa lutje dhe meditim mbi Fjalën e Perëndisë, dhe pa ato momente të ëmbla e shushatëse të një marrëdhënie të thellë me Krishtin ... veprat tona të shërbimit, mund të kthehen lehtësisht në "vepra të mishit" (të egos) me qëllimin që vëmendja të bjerë tek ne, dhe jo tek ata të cilëve u shërbejmë.

Adhurimi i kryer me vullnet e vendos padyshim zemrën tuaj të përballët, të dorëzohet dhe të shndërrohet në praninë e Tij. Meqenëse i gjithë ky udhëtim i ecjes së krishterë është udhëtim i zemrës, atëherë mund ta kuptoni se, të mësosh të ADHUROSH me gjithçka që je është një hap tejet i rëndësishëm në këtë proces. Perëndia ka dëshiruar gjithmonë VËRTETËSI në lidhje me shërbimin ndaj Tij ... dhe e vërteta përcaktohet në zemrën tënde. Ja përse përkujdesja dhe mirëqenia e zemrave tona ka rëndësi parësore për Zotin.

"Ruaje zemrën tënde me shumë kujdes, sepse
nga ajo dalin burimet e jetës"
(*Fjalët e Urta 4:23*)

Kurrë nuk do ta harroj nxitjen që pastor Bill Hybels, nga Willow Creek Community Church, pranë Çikagos, na dha disa vite më parë, kur tha se si të krishterë dhe drejtues, nuk është e mjaftueshme të flasim mbi padrejtësinë dhe të shohim DVD rreth saj. Ai tha se ne duhet ta lejojmë varfërinë të na prekë, të na përfshijë ... në mënyrë që era dhe realiteti i luftës për mbijetesë të na kthehen në një ndjenjë që nuk do ta harrojmë kurrë, dhe që jo thjesht të dërgojmë financa

dhe të ndjehemi se e kemi bërë pjesën tonë. Por të thirrëmi në veprim nga dashuria e madhe e Perëndisë - që të ndajmë dashurinë e jetën e Tij dhe të besojmë se Ai siguron një rrugë, ky është udhëtimi në të cilin jemi thirrur të ecim. Dhe ky është vendi ku dashuria jonë në veprim, adhurimi me jetën tonë vihen në lëvizje.

"Dhe kushdo që e pranon një fëmijë të vogël si ky
në emrin tim, më pranon mua"
(Mateu 18:5)

"Kush do të kujdeset për fëmijët e mi?"-thërret një nënë që është duke vdekur, duke ditur se shumë shpejt fëmijët e saj do t'u bashkohen milionave të tjerë nëpër botë që kërkojnë një nënë tjetër. Kam parë miq që vuanin nga kanceri të bënin të njëjtën pyetje. Nuk mund të mendoj ndonjë thyerje tjetër më të madhe të zemrës, apo një rënkim më të thellë të shprehur në momentet më të errëta. Dua të bërtas dhe t'i them asaj: "NE DO TË KUJDESEMI!". Pa dyshim kjo është një fushë ku ne duhet të përveshim mëngët, të gëlltitemi fort, të lutemi e të BESOJMË dhe të ecim me besim. Nuk është e thënë të jetosh në vendet e botës së tretë për të gjetur jetimë që kanë nevojë për një familje, apo njerëz të vetmuar që kërkojnë miqësi; çdonjëri prej nesh jeton në qytete ku fëmijët vërtiten nëpër sistemet qeveritare të cilat përpiqen të bëjnë më të mirën e mundshme për të përmbushur një nevojë që ne, Kisha, mund të ndihmojmë ta përmbushim.

Unë e dua Kishën ... ajo është kaq e shumëllojshme dhe me të vërtetë po ngrihet mbi planet me një ndjenjë të re vetëbesimi dhe shkëlqimi. Por, Kisha është në më të mirën e saj kur, së pari dhe mbi të gjitha, dëshiron Perëndinë, me gjithçka që ajo është ... dhe kur ajo qëndron me krahët hapur për t'i shërbyer komunitetit të lënduar dhe botës së thyer, duke i lidhur njerëzit me Jezusin dhe gjithçka që kjo përfshin. Jo duke gjykuar apo kritikuar të varfrit, por

thjesht duke DASHUR ... dhe dashuria është e kushtueshme. Dashuria është folje ... jo emër. Së bashku, me të vërtetë mund të qëndrojmë në hendek për ata që nuk kanë zë ... për të dashur Zotin, Perëndinë tonë me gjithë zemrën, frymën, mendjen dhe fuqinë tonë ... DHE për të dashur të afërmit porsì vetveten. Me të vërtetë mahnitëse!

Pra, si mund ta ndalojmë këtë gjigant (në dukje) të shpresëhumbjes? Si mund t'ua hapin derën atyre që kanë ngecur në këtë burg të rrezikshëm?

ASNJË prej nesh nuk mund ta ndalojë vetëm. Edhe filantropët më inteligjentë dhe më të interesuar të botës kanë NEVOJË për njerëz të tjerë dhe për ekspertizën e grupeve të ndryshme të ekspertëve që punojnë së bashku për të mirën e përgjithshme, për të pasur përfitimin maksimal për shumicën më të madhe të njerëzve. Por ne na DUHET një fillim i ri; ne mund të sponsorizojmë një fëmijë, mund të jemi zëri për të përvuajturit në komunitetin tonë, mund të ndihmojmë në një farë mënyre në sistemin e birësimit (p.sh. përkujdesje në raste urgjencash, përkujdesje afatshkurtër ose afatgjatë, programet e shoqërizimit në fundjavë), mund të ngremë fonde për bamirësi ose për një nevojë që shqetëson zemrën tuaj. Merrni iniciativën në kishën tua dhe vëreni trupin e Krishtit në lëvizje, jetoni pak më thjesht-duke pasur parasysht që të jetojmë për të dhënë, jo vetëm për të shpenzuar ... lista nuk ka fund.

Njëllon e rëndësishme, le të sigurohemi se jeta dhe zemra jonë janë të mbushura dhe të gjalla për çdo mundësi që paraqitet përditë, qoftë kjo botërore apo lokale ... ashtu si te historia e Samaritanit të mirë, i cili shkoi përtej të zakonshmes dhe madje la edhe punët e veta për të dhënë ndihmë aty ku të tjerët panë dhe thjesht kaluan. Ky Samaritan u PREK nga dhembshuria ... dhe jo vetëm që u prek emocionalisht, por edhe u përgjigj me veprim.

Dhe më lejoni t'ju them, se nëse po kaloni një kohë kur ndjeheni se duhet t'ju shërbejnë, dhe jo të jeni ju ai që jepni, inkurajohuni.

Rrethojeni veten me një mjedis adhurimi dhe lavdërimi, mbusheni shtëpinë me muzikë që ju frymëzon zemrën, mbusheni makinën me disqe që kanë Fjalën e Perëndisë, rriini me familjen, kishën dhe bashkësinë ku e dini se do të ushqeheni dhe inkurajoheni ... dhe lejojini Frymën e Perëndisë t'ju mbushë vazhdimisht përbrenda. Nëse keni nevojë për shërim, ose për një bekim financiar, ose për një mrekulli në një marrëdhënie ... Perëndia ynë është i aftë ta bëjë. Lëshojeni veten në krahët e sigurtë të Zotit tonë, që është forca jonë, sepse Ai nuk do të të lërë dhe as do të të braktisë kurrë; të mbështetesh tek Ai është gëzimi dhe shpresa më e madhe që ju keni. Po ju lë me këtë kujtesë të madhe ... DUAJENI Zotin Perëndinë tuaj me gjithë zemrën, mendjen, shpirtin dhe fuqinë tuaj DHE duajeni të afërmin tuaj porsivetveten. JU ruheni si thesar dhe vlerësoheni shumë! Mos e harroni kurrë këtë!

Me gjithë zemër,
Darlene Z.

Udhëtimi i zemrës është një prej mistereve më të ndërlikuara që ekzistojnë-ngazëllimi dhe trishtimi, shpresa dhe pritja, dhe për shumë njerëz, zhgënjimi i patregueshëm që na bën të mos duam të ndjejmë më asgjë. Kur nuk e kuptojmë dashurinë e madhe të Perëndisë, që Ai na e ka dhënë për t'u mbështetur e për të gjetur forcë në të, zemrat tona gjejnë mënyra të tjera për të përballuar, menaxhuar, për të mbijetuar madje edhe në situatat më të vështira. Ky është vendi ku shumë njerëz gjenden sot, nga më të pasurit tek më të varfrit, sepse varfëria e zemrës nuk bën dallime kur kërkon të gjejë një shtëpi.

Ashtu siç na kujtoi edhe Darlene Zschech, profeti Isaia foli për një Revolucion Dashurie radikale tek Isaia 61:11, ndërsa përshkruan ditën kur dashuria do të bëjë që njerëzit të gjejnë drejtësinë që u takon dhe Jezusi do të bënte një rrugë të re përmes shkretëtirës: "Prandaj, ashtu si [me siguri] toka bën që të rritet bimësia e saj dhe

kopshti bën që të mbijë atë që është mbjellë, po kështu Zoti, ZOTI, do të bëjë që të mbijë drejtësia dhe lëvdimi përpara tërë kombeve [nëpërmjet fuqisë vetë-përmbushëse të fjalës së Tij]".

Më Shumë se Thjesht një Ide e Shkëlqyer

Revolucioni i dashurisë është jo vetëm një ide e shkëlqyer por edhe e nevojshme, nëse duam të shikojmë disa prej padrejtësive më të mëdha të botës sot të zhduken, përfshirë edhe tragjedinë më të rëndë - tragjedinë e zemrës së thyer të njerëzimit. Psalmi 27:3 thotë: "Edhe sikur një ushtri të dilte kundër meje, zemra ime nuk do të kishte frikë; edhe sikur një luftë të pëlciste kundër meje, edhe atëherë do të kisha besim". Kjo është ajo çka duhet të ndodhë në zemrat e të gjithë njerëzve.



KAPITULLI

2

Rrënja e Problemit

Çelësi i lumturisë nuk është të të duan,
por të kesh dikë që ta duash.

Anonim

Rrënja e një gjëje është vetë burimi i saj-fillimi, mbështetja themelore. Zakonisht, rrënjët gjenden nën tokë dhe për këtë arsye ne shpesh i shpërfillim dhe i kushtojmë vëmendje vetëm asaj që shohim mbi sipërfaqe. Kur një njeri ka dhimbje dhëmbi, shpesh dentistit i duhet të hapë një kanal në dhëmbin e tij. Rrënja e dhëmbit është prishur dhe prandaj duhet të kurohet, në të kundërt dhëmbi nuk do të reshtë së dhemburi. Rrënja e dhëmbit nuk mund të shihet, por ju e dini që gjendet aty për shkak të dhimbjes së madhe. Bota është në dhimbje dhe kjo dhimbje nuk do të ndalojë kurrë, nëse nuk shkojmë tek rrënjët e problemeve që pllakosur individët dhe shoqëritë. Unë besoj se kjo rrënjë është egoizmi.

Jam përpjekur të mendoj për ndonjë problem që nuk rrënjoset në egoizëm, por nuk kam arritur të gjej as edhe një. Njerëzit nuk e kanë për gjë të shkatërrojnë jetën e dikujt tjetër për të marrë atë që

Jam përpjekur të mendoj për ndonjë problem që nuk është rrënjësor në egoizëm, por nuk kam arritur të gjej as edhe një.

duan ose për t'u ndjerë mirë. E thënë me pak fjalë, egoizmi është burimi i gjithë problemeve të botës.

Egoizmi Ka Mijëra Fytyra

Egoizmi ka mijëra fytyra dhe ndoshta kjo është arsyeja pse nuk arrijmë ta dallojmë për atë që është. E shohim tek foshnjat që ulërijnë kur nuk marrin atë që duan dhe tek fëmijët që marrin lodrat e fëmijëve të tjerë. Është e dukshme në dëshirën që kemi për t'u dukur më mirë se të tjerët dhe për të interpretuar më mirë se ata. Egoizmi ka të bëjë me dëshirën për të qenë i pari në gjithçka dhe, ndonëse nuk është gabim të duam të japim më të mirën, është e gabuar të gëzohemi kur i shohim të tjerët të dështojnë në mënyrë që ne të kemi sukses.

Unë besoj se të gjitha format e egoizmit janë të këqija dhe shkaktojnë probleme. Në këtë seksion, dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen në tre lloje specifike egoizmi që gjenden në botën e sotme dhe në rezultatet negative që ato sjellin.

Ann është trembëdhjetë vjeç. Babai i thotë se tani ajo është bërë grua dhe se ka ardhur koha që ajo të bëjë atë që bëjnë gratë. Kur ai mbaron së demonstruari se çfarë do të thotë të jesh grua, ajo ndjehet e turpëruar, e frikësuar dhe e pistë. Ndonëse i ati e siguron se ajo që po i bën ai është një gjë e mirë, ajo pyet veten përse ai i kërkon ta mbajë sekret dhe pse kjo gjë e bën të ndihet kaq keq. Ndërsa vitet kalojnë dhe babai e ngacmon dhe e përdhunon vazhdimisht, Ann mbyllet emocionalisht për të mos e

ndjerë më dhimbjen. Babai i ka vjedhur asaj fëmijërinë, virgjërinë, pafajësinë dhe, pa ndërhyrjen e Perëndisë, ai do t'i kishte vjedhur edhe jetën-dhe gjithçka për të marrë atë që donte ai.

Ne ndjejmë neveri dhe revoltohemi kur dëgjojmë për rastet e incestit, por e vërteta është se 90-95% e gjithë rasteve të incestit nuk raportohen. Unë jam abuzuar seksualisht nga babai im për shumë vite. U përpoqa dy herë t'i tregoj dikujt se çfarë po më ndodhte, por meqenëse ata nuk më ndihmuan, vuajta e vetme derisa arrita moshën madhore dhe më në fund fillova të tregoja historinë time dhe të merrja shërimin nga Perëndia. Babai im vdiq në moshën 86-vjeçare, pa u ndëshkuar asnjëherë formalisht për krimin e tij. Njerëzit që punonin me të, që shkonin në festa dhe në piknik me të, nuk e morën vesh kurrë se ai e përdhunonte vajzën që kur ajo ishte në moshë shumë të vogël.

Ne shohim çfarë bëjnë njerëzit dhe shpejtojmë t'i gjykojmë, por rrallë i njohim shkaqet rrënjësore të sjelljes së tyre. Shumë gra që ne i gjykojmë si "problematike në shoqëri", janë viktima të incestit. Për shembull:

- 66% e gjithë prostitutave janë viktima të abuzimit seksual që fëmijë.
- 36.7% e gjithë grave në burgjet e SHBA-së janë abuzuar që fëmijë.
- 1/3 e gjithë fëmijëve të abuzuar apo të braktisur, më vonë do të abuzojnë dhe braktisin fëmijët e tyre.
- 94% e gjithë viktimave të abuzimit seksual janë nën moshën 12 vjeçare kur abuzohen për herë të parë.

Dhimbja që shkaktohet nga incesti dhe abuzimi seksual është tronditëse. Gjithçka ka nisur për shkakun se njerëzit janë egoistë dhe nuk shqetësohen nëse dikush lëndohet, për sa kohë që marrin atë që duan.

Natyrisht, ndoshta ju nuk do të vrisnit, vidhnit, gënjenit apo nuk do të kryenit veprime të dhunshme kundrejt fëmijëve, por, megjithatë gjasat janë që ju jeni egoistë në disa mënyra. Nëse guxojmë të justifikojmë egoizmin tonë duke drejtuar gishtin tek ata që kanë bërë krime më të rënda, nuk do të trajtojmë kurrë me sukses problemet e sotme të shoqërisë sonë. Secili prej nesh duhet të marrë përgjegjësi të rregullojë sjelljen e vet egoiste, pavarësisht nga shkalla e egoizmit nivelit në të cilin gjendet apo mënyrës se si e shpreh.

Lakmia Shpesh egoizmi merr formën e lakmisë. Lakmia është fryma që nuk kënaqet kurrë dhe gjithmonë dëshiron më shumë. Shoqëria jonë sot, është pa dyshim e orientuar drejt konsumimit. Unë habitem kur shikoj gjithë ato qendra tregtare që ekzistojnë dhe ato që po ndërtohen. Ngado që të hedhës sytë diçka ofrohet për t'u blerë. Gjëra, gjëra dhe akoma më shumë gjëra - dhe gjithçka është një iluzion. Ato premtojnë një jetë më të lehtë dhe më shumë lumturi, por për shumë njerëz ato krijojnë një borxh shtypës.

Presioni dhe tundimi për të blerë shumë e më shumë, na mban të rrënjësuar në egoizëm. Por, lajmi i mirë është se ne mund të ndryshojmë, nëse me të vërtetë e dëshirojmë këtë gjë. Le të mësojmë të blejmë atë për të cilën kemi nevojë dhe disa gjëra që i dëshirojmë dhe, pastaj, le t'ua mësojmë të japim shumë prej zotërimeve tona, veçanërisht ato që nuk i përdorim më, atyre që kanë më pak se ne. Le të praktikojmë dhënien, derisa ajo të jetë gjëja e parë dhe më e natyrshme që bëjmë çdo ditë të jetës sonë. Për shumicën e njerëzve, kjo do të ishte me të vërtetë një mënyrë revolucionare të jetuari.

Bibla thotë se dëshira për para është rrënja e gjithë të këqijave (shih 1Tim 6:10). E vetmja arsye pse njerëzit i duan paratë dhe bëjnë pothuajse gjithçka për t'i pasur, është thjesht që ata mendojnë se paraja mund t'i bëjë të kenë gjithçka që dëshirojnë. Ata besojnë se paratë mund të blejnë lumturinë. Njerëzit vazhdimisht vrasin, vjedhin dhe gënjejnë për para-dhe kjo është e rrënjësuar në

sëmundjen e egoizmit. Së fundmi, lexova një artikull nga një aktor i famshëm i cili thoshte se njerëzit besojnë se po të kenë të gjitha gjërat që dëshirojnë, do të jenë të lumtur, por ky është një premtim i rremë. Ai vazhdonte duke thënë se kishte gjithçka që një njeri mund të dëshironte dhe kishte zbuluar se megjithatë nuk ishte i lumtur, sepse, sapo njeriu ia arrin qëllimit të zotërojë gjithçka që bota ofron, ata mbeten përsëri me veten e tyre.

Divorci Egoizmi është gjithashtu shkaku rrënjësor i divorcit. Shpesh, njerëzit martohen duke pasur mendime të gabuara për martesën. Shumë prej nesh janë të bindur se bashkëshorti/bashkëshortja është dikush që duhet të na mbajë të lumtur, dhe kur kjo gjë nuk ndodh, fillon lufta. Sa shumë më ndryshe do të ishin gjërat nëse ne martohemi dhe vendosim që do të bëjmë gjithçka që është e mundur për ta mbajtur partnerin tonë të lumtur!

Tani ju mund të jeni duke menduar, *nuk do ta bëj këtë gjë, sepse e di që do të përfitonin prej meje*. Po të isha në vitet e mia të para, do të kisha rënë dakord me ju, por tani, pasi kam jetuar një jetë të tërë, besoj se Bibla, në fund të fundit, është e vërtetë. Ajo thotë se dashuria nuk dështon kurrë (shih 1Kor 13:8). Ajo gjithashtu thotë se çfarë njeriu mbjell, "atë edhe do të korrë" (Gal 6:7). Nëse unë e besoj Biblën, dhe unë vërtet e besoj, atëherë duhet të besoj se jam përgjegjëse për të korrrat që marr në jetën time, sepse mbështetet në farat që mbjell. Nëse mbjellim mëshirë, korrim mëshirë; nëse mbjellim mirësi, do të korrim mirësi.

Mendjen e Kisha Gjithmonë te Vetja

Kur shikoj prapa në dyzet e dy vitet që Dave dhe unë kemi qenë të martuar, tmerrohem nga fakti se sa egoiste kam qenë, veçanërisht në vitet e para të martesës. Me sinqeritet them se nuk dija të veproja

më mirë. Në shtëpinë në të cilën u rrita, gjithë ç'kam parë ka qenë egoizëm dhe nuk kam pasur askënd të më mësonte ndryshe. Të kisha ditur si të isha dhënëse dhe jo marrëse, jam e sigurt se vitet e para të martesës do të kishin qenë shumë më të mira. Për shkak të pranisë së Perëndisë në jetën time, kam parë se si gjërat kanë ndryshuar dhe se si plagët e vjetra janë shëruar, por kam humbur kot shumë vite të cilat nuk mund t'i kthej mbrapsht.

Në kontrast të fortë me mënyrën si unë jam rritur, Dave u rrit në një shtëpi të krishterë. Nëna e tij ishte një grua e perëndishme e cila lutej dhe i mësonte fëmijët të jepnin. Si rezultat i edukimit të tij, Dave zhvilloi cilësi të cilat unë nuk i kisha parë kurrë në jetën time derisa e takova. Shembulli i tij ka qenë jashtëzakonisht i vlefshëm për mua. Nëse ai nuk do të kishte qenë shumë i duruar, gjë që është një aspekt i dashurisë, jam e sigurt se martesa jonë nuk do të kishte zgjatur shumë, por falënderoj Perëndinë që nuk ndodhi kështu. Pas dyzet e dy viteve martesë, me sinjeritet mund të them se martesa sa vjen dhe bëhet më e mirë. Tani, unë jam më e lumtur se ç'kam qenë ndonjëherë sepse jap më shumë në marrëdhënien tonë se ç'kam dhënë ndonjëherë. Me të vërtetë më pëlqen të shikoj se si Dave bën gjërat që i pëlqejnë dhe kjo gjë është në kontrast me gjithë ato vite kur zemërohesh sa herë që nuk i arrija gjërat sipas "mënyrës sime".

Mendjen e kisha gjithmonë te vetja dhe asgjë nuk ndryshoi derisa u mërzita që jeta time ishte "e gjitha" për mua, mua dhe përsëri më shumë për mua. Jezusi erdhi të hapë dyert e burgut dhe të çlirojë të burgosurit (shih Isa 61:1). Ai më ka çliruar nga shumë gjëra, më e madhja e të cilave është nga vetja ime. Unë jam çliruar nga vetja ime! Unë vazhdoj të rritem çdo ditë në këtë liri, por jam falënderuese që tani kuptoj se gëzimi i vërtetë nuk gjendet kur i arrij gjërat gjithmonë sipas "mënyrës sime".

Ndoshta, ashtu si unë, edhe ju keni pasur shembuj jo të mirë në jetë dhe ju duhet të çmësoni disa gjëra që i keni mësuar në vitet e hershme. Jini të sinqertë: Si reagoni kur nuk arrini atë që doni? A

zemëroheni? A mërmërisni dhe ankoheni? A jeni në gjendje t'i besoni Perëndisë të kujdeset për ju apo po jetoni me frikën se, nëse nuk kujdeseni për veten, askush tjetër nuk do ta bëjë këtë për ju? Besimi se duhet të kujdesesh për veten ju çon drejt egoizmit, gjë e cila ju çon në një jetë jo të lumtur. Unë ju nxis, sot, t'i ktheni shpinën egoizmit dhe të filloni të vlerësoni, të kujdeseni dhe me të vërtetë t'i doni të tjerët.

Egoizmi Është Zgjedhje

Shumë prej nesh kalojnë shumë kohë duke menduar, diskutuar dhe duke bërë plane për veten. Ndonëse unë qëndroj fuqishëm në faktin se ne duhet ta duam veten në mënyrë të ekuilibruar, nuk besoj se duhet të jemi kaq të dashuruar pas vetes, saqë të bëhemi qendra e botës sonë dhe të shqetësohemi vetëm se si të marrim atë që duam. Patjetër, ne duhet të kujdesemi për veten, sepse jemi tepër të vlefshëm për planin e Perëndisë në Tokë. Ai na dha jetë që ne të gëzohemi në të (shih Gjoni 10:10). Prandaj, ne duhet ta jetojmë jetën, por duhet të kuptojmë se rruga e vërtetë drejt gëzimit, është ta japësh jetën tënde dhe jo ta mbash atë për vete.

Jezusi thotë se nëse duam të jemi dishepujt e Tij, ne duhet ta harrojmë veten, të heqim dorë nga vetja e nga gjithë interesat tona personale dhe ta ndjekim Atë (Marku 8:34). Tani, e pranoj se ky është një mendim disi i frikshëm, por kam një avantazh, sepse kam jetuar mjaft për ta provuar dhe e kam parë se funksionon. Më tej Jezusi thotë se, nëse ne do të heqim dorë nga jeta "më e ulët" (jeta egoiste), mund të kemi jetën "më të lartë" (jetën jo-egoiste), por nëse e mbajmë jetën më të ulët, do ta humbasim jetën më të lartë (shih Marku 8:35). Ai na jep zgjedhje në lidhje me mënyrën se si ne do të jetojmë. Ai na tregon se çfarë do të funksionojë shumë mirë dhe pastaj na lë të vendosim nëse duam ta bëjmë ose jo. Unë

mund të qëndroj egoiste dhe po kështu mund të bëni edhe ju, por lajmi i mirë është se ne nuk na duhet të qëndrojmë kështu. Ne kemi fuqinë e Perëndisë që na është dhënë për të na ndihmuar ta kapërcejmë vetveten dhe ta jetojmë jetën tonë për të bërë më të mirë jetën e dikujt tjetër.

Udhëtimi

Egoizmi nuk është një sjellje e mësuar, përkundrazi, ne kemi lindur me të. Ai është pjesë e lindur e natyrës sonë. Bibla i referohet si "natyra mëkatore". Adami dhe Eva mëkatuan kundër Perëndisë duke bërë atë që Ai u tha të mos e bënin dhe parimi i mëkatit që ata themeluan, do të tejçohet përgjithmonë tek çdo njeri që do të lindte. Perëndia dërgoi Birin e Tij, Jezusin, të vdiste për mëkatet tona dhe të na çlironte prej tyre. Ai erdhi për të zhbërë atë që bëri Adami. Kur ne e pranojmë Jezusin si Shpëtimtarin tonë, Ai vjen për të jetuar në frymën tonë dhe nëse e lejojmë këtë pjesë të rinovuar brenda nesh të drejtojë vendimet tona, atëherë mund ta mposhtim natyrën mëkatore që gjendet në mishin tonë. Kjo natyrë mëkatore nuk largohet, por më i Madhi që jeton brenda nesh, na ndihmon ta mposhtim atë çdo ditë (shih Gal 5:16). Kjo nuk do të thotë se ne nuk mëkatojmë kurrë, por ne mund të përmirësohemi dhe të kemi progres gjatë jetës sonë.

Unë sigurisht që nuk mund të them se e kam mposhtur tërësisht egoizmin dhe dyshoj se mund ta bëjë ndonjë njeri tjetër. Ta thuash këtë gjë, do të thotë të thuash se nuk mëkatojmë kurrë, sepse i gjithë mëkati i ka rrënjët në një lloj egoizmi. Unë nuk e kam mposhtur tërësisht egoizmin, por çdo ditë kam shpresën se përmirësohem. Unë jam në një udhëtim dhe ndonëse mund të mos arrij, kam vendosur se, kur Jezusi të vijë për të më marrë në shtëpi, Ai do të më gjejë duke synuar drejt qëllimit (shih Fil 3:12-13).

Apostulli Pal bëri deklaratën vijuese: "Por rroj; jo më unë, po Krishti (Mesia) rron në mua" (Gal 2:20). Pali dëshironte të thoshte se ai nuk po jetonte më për veten dhe vullnetin e tij, por për Perëndinë dhe vullnetin e Tij. U inkurajova shumë kur një ditë, ndërsa po studioja, zbulova se Pali e tha këtë afërsisht njëzet vjet pas konvertimit të tij. Të mësosh të jetosh pa egoizëm ishte një udhëtim për të, ashtu siç është edhe për çdo njeri tjetër. Pali, gjithashtu tha: "Përditë unë po vdes [përballem me vdekjen çdo ditë dhe e mposht veten time]" (1 Kor 15:31). Me fjalë të tjera, vendosja e të tjerëve si prioritet, ishte një betejë e përditshme dhe kërkonte vendimmarrje të përditshme. Secili prej nesh duhet të vendosë se si do të jetojë dhe për çfarë do të jetojë; dhe nuk ka kohë më të mirë për ta bërë këtë sesa tani. Si unë, ashtu edhe ti, kemi vetëm një jetë për të jetuar dhe vetëm një jetë për të dhënë, prandaj pyetja qëndron: "Si do ta jetojmë atë?" Unë besoj fuqishëm se nëse secili prej nesh bën pjesën e vet, të vendosë pra mirëqenien e të tjerëve si prioritet, atëherë ne do të shohim dhe do të bëhemi pjesë e një revolucioni që ka fuqinë të ndryshojë botën.

Asnjë Njeri Nuk Është Ishull

Jam e sigurt se keni dëgjuar për shprehjen e njohur të John Donne-s "Asnjë njeri nuk është ishull". Këto fjalë shprehin me thjeshtësi faktin se njerëzit kanë nevojë për njëri-tjetrin dhe ndikojnë njëri-tjetrin. Ashtu si jeta e babait tim ka ndikuar tek unë në mënyrë negative dhe jeta e Dave-it ka ndikuar tek unë në mënyrë pozitive, ashtu edhe jetët tona mund dhe me të vërtetë ndikojnë njerëz të tjerë. Jezusi na tha ta duam njëri-tjetrin, sepse kjo është e vetmja mënyrë se si bota do të njohë që Ai ekziston (shih Gjoni 13:34-35). Perëndia është dashuri, dhe kur ne shfaqim dashuri me anë të fjalëve dhe veprimeve tona, ne po u tregojmë njerëzve se si është Perëndia. Pali

thotë se ne jemi ambasadorët e Perëndisë, përfaqësuesit e Tij personalë dhe Ai është duke i bërë thirrje botës nëpërmjet nesh (shih 2 Kor 5:20). Sa herë që mendoj për këtë varg, gjithçka që mund të them është: "Ua! Çfarë privilegji dhe përgjegjësie!".

Një prej mësimëve që më duhej të mësoja në jetë, ishte se nuk mund të kisha privilegje pa përgjegjësi. Ky është një prej problemeve të shoqërisë sonë sot. Njerëzit dëshirojnë atë që nuk meritojnë! Egoizmi thotë: "Ma jep mua! E dua unë dhe e dua tani!". Urtësia thotë: "Mos më jep asgjë për të cilën nuk jam i pjekur ta trajtoj ashtu siç duhet". Botës i mungon mirënjohja, madje i mungon shumë, dhe kjo sepse ne nuk duam më të presim apo të sakrifikojmë asgjë. Kam kuptuar se gjërat për të cilat jam më falënderuese janë gjërat për të cilat jam munduar më shumë dhe kam pritur më gjatë. Gjërat që përftohen lehtë, zakonisht nuk kanë shumë vlerë për ne.

Në shumë mënyra, ne po rrisim një brez egoist fëmijësh, sepse u japim atyre shumë shpejt shumë gjëra. Shpesh, u blejmë biçikletën një vit para se të jenë në gjendje t'i japin, ose makinën kur mbushin gjashtëmbëdhjetë vjeç. U paguajmë faturat e shkollës, u blejmë shtëpinë kur martohen dhe ua mbushim shtëpinë me mobilje të shtrenjta. Pastaj, kur fëmijët tanë përfundojnë në telashe financiare, nëse është e mundur, i nxjerrim nga situata dhe jemi aty për ta sa herë që kanë nevojë. I bëjmë këto gjëra në emër të dashurisë, por a i duam kështu me të vërtetë fëmijët tanë apo thjesht po i llastojmë? Ndonjëherë, duke bërë këto gjëra, prindërit përpiqen të "paguajnë" për kohën që nuk kaluan me fëmijët e tyre kur ishin më të vegjël. Kur u japin fëmijëve shumë gjëra, ata thjesht zbusin ndjenjën e fajit dhe nëse ekziston mundësia, dhënia e parave është e thjeshtë kur prindërit janë shumë të zënë me punë.

Të gjithë ne dëshirojmë shumë t'i bekojmë fëmijët tanë, por ne duhet të ushtrojmë disiplinë në sasinë e gjërave që bëjmë për ta. Mbreti Salomon na këshillon të përdorim "urtësi" (Fja 1:3). Nganjëherë, të thuash "jo" mund të jetë dhurata më e mirë që

mund t'u japim fëmijëve, sepse i ndihmon ata të mësojnë mësimet e vlefshme të privilegjit dhe përgjegjësisë.

Jepini Formë Bujarisë

Jepni shembullin e një jete bujare jo vetëm para syve të fëmijëve tuaj por edhe para të gjithë atyre me të cilët takoheni. Nëse ju jeni dhënë më shumë se sa marrës, nuk do të duhet shumë kohë para se të tjerët të kuptojnë se jeni krejt ndryshe nga njerëzit me të cilët janë mësuar. Atëherë, ndërsa bëhen dëshmitarë të gëzimit tuaj, ata ndoshta aftësohen për të lidhur pikat dhe për të kuptuar se dhënia e bën njeriun më të lumtur se sa egoizmi. Njerëzit shikojnë dhe unë mrekullohem se si ata i vënë re dhe i kujtojnë gjërat.

Pali thotë se ne duhet t'ua bëjmë të ditur të gjithë njerëzve bujarinë, kujdesin dhe frymën tonë të duruar (Fil 4:5). Jezusi na inkurajoi që të lejojmë gjithë njerëzit të shohin mirësinë dhe veprat tona të mira, në mënyrë që ata të njohin dhe përlëvdojnë Perëndinë (shih Mt 5:16). Jezusi nuk na tha të tregohemi mburraveç apo t'i bëjmë gjërat që të shohin të tjerët; Ai, na inkurajoi të kuptojmë se sa shumë ndikojmë tek njerëzit rrotull nesh. Sigurisht, edhe sjellja negative ndikon gjithashtu tek njerëzit e tjerë, siç e kam përmendur edhe më parë, por bujaria ndikon njerëzit në mënyrë pozitive dhe na bën ne njerëz të lumtur.

Po Për Mua?

Tani, ndoshta ju po mendoni: *Po për mua? Kush do të bëjë ndonjë gjë për mua?* Kjo është ajo çka zakonisht na pengon të jetojmë në mënyrën që Perëndia dëshiron. Çështja rrotullohet gjithmonë tek "unë". Po unë, po unë, po unë? Jemi mësuar kaq shumë të

kujdesemi për përmbushjen e dëshirave tona, saqë vetëm mendimi që duhet të harrojmë veten vetëm për një ditë, është shumë i frikshëm. Por, nëse arrijmë të zotërojmë kurajon për ta provuar, do të mahnitemi me lirinë dhe gëzimin që do të përjetojmë.

Pothuajse gjatë gjithë jetës sime më parë, zgjohesha çdo ditë dhe, shtrirë në krevat, thurja plane për veten time. Mendoja se çfarë doja dhe se çfarë do të ishte më e mira për mua, dhe se si do t'i bindja familjen dhe miqtë e mi të bashkëpunonin për planet e mia. Ngrihesha dhe e kaloja ditën duke pasur veten time në mendje, dhe sa herë që gjërat nuk shkonin sipas planeve të mia, mërzitesha, humbisja durimin, acarohesha dhe zemërohesha. Mendoja se nuk isha e lumtur sepse nuk po arrija atë që doja, por, në të vërtetë, unë nuk isha e lumtur sepse gjithçka që bëja ishte të përpiqesha të arrija atë që doja, pa u shqetësuar shumë për të tjerët.

Tani që po zbuloj se sekretet e gëzimit është në dhënien e jetës dhe jo në ruajtjen e saj, mëngjeset e mia janë shumë ndryshe. Sot në mëngjes, para se të filloja të punoja me këtë kapitull, u luta dhe kalova kohë duke menduar për gjithë njerëzit që e dija se do t'i takoja sot. Pastaj u luta sipas Romakëve 12:1, që flet për përkushtimin e vetvetes ndaj Perëndisë si flirime të gjalla, duke i ofruar të gjitha aftësitë tona Atij në përdorim të Tij. Ndërsa po mendoja për njerëzit me të cilët do të punoja apo do të takoja ditën e sotme, i kërkova Perëndisë të më tregonte ndonjë gjë që mund të bëja për ta. E vendosa në mendje t'i inkurajoja dhe t'u bëja komplimente. Me siguri që ne mund të gjejmë një gjë të mirë për t'u thënë njerëzve që takojmë. Thjesht duke bërë këtë gjë, e mbajmë mendjen larg vetes. Besoj se Perëndia do të më drejtojë ndërsa vazhdoj ditën e sotme.

Nëse dëshironi t'ia përkushtoni veten Perëndisë, në mënyrë që Ai të mund t'ju përdorë për të ndihmuar të tjerët, ju sugjeroj të luteni kështu: "Zot, të ofroj Ty sytë, veshët, gojën, duart, këmbët, zemrën, financat, dhuntitë, talentet, aftësitë, kohën dhe energjinë time. Më përdor për të qenë bekim kudo që shkoj sot".

"Zot, të ofroj Ty sytë, veshët, gojën, duart, këmbët, zemrën, financat, dhuntitë, talentet, aftësitë, kohën dhe energjinë time. Më përdor për të qenë bekim kudo që shkoj sot".

Ju nuk do ta njihni kurrë gëzimin e të jetuarit kështu, derisa vërtet ta provoni. Unë e quaj "zakon të shenjtë" dhe, si gjithë zakonet, ai duhet të praktikohet që të bëhet i tillë. Ka ditë që ende zihem tërësisht nga vetvetja dhe harroj të praktikoj zakonin tim të ri, por kur e humbas gëzimin dhe entuziazmin për jetën, më kujtohet shpejt se përsëri kam dalë jashtë binarëve.

Ka disa vite që përpiqem të jetoj sipas kësaj mënyre dhe ka qenë një betejë e vërtetë. "Jeta e vetes" është rrënjësuar thellë në çdo qelizë të qenies sonë dhe nuk vdes kollaj. Kam lexuar libra rreth dashurisë, kam parë e riparë çfarë thotë Bibla rreth saj dhe jam lutur për këtë gjë. Kam folur me miqtë, kam predikuar për të dhe kam bërë gjithçka që është e mundur për ta pasur si parësi në mendimet e mia. Nganjëherë, kur kuptoj se jam bërë përsëri egoiste, nuk mërzitem, sepse mërzitja me veten vazhdon të më mbajë të lidhur me veten. Kur dështoj, i kërkoj Perëndisë të më falë dhe filloj nga e para; dhe unë besoj se kjo është mënyra më e mirë. Ne kalojmë shumë kohë duke u ndjerë keq me veten për shkak të gabimeve që bëjmë-dhe kjo është humbje kohe. Vetëm Perëndia mund të na falë dhe Ai është tërësisht i gatshëm ta bëjë këtë, nëse ne thjesht ia kërkojmë.

Po, unë besoj fuqishëm se rrënja e problemit të botës sot është egoizmi, por ama është e mundshme të jetosh në këtë botë e megjithatë të refuzosh të jesh si bota. Nëse bashkoheni me mua për të filluar një Revolucion Dashurie, nëse ju do të ndryshoni krejtësisht, në mënyrë radikale, në mënyrën se si keni jetuar dhe plot energji të filloni të jetoni për t'i dashur të tjerët dhe jo për t'u dashur, atëherë mund të bëheni pjesë e zgjidhjes dhe jo të jeni më pjesë e problemit. A jeni gati për të filluar?



KAPITULLI

3

Asgjë e Mirë nuk Ndodh Rastësisht

Unë vigjëloj mbi fjalën time që të ketë efekt.

Jeremia 1:12

Asnjë nga revolucionet që ndryshuan botën nuk kanë ndodhur rastësisht. Në disa raste, ato filluan me pak njerëz që diskutonin mbi ndryshimet e nevojshme. Nëse këto ngjarje histori-bërëse lindën si shkak i revoltave rastësore apo ishin të mirë-organizuara, ato nuk ndodhën thjesht rastësisht. Ato ishin të paramenduara, të qëllimshme, gjithë pasion dhe strategjike. Ato filluan sepse dikush refuzoi të mos bënte asgjë; dikush refuzoi t'i "linte gjërat të zhvilloheshin" vetë; dikush refuzoi të ishte pasiv dhe i plogësht ndërsa padrejtësia rendte e shfrenuar. Revolucionet ndodhin sepse dikush vendos të veprojë.

Vepro Tani!

Bibla është e mbushur me udhëzime që na nxisin të jemi veprues. Udhëzimi për të qenë veprues dhe jo pasivë, është tepër i thjeshtë,

por miliona njerëz e injorojnë tërësisht atë. Ndoshta mendojnë se gjërat do të bëhen më mirë vetë. Nuk ndodh kështu. Asgjë e mirë nuk ndodh rastësisht. Sapo e mësova këtë gjë, jeta ime ndryshoi për mirë.

Vetëm dëshira për diçka nuk sjell rezultatet që dëshirojmë, por ne duhet të bëjmë çka është e nevojshme për t'i arritur ato rezultate. Nuk do të gjejmë kurrë një njeri të suksesshëm që e kaloi jetën duke e dëshiruar suksesin dhe kështu e arriti atë. Po ashtu, nuk do të gjeni asnjë njeri që, duke mos bërë asgjë, arriti të bëhej i suksesshëm. I njëjti parim zbatohet edhe për ata që duan të jenë pjesë e Revolucionit të Dashurisë. Nëse dëshirojmë t'i duam njerëzit ashtu si Jezusi udhëzoi, do të na duhet t'ia vëmë vetes si qëllim (që t'i duam). Nuk do të ndodhë rastësisht.

Bibla na thotë se duhet të *përpiqemi* të jemi të dashur dhe të mirë (shih 1 The 5:15). *Të përpiqesh* është një fjalë e fortë që do të thotë "të dëshirosh, të ndjekësh dhe të shkosh pas". Nëse i kërkojmë mundësitë, me siguri do t'i gjejmë dhe kjo do të na mbrojë nga të qenët të plogësht dhe jo të frytshëm. Ne duhet të pyesim veten nëse jemi vigjilentë dhe veprues, apo pasivë dhe të plogësht? Perëndia është vigjilent dhe veprues! Unë jam e lumtur që Ai është i tillë; përndryshe, gjërat në jetën tonë do të prisheshin me shpejtësi. Perëndia, jo vetëm që krijoi botën dhe çdo gjë që ne shohim dhe shijojmë në të, por Ai gjithashtu e mban atë në veprim, sepse Ai e di se gjërat e mira nuk ndodhin rastësisht; ato ndodhin si rezultat i një veprimi të mirë (shih Heb 1:3).

Veprimtaritë e frymëzuara dhe të vlerësuara nga Perëndia, na bëjnë të mos jemi të plogësht dhe pa fryte dhe kështu ato na mbrojnë. Nëse jemi veprues, duke bërë gjërat e duhura, ne ruhem i mos bëjmë gjërat e gabuara. Me sa duket, nuk na duhet të përpiqemi shumë të bëjmë të gabuarën; natyra jonë njerëzore na tërheq në atë drejtim nëse nuk zgjedhim të bëjmë atë që është e drejtë.

Për shembull, nuk na duhet të zgjedhim sëmundjen; gjithçka që duhet të bëjmë është të qëndrojmë rrotull saj dhe ne mund ta marrim atë. Por ne duhet të zgjedhim shëndetin. Për të qenë e shëndetshme, mua më duhet të marr vendime të mira në lidhje me ushtrimet, gjumin dhe ushqimin. Më duhet të zgjedh të mos shqetësohem, apo të jem e zemëruar, sepse e di se kjo gjë do të më lodhë dhe ndoshta do të më shkaktojë simptoma të tjera fizike. Për të qenë e shëndetshme, unë duhet të investoj në shëndetin tim, por shumë lehtë mund të sëmurem në qoftë se nuk bëj asgjë për t'u kujdesur për veten time.

Mishi Është Përtac

Apostulli Pal na mëson qartë se mishi është përtac, plot epsh dhe dëshiron shumë gjëra të mëkatshme (shih Rom 13:14). Falenderojmë Perëndinë që ne jemi më shumë se thjesht mish. Ne gjithashtu kemi një frymë dhe Perëndia banon në pjesën frymërore të të krishterit. Perëndia është i mirë dhe fakti që Ai banon në ne, do të thotë se ne ne gjendet mirësi. Me anë të frymës ne mund të disiplinojmë dhe sundojmë mishin tonë-por kjo arrihet me përpjekje. Arrihet me bashkëpunimin me Frymën e Shenjtë, i Cili na fuqizon dhe na aftëson të bëjmë gjëra të mira. Pali thotë se ne nuk duhet të kujdesemi për mishin dhe unë besoj se një mënyrë se si ne kujdesemi për të është kur thjesht nuk bëjmë asgjë!

Të mos bësh asgjë është shumë ngjitëse. Sa më shumë të mos bëjmë gjë, aq më shumë nuk duam të bëjmë gjë. Jam e sigurt se e keni provuar kur rrini shtrirë në shtëpi gjithë ditën dhe keni parë se sa më shumë të rrini shtrirë, aq më e vështirë është të ngrihen. Kur ngrihen për herë të parë, ju duket vetja e ngrirë dhe e lodhur, por energjia ju kthehet kur vazhdoni ta detyroni veten të lëvizni.

Sot u zgjova me humor disi të keq. Kam punuar shumë gjatë

gjithë fundjavës në një konferencë dhe akoma jam disi e lodhur. Përveç kësaj, përjetova një zhgënjim personal për diçka në të cilën po shpresoja. Më vinte të shtrihesha në kolltuk dhe të ndjeja keqardhje për veten gjatë gjithë ditës, por, duke qenë se kam përvojë disavjeçare që e bëj këtë gjë dhe e di se nuk është frytdhënëse, kam vendosur të zgjedh ndryshe. Vendosa të nis të shkruaj këtë kapitull mbi veprimtarinë. Kjo është mënyra ime për të luftuar kundër ndjenjave të mishit tim! Sa më shumë të shkruaj, aq më mirë ndihem.

Në momentet kur mishi ynë na tndon të jemi dembelë, ne mund ta mposhtim duke i kërkuar Perëndisë të na ndihmojë dhe duke vendosur të jemi aktivë dhe jo të plogësht. Pastaj, ndërsa ecim përpara dhe veprojmë sipas vendimit që kemi marrë, do të shikojmë se ndjenjat do të pasojnë natyrshëm. Perëndia më ka dhënë frymën e disiplinës dhe të vetëkontrollit tamam për ditë si dita e sotme, por më takon mua të zgjedh nëse do të përdor atë që Ai më ka dhënë, apo thjesht do të ndjek rrugët e mishit.

Pali gjithashtu shkruan për "të krishterë në mish", të cilët janë njerëz që e kanë pranuar Jezu Krishtin si Shpëtimtarin e tyre, por nuk bashkëveprojnë kurrë me Frymën e Shenjtë për t'u rritur në pjekuri frymërore. Tek 1 Korintasve 3:1-3 Pali u tha të krishterëve se atij i duhej t'u fliste atyre si njerëzve jo-frymërorë të mishit, në të cilët mbizotëron natyra e mishit. Ai madje nuk mund t'u mësonte gjëra të forta, por i duhej të kufizohej në çka ai i quan "mesazhe qumështi". Ai u tha se ata ishin jo-frymërorë sepse e lejonin veten të kontrolloheshin nga impulse të rëndomta. Po ju a i lejonin impulset e rëndomta t'ju kontrollojnë? Sot, ndjehesha shumë e tunduar t'i lejoja impulset e rëndomta të më kontrollonin dhe, që të jem e sinqertë, ndoshta do të më duhet t'i rezistoj tundimit përgjatë gjithë ditës duke qëndruar aktive dhe duke e detyruar veten të bëj diçka që besoj se do të sjellë fryte të mira. Nuk mund t'ia lejoj vetes të lëshohem në ndjenjat e mia sepse nuk kam ditë për të humbur.

Nuk Ka Shpërblime për Pasivitetin

Asnjë prej nesh nuk ia lejon dot vetes ta harxhojë kohën kot duke u shtrirë dhe duke mos bërë asgjë. Perëndia nuk e shpërblen pasivitetin. Njerëzit mosveprues nuk e përdorin vullnetin e tyre të lirë për të bërë atë që e dinë se është e drejtë. Përkundrazi, ata presin t'u vijë humori për të bërë diçka ose të motivohen nga ndonjë forcë e jashtme misterioze. Ata urojnë të ndodhë diçka e mirë, e veçanërisht t'u ndodhë atyre personalisht, dhe përkushtohen të mos bëjnë asgjë, ndërsa presin ta shohin dëshirën e tyre të përmbushet. Perëndia nuk e përgëzon këtë lloj qëndrimi; në fakt, ky qëndrim është krejt i rrezikshëm.

Vendimi për të mos bërë asgjë mbetet vendim, vendim i cili na bën gjithnjë e më të dobët. I jep djallit gjithnjë e më shumë mundësi për të na kontrolluar. Vendi bosh mbetet vend dhe Fjala e Perëndisë na mëson se, nëse djalli vjen dhe gjen një boshllëk, ai e zë vendin me shpejtësi (shih Mt 12:43-44). Mosveprimi tregon se ne jemi dakord dhe pajtohemi me atë që po ndodh. Tek e fundit, nëse nuk po bëjmë asgjë për të ndryshuar, do të thotë se ne mendojmë se çfarëdo që po ndodh është në rregull.

Bëj Diçka

Ne kemi marrë shumë njerëz në udhëtime misionare për t'u shërbyer njerëzve dëshpërimisht në nevojë, por ata nuk reagojnë të gjithë në të njëjtën mënyrë. Të gjithë ndjejnë dhembshuri kur shikojnë kushtet e tmerrshme në të cilat jetojnë njerëzit në fshatrat e largëta të Afrikës, Indisë apo në pjesë të tjera të botës. Shumë qajnë; shumë tundin kokën dhe mendojnë se këto kushte janë të tmerrshme, por jo të gjithë vendosin të bëjnë diçka për t'i ndryshuar këto kushte. Shumë luten që Perëndia të bëjë diçka dhe

lumturohen që shërbesa jonë po bën diçka, e megjithatë asnjëherë nuk mendojnë t'i kërkojnë Perëndisë me këmbëngulje se çfarë ata vetë mund të bëjnë. Madje, do të guxoja të thoja se shumica e tyre kthehen në shtëpi, zihen përsëri me punët e jetës së tyre dhe shumë shpejt harrojnë atë që kanë parë. Por, falënderojmë Perëndinë që ka disa individë, të cilët janë të vendosur për të gjetur mënyra për të sjellë një ndryshim. Mos harroni: indiferenca nxjerr një justifikim, kurse dashuria e gjen një rrugë për të ndihmuar. Kushdo mund të bëjë diçka!

Mos harroni: indiferenca nxjerr një justifikim, kurse dashuria
e gjen një rrugë për të ndihmuar.

Më kujtohet një grua që vendosi se duhej të ndihmonte në një farë mënyre. Për një farë kohe ajo nuk arriti të gjente dot se çfarë duhej të bënte sepse nuk kishte para shtesë për të kontribuar dhe nuk mund të shkonte për të jetuar në mision. Por, ndërsa vazhdoi të lutej për situatën, Perëndia e inkurajoi të shihte çfarë kishte, jo çfarë nuk kishte, dhe jo në ato gjëra që ajo nuk i kishte. I ra ndër mend se i jepej shumë për të bërë ëmbëlsira. Kështu, ajo i kërkoi pastorit të saj nëse mund të piqte ëmbëlsira gjatë javës dhe të mund t'i shiste të dielën, pas shërbesës, për sa kohë që fitimet të shkonin për fushën e misionit. Kjo pra, u bë një mënyrë se si ajo dhe anëtarë të tjerë të kishës u përfshinë në mision dhe e mbajti atë aktive për të bërë diçka për të ndihmuar dikë tjetër.

Njoh gjithashtu edhe një grua tjetër, e cila u dëshpërua kaq shumë për të bërë diçka, saqë preu flokët e saj të gjatë e të bukur dhe i shiti për të ndihmuar jetimët. Kjo gjë mund t'ju duket disi radikale, por e them me siguri se është më mirë kështu, sesa të mos bësh asgjë. Të mos bësh asgjë është e rrezikshme, sepse i hap dyert djallit për të qenë aktiv në jetët tona.

Një tjetër grua që kam intervistuar, e cila punon si masazhatore terapiste, pasi kishte marrë pjesë në një prej konferencave ku unë kisha folur mbi domosdoshmërinë për të ndihmuar të tjerët, organizoi një ditë të veçantë trajtimi dhe vendosi që të gjitha të ardhurat të shkonin në ndihmë të të varfërve. Ajo mbledhi një mijë dollarë për misionin dhe gjithashtu dëshmoi se dita kur ajo dha paratë, ishte jetë-ndryshuese për të dhe për ata që po merrnin pjesë. Ajo tregoi se sa të entuziazmuar ishin të gjithë ndërsa punonin së bashku për të ndihmuar të varfrit dhe nevojtarët.

Të gjithë ne kemi nevojë të na duan, por unë besoj se gëzimi ynë personal është i lidhur ngushtë me dashurinë ndaj të tjerëve. Kur ne japim, në zemrën tonë ndodh diçka e bukur.

Pasiviteti Fton Armikun

Është e lehtë të rrish ulur ose shtrirë në kolltuk dhe t'i kërkosh Perëndisë të kujdeset për gjithçka, por kjo gjë na bën të plogësht, jo të frytshëm dhe të hapur ndaj sulmeve të të ligut. Nëse mendjet tona janë bosh e pa mendime të mira, djalli i mbush lehtësisht me mendime të këqija. Nëse jemi përtacë dhe mosveprues, ai na tundon lehtësisht për të bërë gjënë e gabuar e madje edhe për të mëkatuar. Bibla na e thotë shumë shpesh se duhet të jemi veprues dhe jo përtacë dhe të pafrytshëm. Nëse mendojmë vazhdimisht se çfarë mund të bëjmë për të tjerët, atëherë nuk do të mbetet në vend për mendime të gabuara.

Njerëzit përtacë shkurajohen, bien në depresion dhe mbushen me keqardhje për veten e tyre shumë lehtë. Ata mund të bien në të gjitha llojet e mëkateve. Madje, apostulli Pal tha se, nëse një grua e re mbetet e ve, ajo duhet të martohet përsëri. Në të kundërt, ajo mund të bëhet thashethemexhie dhe njeri i bezdisshëm (shih 1 Tim 5:11-15). Pali vazhdoi edhe më tej duke thënë se disa prej

vejushave më të reja, nëpërmjet mosveprimit të tyre, ishin mënjanuar dhe po shkonin pas Satanit. Sa e rëndësishme është, pra, të qëndrojmë veprues? Unë besoj se shkrimet e Palit pohojnë se kjo gjë është shumë e rëndësishme.

Në fakt, nëpër gjithë Shkrimin e Shenjtë, Perëndia na inkurajon të mos bëhemi pasivë. Në kohët e Dhjatës së Vjetër, kur një njeri vdiste, izraelitët lejoheshin të vajtonin të dashurin e tyre vetëm për tridhjetë ditë (shih LiP 34:8). Në pamje të parë, kjo mund të duket diçka e pandjeshme, por Perëndia e dha këtë ligj sepse Ai e di se vajtimi dhe pasiviteti i gjatë mund të na çojë në probleme serioze.

Ne duhet të qëndrojmë aktivë-jo më tepër seç duhet që të mos konsumohemi-por mjaftueshëm që të na mbajë në drejtimin e duhur. Ekuilibri është shumë i rëndësishëm. Ne nuk mund ta kalojmë gjithë kohën që kemi duke ndihmuar njerëz të tjerë, por nga ana tjetër, po të mos kalojmë aspak kohë krijon probleme të mëdha. Nëse sillni ndër mend dikë që njihni, i cili është dembel, mosveprues dhe pasiv, me siguri që keni kuptuar se ata nuk janë të lumtur sepse pasiviteti dhe mungesa e gëzimit ecin së bashku.

Disa vite më parë tezes sime i duhej të lëvizte në një qendër lehtësuese për të moshuarit. Gjatë tre a katër viteve të para, ajo nuk donte të bënte asgjë. Ajo ishte trishtuar që i ishte dashur të linte shtëpinë dhe nuk kishte dëshirë të merrte pjesë në jetën e re që po i ofrohej. Ndonëse kishte shumë veprimtari në dispozicion dhe madje edhe mundësi për të ndihmuar të tjerët, ajo ngulmonte të mos bënte asnjë prej tyre. Ditë pas dite qëndronte ulur në apartamentin e saj e dëshpëruar. Ndjehej keq fizikisht dhe shpesh ishte e vështirë të qëndroje me të. Më në fund ajo vendosi se nuk mund të rrinte duke mos bërë asgjë dhe u përfshi në studime biblike dhe në vizitat e pacientëve në anën tjetër të shtëpisë së të moshuarve. Ajo filloi të luante, të shkonte nëpër festa dhe zuri shumë miq. Shumë shpejt nisi të më thoshte se ishte më e lumtur se ç'kishte qenë ndonjëherë në jetën e saj dhe ndjehej shumë mirë fizikisht.

Gjendja e një njeriu pasiv shkon nga keq, në shumë keq, derisa pasiviteti i tij fillon të prekë çdo fushë të jetës së tij. Në mënyrë pasive ai e lejon veten të flaket sa andej-këndeje nga mjedisi dhe rrethanat. I lejon ndjenjat ta drejtojnë dhe meqenëse nuk ka dëshirë të bëjë asgjë, ai thjesht shikon dhe ankohet ndërsa jeta po i shkatërrohet. Do të bëjë shumë gjëra, e megjithatë ndjehet i pushtuar nga një ndjenjë e papërshkrueshme. Ndjehet dembel dhe nuk ka ide krijuese. Madje fillon të mendojë se diçka nuk shkon fizikisht dhe se kjo është arsyeja pse ka mungesë energjie. Për të, jeta është kthyer në një varg problemesh të pakapërcyeshme.

Zakonisht, ne e lejojmë veten të bjerë në pasivitet pasi përjetojmë një pengesë apo një varg zhgënjimesh, ose kur na godet një tragjedi-kësaj do t'i referohem në fund të këtij kapitulli. Kur ndodhin gjëra të tilla, ne mund të duam të heqim dorë, por kur e bëjmë këtë gjë, Satani po pret të hidhet dhe të përfitojë nga situata. Ne, nuk mund të lejojmë për asnjë lloj arsyeje, që pasiviteti ynë t'i japë mundësi armikut të hyjë në jetët tona.

Të Qenit Veprues Më Ndhmon të Kaloj Një Ditë të Keqe

Ndërsa sot unë po kaloj një "ditë të vështirë", ka me miliona njerëz në botë që mendojnë se dita ime është festë në krahasim me atë që ata po përballen. Për më shumë se dy dekada, një ushtri me rebelë në Afrikën Lindore po skllavëron fëmijë duke i detyruar të bëhen ushtarë në një luftë të ndezur nga milicia guerile, e cila ka guximin ta quajë veten Ushtria e Rezistencës së Zotit. Këta guerilë terrorizojnë pjesën veriore të Ugandës; ata rrëmbejnë fëmijë që në moshën shtatë vjeçare dhe i detyrojnë të bëhen ushtarë, skllevër të seksit ose për punë të tjera poshtëruese. Disa statistika thonë se numri i fëmijëve të rrëmbyer shkon nga tridhjetë mijë deri në dyzet

mijë fëmijë. Ajo që filloi si rebelim ndaj qeverisë sunduese, tani është kthyer në kasaphanë të njerëzve të pafajshëm nga një komandant i cili deklaroi se ka si synim të ndërtojë një shoqëri të mbështetur në Dhjetë Urdhërimet, ndërsa i shkel secilën prej tyre.

Ky njeri, Joseph Kony, ka qenë një djalë katolik që shërbente pranë altarit. Tani, ai përziën Dhjatën e Vjetër me Kuranin dhe me ritualet tradicionale fisnore për të nxjerrë doktrinën e tij. Taktikat e tij kanë qenë brutale. Ndërsa po shkruaj këtë libër, është vendosur një armëpushim dhe shumë prej fëmijëve po lirohen, por në shumicën e rasteve prindërit e tyre janë therur, kështu që ata nuk kanë shtëpi ku të kthehen. Shumë prej fëmijëve i kanë detyruar të marrin drogë dhe tashmë ata janë bërë vartës të saj. Madje i kanë detyruar të kryenin akte të dhunshme që janë të pabesueshme edhe për një të rritur, e jo më për një fëmijë. Fëmijët janë detyruar të qëllojnë me armë mbi gjithë familjen e tyre. Çfarë duhet të bëjnë ata tani? Ata enden nëpër rrugë, të mbushur me zemërim dhe përpiqen të gjejnë një mënyrë për të harruar çfarë kanë bërë. Ata kanë nevojë për ndihmë dhe unë lutem sot e i kërkoj Perëndisë të më përdorë. Unë mund ta heq mendjen nga vetja qëllimisht dhe të mendoj për njerëz të tillë siç ju përshkrova-njerëz që kanë probleme të vërteta.

I mbaj mend vështirësitë e pashpresa mbi fytyrat e njerëzve kur pata privilegjin të udhëtoja në Ugandë dhe do të vazhdoj të gjitha përpjekjet për t'u dërguar atyre ndihmë. E imagjinoj veten ndërsa përpiqem të vendos një buzëqeshje në fytyrat e tyre të vogla për të zëvendësuar zemërimin që pashë kur erdha për herë të parë. Imagjinoj se si do të jenë jetët e tyre pasi t'i ndihmojmë të ndërtojnë një fshat të ri adoptues ku ata mund të kenë prindër adoptivë, ushqim të mirë, dashuri dhe edukim si edhe mësim të duhura rreth Jezusit dhe planit të Tij për jetën e tyre.

Fëmija Ushtar

"Të lutem Perëndi, boll me vrasje! Jo sot! Nuk mund të shoh dot më!". Kjo ishte lutja.

Që prej larg, Allen-i mund të dëgjojë ulërimat, shpërthimin e mprehtë të të shtënave dhe pushtohet nga paniku i terrorit absolut. Ai e di tepër mirë kuptimin e atyre zhurmave. Si mund t'i harrojë? Ishin të njëjtat zhurma që dëgjoji tamam para se ushtarët sulmuan fshatin dhe me dhunë rrëmbyen nënën dhe babain e tij, duke i rrahur brutalisht deri në vdekje për të frikësuar dhe shtrënguar të rrëmbyerit e tjerë.

Në atë ditë të tmerrshme, rebelët e lanë Allen-in pas. Por pasi ishte fshehur nëpër shkurre së bashku me pesë djem të tjerë, duke fjetur përdhé, pa ujë e pa ushqime, rebelët i gjetën. Allen ishte vetëm dhjetë vjeç.

Që nga momenti që u rrëmbye, ai rrihej dy ose tre herë në ditë dhe i jepej pak ushqim ose ujë. "Çohu djalë! Është koha për të parë se si vdesin shokët e tu!" - i bërtiste ushtari Allen-it. Atë e detyronin të shikonte, ndërsa ushtarët qëllonin shokët e tij me çomange në kokë derisa ata të binin përdhe pa ndjenja në pellgun e gjakut të tyre. Nën kërcënimin e vdekjes, rebelët e detyruan të kryente gjithashtu akte të neveritshme. Ai e ndjente që zemra po i rrëshqiste në errësirë ...

Sonte Allen-i po bën plane të largohet kur të dërgohet për të mbledhur dru për zjarr. Ai do të vrapojë shumë fort ... do të vrapojë derisa të rrëzohet nëse i duhet. Ëndrra e tij është liria. Ndoshta, nëse vrapon mjaft larg, do të mund të jetojë një ditë pa vrasje dhe ndoshta do të fillojë të shërohet.

Aktualisht, Allen jeton në një fshat të ri në Gulu të Ugandës, i ndërtuar për të strehuar dhe ndihmuar fëmijët ushtarë. Shërbesa e Joyce Meyer, në partneritet me Shërbesat Watoto,

është duke ndihmuar në zhvillimin e këtij fshati për të arritur fëmijët e vuajtur.

Statistikat thonë:

- Ushtria e Rezistencës së Zotit ka rrëmbyer mbi tridhjetë mijë fëmijë për të shërbyer si ushtarë ose skllavër të seksit në Uganda.³
- Në vitin 2007, ka pasur rreth 250,000 fëmijë ushtarë në të gjithë botën.⁴

Ndërsa po vendosja nëse duhej të qëndroja në vendin e mbledhjes së plehrave gjithë ditën, mora një e-mail nga disa miq që i kanë shërbyer Perëndisë për më shumë se njëzet e pesë vjet. Ishte një lajm për djalin e tyre njëzet e dy vjeçar, i cili ka një kancer në gjëndrat tiroide që po i kërcënon jetën. Nëse shoh përtej vetes dhe kuptoj se në botë po ndodhin shumë gjëra përveç "meje", dalëngadalë filloj të ndjehem më pak e shqetësuar për problemet e mia dhe më shumë mirënjohëse për bekimet.

Habitem kur mendoj sa shumë prej problemeve tona lidhen me atë që mendojmë. Për sa kohë mendoj për atë që doja por që nuk e mora, më bie humori poshtë e më poshtë. Por kur mendoj për ato që kam dhe tragjeditë me të cilat po përballen njerëzit e tjerë, kuptoj se në të vërtetë nuk kam aspak probleme. Në vend që të ndihem keq, mund të bëhem mirënjohëse!

I jam mirënjohëse përjetësisht Perëndisë që më kujton të jem aktive dhe të bëj të mirën, sepse mos harroni: ne e mposhtim të keqen me të mirë (shih Rom 12:21). A ju ka keqtrajtuar ndokush? Pse të mos luteni për të? Do t'ju bëjë të ndiheni më mirë. A keni pasur ndonjë zhgënjim? Kërkojini Perëndisë t'ju tregojë njerëz të tjerë që janë më të zhgënjyer se ju dhe përpiquuni t'i inkurajoni. Kjo

do t'i ndihmojë ata dhe në të njëjtën kohë do t'ju bëjë juve të ndiheni më mirë.

Bota po bëhet gjithnjë e më e dhunshme. Ndërsa po shkruaj, më ka ardhur një tjetër mesazh-një tekst që më informonte se një kishë në një qytet tjetër përjetoi të shtëna sporadike mbrëmjen e shkuar. Dy persona kanë vdekur dhe pesë të tjerë janë plagosur. Më kujtohet çfarë thotë Bibla tek vargjet e Mateut 24, të cilat flasin për shenjat e kohëve të fundit dhe thonë se mes gjithë dhunës dhe nevojës së madhe, dashuria e shumë njerëzve do të ftohet. Kjo është ajo kundër së cilës duhet të luftojmë. Ne nuk mund ta lëmë dashurinë të zhduket sepse nëse e lejojmë, jemi duke ia dorëzuar planetin së keqes.

Kur dëgjova për të shtënat në kishë, mund të kisha thënë: "Oh, sa keq!". Mund të isha ndjerë keq për disa minuta dhe pastaj të isha kthyer tek zhgënjimet e mia. Por unë refuzova të sillesha ashtu, sepse nuk do të jetoj me atë lloj sjelljeje. Pasi dëgjova për këtë krizë, u mendova për disa minuta dhe vendosa t'i kërkoja djalit tim të merrte pastorin në telefon dhe ta pyeste pastorin se si mund t'i ndihmonim. Ndoshta familjet që humbën njerëzit e tyre të dashur kanë nevojë për ndonjë gjë apo thjesht të dinë se dikush kujdeset dhe ndihmon.

Habitem kur mendoj se sa shpesh kalojmë kohë të vështira dhe asnjë nuk na telefonon. Besoj se njerëzit mendojnë se ndoshta këtë gjë po e bëjnë të tjerët dhe kështu asnjë nuk e bën.

Kujt i Takon Kjo Punë?

Kjo është një histori që e kam dëgjuar vite më parë për katër persona të quajtur Çdonjëri, Dikushi, Ndonjëri dhe Askushi. Ishte një punë shumë e rëndësishme për t'u bërë dhe Çdonjëri ishte i sigurt se Dikush do ta bënte. Ndonjëri mund ta kishte bërë, por

Askush nuk e bëri. Dikush u zemërua shumë për këtë gjë sepse ishte detyra e Çdonjërit. Çdonjëri mendoi se Ndonjëri mund ta bënte, por Askush nuk e kuptoi se Çdonjëri nuk do ta bënte. Në fund, Çdonjëri fajësoi Dikushin kur Askush nuk bëri atë që Ndonjëri mund ta kishte bërë.

Një herë kam lexuar për një incident tronditës që pasqyron në mënyrë tragjike parimet e kësaj historie në jetën e vërtetë. Në vitin 1964, Catherine Genovese u godit me thika për tridhjetë e pesë minuta, deri në vdekje, ndërsa tridhjetë e tetë komshinj po shikonin ngjarjen. Reagimi i tyre u përshkrua si i ftohtë dhe moskokëçarës, rezultat i mosinteresimit dhe ftohjes urbane. Më vonë, kërkimi i kryer nga Latane dhe Darley zbuloi se asnjë nuk kishte ndihmuar thjesht sepse kishte kaq shumë shikues. Dëshmitarët e ngjarjes panë njëri-tjetrin për drejtim se çfarë duhej bërë. Meqenëse asnjë nuk po bënte asgjë, vendosën që asnjë nuk duhej të bënte asgjë.

Njerëzit kanë më pak të ngjarë të marrin ndihmë nëse numri i spektatorëve rritet. Një student që shfaqej të kishte kriza epileptike u ndihmua në 85 % të rasteve kur vetëm një shikues ishte i pranishëm, por kur disa njerëz ishin të pranishëm, ai mori ndihmë vetëm në 31 % të rasteve.

Ky studim provon se sa më shumë që njerëzit nuk bëjnë asgjë, aq më tepër nuk do të bëjnë asgjë. Por në qoftë se një grup i vogël njerëzish të përkushtuar do të fillojnë t'u gjenden pranë të tjerëve me përkujdesje dhe dashuri, me buzëqeshje dhe komplimente, mirënjohje dhe respekt, etj, atëherë kjo lëvizje mund dhe do të rritet.

Studimet kanë provuar se ne ndikohemi shumë nga çfarë bëjnë njerëzit rreth nesh. Ne shikojmë njëri-tjetrin për drejtim edhe kur jemi krejtësisht të pavetëdijshëm që jemi duke e bërë këtë gjë. Shumica e njerëzve do të bien dakord me shumicën edhe nëse nuk janë tërësisht dakord. Ata e bëjnë këtë thjesht për të qenë pjesë e grupit.

Nëse duam të jemi pjesë e Revolucionit të Dashurisë, ne si të krishterë duhet të bëhemi shembuj për të tjerët, në vend që thjesht

të shkrihemi në sistemin e botës. Nëse dikush do të kishte guxim të mjaftueshëm për të vepruar apo dashuri të mjaftueshme për të ndihmuar, jeta e Catherine Genovese-s do të ishte shpëtuar.

*A Po Bëni Lutje të Cilave Perëndia
Mund t'u Përgjigjet?*

Dëshiroj t'ju sugjeroj diçka që ju mund ta shtoni në lutjet tuaja të përditshme. Çdo ditë, pyeteni Perëndinë se çfarë mund të bëni për Të. Pastaj, ndërsa vazhdoni me ditën tuaj, shikoni mundësitë për të bërë atë që mendoni se do të bënte Jezusi nëse Ai do të ishte akoma në Tokë në formë trupore. Ai jeton në ju tani nëse jeni i krishterë dhe jeni ambasadori i Tij, prandaj sigurohuni ta përfaqësoni shumë mirë Atë. Kam kaluar shumë vite ku në lutjet e mëngjesit i kam thënë Zotit se çfarë Ai mund të bënte për mua, por vetëm këto kohët e fundit i kam shtuar këtë pjesë të re: "Perëndi, çfarë mund të bëj për Ty sot?".

S'ka shumë kohë që po i kërkoja Perëndisë të ndihmonte një mikeshë e cila po kalonte një kohë shumë të vështirë. Ajo kishte nevojë për diçka, prandaj unë i kërkoja Perëndisë të siguronte për të. Për habinë time, Ai mu përgjigj: "Boll më kërrove Mua për të siguruar për nevojat e saj; Më kërko të të tregoj se çfarë ti mund të bësh". Kam kuptuar se shpesh i kërkoj Perëndisë të bëjë gjëra për mua kur Ai do që unë t'i bëj ato gjëra vetë. Ai nuk pret që të bëj asgjë pa ndihmën e Tij, por as nuk do të bëjë gjithçka për mua, ndërsa unë qëndroj duarkryq. Perëndia dëshiron që ne të jemi të hapur për t'u përfshirë. Ai dëshiron që ne të përdorim burimet tona për të ndihmuar njerëz të tjerë dhe nëse ajo që kemi nuk

Perëndia dëshiron që ne të jemi të hapur për t'u përfshirë.

është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e tyre, atëherë mund të inkurajojmë të tjerë për t'u përfshirë, në mënyrë që së bashku të bëjmë atë që duhet bërë.

Unë ju inkurajoj të bëni lutje të cilave Perëndia mund t'u përgjigjet. Ti dhe Ai jeni partnerë dhe Ai dëshiron të punojë *me* dhe *nëpërmjet* jush. Kërkojini Atij t'ju tregojë se çfarë mund të bëni dhe mbështetuni në Të për t'ju dhënë jo vetëm krijimtarinë, por edhe burimet për ta realizuar atë.

Mos u frikësoni kur them "Përdorni burimet tuaja". Unë po flas për më shumë se paratë. Burimet tona përfshijnë energjinë, kohën, talentet dhe pasurinë materiale, si dhe financat tona. Ndiurma ndaj dikujt mund të përfshijë para, por shpesh ka të bëjë me kohën që na duhet të shpenzojmë dhe unë mendoj se, në shoqërinë tonë, ne jemi kaq të lidhur me kohën, sa që shpesh e kemi më të lehtë t'i japim para dikujt që është në nevojë sesa të kalojmë kohë duke u kujdesur për të. Unë kam kuptuar dhe tani besoj, se ajo që unë e quaj shërbesa e "të qëndruarit pranë", është shpesh ajo për të cilën njerëzit kanë më shumë nevojë.

Një mikesha ime jeton në një qytet të madh ku të pastrehët janë një problem i madh. Një natë dimri, ndërsa po kthehej nga puna në shtëpi, kaloi pranë një njeriu që lypte për para. Ishte ftohtë dhe errësirë, ajo kishte kaluar një ditë të gjatë e të lodhshme dhe mezi priste të arrinte në shtëpi. Duke mos dashur të nxirrte portofolin në një situatë jo të sigurt, ajo futi dorën thellë në çantë për të gjetur ndonjë monedhë. Ndërsa gishtat e saj po kërkonin në çantë, lypsari filloi t'i tregonte se i kishin vjedhur pallton në qendrën e të pastrehëve ku kishte qëndruar një natë më parë dhe për disa vështirësi të tjera ai kishte kaluar. Ende duke u përpjekur të gjente disa monedha, ajo tundte kokën në momentet e duhura dhe herë pas here thoshte "Sa keq!". Kur më në fund i gjeti paratë, ajo i la në kutinë e lypsarit. Ai buzëqeshi dhe tha: "Faleminderit që fole me mua." Mikja ime thotë se atë natë ajo kuptoi se lypsari i kishte

vlerësuar qindarkat që ajo i dha, por ajo që ai kishte vlerësuar më shumë ishte fakti se dikush e kishte dëgjuar dhe i ishte përgjigjur.

Në kemi një ekip njerëzish nga shërbesa jonë, të cilët përpiqen të ndihmojnë njerëzit që jetojnë në tunelet nën urën e qendrës së qytetit. Ata kanë zbuluar se secili nga këta njerëz ka pasur një jetë normale para se të vinte në tunele dhe ata të gjithë kanë nga një histori. Diçka tragjike u ka ndodhur që i çoi në rrethanat e tyre aktuale. Ata i vlerësojmë sanduiçet dhe vajtjet në kishë ku ata mund të lahen dhe të marrin rroba të pastra, por më shumë ata vlerësojnë dikë që ka kohë të mjaftueshme për të biseduar me ta dhe për të parë kush janë dhe se çfarë u ka ndodhur.

Më lejoni t'ju inkurajoj të bëni çdo gjë që mundeni për t'i ndihmuar të tjerët. Nëse ata thjesht kanë nevojë që t'u gjendeni pranë, atëherë kaloni kohë për ta bërë këtë gjë. Kërkojini Perëndisë se çfarë Ai dëshiron që ju të bëni-dhe Ai do t'i përgjigjet lutjes suaj në mënyrë të tillë që ju të mund të veproni.

Praktikoni Mirësinë Agresive

A besoni se bota është e mbushur me padrejtësi? A mendoni se duhet bërë diçka për fëmijët e uritur? A duhet dikush të ndihmojë 1.100.000 njerëz të cilët nuk kanë ujë të pijshëm? A duhet të jetojnë njerëzit në rrugë dhe nën ura? A duhet që një familje me të cilën keni shkuar në kishë për vite me radhë, të përjetojë një tragjedi dhe të mos marrë asnjë telefonatë nga dikush për të pyetur se pse ata nuk kanë qenë në kishë për tre muaj? Nëse një kishë e një denominacioni tjetër në qytetin tuaj digjet nga zjarri, a është e përshtatshme vetëm të lutesh dhe të mos bësh asgjë praktike për t'i ndihmuar? A besoni se dikush duhet të bëjë diçka në lidhje me padrejtësinë? Unë mendoj se disi u jeni përgjigjur saktë të gjithë këtyre pyetje, kështu që kam një pyetje të fundit: Çfarë do të bëni?

A do të jeni ju ai "dikush" që bën atë që duhet bërë?

Kur ju pyes se çfarë do të bëni, a mos ndoshta ndjeheni të frikësuar kur mendoni se çfarë do të thotë "të bësh diçka"? Unë e kuptoj ndjenjën e të qenit të pushtuar nga paniku. Në fund të fundit, nëse me të vërtetë vendos të harroj veten dhe të filloj të përpiqem në mënyrë agresive për të ndihmuar, çfarë do të ndodhë me mua? Kush do të kujdeset për mua, nëse nuk do të kujdesem unë për veten time? Perëndia ka thënë se Ai do të kujdeset, kështu që unë mendoj se ne duhet të zbulojmë nëse Ai e kishte me të vërtetë atë që ka thënë. Përse të mos tërhiqemi nga "kujdesi për veten" dhe të shohim nëse Perëndia mund të bëjë një punë më të mirë sesa ju. Nëse do të kujdeseni për biznesin e Tij, i cili është të ndihmosh njerëzit e përvuajtur, unë besoj se Ai do të kujdeset për punët tona.

Vazhdoni të Lëvizni

Ndërsa e mbyll këtë kapitull, më lejoni të them se e kuptoj se në jetë mund të na ndodhin gjëra që na shtyjnë të tërhiqemi nga bota për një farë kohe. Unë e kuptoj se kur ndodhin ndryshime të mëdha në jetë, ato kërkojnë një periudhë përshtatjeje dhe gjithashtu e di se humbjet ose traumat mund t'i bëjnë njerëzit të mos duan të bashkëveprojnë ose t'i ndihmojnë të tjerët. Unë jam në favor të këtyre gjërave dhe nëse keni përjetuar një humbje të tillë që ju ka lënë të mpirë dhe me ndjesinë për të mos bërë asgjë, e kuptoj se si ndiheni, por unë dua t'ju inkurajoj ta mbani veten në lëvizje. Djalli dëshiron t'ju mbajë të izoluar sepse kur jeni të vetëm, nuk mund të keni forcë t'i mposhtni gënjeshttrat e tij. E di se mund të tingëllojë pothuajse qesharake t'ju them të shkoni të ndihmoni dikë tjetër, por unë besoj me gjithë zemrën time, se kjo është një mbrojtje për ty, si edhe përgjigje për problemet e botës.

Më lejoni ta them përsëri: Unë besoj me vendosmëri se ne kemi nevojë për një Revolucion Dashurie. Të gjithë ne i kemi provuar egoizmin dhe depresionin, dekurajimin dhe vetë-keqardhjen dhe kemi parë frytet e tyre. Bota është e mbushur me pasojat e këtyre gjërave. Le të bashkohemi së bashku dhe të biem dakord se do ta jetojmë jetën sipas mënyrës së Perëndisë. Të biem dakord se do të jemi të ndërgjegjshëm për të qenë një bekim për të tjerët (shih Gal 6:10). Të veshim dashurinë (shih Kol 3:14). Kjo do të thotë të jemi aktivë në qëllimin për të ndihmuar të tjerët. Të shikojmë dhe të lutemi për mundësi; të bëhemi "agjentë" për Perëndinë! Çdo ditë, Jezusi ngrihej dhe bënte të mira (shih Veprat 10:38). Sa e thjeshtë që duket! Pyes veten se si e kemi humbur këtë gjë gjatë gjithë kësaj kohe.



KAPITULLI

4

I Ndërprerë nga Perëndia

Tani është koha e pranimit, jo nesër, jo në një kohë tjetër më të përshtatshme. Sot puna jonë mund të bëhet më mirë dhe jo në ndonjë ditë të ardhshme ose vit të ardhshëm.

W.E.B. DuBois

Unë shpesh qëndroj në hotele gjatë udhëtimeve të shërbesës dhe kur jam në dhomën time, gjithmonë vendos në derë shenjën "Mos Shqetësoni", që askush të mos më shqetësojë. Të vendos një shenjë të tillë në derën e dhomës së hotelit është e pranueshme, por të kem një të tillë në jetën time, nuk është.

A e keni vënë re ndonjëherë se Perëndia nuk i bën gjithmonë gjërat sipas orarit tuaj ose në mënyra që janë të rehatshme për ne? Pali i tha Timoteut se si shërbëtor i Perëndisë dhe shërbenjës i ungjillit, atij i duhej të përmbushte detyrat e tij qofshin këto të lehta apo të mundimshme (shih 2 Tim 4:2). Nuk besoj që Timoteu të ishte aq i dhënë pas komoditetit sa jemi ne sot, e megjithatë Pali mendonte se ishte e rëndësishme t'i kujtonte atij të ishte i përgatitur për të qenë i ndërprerë nga Perëndia ose i shtyrë prej Tij për të bërë

gjëra të mundimshme për të. Nëse Timoteu e kishte të nevojshme të dëgjonte këtë mesazh, unë jam e sigurt se edhe ne na duhet ta dëgjojmë shpesh këtë mesazh, sepse ne ndoshta jemi më të varur nga komoditeti sesa Timoteu. Që të shoh se sa shumë e vlerësoj komoditetin, mjafton të dëgjoj veten të ankohem kur madje edhe pajisja më e vogël që kam, nuk punon siç duhet-pjatararësja, kondicioneri, tharësja e flokëve, rrobatharësja, lavatriçja, mikrovala apo gjëra të tjera të panumërta.

I dëgjoj njerëzit në konferencat tona në Amerikë të ankohen sepse kanë parkuar disa blloqe larg vendit të konferencës, por në Indi, njerëzit ecin tre ditë në këmbë për të shkuar në një konferencë mbi Biblën. I shoh njerëzit në Amerikë të shqetësojnë të tjerët përreth tyre për të shkuar në tualet, për të pirë ujë apo për të bërë një telefonatë, por në Indi njerëzit ulen në dhë shumicën e ditës, pa e çuar ndër mend të çohen. Në vendin tim, njerëzit ankohen nëse është shumë ftohtë ose shumë vapë, e megjithatë kur shkoj në Indi, të vetmit njerëz që dëgjoj të ankohen për vapën janë ata që kam sjellë unë me vete, duke përfshirë edhe veten time.

Unë besoj se ne jemi të varur nga komoditeti. Nuk jam duke sugjeruar që të heqim dorë nga komoditetet tona moderne dhe sigurisht që e kuptoj se dëshirojmë t'i kemi gjërat me të cilat jemi mësuar, por ne duhet të kemi mendimin e duhur në lidhje me komoditetin. Nëse mund ta kemi atë, faleminderit Perëndisë (faleminderit me të vërtetë!). Por nëse nuk jemi në gjendje t'i kemi këto lehtësira, kjo kurrë nuk duhet të na ndalojë të bëjmë çdo gjë që Perëndia na kërkon të bëjmë.

Më kujtohet një rast, disa vite më parë, kur një çift të verbërish dëshironin të vinin në seancat mësimore të së mërkurës mbrëma, të cilat mbaheshin në një qendër banketi në St. Louis. Ata zakonisht merrnin autobusin, por rruga e tyre e zakonshme ishte anuluar, kështu që mënyra e vetme që ata të mund të vazhdonin të vinin, ishte që dikush t'i merrte dhe t'i kthente më pas në shtëpi. Çfarë

mundësie! Mendova se njerëzit do të qëndronin në radhë për të ndihmuar, por askush nuk ishte i gatshëm, sepse ata jetonin në një zonë që konsiderohej "jashtë rruge".

Me fjalë të tjera, sigurimi i transportit për këtë çift do të ishte i parehatshëm. Mбай mend se këtë detyrë ia ngarkuam një prej punonjësve tanë, që do të thotë se na u desh ta paguajmë atë person. Është e habitshme se sa më të gatshëm jemi për të "ndihmuar" në qoftë se do të paguhemi për këtë gjë. Nuk duhet të harrojmë se dashuria për para është rrënja e gjithë së keqes. Nuk mund të lejojmë që paraja të jetë motivuesja jonë kryesore në jetë. Të gjithë kemi nevojë për paranë, por ne duhet t'i ndihmojmë të tjerët dhe fakti se këto vepra mirësie janë ndonjëherë të parehatshme, është vërtet mirë për ne. Shpesh, mundësi të tilla janë "kohë prove", kohë kur Perëndia na kontrollon për të parë nëse jemi apo jo të përkushtuar. Nëse jeni të gatshëm për të bërë diçka të mirë për dikë tjetër, pa pagesë dhe ndoshta pa fituar merita, kjo është shenjë pozitive që zemra juaj frymërore është në gjendje të mirë.

Kur Perëndia donte të shikonte nëse izraelitët do t'i bindeshin urdhërimeve të Tij, Ai i udhëhoqi ata në rrugën e gjatë dhe të vështirë të shkretëtirës (shih LiP 8:1-2). Ndonjëherë Ai bën të njëjtën gjë me ne. Ne jemi shumë të gatshëm t'i "bindemi" Perëndisë kur është e lehtë dhe kur shpërblehemi shpejt për përpjekjet tona. Po çfarë ndodh kur është e parehatshme, kur nuk përputhet me planin tonë dhe kur nuk duket të ketë asgjë fitimprurëse për ne? Sa të bindur jemi atëherë? Këto janë pyetje që të gjithë duhet t'ia bëjmë vetes, sepse është shumë e rëndësishme të jemi të sinqertë në lidhje me përkushtimin tonë. Është e lehtë të qëndrojmë në kishë dhe të këndojmë "Unë dorëzoj gjithçka", por çfarë bëjmë ne kur dorëzimi është më shumë se një këngë dhe është në fakt një kërkesë?

Perëndi, Tani Nuk Është Koha e Duhur

Bibla na tregon për një njeri që nuk e ndoqi Perëndinë, sepse duke bërë kështu do të ishte e parehatshme. Ky njeri, i quajtur Feliks, i kërkoi Palit të vinte dhe t'i predikonte atij ungjillin. Por kur Pali filloi t'i fliste për jetën e drejtë, pastërtinë e jetës si dhe kontrollin e pasioneve, Feliksi u alarmua dhe u frikësua. Ai i tha Palit të largohej dhe se do ta thërriste në një kohë më të përshtatshme (shih Veprat 24:25). Kjo histori më duket jashtëzakonisht zbavitëse, jo sepse është vërtet qesharake, por sepse në mënyrë të qartë paraqet mënyrën si ne jemi. Nuk e kemi problem të dëgjojmë se sa shumë Perëndia na do dhe për planet e mira që Ai ka për jetën tonë, por kur Ai fillon të na ndëshkojë ose të na korrigojë në ndonjë mënyrë, ne përpiqemi t'i themi Atij se "tani" nuk është koha e duhur. Ai kurrë nuk zgjedh një kohë që ne do ta konsideronim si "koha e duhur" dhe mendoj se Ai e bën këtë qëllimisht!

Kur izraelitët udhëtonin nëpër shkretëtirë, ata udhëhiqeshin nga një re gjatë ditës dhe një shtyllë zjarri natën. Kur reja lëvizte, atyre u duhej të lëviznin dhe kur rrinte pa lëvizur, ata qëndronin aty ku ishin. Gjëja interesante është se ata nuk dinin asnjë model ose plan se kur reja mund të lëvizte. Ata thjesht duhej të lëviznin kur reja të lëvizte (shih Num 9:15-23). Bibla thotë se ndonjëherë ajo lëvizte gjatë ditës dhe nganjëherë gjatë natës. Ndonjëherë qëndronte pa lëvizur për disa ditë dhe nganjëherë për një ditë. Nuk besoj se natën, ata varnin shenjën "Mos Shqetësoni!" në hyrje të tendave të tyre, për t'i bërë të njohur Perëndisë se nuk donin të bezdiseshin. Kur Ai vendoste se ishte koha për të ecur përpara, ata mblidhnin plaçkat dhe e ndiqnin. Dhe kur Ai vendos se është koha që ne të lëvizim drejt një tjetër niveli në udhëtimin tonë me Të, ne kurrë nuk duhet të themi "Kjo nuk është koha e duhur!".

A nuk do të kishte qenë më mirë sikur Perëndia t'u kishte dhënë një kalendar mujor duke u treguar të gjitha ditët e lëvizjes në mënyrë

që ata të mund të kishin qenë mendërisht, emocionalisht dhe fizikisht të përgatitur? Pyes veten pse Ai nuk e ka bërë këtë gjë. A na ndërpret Ai me qëllimin e vetëm për të parë se si ne do të përgjigjemi?

Perëndia njeh më të mirën dhe koha e Tij është gjithmonë e drejta. Fakti që unë nuk *ndihem* gati për të trajtuar diçka në jetën time nuk do të thotë se unë nuk jam gati. Perëndia është kreu i komisionit të "rrugëve dhe mendimeve". Rrugët e Tij nuk janë rrugët tona, por ato janë më të larta dhe më të mira se rrugët tona (shih Isa 55:9).

Përse Nuk Është më e Lehtë?

Nëse Perëndia do që ne t'i ndihmojmë njerëzit, pse nuk e bën Ai këtë gjë të lehtë dhe me kosto efektive? Më lejoni t'i përgjigjem kësaj pyetjeje me një pyetje tjetër. A sakrifikoi Jezusi ndonjë gjë për të blerë lirinë tonë nga mëkati dhe robëria? Pyes veten përse Perëndia nuk e bëri planin e shpëtimit më të lehtë. Në fund të fundit, ai mund të bënte planin që donte dhe thjesht të thoshte "Kjo do të funksionojë". Duket se në ekonominë e Perëndisë nuk ia vlen të kesh asgjë që kushton lirë. Mbreti David tha se nuk do t'i jepte Perëndisë diçka që atij nuk i kushtonte asgjë (shih 2 Sam 24:24). Unë kam mësuar se dhënia e vërtetë nuk është të japësh deri sa e ndjen që mund të japësh. Të jap të gjitha rrobat dhe sendet e mia shtëpiake, që janë të vjetra dhe me të cilat kam përfunduar punë, mund të jetë një gjest i mirë, por nuk barazohet me dhënien e vërtetë. Dhënia e vërtetë ndodh atëherë kur jap diçka që dua ta mbaj. Jam e sigurt se i keni kaluar ato kohë prove kur Perëndia ju kërkon që të dhuroni diçka që ju pëlqen. Ai na dha Birin e tij të vetëm për shkak se na do. Kështu pra, çfarë do të na shtyjë dashuria të bëjmë? A mundet, të paktën, të prishim rehatinë tonë herë pas here për të ndihmuar dikë në nevojë?

Kohët e fundit pashë një histori në televizor për një çift të ri të

cilët ishin shumë të dashuruar dhe së shpejti do të martoheshin. Tragjikisht, ajo pësoi një aksident me makinë që e la në koma për muaj të tërë. Burri me të cilin ajo do të martohej, u ul pranë saj ditë pas dite, derisa më në fund ajo u zgjua. Por vajza kishte pësuar dëmtime në tru dhe do të ishte përgjithmonë e gjymtuar dhe e paaftë të bënte shumë gjëra për veten. I riu nuk e konsideroi aspak faktin e anulimit të martesës. Ajo shkoi në kishë me karrocë invalidësh, nuk ishte në gjendje të fliste qartë për shkak të dëmtimeve të saj, por padyshim ishte tejet e gëzuar. Gjatë gjithë jetës së tij, i riu u kujdes për të dhe ata e gëzonin jetën së bashku. Me ndihmën dhe inkurajimin e tij, ajo madje u bë pjesë e Olimpiadës Speciale dhe arriti të realizonte gjëra të mahnitshme.

Do të kishte qenë shumë e lehtë dhe e kuptueshme edhe për shumicën prej nesh në qoftë se i riu thjesht do të ishte larguar. Në fund të fundit, qëndrimi me të do të thoshte parehati dhe sakrifica të përditshme për djalin. Megjithatë, ai nuk u largua siç bëjnë shumë të tjerë kur përballen me situata të pakëndshme. Ai qëndroi dhe ka shumë gjasa të ketë përjetuar më shumë gëzim në jetë sesa shumë prej nesh.

Nëse jeni si unë, ju pëlqen vërtet të lexoni për njerëz që kanë sakrifikuar aq shumë për të mirën e të tjerëve. Por, unë mendoj se Perëndia dëshiron që unë edhe ti të bëjmë më shumë se thjesht të lexojmë historitë e tyre. Ndoshta Ai do që ju të keni një histori tuajën.

I Bezdisur Për të Mirën e Dikujt Tjetër

Perëndia do të ndërhyjë në një person dhe do t'i kërkojë atij ose asaj të bëjë diçka të parehatshme për ta bërë jetën një personi tjetër më të mirë. Ne duhet të kuptojmë rrugët e Perëndisë ose përndryshe do t'i bëjmë rezistencë asaj që ne duhet të përqafojmë. E vërteta e thjeshtë është kjo: Ne duhet të japim në mënyrë që të jemi të lumtur

dhe dhënia nuk është e vërtetë nëse nuk e ndjejmë sakrificën e saj.

Pjetri, Andrea, Jakobi, Gjoni dhe dishepujt e tjerë ishin shumë të nderuar. Ata u zgjodhën të ishin dymbëdhjetë dishepujt, njerëzit të cilët do të mësonin nga Jezusi dhe pastaj do ta çonin ungjillin në botë. Të gjithë ata ishin të zënë me punë kur Jezusi i thirri. Atyre u duhej të kujdeseshin për jetën, familjet dhe punët e tyre. Pa aspak paralajmërim, Jezusi iu shfaqet dhe u thotë: "Më ndiqni!". Bibla thotë se Pjetri dhe Andrea po hidhnin rrjetat në det, kur Jezusi i thirri, dhe ata i lanë rrjetat dhe e ndoqën (shih Mt 4:18-21). Ai nuk u tha atyre se mund të luteshin për këtë gjë, ose ta mendonin, apo të shkonin në shtëpi dhe të flisnin me gratë dhe fëmijët e tyre. Ai vetëm u tha: " Më ndiqni!".

Ata nuk pyetën sa gjatë do të qëndronin të ikur ose çfarë page do të kishin. Ata nuk pyetën për përfitime, kohë kompensimi për udhëtimet, ose në çfarë hoteli do të qëndronin. Ata madje as nuk pyetën se cili ishte përshkrimi i tyre i punës. Ata thjesht lanë gjithçka dhe shkuan pas Tij. Edhe kur e lexoj këtë pasazh tani, duhet ta pranoj se duket pak e rëndë, por ndoshta sa më e madhe është mundësia, aq më e madhe duhet të jetë edhe sakrifica.

Më kujtohet njëherë kur po ankohesha për disa nga gjërat që Perëndia po më kërkonte të bëja, sepse ndjeja se ndaj të tjerëve nuk ishin vendosur të njëjtat kërkesa. Ai thjesht më tha: "Joyce, ti më ke kërkuar të të jap shumë. A do të të jap shumë, apo jo?". Unë i kisha kërkuar të isha në gjendje të ndihmoja njerëz në të gjithë botën dhe po mësoja se ky privilegj, shpeshherë do të ishte paksa i mundimshëm dhe i parehatshëm.

Është e pamundur të korresh pa mbjellë farë. Mbreti Salomon ka thënë se nëse presim që të gjitha kushtet të jenë të favorshme para se të mbjellim, nuk do të korrim kurrë (shih Pre 11:04). Me fjalë të tjera, ne duhet t'i japim dhe t'i bindemi Perëndisë në kohë të papërshtatshme për ne madje edhe kur është e kushtueshme. Ndoshta këta dymbëdhjetë burra ishin të zgjedhurit, sepse ata ishin

të gatshëm të bënin atë që askush tjetër nuk do ta bënte. Edhe pse Bibla nuk thotë se Jezusi thirri ndonjë i cili e refuzoi, ndoshta Ai e bëri. Ndoshta Atij i ishte dashur të fliste me mijëra njerëz për të arritur tek të dymbëdhjetët. Së paku mendoj se kjo është mënyra që funksionon sot. Njerëzit që janë të gatshëm të sakrifikojnë, t'u priset rehati dhe t'i ndërpresin planet e tyre janë të paktë. Shumë i këndojnë dashurisë së tyre për Jezusin dhe kjo është e bukur, por ne gjithashtu duhet të kujtojmë se edhe pse të kënduarit është gjë e bukur, nuk kërkon sakrificë. Dashuria e vërtetë kërkon sakrificë.

Unë besoj se në botë nuk shfaqet shumë dashuri e vërtetë për shkak se ajo kërkon përpjekje dhe gjithmonë kushton diçka. Ne duhet të mos e harrojmë këtë realitet nëse e kemi seriozisht që të marrim pjesë në një Revolucion Dashurie. Është gjithmonë e urtë të llogarisim kostot përpara se të marrim çdo lloj angazhimi, përndryshe, ndoshta nuk do të përfundojmë atë që kemi filluar.

Ndërprerë nga Perëndia

Sa më shumë që studioj burrat dhe gratë në Bibël, të cilët i konsiderojmë si të "mëdhenj", aq më shumë shoh se ata të gjithë bënë sakrifica të mëdha dhe nuk kishte asgjë të rehatshme në atë që Perëndia u kërkoi atyre të bëjnë.

Abrahamit iu desh të linte vendin e tij, të afërmit dhe shtëpinë e tij dhe të shkonte në një vend që Perëndia as që nuk ia tregoi deri sa ai arriti atje. Ndoshta Abrahami mendonte se mund të përfundonte në një pallat si mbret apo diçka të ngjashme, por në vend të kësaj atij iu desh të shpërngulej nga njëri vend në tjetrin, duke jetuar në tenda të përkohshme. Ai përfundoi në Egjipt-një tokë që ishte "shtypëse (intensive dhe e dhimbshme)"-në mes të një zije buke (Zan 12:10). Edhe pse sakrifica ishte e madhe, Abrahamit iu dha privilegji të ishte njeriu me të cilin Perëndia bëri

besëlidhjen dhe përmes tij të gjitha familjet e Tokës kanë mundësi të bekohen nga Perëndia (shih Zan 22:18). Mahnitëse!

Jozefi shpëtoi një komb nga uria, por jo përpara se Perëndia ta largonte atë me dhunë nga shtëpia e tij e rehatshme, ku ai ishte i preferuari i babait dhe për shumë vite e vendosi në një vend të mundimshëm. Perëndia e bëri këtë në mënyrë që ta vendoste Jozefin në vendin e duhur, në kohën e duhur. Por Jozefi mundi ta marrë vesh këtë vetëm në fund të ngjarjeve. Shpesh, ne nuk e kuptojmë pse jemi aty ku jemi dhe themi: "Perëndi, çfarë po bëj këtu?". Unë ia kam thënë këtë shumë herë Perëndisë dhe, edhe pse ai nuk u shqetësua të më përgjigjej në atë kohë, unë mund të hedh vështrimin pas tani dhe kuptoj se çdo vend ku kam qenë, është bërë pjesë e vendit që gjendem sot.

Esteri i shpëtoi judenjtë nga shkatërrimi, por Perëndia sigurisht që i ndërpreu planet e saj në mënyrë që ajo ta bënte këtë gjë. Ajo ishte një vajzë e re e cila pa dyshim kishte plane për të ardhmen e saj, kur, papritur, pa paralajmërim, asaj iu kërkua të hynte në haremën e mbretit dhe të fitonte favorin e tij në mënyrë që të nxirrte në pah planin e Hamanit të lig, që kishte për synim të vriste judenjtë.

Asaj iu kërkua të bënte gjëra që e bënin të ndihej në rrezik për sigurinë e jetës së saj, por xhaxhai i saj me mençuri tha: "Sepse po të jetë se ti hesht në këtë çast, ndihma dhe çlirimi do të vijnë për judenjtë nga një anë tjetër; por ti dhe shtëpia e atit tënd do të shuheni. Përveç kësaj, kush e di nëse është pikërisht për një kohë të tillë që ti ke arritur në pozitë mbretërore?" (Ester 4:14).

Sikur ajo të mos e kishte bërë këtë sakrificë, Perëndia do të kishte gjetur dikë tjetër, por fati i saj ishte të shpëtonte njerëzit e saj. Ai ishte qëllimi i saj në jetë. Mos e humbisni qëllimin tuaj në jetë vetëm për shkak se nuk doni që Perëndia t'i ndërpresë planet tuaja.

Lista e njerëzve që kanë hyrë në bindje sakrifikuese është e gjatë. Bibla i quan ata, njerëz për të cilët "bota nuk ishte e denjë për ta" (Heb 11:38).

Këta njerëz për të cilët lexojmë, kaluan vështirësi në mënyrë që jeta e dikujt tjetër të mund të ishte më e lehtë. Jezusi vdiq në mënyrë që ne të kemi jetë dhe ta kemi me bollëk. Ushtarët vdesin në mënyrë që civilët të mund të qëndrojnë të sigurt në shtëpitë e tyre. Etërit shkojnë në punë në mënyrë që familjet e tyre të mund të kenë jetë të mirë dhe nënat kalojnë nëpër dhimbjet e lindjes për të sjellë një tjetër jetë në botë. Duket mjaft qartë se dikush zakonisht duhet të përjetojë dhimbje ose shqetësim që dikush tjetër të fitojë diçka.

Ky kapitull është shumë i rëndësishëm, sepse nëse të jesh pjesë e një Revolucionit Dashurie është thjesht një ide që ju jep një ndjenjë të bukur, ju do të ndryshoni mendje për të qenë pjesë e tij, kur të kuptoni se do t'ju duhet të bëni disa gjëra që nuk do të preferoni t'i bënit në mënyrë që të ecni në dashuri. Do t'ju duhet të duroni dikë që do të preferoni t'i largoheshit, kjo sepse dashuria i duron dobësitë dhe mangësitë e të tjerëve. Do t'ju duhet të qëndroni në një vend jo shumë të këndshëm thjesht sepse ju jeni e vetmja dritë në errësirë. Do t'ju duhet të largoheni nga një vend për shkak se mjedisi ju josh për mëkat. Në fakt, Abrahami jetonte në mesin e idhujtarëve, duke përfshirë edhe familjen e tij, kështu që nuk është çudi që Perëndia i kërkoi të largohej nga vendi dhe populli. Ndonjëherë Perëndisë i duhet të na ndajë nga fgjërat e njohura për ne, për të na treguar atë që Ai dëshiron që ne të shohim.

Nëse do të merrni vendimin se nuk e keni problem t'ju prishet rehatia ose të ndërpriteni, atëherë Perëndia mund t'ju përdorë. Ju mund të sillni një ndryshim në botë. Por nëse mbeteni të varur në rehatinë tuaj, Perëndisë do t'i duhet t'ju anashkalojë për të gjetur një njeri me stomak të fortë për gjërat e vështira të jetës.

Nëse do të merrni vendimin se nuk e keni problem t'ju prishet rehatia ose të ndërpriteni, atëherë Perëndia mund t'ju përdorë.

Sodoma dhe Gomora

Ju ndoshta keni dëgjuar për Sodomën e Gomorën dhe ligësinë e tmerrshme në ato qytete. Por, në fakt, çfarë bënë ata që ishte aq e papëlqyeshme për Perëndinë? Ne shpesh mendojmë se çoroditja e tyre seksuale e shtyu më në fund Perëndinë dhe e detyroi Atë t'i shkatërronte, por në fakt ishte një situatë krejt e ndryshme që e bëri Atë të vepronte kundër tyre. Unë u trondita kur pashë të vërtetën e shkatërrimit të tyre. E zbulova ndërsa kërkoja Shkrimet në lidhje me nevojën për të ushqyer të varfrit. "Ja, *kjo qe paudhësia* e motrës sate Sodoma: ajo dhe bijat e saj jetonin në krenari, në bollëkun e bukës dhe në një plogështi të theksuar, por nuk përkrahnin dorën e të përvuajturit dhe të të varfrit. Ishin fodulle dhe kryenin neveri përpara meje; prandaj i hoqa nga mesi, kur e pashë këtë "(Eze 16:49-50, theksi i imi).

Problemi me Sodomën dhe Gomorën ishte se ato kishin shumë dhe nuk po i ndanin me njerëzit në nevojë. Ata ishin të plogësht dhe jetonin një jetë tepër të rehatshme, gjë që i çoi të kryenin akte të neveritshme. Nga kjo shohim qartë se përtacia dhe rehatia e tepruar nuk është e mirë për ne dhe na çon në më shumë probleme. Mosndarja e atyre që kemi me njerëzit që kanë më pak se ne, nuk është e mirë për ne dhe është në fakt e rrezikshme, sepse kjo lloj jete egoiste lejon që e keqja të përparojë. Jo vetëm që këto gjëra nuk janë të mira për ne, por ato janë ofenduese edhe ndaj Perëndisë. Ai pret që ne të jemi kanale ku Ai të rrjedhë, jo rezervuarë që të mbajmë çdo gjë që kemi për veten tonë.

Ne i vlerësojmë të gjitha të mirat që janë në dispozicion për ne sot, por në një farë mënyre, mendoj se Satani po i përdor ato për të shkatërruar çdo gatishmëri për të dalë nga zona e rehatisë e për t'iu bindur Perëndisë ose për të ndihmuar të tjerët që janë në nevojë. Ne kemi krijuar varësi ndaj gjërave lehtësuese, dhe prandaj duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm. Ashtu si shumica e

njerëzve, edhe mua më pëlqejnë gjërat e bukura e të rehatshme. Më pëlqen komoditeti, por gjithashtu përpqem të mos ankojem kur nuk i kam gjërat ashtu si i dua unë. Gjithashtu e kuptoj se prishja e rehatisë është pothuajse gjithmonë pjesë e dhënies së ndihmës të tjerëve dhe unë e di se jam thirrur nga Perëndia për të ndihmuar njerëzit dhe për ta bërë këtë me një qëndrim të mirë.

Mua nuk më pëlqen të më ndërpresin ndërsa shkruaj. Është shumë e bezdisshme për mua nëse ndërpritej, sepse atëherë më duhen shumë përpjekje për t'u kthyer në rrjedhën e punës. Vetëm pak çaste më parë u vura në provë. Më ra telefoni dhe pashë se ishte një grua që e dija se do të më duhej ta dëgjoja për një kohë të gjatë mbi martesën e saj të trazuar. Unë nuk doja domosdoshmërisht të ndaloja së shkruari, por e ndjeja se duhej, sepse kjo grua e veçantë është një njeri i njohur dhe nuk ka njeri të besuar me të cilin mund të flasë. Vetëm për shkak se një person është i mirënjohur në botë, nuk do të thotë se ai nuk është i vetmuar. Ajo është një grua e vetmuar, e njohur ndërkombëtarisht që ka një problem dhe Perëndia donte që unë të ndërprisja shkrimin tim mbi dashurinë që në fakt ta praktikojta atë!! Imagjinojeni këtë. . . Perëndia do që ne të praktikojmë atë që themi se besojmë.



KAPITULLI

5

Dashuria e Gjen Një Rrugë

Dështimi kurrë nuk do të më mposhtë nëse
vendosmëria për të pasur sukses është e fortë mjaftueshëm.

Og Mandino

Dëshira është një motivues i fuqishëm. Më në fund jam përballë me të vërtetën se në qoftë se vërtet dua të bëj diçka, do ta gjej mënyrën për ta bërë. Njerëzit shpesh më pyesin se si arrij t'i bëj gjërat që unë bëj dhe unë thjesht u them: "Sepse dua t'i bëj". E kuptoj që Perëndia më ka dhënë hir dhe ka vendosur dëshirat në zemrën time, por është fakti që unë *dua* të bëj gjëra të caktuara që më motivon për t'i bërë ato. Unë dua të bëj atë që Perëndia dëshiron që unë të bëj. Unë dua t'i ndihmoj njerëzit dhe dua të përmbush fatin tim, apo si thotë apostulli Pal: "Unë dua të përfundoj garën time".

Ju mund të pyesni: "Çfarë ndodh nëse nuk e kam atë dëshirë?". Ju padyshim që dëshironi të bëni vullnetin e Perëndisë, ose përndryshe do ta kishit lënë së lexuari këtë libër që në kapitullin e parë. Nëse keni një marrëdhënie me Perëndinë, nëpërmjet Jezu Krishtit, atëherë e keni dëshirën për të bërë mirë, sepse Ai ju ka

dhënë zemrën dhe Frymën e Tij. Ezekieli 11:19 premton: " Dhe unë do t'u jap atyre një zemër tjetër [një zemër të re] dhe do t'u shtie përbrenda një frymë të re, do të heq nga mishi i tyre zemrën prej guri [e forcuar në mënyrë jo të natyrshme] dhe do t'u jap një zemër prej mishi [të ndjeshme dhe reaguese ndaj prekjes së Perëndisë] ". Ne mund të bëhemi dembelë, pasivë ose egoistë dhe ndonjëherë na duhet të merremi me këto çështje, por si besimtarë është e pamundur të kemi zemrën e Perëndisë dhe të mos duam t'i bindemi Atij dhe t'i ndihmojmë njerëzit.

Pyetja është: Sa shumë e dëshironi? A doni të bëni vullnetin e Tij më shumë se tuajin? A e doni mjaftueshëm sa për të sakrifikuar gjërat e tjera?

Kohët e fundit një djalë i ri më tregoi se sa i palumtur ishte. Ai vazhdoi të më tregonte se e dinte që Perëndia po e thërriste në një vend më të lartë, por shtoi se ndjente që nuk ishte i gatshëm për të bërë sakrificën e nevojshme. U trishtova për të sepse nuk dua që ai të humbasë gëzimin që është në anën tjetër të sakrificës. Lutem që ai të ndërrojë mendje.

Nëse me të vërtetë duam të bëjmë diçka, do ta gjejmë mënyrën për ta bërë. Derisa ta pranojmë këtë, do ta kalojmë jetën të mashtruar nga justifikimet tona se pse nuk mund t'i bëjmë këto gjëra. Justifikimet janë shumë të rrezikshme dhe unë besoj se ato janë një nga arsyet kryesore që ne nuk arrijmë përparimin që dëshirojmë. Ndoshta ju do të donit të bënit fizkulturë, por dilni me një justifikim përse nuk mund ta bëni. Ndoshta ju doni të kaloni më shumë kohë me familjen tuaj, por keni një justifikim përse nuk mund ta bëni. Ndoshta keni kuptuar se duhet të jepni më shumë nga vetja për të ndihmuar të tjerët dhe ju dëshironi ta bëni këtë gjë, por ka gjithmonë arsye (justifikime) përse nuk e bëni. Satani është ai që na i jep justifikimet; derisa ne të kuptojmë se justifikimet na mashtrojnë dhe na mbajnë në mosbindje, do të mbetemi të mbërthyer në një jetë të trishtuar e të pafrytshme.

Një i Afërm i Mirë

Jezusi tha: "Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë forcën tënde dhe me gjithë mendjen tënde, edhe të afërmin tënd porsì vetveten" (Luka 10:27). Ai vazhdoi duke i thënë avokatit me të cilin po fliste se, nëse do të bënte kështu, ai do të kishte jetë, që do të thotë se do të gëzonte një jetë aktive, të bekuar, të pafundme në mbretërinë e Perëndisë. Duke dashur ta lironte veten nga çdo qortim, avokati tha: "E kush është i afërmi im?" Ai donte të dinte saktësisht se cilët ishin këta njerëz, të cilëve ai duhej t'u tregonte dashuri dhe Jezusi iu përgjigj duke i treguar një histori.

Një burrë, i cili po udhëtonte, u sulmua nga grabitësit që i morën sendet personale dhe e rrahën, pastaj e lanë gati të vdekur, shtrirë në anë të rrugës. Rrugës kaloi një prift (një njeri fetar). Ai e pa njeriun që kishte nevojë për ndihmë, por vazhdoi të ecte në anën tjetër të rrugës. Nuk e di nëse ai ishte tashmë në anën tjetër të rrugës apo e kaloi rrugën që njeriu i plagosur të mos e shihte dhe të kërkonte ndihmë, por ai u siguria të mos ecte pranë të plagosurit. Pastaj kaloi një tjetër burrë fetar, një levit, i cili gjithashtu vazhdoi të ecte në anën tjetër të rrugës. Ndoshta këta burra fetarë nguteshin për të shkuar në kishë dhe nuk kishin kohë që në fakt të bënin atë që kisha duhej t'u kishte mësuar. Njerëzit fetarë, shpesh, i përgjigjen nevojës me fjalë fetare, pa ofruar ndihmë praktike. Unë besoj se ky është një nga problemet më të mëdha që kemi sot në krishtërim. Ne jemi krenarë për atë që ne gjoja "dimë", por në shumë raste nuk bëjmë shumë me njohuritë që kemi. Ne flasim shumë, por jo gjithmonë u tregojmë njerëzve atë që duhet të shohin-dhe kjo është dashuria në veprim.

Pasi këta dy burra fetarë kaluan pranë njeriut që gjendej dëshpërimisht në nevojë për ndihmë, një burrë samaritan, një njeri jo shumë fetar, po udhëtonte në të njëjtën rrugë. Kur pa njeriun në

nevojë, ai u mbush me keqardhje e simpati dhe iu afrua për t'i mbuluar plagët. Pas kësaj, e vendosi në kalin e tij dhe e çoi në një han. Samaritani i dha hanxhiut pagën e dy ditëve dhe i kërkoi të kujdeset për të plagosurin derisa ai të kthehej, kohë në të cilën do t'i paguante edhe shpenzimet shtesë. Jezusi e pyeti avokatin se cili prej tre burrave e dëshmoi veten si një i afërm (shiko Luka 10:27-37).

Disa aspekte të kësaj historie më tërheqin vëmendjen. Së pari, siç e përmenda edhe më parë, njerëzit fetarë nuk bëjnë asgjë. Ne duhet të refuzojmë të mos bëjmë asgjë! Edhe nëse ajo çka mund të bëjmë është e vogël, ne, në mënyrë absolute, duhet ta gjejmë mënyrën për të bërë diçka për përmbushjen e nevojave për të cilat Perëndia na bën të vetëdijshëm. Unë e pranoj se ka raste kur gjithçka që mund të bëjmë është të lutemi, ose ndoshta të ofrojmë ndonjë fjalë inkurajuese, por të paktën duhet të jemi aq aktivë sa për të gjetur një mënyrë për të ndihmuar. Ne duhet të paktën të mendojmë për të dhe jo vetëm të supozojmë se nuk mund të bëjmë asgjë, ose, edhe më keq, të gjejmë një justifikim për të mos bërë asgjë, thjesht sepse nuk duam të shqetësohemi.

Gjëja tjetër që më prek në këtë histori është se samaritani e futi veten në mjaft telashe për të ndihmuar njeriun në nevojë. Mendoj se ai u vonua shumë për atje ku ishte nisur. Ai ishte padyshim duke shkuar diku ku i duhej të shkonte, sepse u largua nga njeriu i plagosur goxha kohë për të mbaruar punë para se të kthehej. Ai investoi kohë dhe para, dhe ishte i gatshëm të futej në siklet për t'u kujdesur për dikë në nevojë.

Gjithashtu shoh se samaritani nuk e lejoi këtë nevojë urgjente ta shkëpuste nga qëllimi i tij fillestar. Kjo është gjithashtu e rëndësishme, sepse nganjëherë njerëzit shtyhen kaq shumë nga emocionet e mëshirës, saqë nuk mund përqendrohen më në realizimin e qëllimeve të tyre. Vajza jonë, Sandra, dëshiron shumë, shumë, shumë t'i ndihmojë njerëzit dhe kjo është një gjë e mirë, por jo më vonë se dje ajo më mori në telefon dhe më kërkoi të

lutesha për të që ajo të ketë ekuilibër dhe qartësi se cilin të ndihmojë dhe deri në çfarë mase. Asaj i duhet të kujdeset për dy vajzat e saj binjake, jep mësim mbi prindërimin në kishën e saj dhe ka gjithashtu edhe disa përkushtime ndaj të cilave ndjehet se duhet t'u qëndrojë besnike, e megjithatë ajo vazhdon të dëgjojë nevojat e të tjerëve dhe dëshiron të ndihmojë! Shumë shpesh ajo përfshihet në dhënien e ndihmës pa u menduar se çfarë do të thotë për të apo si do të mund të ndihmojë pa anashkaluar përparësitë e tjera të saj. Rezultati është se, ndonjëherë, në dëshirën e saj të mirë për të ndihmuar, ajo ndjehet e acaruar dhe e hutuar, gjë e cila nuk është aspak vullneti i Perëndisë.

E inkurajova Sandrën të bënte atë që samaritani bëri në historinë e Jezusit dhe po ju inkurajoj edhe juve në të njëjtën mënyrë. Jini të gatshëm të ndryshoni planin tuaj dhe të bezdiseni, jini të gatshëm të jepni kohë dhe të holla, nëse është e nevojshme, për të ndihmuar në përmbushjen e nevojave. Por mos u përpiqni të bëni çdo gjë vetë kur ka edhe njerëz të tjerë që mund të ndihmojnë. Samaritani rekrutoi si ndihmës hanxhiun, në mënyrë që ai të mund të përqendrohej në çështjen për të cilën kishte marrë rrugën.

Djali nuk duket se e ka problem se në cilin kanal kemi përfunduar për sa kohë që nuk jemi në mes të rrugës. Me fjalë të tjera, njerëzit ose nuk bëjnë asgjë, ose përpiqen të bëjnë gjithçka dhe pastaj dekurajohen ose ndjehen të shfrytëzuar. Çdo aspekt i jetës sonë kërkon ekuilibër, madje edhe ndihma ndaj të tjerëve. Unë kam mësuar, jo pa vështirësi, se nuk mund të bëj çdo gjë dhe të bëj gjithçka mirë, dhe kjo është e vërtetë për të gjithë ne. Por, nga ana tjetër, unë nuk mund ta lejoj frikën se mos përfshihem më tepër se ç'duhet të më bëjë të mos përfshihem fare.

Unë gjithashtu shoh se samaritani nuk vuri kufizime në atë që ai ishte i gatshëm për të paguante për këtë nevojë. Ai i tha hanxhiut se do t'i jepte gjithë koston e përkujdesjes ndaj të plagosurit kur të kthehej. Të rrallë janë ata njerëz që janë të gatshëm të bëjnë *çdo gjë* që duhet bërë.

Siç e përmenda edhe më parë, ndonjëherë na duhet të vendosim kufizime në mënyrë që të mbrojmë prioritetet tona të tjera, por në këtë rast njeriu me sa duket kishte mjaft të holla, kështu që ai nuk kishte nevojë të vendoste kufizime. Ai veptoi nga bujaria, jo nga frika. Perëndia nuk mund t'i kërkojë çdonjërit prej nesh që të bëjë gjithçka të nevojshme për të zgjidhur një problem ose për të përmbushur një nevojë, por Ai dëshiron që secili prej nesh të bëjë gjithçka mundet. Dhe, në qoftë se ai na kërkon të bëjmë gjithçka, atëherë ne duhet të bëjmë gjithçka! Dhënia e gjithë vetes sonë është e vështirë dhe besimi ynë shtrihet në nivele të reja, por ajo sjell edhe lirinë kur dimë se nuk ka asgjë në këtë botë që mund të na mbajë të lidhur.

Më kujtohet koha kur Perëndia më kërkoj të jepja të gjitha paratë e mia personale që kisha kursyer, përfshirë edhe të gjitha certifikatat të dhuratave. Ky nivel i ri, për të sakrifikuar *gjithçka*, ishte i vështirë, sepse i kisha kursyer ato para për një kohë të gjatë dhe kisha planifikuar të bëja pazar në kohën e duhur. Çudia më e madhe ishte se dhënia e certifikatave të dhuratave ishte më e vështira. Kisha disa certifikata të mira dhuratë, që i kisha marrë dhuratë për ditëlindje dhe gëzohesha me faktin se i kisha në dispozicion nëse më duhej t'i përdorja ndonjëherë. Unë isha mësuar të jepja, por të jepja *gjithçka*, ishte një nivel i ri. Pasi debatova për një farë kohe me Perëndinë dhe i dhashë çdo justifikim që mund të mendoja, më në fund u binda. Dhimbja që ndjeva kur dhashë pasuritë e mia ishte momentale, por gëzimi i bindjes dhe njohja e faktit se pasuritë nuk më mbanin të lidhur, ishte e përjetshme.

Kjo ishte hera e parë që po sprovohesha në këtë mënyrë, por nuk ka qenë e fundit. Perëndia zgjedh kohën për sprovë dhe kjo është e domosdoshme për të mirën tonë. Sprova nuk na lejon të krijojmë varësi të ngushtë ndaj gjërave. Perëndia dëshiron që të gëzojmë atë që Ai na jep, por Ai gjithashtu dëshiron që ne të mos harrojmë se jemi administratorë, jo pronarë. Ai është Mjeshtri dhe

detyra jonë është që t'i shërbejmë Atij me gëzim, me gjithë zemrën tonë dhe me të gjitha burimet që kemi.

Kush Është i Afërmi Im?

Kë duhet të ndihmoni dhe kush është i afërmi juaj? Është kushdo që ndodh të jetë në rrugën tuaj dhe që ka një nevojë. Mund të jetë dikush që ka nevojë ta dëgjoni, apo ndoshta dikush që ka nevojë për një kompliment ose inkurajim. Mund të jetë dikush që ka nevojë për pak nga koha juaj apo ndoshta dikush të cilin ju mund ta ndihmoni të plotësojë një nevojë financiare. Ndoshta fqinji juaj është dikush i cili ndihet i vetmuar dhe thjesht ka nevojë për miqësinë tuaj.

Kohët e fundit Dave më tha se Perëndia kishte trajtuar me të çështjen e kohës miqësore me të tjerët. Unë gjithmonë kam menduar se Dave është shumë miqësor, por ai ndjen se Perëndia dëshiron që ai të investojë akoma edhe më shumë kohë. Ai u bën njerëzve pyetje nga më të ndryshme për të treguar se kujdeset për ta si individë. Shumë prej njerëzve me të cilët kalon kohë nuk i njeh dhe ndoshta nuk do t'i shohë përsëri. Ndonjëherë ata janë të moshuar apo njerëz nga kombe të tjera që nuk flasin shumë mirë anglisht dhe mund të ndjehen pak në siklet. Kohët e fundit më tregoi për një njeri me aftësi të kufizuar, të cilit njerëzit ia kishin ngulur sytë ndërsa ishte ulur në një kafene. Dave shkoi të fliste me këtë zotëri, ndonëse e meta e tij e bënte shumë të vështirë aftësinë e tij për të folur qartë.

Ne shpesh i shmangim njerëzit të cilët janë në një farë mënyre ndryshe nga ne, sepse ata na bëjmë të ndjehemi në siklet ose të paafte. Ndoshta duhet të mendojmë më shumë për mënyrën se si ata ndjehen sesa të bëjmë çfarë është më e përshtatshme për ne.

Lista e mënyrave se si mund ta tregojmë veten fqinj të mirë me siguri është e pafund, por nëse me të vërtetë duam t'i ndihmojmë

njerëzit dhe të jemi bekim, atëherë do ta gjejmë mënyrën e duhur. Mos harroni, indiferenca gjen justifikim, por dashuria gjen mënyrën e duhur.

Gjëra të Vogla me një Ndikim të Madh

Jezusi nuk e kaloi kot kohën e Tij, prandaj mund të themi se çdo gjë që bëri ishte shumë kuptimplote dhe përmban një mësim të madh për ne. Le të mendojmë për kohën kur ai vendosi t'u lante këmbët dishepujve të Tij (shih Gjoni 13:1-17). Për çfarë ishte e gjithë ajo? Ai kishte parasysh disa mësimë që donte t'u mësonte dishepujve, njëri prej të cilëve ishte nevoja për t'i shërbyer njëritjetrit. Jezusi ishte dhe është Biri i Perëndisë. Në fakt, Ai është Perëndia i shfaqur në personin e dytë të Trinisë. Pra, mjafton të them se Ai është me të vërtetë i rëndësishëm dhe sigurisht nuk do t'i duhej të lante këmbët e askujt, e aq më tepër të nxënësve të vet. Por Ai e bëri këtë sepse dëshironte t'u mësonte se ata mund të ishin në autoritet dhe të shërbyes në të njëjtën kohë. Shumë njerëz sot nuk kanë arritur ta mësojnë këtë mësim të rëndësishëm.

Në kohën e Jezusit, këmbët e njerëzve ishin mjaft të pista. Njerëzit udhëtonin në rrugë të pista dhe vishnin sandale që përbëheshin nga një shollë me disa rripa. Ishte zakon i atyre ditëve që të laheshin këmbët e miqve kur ata hynin në shtëpi, por këtë detyrë e kryenin shërbëtorët dhe jo i zoti i shtëpisë. Jezusi, në të vërtetë, hoqi rrobën e Tij dhe mori peshqirin e shërbëtorit. Ky ishte një gjest që kishte si qëllim të përçonte një mësim. Ai donte të tregonte se ne mund ta lëmë mënjanë "pozitën" tonë për një kohë të mjaftueshme sa për t'i shërbyer dikujt tjetër dhe të mos kemi frikë se mos e humbasim atë status.

Pjetri, dishepulli më me zë, refuzoi me forcë ta lejonte Jezusin t'i lante këmbët, por Jezusi tha se nëse nuk ia lante këmbët Pjetrit,

ata të dy nuk mund të ishin miq të vërtetë. Me fjalë të tjera, ata duhet të bënin gjëra për njëri-tjetrin në mënyrë që marrëdhënia e tyre të ishte e shëndetshme dhe e fortë. Sa shumë martesë mund të shpëtohen ose të paktën të përmirësohen shumë nëse çiftet e aplikojnë këtë parim?

Disa vite më parë vendosa se nuk do të kisha marrëdhënie të njëanshme-marrëdhënie në të cilën unë jap gjithçka dhe personi tjetër merr gjithçka. Ky lloj bashkëveprimi nuk është marrëdhënie reale dhe në fund gjithmonë shkakton pakënaqësi dhe zemërim. Jo vetëm që duhet të bëjmë gjëra për njëri-tjetrin, por në fakt kemi nevojë të bëjmë gjëra për njëri-tjetrin. Kjo është pjesë e mbajtjes së marrëdhënieve të mira.

Jo vetëm që duhet të bëjmë gjëra për njëri-tjetrin, por në fakt kemi nevojë të bëjmë gjëra për njëri-tjetrin.

Ne bëjmë shumë për fëmijët tanë, por edhe ata bëjnë gjëra për ne. Ajo që ata bëjnë mund të jetë diçka që ne mund ta bëjmë vetë me shumë lehtësi. Por ata duhet të japin si edhe të marrin prej nesh dhe ne duam që ata ta bëjnë këtë gjë.

Dhënia nuk duhet të jetë gjithmonë përgjigje e një nevojë të madhe. Ne mund të ndiejmë se duhet të bëjmë diçka për njerëz që nuk duket të kenë aspak nevojë për ne. Nëse nuk ka nevojë, atëherë pse të ndihmojmë? Thjesht sepse dhënia, në çdo formë, i inkurajon njerëzit dhe i bën ata ndjejnë se dikush i do dhe ne të gjithë kemi nevojë të ndiejmë se na duan, pavarësisht sa shumë "gjëra" kemi. Përdorini burimet që keni për të bekuar dhe kurrë nuk do t'ju shterohen burimet.

Larja e këmbëve ishte një detyrë e rezervuar për shërbyesit, por ajo përmbante një mësim të madh: Përgjigjen veten dhe jini të gatshëm të bëni gjëra të vogla që mund të kenë një ndikim të madh.

Gjërat e Vogla kanë Domethënie të Madhe

Ne morëm me vete në Indi grupin Delirius? në një udhëtim misionar. Aty një vajzë e varfër i dha Stu-së, bateristit të tyre në atë kohë, një rrip lëkure të cilën ajo e mbante si byzylyk. Gjesti i vogël i dashurisë, nga një njeri që zotëronte kaq pak, i ndryshoi jetën Stu-së. Ai ka thënë publikisht se për sa kohë që jeton, nuk do ta harrojë kurrë mësimin që ky gjest i mësoi. Nëse dikush me kaq pak ishte i gatshëm për të dhënë, atëherë sa shumë mund të bënte ai vetë? Po, gjërat e vogla mund të ketë një ndikim të madh.

Çfarë gjërash të vogla mund të bësh ti? Jezusi lau këmbët e dishepujve dhe tha se do të jemi të bekuar dhe të lumtur nëse ndjekim shembullin e tij. Më poshtë është një listë e pjesshme e disa gjërave që Bibla thotë se ne mund dhe duhet të bëjmë për njëri-tjetrin:

- Kujdesuni për njëri-tjetrin
- Lutuni për njëri-tjetrin
- Kini në mendje që të jeni bekim për të tjerët
- Mendoni se si mund t'i shprehni mirësi të tjerëve
- Jini miqësorë dhe mikpritës
- Jini të durueshëm me njëri-tjetrin
- Durojini gabimet dhe dobësitë e të tjerëve
- Faleni njëri-tjetrin
- Ngushëlloni njëri-tjetrin
- Jini besimplotë
- Jini besnikë
- Ndërtoni njëri-tjetrin -inkurajojini të tjerët duke u kujtuar pikat e tyre të forta, kur ata ndjehen të dobët
- Jini të lumtur për të tjerët kur ata bekohen
- Jepuni preferencë njëri-tjetrit (le të eci dikush para nesh, ose jepuni atyre më të mirën e diçkaje)

- Konsideroni njëri-tjetrin
- Mbajini sekretet e njerëzve dhe mos tregoni gabimet e tyre
- Besoni me të mirën për njëri-tjetrin

Siç thashë, kjo është një listë e pjesshme. Dashuria ka shumë fytyra ose shumë mënyra se si mund të shihet. Ne do t'i diskutojmë disa prej tyre ndërsa vazhdojmë udhën nëpër këtë libër. Idetë që kam renditur këtu janë gjëra relativisht të thjeshta dhe që të gjithë ne mund t'i bëjmë nëse jemi të gatshëm. Për shumicën e tyre, nuk na duhet të bëjmë plane të veçanta, por mund t'i bëjmë gjatë gjithë ditës ndërsa hasim mundësitë.

Prandaj, pra, si të kemi kohë, le t'u bëjmë të mirën të gjithëve, por me shumë atyre që janë pjesëtar të shtëpisë së besimit.

Galatasve 6:10

Dashuria Duhet të Shprehet

Shpesh mendojmë për dashurisë si të jetë diçka, por fjala dashuri është edhe folje. Dashuria duhet të bëjë diçka në mënyrë që të mbetet ajo që është. Një pjesë e natyrës së dashurisë është se ajo kërkon shprehje. Bibla pyet se, nëse shohim një nevojë dhe e mbyllim zemrën tonë të mëshirës, si mund të jetojë dhe të qëndrojë në dashuri e Perëndisë (shih 1 Gjoni 3:17). Dashuria bëhet gjithnjë e më e dobët në qoftë se nuk mund të shprehet; në fakt, mund të bëhet krejtësisht mosvepruese. Nëse veprojmë me qëllim ndërsa bëjmë gjëra për të tjerët, atëherë e ruajmë veten nga të qenët egoistë, të plogësht dhe jo të frytshëm. Akti më themelor i dashurisë është se Jezusi dha jetën e Tij për ne. Kështu edhe ne duhet ta japim jetën tonë për njëri-tjetrin. Kjo tingëllon ekstreme, apo jo? Për fat të mirë, shumica prej nesh kurrë nuk do të thirret për të

dhënë jetën fizike për dikë tjetër. Por, çdo ditë ne kemi mundësi për të "hequr dorë" nga jeta jonë për një njeri tjetër. Sa herë që ju lini mënjatë dëshirën ose nevojën tuaj dhe e zëvendësoni atë me një vepër dashurie për dikë tjetër, ju keni hequr dorë nga jeta tuaj për një moment, apo një orë, apo një ditë.

Nëse jemi plot me dashurinë e Perëndisë, dhe jemi vërtet sepse Fryma e Shenjtë na i mbush zemrat me dashuri në lindjen e re, atëherë duhet ta lëmë dashurinë të rrjedhë prej nesh. Nëse ajo bëhet e fjetur nëpërmjet pasivitetit, atëherë nuk është e mirë për asgjë. Perëndia aq shumë e deshi botën, sa dha Birin e Tij të vetëm (shih Gjoni 3:16). A e kuptoni? Dashuria e Perëndisë e provokoi Atë të japë! Është e kotë të themi se i duam njerëzit nëse nuk bëjmë asgjë për ta. Vendosni një letër të madhe në shtëpinë tuaj, ndoshta në disa vende, ku shkruhet: "Çfarë kam bërë për të ndihmuar dikë sot?". Kjo do t'ju shërbejë të kujtoni objektivin tuaj ndërsa zhvilloni shprehje të reja dhe bëheni një revolucionar i dashurisë.

Dashuria ka të bëjë me veprimin. Ajo nuk është teori, apo thjesht fjalë. Fjalët janë të rëndësishme dhe ne në fakt mund t'i përdorim ato si nga mënyrat për të dashur njerëzit, por duhet të përdorim të gjitha mjetet e mundshme për të vazhduar së treguari dashurinë mes nesh.

Çfarë mund të bëni për t'i treguar dashuri dikujt sot? Kaloni kohë për të menduar dhe bëni një plan. Mos e lini ditën t'ju kalojë pa ia shtuar gëzimin një njeriu tjetër.



KAPITULLI

6

Të Mposhtësh të Kegen me të Mirë

Gjithçka që duhet që e keqja të triumfojë
është që njerëzit e mirë të mos bëjnë asgjë.

Edmund Burke

Të mos bësh asgjë është e lehtë, por është edhe shumë e rrezikshme. Sepse atje ku e keqja nuk kundërshtohet, ajo gjen vend e shumohet. Të gjithë ne, shpesh, biem në grackën e të ankuarit për gjërat e gabuara të shoqërisë dhe jetës sonë, por ankimi nuk bën gjë tjetër veçse na dekurajon edhe më shumë. Ai nuk ndryshon asgjë, sepse në të nuk gjendet pushtet pozitiv.

Imagjinoni se në çfarë rrëmuje do të ishte bota nëse Perëndia vetëm do të ankohej për çdo gabim që është bërë që prej kohës së krijimit. Por Perëndia nuk ankohet. Ai vazhdon të jetë i mirë dhe punon për drejtësinë. Ai e di se e keqja mund të kapërcehet me të mirë! E keqja është e fuqishme vërtet, por e mira është edhe më e fuqishme.

Ne duhet të ndalemi një çast dhe të kuptojmë se Perëndia punon nëpërmjet njerëzve të Tij. Po, Perëndia është i mirë gjatë gjithë

kohës. Por Ai ka zgjedhur të punojë mbi këtë Tokë nëpërmjet fëmijëve të Tij-nëpërmjet teje dhe meje. Është përlulësi të kuptosh se Ai mund të bëjë shumë më tepër nëse ne do t'i përkushtoheshim dashurisë dhe do të bënim të mira në çdo kohë. Duhet të kujtojmë udhëzimet e Jezusit tek Mateu 5:16: "Ashtu le të shndrisë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej".

Mirësia Është e Fuqishme

Sa më shumë t'i përgjigjemi së keqes me të keqe, aq më shumë rritet ajo. Më kujtohet një film me titullin *El Cid*, ku tregohet historia e një njeriu që bashkoi Spanjën dhe u bë hero i madh duke përdorur parimin për të cilin po flas. Për shekuj me radhë, të krishterët luftonin kundër maurëve. Ata e urrenin dhe vrisnin njëri-tjetrin. Në një betejë, El Cid kapi pesë maurë, por nuk pranoi t'i vriste sepse kuptoi se vrasja nuk kishte sjellë ndonjë të mirë. Ai besonte se duke treguar mëshirë, armiqtë e tij do të ndryshonin zemrat e tyre dhe pastaj të dy grupet do të mund të jetonin në paqe. Edhe pse ai fillimisht u etiketua si tradhtar për shkak të veprimeve të tij, këto veprime funksionuan dhe ai u nderua si hero.

Një prej maurëve që ai kapi tha: "Kushdo mund të vrasë, por vetëm një mbret i vërtetë mund të tregojë mëshirë ndaj armiqve të tij." Për shkak të këtij akti mirësie, armiqtë e El Cid-it ofruan të bëheshin miqtë dhe aleatët e tij nga ai moment e tutje. Jezusi është mbret i vërtetë dhe Ai është i mirë, i dashur dhe i mëshirshëm me të gjithë. Më e pakta që mund të bëjmë është të ndjekim shembullin e Tij.

Në këtë çast, a mund të mendoni për ndonjë njeri ndaj të cilit mund të tregoheni të mëshirshëm? A ka ndonjë person që ju ka trajtuar në mënyrë të gabuar dhe ndaj të cilit ju mund të tregoheni

të mirë? Të jeni të mëshirshëm dhe të mirë, sidomos ndaj armiqve tuaj, mund të jetë një nga gjërat më të fuqishme që keni bërë ndonjëherë.

Lutja Funksionon

Vitet e fundit, kemi parë se si e keqja është rritur me shpejtësi nëpërmjet gjërave të këqija që shfaqen në televizion apo portretizohen nëpër filma. Disa vjet më parë jam tronditur kur njerëz fallxhorë filluan të kenë programe në televizion. Ata u tregonin njerëzve të ardhmen e tyre përkundrejt një tarife. Kushdo që ishte i gatshëm të paguante mund të telefononte për të marrë një të ashtuquajtur "lexim". Unë ankohesha shpesh në lidhje me këtë gjë duke bërë komente të tilla si: "Është e tmerrshme që lejojnë të tilla gjëra në televizion. Kaq shumë njerëz po humbin paratë e tyre dhe po mashtrohen". Kam dëgjuar shumë të tjerë të thonë në thelb të njëjtën gjë. Një ditë Perëndia më dha këtë mendim në zemër: *nëse ju dhe gjithë të tjerët që ankoheni do ta kishit kaluar atë kohë duke u lutur për fallxhorët, unë tashmë do të mund të kisha bërë diçka në lidhje me ta.* Fillova të lutem dhe u kërkova disa të tjerëve të bënin të njëjtën gjë. Pa kaluar shumë kohë, shumë prej atyre programeve, të mos them të gjitha, u shpallën si mashtruese dhe u hoqën nga transmetimi.

Shpesh kemi tendencën të ankohemi për atë që "ata" bëjnë, njësoj si unë kur "ata" filluan të transmetonin programet e parashikimit të së ardhmes në televizion, por nuk bëjmë asgjë për të përmirësuar situatën. Lutja është një gjë e mirë që ka fuqinë të mposhtë të keqen, prandaj duhet të lutemi për çdo gjë për të cilën tundohejmë të ankoheni. Perëndia i konsideron ankimet dhe murmurimat të këqija, por lutjet e mbushura me besim janë të fuqishme dhe efektive. Lutja hap derën që Perëndia të punojë dhe të bëjë diçka të mirë.

Përgjigjuni siç duhet të Keqes

Ndërsa po përpiqeshin udhëtonin nëpër shkretëtirë për të arritur në Tokën e Premtuar, izraelitët hasën sprova dhe vështirësi dhe reaguan duke u ankuar, shfryrë dhe murmuritur. Ata iu dhanë çdo lloj imoraliteti dhe një nga mëkatet e tyre ishte ankesa. Ankesa solli shkatërrimin jetës së tyre dhe shumë prej tyre vdiqën (shihni 1 Kor. 10:8-11). Nëse ata do t'i ishin përgjigjur sprovave duke mbetur mirënjohës ndaj Zotit, duke e adhuruar dhe lavdëruar Atë dhe duke qenë të mirë me njëri-tjetrin, besoj se do t'ia kishin dalë mbanë ta kalonin shkretëtirën në një kohë shumë më të shkurtër. Por përkundrazi, shumica e tyre vdiqën rrugës, nëpër shkretëtirë, dhe kurrë nuk arritën në destinacion. Pyes veten se sa herë ne nuk kemi arritur të shohim rezultatet e mira që dëshirojmë, thjesht sepse i përgjigjemi gjërave të këqija me ankesë në vend që të lutemi, të lavdërojmë, të falënderojmë dhe të vazhdojmë të kujdesemi për njerëzit në nevojë.

Besimi dhe Dashuria

Për shumë vite me radhë, një pjesë e madhe e mësimdhënies që kam dëgjuar në kisha dhe konferenca ishte në lidhje me besimin. Edhe librat që kam lexuar ishin në lidhje me besimin. Dukej se tema kryesore e mësimdhënies në të gjithë botën e krishterë ishte "Besojini Perëndisë dhe çdo gjë do të shkojë mirë."

Pa besim, nuk mund ta kënaqim Perëndinë (shih Heb. 11:06), kështu që patjetër duhet ta vëmë besimin tonë tek Ai dhe të mbështetemi në Të. Por, ka diçka tjetër në Fjalën e Perëndisë që besoj se plotëson foton që ne duhet të shohim. Unë do ta ndaj atë me ju, por së pari më lejoni t'ju tregoj disa nga përvojat e mia në vitet e para të udhëtimit tim me Perëndinë.

Në moshën nëntë vjeçare pranova Jezusin si Shpëtimtarin tim, por nuk e kuptoja se çfarë kisha në Të apo se si marrëdhënia me Të mund të më ndryshonte jetën, sepse nuk kisha "edukim të vazhdueshëm" në çështjet frymërore. Shtëpia në të cilën u rrita ishte shumë problematike. Babai ishte i alkoolizuar, jo besnik ndaj nënës sime dhe shumë i dhunshëm e i zemëruar. Siç përmenda edhe më lart, ai gjithashtu më abuzonte vazhdimisht seksualisht. Lista vazhdon edhe më, por besoj se e kuptuat situatën.

Tani, përshpejtojeni jetën time në moshën 23 vjeçare. U martova me Dave-in dhe fillova të shkoj në kishë. E doja Perëndinë dhe dëshiroja të mësoja, prandaj mora klasa që më lejonin të isha e përhershme në bashkësi dhe shkoja në kishë rregullisht. Mësova mbi dashurinë dhe hirin e Perëndisë si edhe mbi doktrinat e shumta të kishës të cilat ishin të rëndësishme për themelin e besimit tim.

Në moshën tridhjetë e dy vjeçare, isha shumë e irrituar sepse krishtërimi nuk po më ndihmonte praktikisht në jetën time të përditshme. Besoja se do të shkoja në qiell kur të vdisja, por isha e dëshpëruar për pak ndihmë për t'i kaluar ditët në tokë me paqe e me gëzim. Shpirti më ishte mbushur me dhimbje për shkak të abuzimit gjatë fëmijërisë sime dhe unë e shfaqja këtë dhimbje çdo ditë me anë të qëndrimit tim dhe të paaftësisë për të mbajtur marrëdhënie të mira me njerëzit e tjerë.

Bibla na thotë se nëse e kërkojmë Perëndinë me zell, atëherë do ta gjejmë Atë (shihni Fja. 8:17). Fillova ta kërkoja vetë Perëndinë për gjërat që më mungonin dhe pata një takim me Të, takim i cili më solli shumë pranë Tij. Ai papritmas u duk shumë i pranishëm në jetën time të përditshme dhe unë fillova të studioj me zell në mënyrë që ta njihja Atë më mirë. Dukej se ngado që shkoja, dëgjoja të flitej për besimin. Mësova se mund ta zbatoja besimin tim në shumë rrethana, gjë e cila do t'i jepte Perëndisë mundësinë të përfshihej dhe të më ndihmonte.

Unë besoja me gjithë zemër se parimet që po mësoja ishin të

drejta, e megjithatë përjetoja irritim të madh sepse nuk po gjeja mënyrën se si t'i bëja këto parime të funksiononin për mua, të paktën deri në atë masë për të cilën kisha dëshpërimisht nevojë. Në atë kohë, Perëndia po më përdorte në shërbesë dhe kjo shërbesë ndaj të tjerëve ishte mjaft e gjerë. Patjetër që kisha bërë progres të madh, por thellë në zemër ndjeja se më mungonte diçka, kështu që edhe një herë fillova ta kërkoja seriozisht Perëndinë. Përmes studimeve dhe kërkimeve të thella kuptova se më mungonte mësimi kryesor për të cilin Jezusi erdhi që të na mësonte: të duam Perëndinë, të duam veten tonë dhe të duam të tjerët (shihni Mt. 22:36-39). Kisha mësuar shumë mbi besimin ndërsa ecja me Perëndinë, por nuk kisha mësuar mbi fuqinë e dashurisë.

Besojini Perëndisë dhe Bëni të Mirën

Gjatë viteve të udhëtimit tim duke mësuar për këtë temë të mrekullueshme, kuptova se besimi vepron vetëm nëpërmjet dashurisë. Sipas Galatasve 5:6, besimi është në të vërtetë "i aktivizuar dhe i fuqizuar dhe i shprehur" nëpërmjet dashurisë.

Fryma e Shenjtë më drejtoi të studioja Psalmin 37:3, i cili thotë: "Ki besim (strehohu, mbështetu dhe jë i sigurt) tek Zoti dhe bëj të mirën". U tremba kur kuptova se kisha vetëm gjysmën e asaj që më duhej të dija për t'u lidhur siç duhet me Perëndinë. Kisha pjesën e besimit, por jo "bëj të mirën". Unë dëshiroja që të më ndodhnin gjëra të mira, por nuk isha tepër e shqetësuar për të qenë e mirë me të tjerët, veçanërisht kur isha e lënduar ose kur kaloja një kohë sprove personale.

Psalmi 37:3 më hapi sytë të kuptoja se po i besoja Perëndisë, por nuk isha përqendruar të bëja të mirën. Kuptova se nuk isha e vetmja që kisha mangësi në këtë fushë dhe shumica e të krishterëve që njihja ishin ndoshta në gjendje të njëjtë. Ne të gjithë ishim të

preokupuar t'i "besonim" Perëndisë për gjërat që dëshironim t'i kishim. Ne luteshim së bashku dhe çlironim besimin tonë përmes lutjes në një mendje, por nuk takoheshim për të diskutuar se çfarë mund të bënim për të tjerët ndërsa prisnim përmbushjen e nevojave tona personale. Kishim besim, por ai nuk aktivizohej nga dashuria!

Nuk dua të tingëllojë sikur isha krejtësisht egocentrike, sepse në të vërtetë nuk ishte ashtu. Unë po shërbeja dhe doja t'i ndihmoja njerëzit, por së bashku me dëshirën për të ndihmuar gjendeshin edhe shumë motive të papastrat. Shërbesa më jepte një ndjenjë vetë-vlerësimi dhe rëndësie. Ajo më dha pozitë dhe një farë ndikimi, por Perëndia dëshironte që gjithçka që unë bëja, ta bëja me një motiv të pastër dhe unë kisha ende shumë për të mësuar. Kishte raste kur tregoja vepra mirësie ndaj të tjerëve, por dhënia e ndihmës nuk ishte motivi im parësor. Duhej të isha shumë më tepër agresive dhe e qëllimshme për t'i dashur të tjerët; duhej të ishte gjëja kryesore në jetën time, jo një veprimtari dytësore.

Pyetni veten se çfarë ju motivon më shumë se çdo gjë tjetër dhe përgjigjuni me ndershmëri. A është dashuria? Nëse nuk është, a jeni të gatshëm të ndryshoni përqendrimin tuaj në çfarë është e rëndësishme për Perëndinë?

‘Lutem me gjithë zemër që Perëndia t'i kalojë këto fjalë nga kjo letër në zemrën tuaj. Të mësoja të vërtetën e fuqisë së dashurisë ishte kaq jetëndryshuese për mua, sa që dua që edhe gjithë të tjerët ta dinë këtë gjë. Nuk po them se ju nuk e dini, sepse e vërteta është se mund të dini jashtëzakonisht më shumë se mua. Por, nëse nuk e dini ende, lutem që ajo që po ndaj me ju, do të ndezë një zjarr brenda jush dhe do t'ju inkurajojë të bëheni pjesë e Revolucionit të Dashurisë, i cili besoj se ka fuqinë të ndryshojë botën!

Nxisni Vetën dhe të Tjerët

Imagjinoni se sa ndryshe do të ishte bota nëse secili prej nesh, që shpall se njeh Krishtin, çdo ditë do të bënte një gjë të mirë për dikë tjetër. Rezultatet do të ishin të habitshme. Tani imagjinoni se çfarë do të ndodhte nëse ne të gjithë vendosim si qëllim që çdo ditë të bëjmë dy vepra dashurie, mirësie apo të dobishme për dikë tjetër. Jam e sigurt se po e kuptoni idenë. Rezultatet do të ishin të mahnitshme. Bota do të ndryshonte shpejt, sepse me të vërtetë do të mund ta mposhtnim të keqen me të mirë nëse të gjithë do të përkushtoheshim të jetonim në rrugën që Jezusi na tregon.

Ju mund të tundoheni të pyesni "Kjo nuk do të ndodhë kurrë, kështu që pse të mundohemi ta provojmë"? Mos e lejoni veten të mposhteni nga mendimi negativ ende pa filluar. Unë tashmë kam vendosur se do të bëj pjesën time dhe lutem që edhe njerëzit e tjerë të bëjnë pjesën e tyre. Gjithashtu do të flas me njerëz të tjerë dhe do t'i inkurajoj të bëjnë sa më shumë që munden për të tjerët. Do të ishte mbresëlënëse nëse shumë prej bisedave tona do të ishin përqendruar rreth mënyrave se si mund t'i ndihmojmë të tjerët dhe të nxirrnim ide krijuese rreth gjërave që mund të bëjmë për ta.

Unë kam tre miq që jetojnë në këtë mënyrë mahnitëse dhe kur shkojmë për drekë ose për kafe së bashku, shpesh e përdorim kohën për të folur për gjërat që Perëndia na ka vendosur në zemër për të bërë për të tjerët ose ide krijuese se si të jemi bekim në një mënyrë të re. Besoj se biseda të tilla janë shumë të pëlqyeshme për Perëndinë dhe sigurisht që janë më të mira se sa të ankohesh për gjithçka që shkon keq në këtë botë. Do të doja t'ju sfidoja të merrnit një rol udhëheqës në Revolucionin e Dashurisë. Rendisni njerëzit që njihni dhe ftojini në një sesion për të planifikuar mbi mënyrat se si të përmbushim praktikisht nevojat e të tjerëve. Ndajini parimet e këtij libri me ta dhe gjeni një objektiv. Gjeni dikë që ka nevojë

për ndihmë dhe përpikuni së bashku si grup për ta ndihmuar.

Ideja për t'i inkurajuar të tjerët për të qenë agresivë në vepra të mira, nuk është e re. Shkrimtari i Hebrenjve ka folur për këtë gjë "Dhe le të kujdesemi për njëri tjetrin, për t'u nxitur (për t'u vënë në lëvizje) për dashuri dhe vepra të mira" (Heb. 10;24).

Vini re, ju lutem, se ky varg thotë se ne duhet të ofrojmë përkujdesje të *vazhdueshme* për njëri-tjetrin dhe të studiojmë e të mendojmë se si mund t'i nxisim njerëzit për të bërë vepra të mira, të dobishme dhe të mbushura me dashuri . Ai i inkurajoi njerëzit të cilëve u shkroi të bënin të njëjtën gjë për të cilën po ju inkurajoj edhe unë juve sot. A mund ta imagjinoni se si djalli do ta përbuzte mbledhjen tonë së bashku për të gjetur mënyra krijuese për t'i bërë mirë njëri-tjetrit? Ai do të preferonte që ne të gjykojmë, të jemi kritikë, të gjejmë gabime, të bëjmë thashetheme dhe të ankohe mi. Unë besoj se të bësh gjënë e duhur duhet të formosh shprehi të reja dhe të zhvillosh vepra agresive dashurie, por rezultatet do të jenë të mrekullueshme.

Jini të Pasur në Vepra të Mira

Pali e udhëzon Timoteun, një predikues i ri, t'i porosisë njerëzit "të bëjnë të mira, të jenë të pasur në vepra të mira, të jenë bujarë dhe të gatshëm për të ndarë me të tjerë" (1 Tim. 6:18). Këtu duket qartë se Pali mendonte se njerëzit duheshin kujtuar t'i bënin këto gjëra. Udhëzimi për të qenë agresiv në vepra të mira është një udhëzim që ia vlen t'ua kujtosh njerëzve edhe sot. Unë ju inkurajoj që jo vetëm të kujtoni të tjerët, por që edhe të gjeni mënyra për të kujtuar vetveten. Mbani një bibliotekë të mirë librash dhe mesazhesh mbi temën e dashurisë dhe lexojini ose dëgjojin shpesh. Bëni gjithçka duhet për t'u siguruar se nuk do të harroni gjënë më të rëndësishme për Perëndinë.

Unë besoj se bota i shikon të krishterët, prandaj çfarë ne bëjmë është e rëndësishme. Pjetri i inkurajoi besimtarët të silleshin siç duhet dhe me ndershmëri midis johebrenjve, jobesimtarëve të atyre ditëve. Ai tha se edhe nëse jobesimtarët prireshin t'i përgojnin besimtarët, nëse shihnin veprat e tyre të mira dhe dashuri, do të vinin të lavdëronin Perëndinë (shihni 1 Pj 2:12).

Nëse fqinjët tuaj e dinë se ju shkoni në kishë çdo të dielë, ju siguroj se ata shikojnë edhe sjelljen tuaj. Kur isha e vogël, fqinjët tanë shkonin vazhdimisht në kishë. Në fakt, ata shkonin disa herë në javë, por bënë edhe shumë gjëra që nuk duhej t'i bënin. Mbaj mend babain tim kur thoshte: "Se mos janë ata më të mirë se unë! Ata dehen, përdorin fjalë të pista, tregojnë shaka të pista dhe kanë karakter të keq. Një tufë hipokritësh janë!". Gjithsesi, babai im po kërkonte një justifikim dhe sjellja e tyre vetëm i hidhte zjarrit benzinë.

Sigurisht që e kuptoj se edhe pse të krishterë, ne nuk sillemi në mënyrë të përkryer. Njerëzit të cilët duan një justifikim për të mos besuar në Jezusin ose të mos praktikojnë krishtërimin, do të na shikojnë dhe kritikojnë gjithmonë, por ne duhet të bëjmë më të mirën e mundshme dhe të mos u japim arsye për të na gjykuar.

Shikoni si Mund të Bekoni

Gjithmonë përpiqem të jem e ndjeshme nëse Perëndia dëshiron të më tregojë ndonjë gjë që Ai do që unë të bëj për t'u dëshmuar të tjerëve ose për të qenë bekim për dikë. Disa ditë më parë isha në një sallon bukurie. Në dyqan ishte edhe një vajzë e re, e cila ishte shtatzënë me fëmijën e saj të parë. Kishte dy muaj që qëndronte në shtrat për shkak të dhimbjeve të parakohshme të lindjes dhe ardhja në sallon ishte mundësia e saj e parë për të dalë nga shtëpia pas gjithë asaj kohe. Fëmija do t'i lindte pas një jave dhe ajo ishte

duke bërë një manikyr dhe pedikyr. Biseduam pak dhe unë fillova të ndjej se do të ishte një gjest i këndshëm nëse do ta bekoja duke paguar për shërbimet e saj. Prita pak për të parë nëse do ta kisha akoma këtë dëshirë dhe meqë e kisha, pagova për të në të njëjtën kohë kur pagova edhe për shërbimet e mia. Ajo natyrisht u habit, por edhe u bekua. Nuk e bëra shumë të madhe këtë veprim, thjesht e bëra. Ndoshta, ndonjë ditë ajo do të më shohë në televizor ose do të shohë ndonjë prej librave të mi dhe do të kujtohet se unë me të vërtetë e bëj atë që them se besoj.

Këto gjëra nuk i bëj për t'u dukur, por ajo që njerëzit shohin flet më shumë se fjalët. Çdo njeri në sallën e di se unë jam mësuese dhe shërbenjëse e Biblës. Edhe pse nuk i thashë asaj gruajë të re asgjë për veten time, jam e sigurt se të tjerët t'ia kenë thënë pasi u largova. Kështu pra, një vepër e vogël mirësie arriti disa qëllime. Më bëri mua të lumtur, bëri atë të lumtur, ishte një shembull për të tjerët që po shikonin dhe, ishte një dëshmi që i dha lavdi Perëndisë. Unë kisha edhe një mundësi tjetër. Mund t'i mbaja paratë dhe të mos bëja asgjë. Kjo do të ishte shumë e lehtë, por jo aq e kënaqshme për shpirtin tim.

Mos u Shqetëso për Çfarë Mendojnë Njerëzit

Ju mund të mendoni, *Joyce*, me të vërtetë do të dukesh njeri i çuditshëm të paguaja faturën e dikujt që nuk e njoh. Nëse mendoni kështu, ju kuptoj plotësisht. Edhe unë kështu mendoj. Pyes veten se çfarë mendojnë të tjerët apo si do të reagojnë, por pastaj kujtohem se ky nuk duhet të jetë shqetësimi im. Unë shqetësohem vetëm për të qenë një ambasador i Krishtit.

Një ditë, ofrova t'i blija kafën një gruajë që ishte pas meje në radhë tek Starbucks dhe ajo refuzoi kategorikisht. Në fakt, ajo krijoi një situatë të tillë që më zuri ngushtë dhe menjëherë mendova,

Mirë, pra, nuk do ta bëj këtë gjë përsëri. Me mua ishte edhe Dave-i dhe ai më kujtoi se kjo ishte pikërisht çfarë djalli dëshironte, kështu që ndryshova mendje. Kohë të tilla nuk janë të lehta, por ky incident më bëri të vetëdijshme se sa shumë njerëz nuk dinë si të pranojnë një bekim ndoshta sepse nuk u ka ndodhur kurrë.

Ndonjëherë i bëj gjërat në mënyrë anonime, por ka raste kur nuk mund ta fsheh atë që bëj, prandaj kam vendosur se e rëndësishme është që zemra ime të jetë e drejtë. Çdo vepër mirësie është mënyra ime për t'iu bindur Perëndisë dhe për ta mposhtur të keqen në botë. Nuk e di se çfarë gjërash të këqija u kanë ndodhur njerëzve dhe ndoshta veprat e mia të mirësisë mund të ndihmojnë në shërimin e plagëve në shpirtin e tyre. Gjithashtu besoj se mirësia ndaj të tjerëve është një mënyrë se si unë t'ia kthej djallit për dhimbjen që më ka shkaktuar në jetën time. Ai është i lig në shkallën maksimale; ai është autori i gjithë së keqes që përjetojmë në botë, prandaj çdo vepër dashurie, mirësie dhe dhembshurie është si ta godasësh atë në të keqen e tij, zemrën e tij të ligë.

Nëse ju jeni keqtrajtuar dhe shpesh keni dëshiruar një mënyrë se si mund t'ia ktheni djallit për dhimbjen që ju ka shkaktuar, atëherë jini të mirë me sa më shumë njerëz. Kjo është mënyra e Perëndisë dhe me siguri që do të funksionojë, sepse dashuria nuk dështon kurrë!

E kam Blerë Njeriun me Dashuri

Bibla thotë se Perëndia na bleu me një çmim të vyer-gjakun e Birit të Tij, Jezu Krishtit (shihni 1 Kor. 6:20, 1 Pj. 1:19, Zbu. 5:9). Kjo vepër e mahnitshme mirësie prapësoi të keqen që djalli kishte bërë dhe u hapi rrugën për faljen e mëkateve të të gjithë njerëzve dhe të gëzimit të një marrëdhënieje personale me Perëndinë.

Siç e kam përmendur, babai im më abuzoi seksualisht për shumë

vite me radhë dhe veprimet e tij të këqija më dëmtuan shpirtin dhe më lanë të plagosur e të paaftë për të jetuar normalisht, derisa Jezusi më shëroi. Të lija pas ato gjëra që më bëri dhe të isha në gjendje ta falja tërësisht, ishte një proces. Së pari, mora vendimin të mos e urreja më, sepse Perëndia më bëri të vetëdijshme se dashuria për Të dhe urrejtja për babain tim natyror, nuk mund të qëndronin në të njëjtën zemër. I kërkova Perëndisë të më ndihmonte dhe Ai e mori urrejtjen nga zemra ime. Megjithatë, ende nuk doja të kisha të bëja shumë me babain tim dhe qëndroja sa më larg tij që të mundja.

Shëndeti mendor i nënës sime po binte vazhdimisht. Vitin që u martova me Dave-in ajo pati një krizë nervore sepse e dinte çfarë më kishte bërë babai por nuk dinte si ta trajtonte këtë çështje. Ajo e kapi atë duke më abuzuar dhe kur unë isha katërmbëdhjetë vjeç, por, siç thashë, nuk dinte çfarë të bënte kështu që nuk bëri asgjë. Ky vendim i saj ishte shumë i keq për të gjithë ne. Për dy vite radhazi, ajo mori trajtime ndaj tronditjes që pësoi dhe ato ia fshinë kujtimin e abuzimit seksual. Unë nuk doja të bëja asgjë që mund t'i kthente këto kujtime mamasë sime, prandaj edhe pse ishte shumë e vështirë të qëndroja në prani të babait, i vizitoja ata së bashku me familjen time në pushime dhe vetëm atëherë kur patjetër duhej.

Përfundimisht, prindërit e mi lëvizën jashtë qytetit dhe u kthyen në qytezën ku ata u rritën. Ata ishin rreth 300 kilometra larg meje dhe unë u gëzova shumë sepse zhvendosja e tyre do të thoshte se unë do t'i takoja edhe më rrallë. Në një moment gjatë këtyre viteve kisha arritur ta falja babain, por nuk e kisha falur atë *plotësisht*.

Ndërsa prindërit po plakeshin dhe shëndeti e të ardhurat e tyre ishin duke rënë, Perëndia filloi të punonte me mua për t'i sjellë ata përsëri mbrapsht në St. Louis, Missouri, ku ne jetonim dhe të kujdeseshim për ta deri në fund. Kjo do të thoshte t'u blinim atyre një shtëpi, mobilie, një makinë dhe të siguronim një person që do t'u pastronte shtëpinë, t'u bënte pazarin, të priste barin dhe të

mirëmbante shtëpinë. Në fillim mendova se kjo ishte ide e djallit që përpiqej të më mundonte, por në fund kuptova se ishte plani i Perëndisë dhe me sinjeritet mund të them se ishte një nga gjërat më të vështira që kam bërë ndonjëherë në jetën time.

Para së gjithash, unë dhe Dave-i kishim një sasi të vogël parash që kishim kursyer dhe shpërngulja e prindërve të mi në një shtëpi do t'i shpenzonte të gjitha. Së dyti, mendoja se ata nuk e meritonin ndihmën time sepse nuk kishin bërë asnjëherë asgjë për mua, përveç abuzimit dhe braktisjes. Ndërsa unë dhe Dave-i bisedonim dhe luteshim në lidhje me këtë gjë, kuptoja gjithnjë e më shumë se ajo që Perëndia po më kërkonte të bëja ishte jo vetëm gjëja më e vështirë që më kishte kërkuar ndonjëherë, por do të ishte edhe gjëja më e fuqishme që kisha bërë ndonjëherë.

Lexova çdo varg që mund të gjeja në lidhje me dashurinë ndaj armiqve, mirësinë dhe favorin ndaj tyre. Vargu i mëposhtëm me të vërtetë më preku shumë:

Por ju t'i doni armiqtë tuaj, bëni të mirë [duke bërë favore në mënyrë që dikush të përfitojë] dhe jepni hua pa pasur shpresë për asgjë, dhe shpërblimi juaj do të jetë i madh [i pasur, i fuqishëm, intensiv dhe i bollshëm] dhe ju do jeni bijtë e Më të Lartit, sepse ai është dashamirës me mosmirënjohësit dhe të ligjtë.

(Luka 6:35)

Ky varg thotë se ne nuk duhet të konsiderojmë asgjë si të humbur dhe të mos dëshpërohemi për asgjë. Para se ta kuptoja këtë parim, e shikoja fëmijërinë time si vite të humbura, por tani Perëndia po më kërkonte t'i shikoja si përvojë të cilën mund ta përdorja për të ndihmuar të tjerët. Luka thotë gjithashtu se ne duhet të bekojmë dhe të lutemi për ata që na abuzojnë dhe keqpërdorin (shihni Luka 6:28). Kjo duket shumë e padrejtë, por që prej asaj

kohe kam mësuar se kur fal, jam duke i bërë vetes një favor. Kur unë fal, e çliroj veten nga të gjitha pasojat e së keqes që më është bërë dhe atëherë Perëndia mund të merret me gjithë situatën time. Nëse armiku im nuk është i shpëtuar, unë mund të jem duke blerë shpirtin e tij.

Babai im u habit jashtëzakonisht nga oferta ime dhe e Dave-it dhe ndonëse asnjëherë nuk u shpreh, unë e di se ai pyeste veten përse ne do të bënim kaq shumë për të pas asaj që ai më kishte bërë mua.

Tre vite shkuan dhe nuk pashë asnjë ndryshim tek ai. Ai ishte ende i poshtër, zemërohej me lehtësi dhe shumë egoist. Në fakt, kishte raste kur dukej sikur temperamenti i tij po përkeqësohej. Tani e kuptoj se Perëndia po punonte me të gjatë gjithë asaj kohe. Tre vjet pasi bëmë atë që Perëndia na kërkoi, babai im u pendua duke qarë me lot dhe pranoi Jezusin si Shpëtimtarin e tij. Kjo ishte një përvojë me të vërtetë e mrekullueshme. Ishte ai që e filloi këtë proces. Ai na kërkoi t'i shkonim në shtëpi dhe na kërkoi të falur. Ai më kërkoi mua dhe Dave ta falnim dhe madje përmendi faktin sa të dashur kishim qenë me të. E pyetëm nëse dëshironte të ftonte Jezusin në jetën e tij dhe ai jo vetëm që e bëri, por gjithashtu kërkoi nëse mund ta pagëzonim. Unë pata privilegjin të shihja babain tim, njeriun që më kishte abuzuar, të njihte Zotin. Pastaj kuptova se më parë kisha menduar se thjesht po blija një shtëpi, disa mobilie dhe një makinë, por në të vërtetë kisha blerë një njeri me anë të një veprë të pamerituar mirësie.

Gjatë kësaj kohe, unë dhe Dave-i pamë gjithashtu shërbesën tonë të rritej në mënyrë të mahnitshme, duke na mundësuar të ndihmonim më shumë njerëz. Unë besoj se kjo rritje ishte pjesë e të korrave të farës së bindjes që ne kishim mbjellë. Kur Perëndia na kërkon të bëjmë gjëra të vështira, Ai gjithmonë e bën këtë për të mirën tonë dhe për të mirën e Mbretërisë së Tij. Ne me të vërtetë mund ta mposhtim të keqen me të mirë. Ashtu siç John Wesley ka

thënë: "Bëni gjithë të mirën që mundni, me të gjitha mjetet që mundni, në të gjitha mënyrat që mundni, në të gjithë vendet që mundni, në çdo kohë që mundni, për të gjithë njerëzit që mundni, për sa kohë që mundni".

Të Vejat e Luftës

Jennifer dëgjon thirrjet e fëmijëve dhe vrapon për t'i shpëtuar. Ashtu siç ka bërë edhe shumë herë më parë, u thotë se gjithçka do të shkojë mirë. Si nënë që është, ajo do të vazhdojë t'u thotë këtë gjë derisa ata ta besojnë.

Ajo e di se ç'do të thotë të jesh e frikësuar, e rrëmbyer dhe e abuzuar. Kur ishte dymbëdhjetë vjeç, ajo u rrëmbye me forcë nga shtëpia e saj, u nda nga familja dhe fshati i saj nga ushtarët rebelë të përfshirë në luftën më të gjatë të Afrikës. Dëshira e saj për të jetuar i dha kurajën për t'u arratisur pas rrahjeve, përdhunimit dhe punës së rëndë të vazhdueshme. Ajo udhëhoqi edhe të tjerë drejt një vendi më të sigurtë.

Por, kur u kthye në shtëpi, familja e saj ishte zhdukur. E vetme dhe e dëshpëruar për një jetë dhe shtëpi të re të sajën, ajo u martua me një burrë, i cili tashmë e kishte një grua. Në ditën e saj të martesës, ai e rrahu dhe e preu në prani të miqve të saj. Por kjo nuk ishte goditja më e rëndë. Në një ditë të veçantë kur ajo duhej të ndihej si princeshë, si thesar dhe të rrethohej me dashuri, ai u tha të gjithë të pranishmëve se ajo ishte e padobishme dhe një turp për të. Fjalët e tij u zhytën thellë, duke krijuar një dhimbje shumë më të madhe sesa rrahjet fizike që vazhdonin.

Në përfundim, burri i saj vdiq nga SIDA dhe ajo u gjend përsëri e vetme. Tashmë grua e ve me dy fëmijët, ajo pyeti Perëndinë: *"A je këtu? Kështu do të jetë jeta ime, vetëm tortura,*

vuajtje dhe turp?". Perëndia i tregoi besnikërinë e Tij dhe tani Jennifer gjendet në procesin e ripërtëritjes së saj të plotë.

Sot, Jennifer jeton e sigurt në një fshat të ri të ndërtuar nga Shërbesat Watoto, në partneritet me Shërbesat e Joyce Meyer. Me dinjitet të ripërtëritje dhe me qëllim në jetë, ajo tani është duke u kujdesur për fëmijët jetimë të luftës. Për fat të keq, shumë të tjerë janë ende në nevojë të madhe për shërim dhe ripërtëritje.

Fjala e Zotit na thotë në mënyrë të përsëritur të kujdesemi për vejushat dhe jetimët. Duket se Perëndia ka një vend të veçantë në zemrën e Tij për ta dhe kështu duhet të kemi edhe ne.

Statistikat thonë:

- Në shumë vende, vejushat, burrat e të cilave kanë vdekur nga SIDA, janë dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe u nënshtrohen formave ekstreme të dhunës.¹
- Familjet e kryesuara nga vejushat, shpesh përfaqësojnë një prej nëngrupeve më të varfra të Afrikës.²



KAPITULLI

7

Drejtësi për të Shtypurit

Drejtësia nuk konsiston në të qenit neutral midis së drejtës dhe së gabuarës, por në gjetjen e së drejtës dhe në mbrojtjen e saj, kudo që ajo gjendet, kundër së gabuarës.

Theodore Roosevelt

Perëndia është një Perëndi i drejtësisë. Në fakt, drejtësia është një prej cilësive të Tij që unë e preferoj shumë. Thënë thjesht, do të thotë se Ai i kthen gjërat e gabuara në të drejta. Bibla thotë se drejtësia dhe e drejta janë themelet e fronit të Tij (shihni Psa 89:14). Themeli është ai mbi të cilin ndërtesa qëndron, kështu që mund të themi se e gjithë veprimtaria e Perëndisë mbi Tokë qëndron mbi faktin se Ai është i drejtë dhe i paanshëm. Si shërbëtorë të Perëndisë, ne udhëzohemi ta duam drejtësinë dhe të drejtën dhe të punojmë për vendosjen e saj në Tokë.

Mungesa e drejtësisë në një shoqëri e çon atë gjithmonë në telashe. Nga viti 1789 deri më 1799, Franca përjetoi një revolucion. Ishte një luftë e përgjakshme në të cilën fshatarët u ngritën kundër aristokratëve dhe drejtuesve fetarë të asaj kohe. Për sa kohë që

mbreti dhe mbretëresha e Francës e trajtonin popullin me drejtësi dhe paanësi, mbretëria e tyre lulëzoi; por, kur mbreti dhe mbretëresha, për shkak të egoizmit, lejuan përhapjen e kequshqyerjes, urisë dhe të sëmundjeve ndërsa e tatonin popullin dhe vazhdonin të jetonin jetë luksoze, njerëzit përfundimisht u revoltuan kundër tyre. Kur i trajtuan qytetarët në mënyrë të padrejtë, themelet e fronit të tyre u plasaritën dhe përfundimisht u shkatërruan.

E vërteta qëndron në faktin e thjeshtë se pa drejtësi, gjërat nuk funksionojnë ashtu siç duhet. Sot, shoqëria jonë është e mbushur me padrejtësi dhe ndonëse disa njerëz përpiqen shumë ta luftojnë atë, shumica e njerëzve të tjerë ose nuk u intereson, ose edhe nëse duan, thjesht nuk dinë se çfarë të bëjnë.

Është Detyra Jonë

Kush kujdeset për jetimët, vejushat, të varfrit dhe të shtypurit? Perëndia kujdeset. Po ne a kujdesemi? Kur njerëzit shtypen, ata mbajnë një barrë të paarsyeshme; ajo i pushton, i shfuqizon dhe i

Kush kujdeset për jetimët,
vejushat, të varfrit dhe të shtypurit?

dobëson ata. Shpesh, kjo barrë i bën të ndihen të pashpresë. Perëndia është Ati i jetimëve dhe mbrojtësi i vejushave (shihni Psa 68:5). Ai ka një vend të veçantë në zemrën e Tij për njerëzit e vetmuar që nuk kanë askënd që të kujdeset për ta. Perëndia ndihmon të vuajturin dhe siguron drejtësi për të varfrin dhe nevojtarin (shihni Psa 140:12). Jam e sigurt se jeni të kënaqur që Perëndia i ndihmon këta njerëz të lënduar, por unë ju bëj thirrje të mos harroni se Perëndia e kryen punën e Tij nëpërmjet njerëzve që

i nënshtrohen Atij. Tani, pyeteni veten se çfarë jeni duke bërë ju personalisht për ta.

Siç përmenda edhe më parë, Bibla ka më shumë se dy mijë vargje të cilat flasin për detyrën tonë ndaj të varfërve dhe nevojtarëve. Meqenëse Perëndia frymëzoi kaq shumë vargje, atëherë duhet të ketë një mesazh të cilin Ai po mundohet të na e bëjë të ditur. Sa e rëndësishme është për secilin prej nesh të përfshihet në ndonjë mënyrë për të ndihmuar njerëzit e vuajtur? Ndoshta është më e rëndësishme sesa shumë prej nesh mund ta kuptojnë.

Besimi i Vërtetë

Apostulli Jakob thotë se besimi i vërtetë që shprehet në vepra të jashtme është "të vizitosh jetimët dhe të vejat në shtrëngimet e tyre" (Jakobi 1:27). Kjo do të thotë se nëse besimi ynë është i vërtetë, atëherë ne do të përfshihemi në dhënien e ndihmës ndaj atyre që janë të shtypur nga rrethanat e jetës. Nga ky varg, unë arrij në përfundimin se nëse nuk i ndihmoj këta njerëz, atëherë besimi im nuk duhet të jetë i vërtetë. Mund të jetë një formë besimi (feje), por me siguri nuk është plotësisht ajo që Perëndia ka për qëllim të jetë.

Kam mësuar se jo të gjithë që ulen në kishë të dielën janë të krishterë të vërtetë, ashtu siç Perëndia dëshiron. Ndjekja e rregullave dhe e doktrinës nuk e bën njeriun besimtar të vërtetë të Jezu Krishtit. Si mund ta them këtë gjë? E them sepse kur ne pranojmë Krishtin si Shpëtimtarin tonë, marrim zemrën e Perëndisë dhe Frymën e Tij (Eze 11: 19); duke qenë kështu, na duhet të mësojmë të kujdesemi për atë që Perëndia kujdeset dhe Ai kujdeset për njerëzit e lënduar.

Ç'të mirë do të kishte sikur bijtë e mi, të cilët drejtojnë shumicën e punëve të përditshme të Shërbesave të Joyce Meyer, të thonin se ndajnë të njëjtën zemër me mua, nëse nuk do të bënin atë që do të bëja unë në një situatë të caktuar? Arsyeja pse unë i kam vendosur

bijtë e mi në pozitën në të cilën ndodhen është se ata na njohin nga afër dhe kanë të njëjtën zemër si ne në lidhje me ndihmën ndaj të tjerëve.

Duajeni Njëri-Tjetrin

Unë besoj fuqimisht se ne duhet ta duam njëri-tjetrin, domethënë ata me të cilët jemi në kontakt në jetën e përditshme, si edhe ata që nuk mund t'i takojmë kurrë personalisht, të cilët jetojnë në vende të largëta (shihni Vep 2:44-45, Vep 4:31-32, 2 Kor 8:1-4). Ndërsa vazhdojmë me këtë libër, do të dëshiroja t'i mbanit në mendje të dy këto grupe njerëzish. Për shembull, ju mund të jepni financa për të mbështetur një jetim të botës së tretë nëpërmjet një shërbese që kujdeset për ta por gjithashtu mund të ftoni një vejushë në kishën tuaj për drekë e ndërsa jeni bashkë me të, mund ta pyesni mjaftueshëm për t'u siguruar se nevojat e saj po përmbushen siç duhet. Nëse ajo përmend një nevojë të sajën që ju mund ta përmbushni, atëherë bëjeni me gëzim, sepse Perëndia do një dhurues të gëzuar (2 Kor 9:7).

Shumica prej nesh do t'i ndihmonte familjet ose njerëzit që i njohim nga afër nëse ata do të ishin në nevojë, por sa më larg të jenë njerëzit nga rrethi ynë personal, aq më pak të ngjarë ka që të kujdesemi për ta apo të jemi të gatshëm të përfshihemi në dhënie e ndihmës ndaj tyre. Unë besoj se Perëndia dëshiron ta ndryshojë këtë gjë. E kuptoj se si individ, nuk mund të përmbush plotësisht çdo nevojë që dëgjoj, por me siguri që mund të jem e hapur e t'i lejoj Perëndisë të më tregojë nëse ka diçka që unë mund ta bëj. Jam e vendosur që të mos supozoj më se nuk mund të bëj asgjë në lidhje me nevojat të cilat më janë bërë të ditura. Kam kuptuar se kjo është një mënyrë pasive e të shikuarit të nevojave dhe nuk është mënyra se si Perëndia do që unë t'u drejtohem atyre.

Bota ka Nevojë që Kisha të Sillet si Kishë

Jezusi e pyeti tri herë Pjetrin nëse ai e donte Atë dhe në të trija herët kur Pjetri i tha "Po", Jezusi iu përgjigj "Kulloti qengjat e mi", "Ruaji delet e mia" (shihni Gjoni 21:15-17). Jezusi nuk po fliste për ushqimin e kafshëve; Ai po fliste për ndihmën që i duhej dhënë popullit të Tij. Në shumë raste Ai iu referua Vetes si bari dhe popullit të Tij si dele, kështu Pjetri e dinte saktësisht se për çfarë Ai po fliste. Mua më duket se Jezusi në këto vargje po thotë se nëse ne e duam Atë, atëherë duhet t'i ndihmojmë të tjerët dhe jo thjesht të mbledhemi në ndërtesa të dielave në mëngjes për të ndjekur rregullat dhe ritualet. Natyrisht, duhet të duam të shkojmë në kishë për të pasur miqësi, për të adhuruar Perëndinë dhe për të mësuar, por kisha duhet gjithashtu të jetë vendi nga i cili ne ndihmojmë njerëz të tjerë. Nëse kisha nuk është e përfshirë në shpëtimin e të humburve në botë dhe në ndihmën ndaj të shtypurve, përfshirë këtu vejushat, jetimët, të varfrit dhe nevojtarët, atëherë nuk jam besoj se kanë të drejtë ta quajnë veten kishë.

Me dhjetëra mijëra njerëz nuk shkojnë më në kishë dhe udhëheqësit frymërorë në mbarë botën janë të shqetësuar për këtë rënie në pjesëmarrje. Unë besoj se arsyeja e kësaj rënieje ka ndodhur kryesisht sepse shumë kisha janë bërë qendra fetare dhe në to nuk gjendet jetë e vërtetë. Apostulli Gjon tha se ne e dimë se kemi kaluar nga vdekja në jetë për shkak të faktit që ne i duam vëllezërit dhe ai njeri që nuk do, mbahet vazhdimisht në vdekje frymërore (shihni 1 Gjonit 3:14). Nëse një kishë nuk është e tejmbushur me dashurinë e vërtetë të Perëndisë, si mund të jetë e mbushur me jetë?

Kam dëgjuar se në Europë, pothuajse çdo javë, mbyllet një katedrale ose kishë dhe se shumë prej tyre po blihen nga grupe myslimane dhe po shndërrohen në xhami. Me siguri ky nuk është qëllimi i Perëndisë për kishën e Jezu Krishtit. Shumë kisha të mrekullueshme janë duke bërë pikërisht atë që duhet të bëjnë dhe

për këtë arsye këto kisha janë duke u rritur dhe plot jetë. Por, mund të thuhet se këto janë përjashtime dhe jo shumica e kishave.

Kisha e hershme, për të cilën lexojmë në librin e Veprave, ishte një kishë shumë e fuqishme. Ajo tronditi botën e njohur të asaj kohe dhe ndikimi i saj ndihet ende edhe në botën e sotme. Ajo ishte e unifikuar dhe të gjithë njerëzit që ishin pjesë e saj vazhdimisht ndihmonin të tjerët në nevojë. Ata ndihmonin njerëz që i njihnin personalisht dhe njerëz në qytete të tjera për të cilët kishin dëgjuar nga apostujt që i vizitonin dhe i mësonin.

Kisha e hershme u rrit me shpejtësi dhe pati një reputacion të mrekullueshëm sepse ajo ishte e mbushur me njerëz që me të vërtetë e donin njëri-tjetrin. Ajo ç'ka bota ka nevojë është dashuria, jo feja! Ajo ka nevojë për Perëndinë; dhe Perëndia është dashuri. Nëse ne biem në një mendje dhe të gjithë përfshihemi, atëherë mund të fillojmë një Revolucion Dashurie, një lëvizje që do ta tronditë edhe njëherë botën për lavdinë e Perëndisë!

Mësoni të Bëni të Mirën

A është gabim të shohësh apo të dëgjosh për dikë në nevojë dhe të mos bësh absolutisht asgjë. Profeti Isaia thotë: "Mësoni të bëni të mirën, kërkonti drejtësinë, ndihmoni të shtypurin, sigurojini drejtësi jetimit, mbron çështjen e gruas së ve" (Isa 1:17).

Qëllimi i këtij mësimi dhe udhëzimi është të na ndihmojë të mësojmë atë që është e drejtë dhe na inkurajon ta bëjmë atë. Disa vite më parë nuk kisha asnjë ide se sa fort Perëndia ndien në lidhje me punën time për të sjellë drejtësi për të shtypurit, por kur e kuptova, fillova ta bëj këtë gjë.

Që prej kohëve të Dhjatës së Vjetër, kur Ai dha ligjin, Perëndia vazhdimisht ka udhëzuar njerëzit se si t'i trajtojnë jetimët, vejushat, të shtypurit dhe të varfrit. Duke folur nëpërmjet Moisiut, Ai tha:

"Mos mundo asnjë grua të ve, as ndonjë jetim" (Eks 22:22). Perëndia nuk është i njëanshëm, Ai "u siguron drejtësi jetimëve dhe të vejave, ... e do të huajin dhe i jep bukë dhe veshje" (LiP 10:18). Perëndia i tha popullit se nëse ata ushqejnë të huajin, banorin e përkohshëm, vejushën dhe jetimin, Ai do të bekonte punën e duarve të tyre (shihni LiP 14:29). Vini re, ju lutem, se të gjithë këto grupe-vejushat, të huajt, jetimët-ndoshta do të ishin plot me njerëz shumë të vetmuar. Perëndia kujdeset për të vetmuarin!

I Vetmuar dhe i Harruar

Nuk mund ta imagjinoj se sa e vetmuar dhe e harruar ndihet një vajzë e vogël jetime, e cila për të mbijetuar, është detyruar të punojë në prostitucion.

Statistikat thonë:

- Dy milionë vajza, të moshës pesë deri në pesëmbëdhjetë vjeç, prezantohen çdo vit në tregun komercial të seksit.
- 89 përqind e prostitutave duan të largohen.
- Të paktën dyqind mijë gra dhe fëmijë punojnë në prostitucion në Tajlandë dhe një e treta e tyre janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Vajza të vogla gjashtëvjeçare punojnë si prostituta.
- Një herë, një mjek gjeti tridhjetë e pesë burra të përdornin të njëjtën vajzë brenda një ore.

A janë të gjitha këto vajza jetime? Jo, jo të gjitha janë zyrtarisht jetime, pra që nuk kanë prindër. Por ato janë jetime në sytë e Perëndisë, sepse ose nuk kanë prindër, ose prindërit që kanë nuk mund apo nuk duan të kujdesen për to.

Prostitucioni i Adoloshenteve

Të shesësh trupin tënd për kënaqësinë e njerëzve të këqij apo të vdesësh nga uria. Kjo është një zgjedhje e tmerrshme që askush nuk duhet të detyrohet ta bëjë. Ndonëse ajo është vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç, Birtukan e ka bërë këtë zgjedhje që kur ishte katërmëdhjetë. Dhe në çdo zgjedhje, zemra e saj thyhet gjithnjë e më tepër dhe shpirti i shkatërrohet. Është mrekulli që, pavarësisht gjithë gjërave që ka kaluar, ajo ende ndjen diçka.

Ajo gjen forcë kur shikon sytë e vajzës së saj shtatë muajshe, Aamina. *"E kam bërë këtë zgjedhje sepse nuk dua që vajza ime të bëjë të njëjtën zgjedhje"*. Emri i saj etiopian, Aamina, do të thotë "e sigurt", dhe Birtukan ka vendosur se do të bëjë gjithçka që duhet për ta përmbushur premtimin se do ta mbajë vajzën të sigurtë.

Ajo nuk e shet trupin për lakmi apo vetë-kënaqësi. E shet për të mbijetuar. Ajo jeton dhe e kryen punën e saj në një dhomë 1.5 x 2.5 metra. Ajo ka punuar për pesë vjet - asnjë ditë ndalesë ... pa pushime ... pa çlodhje. Ajo mbyll sytë dhe mendon për Aaminën, ndërsa madje edhe pesëmbëdhjetë burra në ditë abuzojnë trupin e saj për të përmbushur dëshirat e tyre të këqija. Dhimbja është e paimagjinueshme, por është mënyra e vetme që ajo di për të siguruar ushqim dhe një vend për të fjetur. Kur mendon për dashurinë që ndjen për Aaminën, nuk arrin të kuptojë se si nëna e saj e ka braktisur kur ishte vetëm pesë vjeç.

Para se të vinte në zonën së cilës i referohen si lagjja e dritave të kuqe në Addis Abeba, ajo ishte duke vdekur nga uria. *"Kisha shpresë, por ajo shpresë duket kaq larg meje tani. E di se Perëndia është me mua dhe më do. Nuk di ndonjë mënyrë tjetër për të jetuar"*.

Një dritëz e zbehtë shprese mbetet për ditën kur mbijetesa e saj nuk do t'i kushtojë një pjesë të zemrës, shpirtin dhe trupin e saj të shkatërruar.

Sot, kësaj shprese do t'i duhet të presë. Klienti i saj i ardhshëm sapo ka mbërritur.

Statistikat thonë:

- Mosha mesatare e hyrjes në prostitucion në mbarë botën është trembëdhjetë deri katërmbëdhjetë vjeç.
- 75 përqind e prostitutave janë nën moshën njëzet e pesë vjeçare.¹

Pamja e Një Niveli të Ri Degradimi dhe Reagimi ndaj Tij

Kur shkova në Indi, në lagjen e dritave të kuqe (zona e prostitucionit), një prej lagjeve të varfra, u prezantova me një nivel të ri degradimi. Kjo lagje, jo vetëm që ishte e ndyrë përtej çdo përshkrimi, por ishte gjithashtu e mbushur me shtëpi publike. Më shpunë në një prej tyre, e cila përbëhej prej tre dhomash të vogla me tre shtretër në çdo dhomë. Asnjë prej shtretërve nuk kishte privatësi. Vajzat apo gratë u shërbenin burrave në këto dhoma të vogla kryesisht natën, duke shpresuar të fitonin para të mjaftueshme për të ngrënë dhe për të ushqyer fëmijët e tyre, nëse kishin, dhe shumë prej tyre kishin fëmijë. Ku qëndronin fëmijët ndërsa mamatë punonin? Ata ose loznin në korridor, ku mund të hynin lehtësisht në dhomat ku gjendeshin mamatë e tyre, ose u jepej alkool për t'i vënë në gjumë që të mos i shqetësonin mamatë. Disa prej tyre kishin dëgjuar për programin tonë të ushqimit dhe shkollimit dhe ne

qemë në gjendje të kujdeseshim për ta gjatë këtyre orëve, në mënyrë që ata të mos shikonin se çfarë ndodhte në shtëpi. Shtëpi! Këta fëmijë të vegjël jetonin në shtëpi publike!

Pa ndihmë, shumica e fëmijëve femra - vajza të vogla - thjesht do të kalonin në jetën e prostitucionit sapo të rriteshin paksa. Këto gra nuk jetojnë kështu sepse e dëshirojnë këtë jetë, por nuk kanë zgjedhje tjetër. Ato janë të paarsimuara dhe janë rritur në mes të varfërisë që shumica prej nesh as nuk do të mund ta kuptonin. Disa prej tyre janë në pronësi të tutorëve, të cilët për synimet dhe qëllimet e tyre, i mbajnë të burgosura dhe i rrahin, nëse nuk fitojnë para të mjaftueshme.

Jam e lumtur të them se ne kemi nisur një program shpëtimi për to. Së pari, kemi punuar në këtë fushë për rreth tre vjet, së bashku me disa shërbesa lokale dhe numri i prostitutave ka rënë nga tre mijë në treqind. Disa njerëz thjesht kanë nevojë për pak shpresë apo ndihmë dhe kanë nevojë që dikush t'u thotë se mund të ndryshojnë e t'u tregojnë se si bëhet ky ndryshim.

Shërbesa jonë ka blerë disa qindra hektarë pronë rreth tre orë larg nga lagjja e dritave të kuqe. Aty kemi ndërtuar një fshat të kompletuar me qendër trajnimi për t'u mësuar këtyre grave një profesion që do t'u mundësojë të mbështesin veten dhe familjen e tyre, pa përdorur prostitucionin. I lëvizëm njëqind gratë dhe fëmijët e parë në Qendrën e Restaurimit në shkurt të vitit 2008 dhe kemi si synim t'i lëvizim të gjitha ato gra që dëshirojnë të ndryshojnë.

Ishte shumë ngushëlluese për mua të dëgjoja vajzat e vogla, veçanërisht adoleshentet, të qeshnin me zë të lartë kur u tregoja dushet dhe banjat që do të kishin. E kuptoni, ato nuk kishin bërë banjë në asnjë mënyrë tjetër veçse duke hedhur mbi vete një kovë me ujë, diku pas ndonjë ndërtese. Është një ndjenjë e mrekullueshme të mund të vendosësh buzëqeshje në fytyrat e tyre dhe t'u japësh shpresë. Patjetër që ndihem shumë më mirë sesa atëherë kur jetoja në mënyrë egoiste, kur isha egoiste dhe

përqendroheshja vetëm tek vetja. Partnerët e shërbesës sonë janë përgjegjësit kryesorë të kësaj shërbese në Indi, sepse është dhënia e tyre besnike që paguan për të dhe ne i vlerësojmë ata shumë.

Mund të shtoj se disa prej grave më të mëdha që kanë rënë në grackën e prostitucionit janë vejusha. Burrat e tyre ose kanë vdekur, ose në disa raste janë vvarë dhe i kanë lënë ato pa asnjë mjet mbijetese, prandaj përsëri ato mbështeten në gjënë e vetme që mund të mendojnë për të fituar para.

Ne mund të mësojmë të bëjmë atë që është e drejtë dhe të ndihmojmë njerëzit e shtypur në botë. Gjithçka që na duhet është informacion dhe vendosmëri dhe ne mund të sjellim një ndryshim pozitiv në jetën e shumë njerëzve. Nëse secili prej nesh do të bëjë pjesën e vet, ne mund të fillojmë një revolucion dashurie.

Padrejtësia Është Kudo

Padrejtësia gjendet jo vetëm në vendet e botës së tretë, por edhe kudo në lagjet e qytetet tona. Ka njerëz, me të cilët punojmë, të cilët kanë nevoja të dëshpëruara. Ne ecim rrugëve pranë tyre dhe i hasim në treg. Padrejtësia ka shumë fytyra. Ajo mund të shihet në fytyrën e një gruaje të cilën bashkëshorti e la, me tre fëmijë, për një grua tjetër. Mund të gjendet në fytyrën e një vajze ose djali të vogël, të cilët, mund të jenë abuzuar fizikisht ose seksualisht nga prindërit ose njerëz të tjerë. Mund të shihet në fytyrën e një babai që është rritur në geto, i cili është brezi i tretë i familjes që jeton në asistencë ekonomike. Ai do të donte të jetonte më mirë, por sinqerisht ai nuk di nga t'ia fillojë apo çfarë të bëjë. Ai është shumë pak i arsimuar dhe nuk ka parë asnjë të jetojë ndryshe nga ai përveç ndoshta në televizor.

Disa njerëz arrijnë të kapërcejnë dhe të ngrihen nga tragjedia e padrejtësisë, por shumica nuk arrijnë dot. Ndoshta ata kanë nevojë për ju, për mua ose për ndonjë tjetër që të mund të investojë në ta.

Shërbesa brenda qytetit punon në shkollat publike për t'i ndihmuar fëmijët të mësojnë lexim dhe shkrim. Kemi kërkuar vullnetarë si tutorë të fëmijëve dhe është dekurajuese të mendosh se sa pak njerëz janë të gatshëm të ofrojnë një orë në javë për një ndihmë të tillë. Natyrisht, mendojmë që "dikush" duhet t'i ndihmojë këta fëmijë, por sesi ndodh që ne nuk jemi tek ata njerëz që shkojnë dhe ndihmojnë! Kemi justifikimet tona dhe ato na zbusin vlarjen e ndërgjegjes, por a janë ato të pranueshme nga Perëndia? Për vite të tëra, kam dhënë justifikime për çdo gjë që nuk doja të bëja, por kam zbuluar një të vërtetë që është kthyer në një prej thënieve të mia të preferuara: "Indiferenca nxjerr justifikime; dashuria e gjen një rrugë".

Indiferenca nxjerr justifikime; dashuria e gjen një rrugë.

Standardi i Drejtësisë

Në Bibël, duke filluar me Dhjatën e Vjetër, shohim shembuj të vazhdueshëm të njerëzve që ishin përfshirë në ndihmën ndaj të varfërve dhe nevojtarëve. Jobi ishte një prej këtyre shembujve. Ai tha se duke qenë sy për të verbrin, këmbë për çalamanin dhe baba për të varfrin dhe nevojtarin, ishte i veshur me drejtësi (shihni Job 29:14-16). Shprehja "veshur" ka një kuptim të veçantë që nuk do të duam të na humbasë. Mendojeni në këtë mënyrë: Kur vesh rrobat e mia, e bëj qëllimisht. Nuk qëndroj pasiv para dollapit dhe pres që ato të kërcejnë nga varëset mbi trupin tim. I zgjedh me kujdes secilën prej tyre dhe jo vetëm që i vesh, por edhe sigurohem që të dukem mirë me to.

Perëndia tha se Jobi ishte njeri i drejtë dhe Jobi thotë se ai u "vesh" me drejtësi. Me fjalë të tjera, ai e bërë këtë gjë qëllimisht. Standardi i drejtësisë në ditët e Jobit kërkonte ndihmën ndaj

vejushave, jetimëve, të varfërve dhe nevojtarëve dhe të gjithë atyre që ishin të shtypur.

Sot, në shoqërinë tonë, nuk na kanë ngelur shumë standarde. Duket se shumica e njerëzve bëjnë thjesht atë që duan të bëjnë dhe egoizmi është ai që sundon. Neve na duhen standarde që prodhojnë burra dhe gra me integritet, të vërtetë, të sinqertë, të nderit, të besimit, të besnikërisë dhe që tregojnë kujdes të vërtetë për njerëzit e lënduar. Nëse më shumë njerëz do të kishin cilësi të tilla, bota jonë do të ishte një vend krejtësisht ndryshe. Përgjigjja juaj mund të jetë, "Po, uroj t'i kishim këta njerëz sot", por mos harroni se dëshira nuk na sjell asnjë të mirë. Ne duhet të veprojmë. Bota jonë do të ndryshojë vetëm nëse njerëzit ndryshojnë dhe ky ndryshim duhet të fillojë me gjithsecilin prej nesh. Të gjithë duhet të mbajmë pishtarin dhe të themi "Unë jam Revolucion i Dashurisë!"

Esteri, e reja hebrease rreth së cilës lexuat në kapitullin katër dhe që në fund u bë mbretëreshë, urdhëroi që të dërgoheshin dhurata për të varfrit kur ajo dhe bashkatdhetarët e saj festuan lirinë e tyre. Pjesë e festimit për gjërat e mira që Perëndia ka bërë për ne, duhet të jetë të kujtohem për ata që janë ende në nevojë. Një mikesha ime, bën pjesë në komitetin e kishës së saj që ndihmon të pastrehët në Krishtlindje. Kisha merr një listë të të gjithë fëmijëve që jetojnë në strehëza të veçanta, së bashku me moshat dhe numrin e veshjeve të tyre. Anëtarët e kishës që kanë mundësi të ndihmojnë, zgjedhin emrin e një fëmije dhe blejnë dhurata Krishtlindjeje vetëm për atë fëmijë. Në dhjetor, organizohet një festë Krishtlindjeje në strehëzë ku ofrohen shumë ushqime, muzikë Krishtlindjeje, tregime mbi lindjen e Jezusit dhe dashurinë e Tij për çdo fëmijë, dhe natyrisht çdo fëmije i jepet një dhuratë.

Pas festës, anëtarët e kishës ndihen mirë që kanë ndihmuar fëmijët e pastrehë. Shumë prej tyre kanë thënë gjithashtu se kur kthehen në shtëpi, ata janë shumë më mirënjohës për shtëpitë dhe bekimet e tyre sesa ishin përpara festës.

Është shumë mirë që të shohim dhe të përjetojmë drejtpërdrejt nevojën e njerëzve të tjerë, sepse kjo na sjell një vetëdije të freskët se sa të bekuar jemi. Gjithashtu, shpresoj se na ndihmon të kuptojmë se sa shumë mund të bëjmë nëse përpiqemi. Njerëzit kanë prirje të jenë më bujarë në kohën e Krishtlindjeve dhe shumë përpiqen t'i ndihmojnë të tjerët, por ne na duhet të kuptojmë se njerëzit e varfër dhe të harruar nga shoqëria janë në nevojë gjatë gjithë kohës, dhe jo vetëm një herë në vit për Krishtlindje.

Ndërsa ju shkruaj sot, Dave-i dhe unë jemi në një hotel që ka një tualet dhe dush jashtëzakonisht të vogël. Është kaq i vogël, sa që Dave mund ta prekë tavanin me kokë. Në fillim ai murmuriti pak për sikletin e krijuar, por pastaj u kujtua për njerëzit që kemi takuar dhe që nuk kanë ujë e u duhet të ecin për orë të tëra për të sjellë në shtëpi ujë të pistë për t'i ndihmuar familjet të mbijetojnë. Këta njerëz rrallë bëjnë dush dhe nëse arrijnë të lahen, kjo natyrisht nuk ndodh në një tualet me dush. Të dy kemi zbuluar se të ndihmojmë të varfrit është një bekim për ne, sepse na ndihmon të mos murmurisim apo ankohemi, por të jemi falënderues në gjithçka, ashtu siç Perëndia dëshiron të jemi.

Boazi, një njeri i pasur dhe drejtues në komunitetin e tij, linte atë që Bibla e quan kallinj me qëllim (Ruth 2:16) në fushat e tij, që Ruthi ta gjente, ta mblidhte dhe ta përdorte për të ushqyer veten dhe vjehrrën e saj. Ruthi dhe Naomi, ishin të dyja vejusha dhe prandaj ishin të varfra. Ligji i asaj kohe urdhëronte që të mos mblidhej i gjithë gruri i fushave. Njerëzit duhej të linin diçka në fushë, që të varfrit të vinin dhe të merrnin pak grurë në mënyrë që edhe ata të ushqeheshin. Shohim se Perëndia vazhdimisht siguron për të varfrin. Por sigurimi i Tij nuk binte prej qiellit apo thjesht shfaqej në mënyrë të mrekullueshme; Ai siguronte nëpërmjet njerëzve.

Dashuri në Veprim

Në Shërbesën Joyce Meyer, ne kemi një llogari të quajtur "Dashuri në Veprim". Shërbesa dhe punonjësit mund të dhurojnë para në këtë llogari për t'u përdorur në mënyrë specifike për nevojat e të punësuarve të cilët mund të jenë duke përjetuar një periudhë të vështirë financiare për një arsye të veçantë. Ndoshta një sëmundje apo ndonjë nevojë e veçantë për fëmijën mund t'i ketë lënë ata me një barrë të vështirë financiare. Ne vendosëm se donim të ishim të përgatitur për t'i ndihmuar njerëzit në mesin tonë që kishin nevoja të vërteta dhe nuk mund t'ia dilnin dot mbanë vetë.

Nëse keni një grup studimi të Biblës apo një grup miqsh që janë të interesuar të jenë pjesë e Revolucionit të Dashurisë, një gjë që mund të bëni është të zgjidhni një thesarmbajtës ose të hapni një llogari të veçantë bankare dhe lejojini njerëzit të dhurojnë në atë fond të veçantë çdo javë ose çdo muaj. Nëse dëshironi, mund ta quani "Dashuri në Veprim", ose mund të zgjidhni edhe emrin tuaj, por përdoreni për të plotësuar nevojat që lindin. Shpesh dëgjojmë për nevoja të ndryshme dhe do të dëshironim të kishim më shumë para. Pse të mos filloni të kurseni për ato raste që kështu të mund të jeni të përgatitur? Nëse nuk mund të gjeni një grup të interesuar për këtë gjë, atëherë gjeni një ose dy njerëz dhe nëse do t'ju duhet, bëjeni edhe vetëm, por mos pranoni të mos bëni asgjë!

*Përse më Duhet Krah nëse Nuk e Përdor;
për të Ndihmuar Dikë?*

Një prej deklaratave shokuese që kam zbuluar ndërsa studioja se si Jobi iu përgjigjej të varfërve, ishte fjala e tij se nëse ai nuk e përdorte krahun për të ndihmuar të lënduarin, atëherë dikush duhej t'ia ndante supin prej trupit (shihni Job 31:21-22). Kjo më bëri të

kuptoj se sa serioz ishte ai në ndihmën ndaj njerëzve. A jam e gatshme për të qenë aq serioze? Po ti?

A ka ndonjë qëllim të vërtetë të jetosh nëse gjithçka që do të bëjmë është të ngrihemi çdo mëngjes dhe ta jetojmë jetën për veten tonë? E kam provuar këtë gjë dhe kam kuptuar se ajo më ka lënë bosh dhe të papërmbushur. Nuk mendoj se kjo është ajo ç'ka Perëndia ka në mendje për të gjithë ne si përfaqësuesit e Tij këtu në Tokë.

Për një kohë të shkurtër, ndala së shkruari këtë dorëshkrim për të ri-lexuar të gjitha vargjet biblike që mund të gjeja në lidhje me dashurinë për tjetrin. Tani jam më e bindur se kurrë se ky është qëllimi i vërtetë i jetës. Unë ju nxis të përkushtoni gjithë qenien tuaj për të bërë të mirën. Ofrojin Perëndisë duart, krahët, gojën, këmbët, sytë dhe veshët tuaj dhe kërkojin Atij t'i përdorë ato për të bërë jetën e dikujt tjetër më të mirë. Përdorini krahët si duar shprese për të ndihmuar dikë që është i uritur, në dhimbje apo i vetmuar.

Të Korrat e Dashurisë

Jeta dhe dhënia me vetëmohim prodhon të korra në jetën tonë. Nuk ka asgjë të gabuar të duash dhe të presësh të korrat. Motivi ynë për t'i ndihmuar të tjerët nuk duhet të jetë për të marrë diçka për vete, por Perëndia na thotë se ne do të korrim atë që mbjellim, prandaj mund të presim për këtë përfitim. Një varg biblik që e shpreh kaq bukur këtë të vërtetë, gjendet tek Luka 6:38: "Jepni dhe do t'ju jepet: një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur, gufuese do t'ju jepet në prehër, sepse me atë masë që do të matni, do t'ju matet edhe juve përsëri".

Perëndia premton se do t'i shpërblejë ata që e kërkojnë Atë me zell (shihni Heb 11:6). Fjala *shpërblim*, në tekstin original grek të

Dhjatës së Re do të thotë "pagesa të marra në këtë jetë" ose "kompensim". Në gjuhën hebraike, në të cilën është shkruar Dhjata e Vjetër, fjala shpërblim do të thotë "fryt, fitim, produkt, çmim ose rezultat". Fjala *shpërblim* është përdorur 68 herë në versionin e Biblës së Amplifikuar. Perëndia dëshiron që ne të presim shpërblime për bindjen dhe zgjedhjet tona të mira.

Nëse kujdesemi për të varfrit dhe të shtypurit, Perëndia premton se ne nuk do të na mungojë asgjë, por nëse i fshehim sytë ndaj nevojave të tyre do të kemi "shumë mallkime" në jetët tona (Fja 28:27). Shkrimtari i Fjalëve të Urta madje thotë se kur u japim të varfërve, jemi duke i dhënë hua Perëndisë (Fja 19:17). Nuk mund ta imagjinoj që Perëndia të mos paguajë interesa të mëdha në çfarë i është dhënë Atij hua.

Unë ju nxis të punoni në vendosjen e drejtësisë për të shtypurit. Kjo do të thotë thjesht që nëse shikoni diçka që e dini se nuk është e drejtë, të veproni për të sjellë drejtësi.

Të Jetosh në Dritë

Të gjithë duam më shumë dritë në jetën tonë. Kjo do të thotë më shumë qartësi, kuptim më të mirë dhe më pak konfuzion. Profeti Isaia deklaroi se në qoftë se do ta ndanim bukën tonë me të uriturin dhe të ftonim në shtëpi të varfrit pa strehë, do të vishnim të zhveshurin dhe nuk do të fshiheshim prej nevojave që gjenden rreth nesh, atëherë drita jonë do të shpërthente (shihni Isa 58:7-8). Ai gjithashtu tha se shërimi, restaurimi dhe fuqia e një jete të re do të buronin shumë shpejt. Kjo tingëllon shumë mirë për mua dhe jam e sigurt se është njësoj edhe për ju.

Isaia shkroi për drejtësinë dhe tha se ajo do të shkonte para nesh e do të na përcillte paqe dhe mirëqenie, dhe se lavdia e Perëndisë do të jetë roja jonë. Nëse jemi duke ndihmuar në mënyrë

aktive të shtypurit, Perëndia shkon para nesh dhe Ai gjithashtu na ruan edhe shpinën! Më pëlqen kjo ndjenjë sigurie.

Isaia më tej thotë se nëse do të derdhim atë me të cilën mbështesim jetën tonë për të uriturit dhe do të plotësojmë nevojat e të vuajturve, atëherë drita jonë do të rritet në errësirë dhe çdo trishtim që kemi përjetuar do të krahasohet me diellin në mesditë (shihni Isa 58:10). Dielli në mesditë është shumë i shndritshëm, prandaj mua më duket se të jetosh në dritë do të thotë të ndihmosh njerëzit.

Zoti do të na drejtojë vazhdimisht dhe madje Ai do të na kënaqë edhe në kohë të thatë. Ai do t'i bëjë kockat tona të forta dhe jeta jonë do të jetë si një kopsht i vaditur (shihni Isa 58:11). E gjithë kjo ndodh si rezultat i përpjekjeve për të sjellë drejtësi për të shtypurin.

Shpresoj që, nëpërmjet këtyre premtimeve, të shihni atë që unë shoh. Mendoj se shumë prej nesh humbasin shumë kohë të jetës së tyre duke u përpjekur të marrin atë që Perëndia e jep me kënaqësi nëse ne thjesht bëjmë atë që Ai po na kërkon. Të kujdesimi për të varfrit, të uriturit, jetimët, vejushat, të shtypurit dhe nevojtarët. Jetojeni jetën duke i ndihmuar të tjerët dhe Perëndia do t'ju kënaqë në çdo mënyrë të mundshme.

REVOLUCIONARI I DASHURISË

Martin Smith

Kujt i Drejtohet Dashuria Jonë?

Më kujtohet gjithçka shumë qartë. Ishte 10 Janar 2008. Rruga anësore, e gjitha me gropa dhe pa asnjë trotuar, ishte aq e ngushtë sa mezi e nxinte autobusin tonë. Dolëm jashtë në nxehtësinë, kaosin dhe erën e njëmijë gomave të përdorura, të hedhura në zjarr, të përziera me gazolinë të lirë dhe me plehurat e muajit të kaluar. Kioska dhe punishte, kasolle dhe shtëpi. Sari dhe sandale dhe këmbë të zbathura dhe një zhurmë që të turbullonte shqisat.

Por e gjithë kjo nuk ishte asgjë në krahasim me atë që do të vinte më pas ...

Ky ishte Mumbai, në Indi. Ishim në një lagje të varfër, ose, për të qenë të saktë, ishim në mëhallën e dritave të kuqe të një prej lagjeve të varfra të qytetit. Në fakt nuk shihej asnjë dritë të kuqe dhe të gjithë dukeshin të zënë me punë-bënin, shisnin, fshinin, mbanin.

Ne ishim aty për të parë Prem Kiran-një projekt kushtuar punës me fëmijët e prostitutave dhe familjet e tyre. Dave dhe Joyce na kishin ftuar. Ata na thanë se ishte një projekt që me të vërtetë duhej ta shikonim vetë.

S'mbaj mend të kem parë ndonjëherë kaq shumë jetë në një dhomë të vetme. Dukej sikur muret nuk ishin në gjendje të duronin më. Shtatëdhjetë fytyra të qeshura, të gjitha u kthyen drejt vizitorëve tamam si lulet e diellit kthehen drejt diellit të mbrëmjes. Jashtë mund të shikoja rrugën, lagjen e varfër dhe rrugicat ku fshiheshin kaq shumë dhimbje, luftë dhe vdekje. Por qëndrimi brenda kësaj dhome, ka qenë përvoja më e fuqishme që kisha provuar ndonjëherë.

Një fëmijë, në veçanti, s'më bëhej ta lija. Emri i saj ishte Farin

dhe ajo kishte diçka që ma bënte të vështirë largimin prej saj.

Zbulova më shumë për të në orën pasuese. Si shumë të tjerë, mamaja e Farin-ës ishte prostitutë. Prem Kiram kishte ndërhyrë dhe e kishte ndihmuar ta përmirësonte jetën e saj duke ofruar ushqim, veshje, edukim dhe mbështetjen e dashur, të përkushtuar e sakrifikuese të të krishterëve. Megjithatë pyetje të shumta e pushtuan mendjen time.

Sa herë i është dashur Farin-ës të fshihej poshtë shtratit ndërsa mamaja e saj punonte?

Ndaj sa rreziqeve është ekspozuar ajo në rrugët e lagjeve të varfra pasi binte mbrëmja?

Si mund të shpresonte se jeta e saj do të ishte ndryshe, nëse ajo nuk dilte tani jashtë asaj situatë?

Si mund të largohesha unë?

Si?

Ajo pasdite në Mumbai ndryshoi gjithçka.

Mbrëmjen tjetër ishim duke luajtur një koncert në qytet. Çfarë mund të bënim tjetër, veçse të merrnim fëmijët dhe nënat e tyre të bashkoheshin në skenë me ne? Kështu ata erdhën dhe ishte e mrekullueshme t'i kishim aty lart me ne të gjithë me buzëqeshje të druajtura, me emocione dhe shok kulturor. Dhe pastaj, ndodhi diçka madhështore. Ne po luanim dhe nënat thjesht filluan të kërcenin. Nënëat e darkave, punëtoret e seksit, të cilat ishin veshur me sari të venitur dhe kishin vënë buzëkuq në buzë, kërcenin lirshëm, me hir e me dashuri para një turme prej mijëra vetash. Duke u rrotulluar si pupla në ajër, me duar që tregonin histori dhe me këmbë që shkëlqin me kujdes, vallja e tyre kapi diçka që unë nuk e kisha parë kurrë më parë.

Dhe në atë moment një mendim goditi mendjen time: Ku duhet të jetë drejtësia? Ku duhet të jenë të mirëpritur njerëzit e dëbuar? Ku duhet ta gjejmë lirinë dhe shpresën ata, jetët e të cilëve janë të shtypura nga varfëria? Ku duhet të derdhet pa ngurrim dashuria jonë?

Unë isha rritur në kishë, por diku gjatë rrugës i kisha humbur disa mësimet. Nuk kisha mësuar se kur vjen puna tek reagimi ynë ndaj varfërisë dhe padrejtësisë - dhe roli i ne të krishterëve si adhurues-Perëndia nuk i do gjërat e ndara me kujdes. Vite më parë, do të isha larguar me vrap nga sugjerimi që këto gra, të detyruara të punonin në prostitucion, të kërcenin mbi skenë ndërsa ne adhuronim. Tani kjo duket si një shenjë e kohërave. Duket se Perëndia është duke i nxitur kishat si kurrë më parë dhe po na bën të ditur se janë këta njerëz që duhet të ndihen të mirëpritur.

Pra, kur përballemi me mendimin se kemi nevojë për një Revolucion Dashurie, unë hasem me një pyetje: Kujt i drejtohet dashuria jonë?

U ktheva në shtëpi nga udhëtimi në Mumbai dhe çdo gjë ishte rrëmujë. Mendja nuk më funksiononte si më parë dhe ndihesha shumë i shqetësuar. Ndjeja një barrë mbi vete në lidhje me Farin-ën - nëse nuk ndërmerrnim ndonjë gjë, atëherë jeta e saj do të shkonte drejt një të ardhmeje të shkurtuar për shkak të vuajtjeve, varfërisë, abuzimit dhe sëmundjeve. Ndjeja se ajo ishte bërë vajza jonë dhe familja jonë ishte e paplotë pa të.

Por planet e Perëndisë ishin të ndryshme nga planet e mia.

Një vit e disa muaj më vonë, ndërsa po shkruaj në lidhje me këtë përvojë, gjërat nuk janë ashtu siç i mendoja unë të ishin. Farin-a nuk është larguar nga ai qytet. Ajo është ende me familjen e saj, por mamaja e saj nuk punon më si prostitutë. Ato do të lëvizin disa orë larg Mumbait për të jetuar në një komunitet të ndërtuar për njerëz si ato ish-punëtore të seksit që duan të fillojnë një jetë të re larg kaosit dhe rrezikut të së kaluarës. Jeta e Farin-ës është më e plotë se sa unë mund të shpresoja.

Po jeta ime?

Në një farë mënyrë kisha të drejtë kur thashë se do të bëhesha sërish baba. Por jo për Farin-ën. Gjatë këtij viti, gruaja ime Anna dhe unë i dhamë jetë një fëmije tjetër - një organizatë bamirësie të

quajtur Arti i Dhembshurisë.

Arti i Dhembshurisë ekziston për të mbledhur para nëpërmjet projekteve të lidhura me artet (si albume dhe libra) të cilat i përdorin shitjet dhe honorarët për të luftuar varfërinë në të gjitha format e saj, llojin ekstrem që u grabit njerëzve jetën dhe llojin që ndoshta mund të jetë më i vështirë për t'u vënë re, por që u vjedh njerëzve shpresën. Të dyve na kujtohet kur kemi folur me Joyce dhe Dave në lidhje me ngjizjen e kësaj organizate, gjë e cila mendoj se i bën ata gjyshër, apo diçka të ngjashme, të Artit të Dhembshurisë. Ishte pasioni dhe urtësia e tyre që na ndihmuan të ndërmerrnim ata hapa të hershëm.

Por, më shumë se kaq, Arti i Dhembshurisë ka të bëjë me ripunimin e formulës. Ai sfidon mitin se kur ne ndalojmë së kujdesuri për të tjerët, besimi ynë vazhdon të qëndrojë në vijën e duhur. Nuk është kështu. E vërteta, natyrisht është se gjithçka bëhet më e dobët. Kur pasioni, qëllimi dhe dashuria jonë drejtohen drejt agjendës sonë, ne thjesht jemi gabim.

Kur dashuria jonë arrin përtej, atëherë e gjejmë veten gjithnjë e më shumë në të njëjtën linjë me rrugën e drejtë të Perëndisë.

Kohët e fundit, sa herë që kam pasur mikrofoni në një skenë para një grupi njerëzish të cilët pyesin veten se çfarë do të ndodhë më pas, kam ndjerë nevojën për të lexuar nga Isaia 58. Në një farë mënyre nuk kam qenë në gjendje t'i rezistoj thjeshtësisë dhe forcës së atyre fjalëve. Ndonëse këto fjalë iu dhanë izraelitëve, pothuajse tre mijë vjet më parë, ato trajtojnë çështje të përjetshme që kanë të bëjnë edhe me ditët e sotme.

Përfshihem nga pasioni i vargjeve hapëse: "Bërtit sa të mundësh, mos u kurse; ngrije zërin tënd si një bori" (Isa 58:1).

Fjalët vijuese duhen thënë me zë të lartë, jo duke i pëshpëritur apo duke i lënë për një periudhë të mëvonshme. Kjo është një çështje e kohëve të sotme që duhet të kapë vëmendjen e të gjithëve, kudo: "Më kërkoni çdo ditë dhe dëshirojnë të njohin rrugët e mia, si një

komb që zbaton drejtësinë dhe nuk e braktis ligjin e Perëndisë së tij; më kërkojnë gjykime të drejta dhe dëshirojnë t'i afrohen Perëndisë" (v. 2, theksimi i fjalëve është imi). Fjalët duket dhe nëse janë problemi. Duket qartë se zemra e tyre nuk është e drejtë dhe ata janë duke rënë.

Perëndia i përgjigjet pyetjes së tyre se përse Ai duket sikur i ka shpërfillur të gjitha veprat me cilësi të lartë fetare: "Ja, ditën e agjërit tuaj bëni atë që ju pëlqen dhe i detyroni punëtorët tuaj të kryejnë punë të rëndë. ... Duke agjëruar kështu si bëni sot, bëni që zëri juaj të mos dëgjohet lart" (vargjet 3-4).

Pastaj vjen përsëri mësimi, përmbledhja që edhe ata prej nesh që kanë qenë duke dremitur atje në fund, ta kuptojnë: "Agjërimi që më pëlqen a nuk është vallë ky: të thyesh zinxhirët e ligësisë ... t'i lësh të lirë të shtypurit ... në ndarjen e bukës sate me atë që ka uri, në sjelljen në shtëpinë tënde të të varfrit pa strehë, në të veshurit e atij që është lakuriq, pa lënë pas dore ata që janë nga gjaku yt?" (vargjet 6-7). S'ka si të jetë më e qartë, apo jo? Të përndjekurit, të abuzuarit, të uriturit, të pastrehët, të varfrit-këta janë njerëzit ndaj të cilëve duhet drejtuar dashuria jonë, jo drejt vetes apo drejt ideve tona të dështuara për të bërë përshtypje si njerëz fetarë.

Perëndia është i qartë në lidhje me rezultatet e gjithë kësaj: "Atëherë drita jote do të shpërthejë si agimi dhe shërimi yt do të mbijë menjëherë ... Atëherë do të thërrasësh dhe ZOTI do të të përgjigjet, do të bërtasësh dhe ai do të thotë: 'Ja ku jam!'" (vargjet 8-9).

Për vite me radhë kemi kërkuar intimitet në adhurimin tonë. Kemi kënduar këngë që flasin se si Perëndia është afër nesh dhe se si jeta jonë i përket Atij. I kemi kërkuar ato momente kur ndiejmë se Perëndia është pranë nesh; kemi ndjekur zërin e Tij dhe kemi kërkuar planet e Tij. Dhe gjatë gjithë kësaj kohe kemi humbur çelësin e intimitetit të vërtetë: "Në rast se ti heq dorë nga zgjedha, të treguarit me gisht dhe të folurit e mbrapshtë, në rast se plotëson nevojat e të uriturit dhe ngop shpirtin e pikëlluar ... ZOTI do të të udhëheqë

vazhdimisht, do të ngopë shpirtin tënd në vendet e thata dhe do t'u japë forcë kockave të tua; ti do të jesh si një kopsht i ujitur dhe si një burim uji, ujërat e të cilit nuk shterojnë" (vargjet 9-11).

Nëse e bëjmë këtë gjë, atëherë më shumë se shpërblimi i dëgjimit të zërit të Perëndisë dhe i mbartjes së dashurisë së Tij ndaj atyre që kanë më shumë nevojë, më shumë se imazhi fantastik i kopshtit të ujitur zhytur në vetë jetën, Isaia bën të qartë se populli i Perëndisë do të fillojë të zërë vendin e vet në histori: "Njerëzit e tu do të rindërtojnë rrënojat e lashta dhe ti do të ngresh përsëri themelet e shumë brezave të shkuar; kështu do të quhesh riparuesi i të çarave, restauruesi i shtigjeve për të banuar në vend" (v. 12).

Ka edhe më: "Do të gjesh kënaqësinë tënde te ZOTI dhe unë do të të bëj që të kalërosh mbi lartësitë e Tokës dhe do të të jap të hash trashëgiminë e Jakobit, atit tënd" (v. 14).

E gjithë kjo ndodh nëse nuk përpiqemi më t'i bëjmë përshtypje Perëndisë duke qenë "frymërorë" dhe duke ofruar shërbesa të mira që u bëjnë përshtypje njerëzve rreth nesh. E gjithë kjo vjen duke ushqyer dikë që është i uritur, duke u dhënë rroba të varfërve, duke mbrojtur të pafuqishmin dhe duke folur për të dobëtin. E gjithë kjo - e gjithë kjo histori realizohet - me vepra nga më të thjeshtat. Ah, sikur-sikur të mësonim të donim më shumë se thjesht veten tonë.

Ka edhe një të vërtetë tjetër prapa gjithë kësaj. Fakti është se është e vështirë të shikosh përtej dhe të përpiqesh ta drejtosh dashurinë drejt të tjerëve. Është më e thjeshtë kur ka të bëjë vetëm me veten. Pse? Pjesërisht për shkak se kështu ka qenë gjithmonë - që prej historisë së çiftit që shijoi frutin e ndaluar, tek mbretërit që vëzhgonin prej çatisë gratë që së shpejti do të ngeleshin vejusha, e deri tek profetët që u drejtuan drejt Spanjës sepse nuk mund të përballeshin me perspektivën e Perëndisë mbi mëshirën e ofruar kujtdo por jo popullit të Tij. Kështu ka qenë gjithmonë me ne, një luftë e vazhdueshme ku vendosim veten në fron, në vend të Perëndisë dhe të Këndvështrimit të Tij mbi jetën.

Duket sikur këto ditë është më e vështirë se kurrë. Kudo rreth nesh gjenden forca që na shtyjnë t'i bindemi etjes sonë, t'u jepemi impulseve sepse "ne ia vlejmë", ta kapim jetën dhe ta kthejmë atë sipas imazhit tonë. Jemi bërë për të dëshiruar-dhe për të pasur-gjithçka: pamjen, veshjen, të ardhurat, shtëpinë, marrëdhëniet, karrierën. Çdo gjë është projektuar për të na lustruar dhe për t'i bërë jetët tona shumë më të mira.

Por ne e dimë të vërtetën e jetës, apo jo? E dimë se pavarësisht presionit për t'u konfirmuar, një jetë e drejtuar drejt vetes nuk mund të na çojë drejt lumturisë së vërtetë.

Gjithmonë më ka pëlqyer kur luanim në ndonjë koncert dhe këndonim këngën e histori-bërësit. Gjatë viteve në bandë, e kemi kënduar me qindra herë, dhe ndjenim se vargjet kishin një lloj force që i bënte njerëzit të ndiheshin të frymëzuar, të fuqizuar dhe të nxitur për të jetuar një jetë të shquar që do të shkruante historinë. Por ka më shumë; duhet të ketë më shumë.

Në qoftë se do të jemi histori-bërës - dhe e ardhmja e miliona njerëzve varet nga numri sa më i madh i atyre prej nesh që marrin përsipër ta bëjnë këtë gjë - atëherë, për shumë prej nesh, kjo gjë do të ndodhë për një grup specifik arsyesh. Ne do ta shkruajmë historinë duke zgjedhur t'i jetojmë jetët tona si një seri veprimesh të vogla vetëmohuese. Ashtu siç ka thënë Nënë Tereza: "Nuk ka gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe". Nëse do të mund ta fusim këtë gjë në ADN-në tonë, dy miliardë të krishterët e botës do të mund t'i jepnin fund varfërisë për punë javësh. Kjo është historia që unë dua të na shohin të bëjmë. Harrojeni përqendrimin tek vetvetja; dhe ashtu si ato fjalë të lashta tek Isaia 68 premtojnë, ne do ta dëgjojmë Perëndinë më qartë dhe do të jemi një hap më afër fuqisë dhe qëllimit të Tij, nëse ndalojmë së bëri këto gjëra për veten tonë dhe thjesht fillojmë të rregullojmë problemet dhe të plotësojmë nevojat e atyre rreth nesh. Po, është kaq e thjeshtë.

Ajo çka unë di me siguri është kjo: e madhja do të jetë gjithmonë

e fuqishme, por e vogla është jashtëzakonisht e bukur. Ky Revolucion Dashurie ka fuqinë për të qenë masiv, por ai do të përbëhet vetëm nga vepra të vogla dashurie vetëmohuese e sakrifikuese. Kështu, skenat tona të mëdha dhe shitjet e mëdha të albumeve dhe këngët e mëdha-mirë, ato janë në rregull, por nuk janë aspak aq emocionuese sa fuqia e jetës që jetohet kundër rrymës.

Edhe diçka tjetër: si përfshihet muzika në gjithë këtë? Tundimi për të lënë pas gjithçka krijuese e për të jetuar në një kuti kartoni, është i fortë. Më duket sikur kjo do të ishte një mënyrë për të bërë më në fund diçka "të vërtetë" me jetët tona. Por nuk është kurrë e gjithë historia. Mirëqenia e njeriut lidhet me tërësinë e tij - trupin, shpirtin dhe frymën. Unë e kam parë personalisht fuqinë e muzikës dhe jam i bindur se ajo është arma sekrete e Perëndisë. Muzika mund të sjellë unitet aty ku ka luftë, mund të zbusë dhimbjen e thyerjes, mund të thyejë zemrat më të forta - dhe të zbusë zemrën e thyer, nga viktimat e gjenocidit të Ruandës deri tek njujorkezët që humbën familjarët e tyre në kullat binjake, si edhe ata urrejtja e të cilëve nxiti kaq shumë vuajtje.

Silleni Perëndinë në këtë ekuacion - jo se mund ta lini Atë ndonjëherë jashtë, por e kuptoni se çfarë dua të them, apo jo?-dhe mund të fitoni një turmë që nën qiellin indian këndon këngë "për Zotin", që adhuron të Plotfuqishmin së bashku me engjëjt. Hapini sytë dhe do të shikoni shërimin të vijë. Ndoshta muzika nuk vendos menjëherë ushqim në gojën e fëmijëve të dëshpëruar, por është një moment ku qielli prek tokën, dhe në atë moment ndodh restaurimi. Është atëherë momenti që ndiejmë se i përkasim dikujt, ndiejmë se nuk jemi vetëm. Për më tepër, ndiejmë se Vetë Perëndia nuk na ka braktisur.

Muzika mund ta bëjë këtë gjë dhe Perëndia nuk po na thërret ta lëmë atë mënjane dhe të shkojmë të jetojmë në një kuti kartoni. Ai na bën thirrje ta përdorim muzikën tonë, e cila është dhurata që Ai

ka vendosur në ne për t'i ndihmuar të varfrit që jetojnë në situata të dëshpëruara. Nëse i praktikojmë këto mësimë, të dhëna aq qartë nga fjalët e Isaias, jam i bindur se në ditët që do të vijnë, do të shohim mrekulli të mëdha, madje përpara se të këndohet një notë e vetme.

Kjo është një muzikë dhe Revolucion Dashurie.

Steven Curtis Chapman, kompozitor e drejtues adhurimi dhe një njeri që të frymëzon me çdo frymëmarrje e që drejton me përlësi dhe hir, i vendosi gjërat në një perspektivë të madhe për mua. Ai mund të ketë shitur me mijëra albume dhe ka marrë çmime të panumërta shfaqjesh, por pyeteni se për çfarë ndihet më shumë krenar apo më i përlur dhe ai do t'ju thotë këtë - mënyra se si familja e tij i është përkushtuar adoptimit të fëmijëve që kanë nevojë për një shtëpi. "Kjo është shenja më e qartë se Perëndia vepron në jetën time" - thotë ai.

Kur shohim përtej vetes sonë, kur dashuria për të tjerët na shtyn përtej rehatisë, kur e vendosim thesarin tonë në rindërtimin e jetëve, atëherë do ta gjejmë veten të jetojmë mes shenjave të pamohueshme se Perëndia është duke vepruar në jetët tona.

Pra, ky është një revolucion që nuk do të jetë televiziv. Nëse e bëjmë siç duhet, nuk do të ketë nevojë të dalë në televizion; prova e dashurisë në veprim do të bëhet e njohur në gjithë jetën tonë, duke transformuar lagjet tona dhe duke dhënë një erë shprese në atmosferë.

Është kaq e thjeshtë.



KAPITULLI

8

Dashuria Është Përfshirëse, Jo Përjashtuese

Nëse i gjykon njerëzit, nuk ke kohë t'i duash.

Nënë Tereza

Jamie u fut në kishën që gjendet në cep të Spruce Avenue dhe Twenty-third Street në Harbor të Illinoisit. Ajo ishte e dëshpëruar për ndihmë. E kishte parë ndërtesën e kishës për një kohë të gjatë dhe kishte vënë re se si grupe njerëzish futeshin ose dilnin prej aty dy apo tre herë në javë. Jamie ishte ulur shpesh në kafenenë përballë kishës, pinte kafe dhe pyeste veten se a do ta pranonin nëse e gjente guximin për të shkuar në një prej shërbesave të kishës.

Kur kishte qenë fëmijë, Jamie kishte ndjekur shkollën e së dielës disa herë së bashku me fqinjën, por sigurisht që dinte shumë pak rreth protokollit të duhur të pjesëmarrjes në kishë. Nuk ishte e sigurt nëse do të përshtatej ose a do të pranohej, prandaj thjesht pinte kafënë dhe shikonte. Përpiqej të shikonte nëse njerëzit e kishës dukeshin më të lumtur kur dilnin sesa ishin kur hynin, por ata largoheshin kaq shpejt sa që nuk mund t'i shihte qartë. Herë pas here, ndonjë njeri vinte në kafene pas shërbesës së kishës. Disa prej tyre uleshin vetëm dhe, sinqerisht, dukeshin të vetmuar si ajo.

Disa vinin me të tjerë dhe qeshnin e dukeshin të lumtur, gjë e cila i jepte asaj shpresë se një ditë ajo mund të gjente kurajon e duhur për të shkuar në shërbesë.

Jamie u rrit në një shtëpi ku mori shumë pak dashuri. Të dy prindërit e saj ishin të alkoolizuar dhe ndonëse nuk e kishin abuzuar haptazi, ata e dëmtuan shumë imazhin që ajo kishte për veten duke qenë të shpejtë në kritika dhe në gjetjen e të metave të saj. Shpesh, ata e krahasonin atë me vëllanë e saj, i cili dukej se ishte më i zgjuar dhe më i talentuar se ajo në çdo gjë. Jamie gjithmonë ndihej e padashur, e shëmtuar, budallaqe dhe sikur të mos kishte aspak vlerë.

Kur ishte trembëdhjetë vjeç, Jamie kishte rënë në shoqëri të gabuar dhe pinte e merrte drogë. Dhimbja e saj emocionale ishte kaq e thellë, sa që ajo e mpinte duke abuzuar me substancat. Ajo gjithashtu zhvilloi edhe çrregullime në ushqyerje, të quajtura bulimi. Ajo hante sasi normale ushqimi, herë pas here hante më shumë se ç'duhej, por gjithmonë e detyronte veten të villte pas ngrënies që të mos shëndoshej.

Kurrë nuk e kishte harruar ditën e dymbëdhjetë vjetorit të lindjes kur mamaja e pa me neveri dhe i tha: "Nuk pata kohë të të përgatisja një tortë për ditëlindje, por ti nuk ke nevojë sepse je mjaft e shëndoshë!". Ajo kurrë nuk kishte menduar se ishte e shëndoshë deri në atë ditë, por që prej asaj kohe, e shihte veten në pasqyrë dhe shihte një vajzë 15 kg më të rëndë se ç'ishte në të vërtetë. Imazhi për veten u shtrembërua për shkak të fjalëve të këqija dhe pa-dashuri që nëna e saj i thoshte vazhdimisht.

Notat e Jamie-t në shkollë nuk ishin shumë të mira dhe ajo nuk ndihej të kishte "brumë për koleg", prandaj pasi u diplomua në gjimnaz, filloi të punonte në një dyqan lokal për të rregulluar raftet dhe për të paketuar ushqimet. Ajo nuk mund të fitonte kurrë para të mjaftueshme për t'u larguar nga shtëpia e prindërve, por ishte në gjendje të blinte veshjet, pijet alkoolike dhe pak drogë kur donte me të vërtetë të dilte jashtë kësaj bote. Në pjesën tjetër të kohës,

përpiqej të mos qëndronte në shtëpi, por ulej në kafene ose ecte nëpër lagje dhe mendonte se si ishin familjet e tjera që jetonin aty. Nuk kishte miq të vërtetë-të paktën jo njerëz të cilëve u besonte ose ku mund të mbështetej. Njerëzit në jetën e saj ishin marrës, jo dhënës dhe ajo ndihej e frikësuar nga shumë prej tyre.

Një ditë, më në fund mori guximin të shkonte brenda kishës ndërsa po futeshin edhe njerëz të tjerë. U shkri mes turmës, pjesërisht duke shpresuar të mos binte në sy, por pjesërisht e dëshpëruar që dikush ta mirëpriste dhe t'i thoshte "Jemi shumë të gëzuar që je këtu sot". Vuri re se disa njerëz po e shikonin dhe madje edhe po pëshpëritnin, por asnjë nuk dukej miqësor. Jamie vishej disi e egër për shijen e shumicës së njerëzve dhe flokët i kishte me tre ngjyra të ndryshme. Ajo kishte flokë të zinj me fije të verdha dhe të kuqe. Kishte veshur xhinse të varura dhe këmbë të gjatë. Nuk e bënte për rehati, por përpiqej të fshihte, siç mendonte ajo, trupin e saj të shëndoshë. Kishte veshur pantofla, të cilat, natyrisht, askush nuk i vishte në kishë-të paktën jo në atë kishë!

Jamie u ul në rreshtin e fundit dhe nuk po kuptonte aspak se çfarë po ndodhte. Njerëzit vazhdimisht ngriheshin në këmbë dhe lexonin gjëra nga një libër që ishte vendosur me kujdes në mbajtësen e anës së pasme të stolit përballë; pastaj uleshin përsëri. U kënduan disa këngë, u luajt organoja, lutje dhe një kosh oferte kalonte nga dora në dorë dhe disa njerëz vendosnin para brenda saj. Një njeri që dukej disi jo i lumtur dhe pak i mërëzitur dha një predikim njëzet minutësh, të cilin Jamie nuk e kuptoi fare. Mendoj se ai duhej të ishte pastori, por nuk ishte e sigurt. Më në fund, shërbesës dukej se po i vinte fundi, sepse të gjithë njerëzit u ngritën në këmbë dhe kënduan edhe një këngë tjetër.

Mendoj se ndoshta dikush do t'i thoshte diçka rrugës duke dalë. Sigurisht, dikush do t'i thoshte diçka. Pastori qëndronte tek dera duke i dhënë dorën njerëzve ndërsa ata dilnin radhazi nga kisha dhe kur Jamie arriti tek ai, ai nuk buzëqeshi dhe as nuk e pa në sy. Ajo e kuptoi

se ai thjesht po bënte detyrën e tij dhe mezi priste të përfundonte.

Ndërsa po zbriste, kuptoi se një grua po e priste në fund të shkallëve. Jamie filloi të gëzohej pak duke menduar se, në fund të fundit, dikush e kishte vënë re. Patjetër që ajo grua e kishte vënë re, vetëm se kishte parë gjithçka që ajo mendonte se ishte e gabuar me mënyrën se si Jamie dukej, prandaj i tha: "Mua më quajnë Margaret Brown. Po ti, si quhesh?". Jamie i tha emrin e vet dhe Margaret vazhdoi duke thënë: "Ti je gjithmonë e mirëpritur këtu, por më lër të të ndihmoj dhe të të them se ne vishemi mirë kur vijmë në kishë këtu në Holiness Tabernacle (Tabernakullin e Shenjtë). Pa xhinse, pa pantofla dhe duhet të mendosh për një stilim tjetër flokësh që tërheq më pak vëmendje. A e di, e dashur, se Jezusi na mëson të jemi të përlurur dhe të mos e tërheqim vëmendjen tek vetja". Ajo i dha Jamie-t një buzëqeshje të shtirë dhe tha përsëri: "Je e mirëpritur në çdo kohë".

Jamie nuk mund të shkonte tek kafeneja atë ditë; i duhej të shkonte diku ku mund të ishte vetëm e të qante. Ajo mendonte se tani, edhe Perëndia e kishte refuzuar dhe e kaloi pjesën tjetër të ditës duke menduar për vetëvrasje. Kishte arritur fundin dhe ndiente se nuk kishte asnjë arsye për të jetuar.

Emrat e mësipërm janë të trilluar. Por bota është e mbushur me Jamie dhe me Holiness Tabernacle dhe me njerëz fetarë si znj. Brown. Është e mbushur me të krishterë që çdo javë radhiten për të hyrë e dalë nga kisha. Shumë prej tyre mezi shkojnë dhe mezi presin të mbarojë shërbesa. Ata janë kritikë, gjykues dhe shumë ekskluzivë!

Perëndia i Do të Gjithë Njësoj

Jezusi ndoshta nuk ishte në Holiness Tabernacle ditën që Jamie shkoi sepse as Ai nuk do të ishte ndierë rehat. Por, po të kishte qenë, Ai do të kishte qenë duke parë për shumë Jamie që mund të

vinin atë ditë. Ai ose do të ishte ulur pranë saj, ose do ta kishte çuar më afër fillimit për t'u ulur me Të, dhe Ai do të kishte pyetur nëse ishte vizitore. Kur të kishte zbuluar se ishte vizitore për herë të parë, Ai do t'i kishte shpjeguar gjithçka që ajo nuk kuptonte. Ai do t'i kishte buzëqeshur sa herë që ajo ta vështronte dhe, duke e njohur Atë, Ai do ta kishte përgëzuar për stilin e saj unik të flokëve sepse Atij i pëlqen varieteti! Ai madje do ta kishte ftuar në kafenenë përballë për të pirë një kafe së bashku me grupin me të cilin Ai dilte zakonisht dhe kur Jamie të largohej, ajo mezi do të priste të kthehej përsëri javën tjetër. Por, për shkak se Jezusi nuk ishte aty atë ditë, asnjë prej atyre njerëzve nuk vepruan si Ai. Asnjë nuk e përfaqësoi Atë siç duhet; dhe asnjë nuk ishte duke imituar Perëndinë.

Nuk Bën dallim Personash

Bibla thotë në disa vende se Perëndia nuk bën dallime personash (shihni Veprat 10:34, Rom 2:11, Efe 6:9). Me fjalë të tjera, Ai nuk i trajton disa njerëz më mirë sesa disa të tjerë për shkak të mënyrës se si ata vishen, të nivelit të të ardhurave, pozitës që gëzojnë apo për shkak të miqësive. Ai, jo vetëm që i trajton të gjithë njëllë, por duket se shkon më tej duke i trajtuar veçanërisht mirë njerëzit e lënduar. Perëndia i dha Moisiut shumë udhëzime që t'ua jepte izraelitëve në lidhje me trajtimin që duhej t'i bënin të huajit në mesin e tyre. Udhëzimi i Tij parësor, në thelb, ishte gjithmonë "Bëjini ata të ndihen rehat dhe të qetë dhe miqësohuni me ta. Në asnjë mënyrë mos i shtypni" (shihni Eks 22:21, Eks 23:9, Lev 19:33). Apostulli Pjetër ka thënë:

Jini mikpritës njëri për tjetrin (me familjen e besimit) [Jini mikpritës, duajini të huajt, me dashuri vëllazërore për miqtë e panjohur, të huajt, të varfrit dhe të gjithë ata që

vijnë në shtegun tënd e që janë të trupit të Krishtit], pa murmuritje [në çdo rast] (përzemërsisht dhe me mirësjellje, pa u ankuar por duke përfaqësuar Atë).

1 Pjetri 4:9

Para se ta kaloni me nxitim këtë pjesë, mendoni një herë se sa miqësorë tregoheni me njerëzit që nuk i njihni dhe veçanërisht me ata që janë krejtësisht ndryshe nga ju. Disa njerëz janë miqësorë nga natyra dhe nga temperament, por ata që nuk duket se e kanë "dhuntinë e miqësisë" duhet të marrin vendimin për ta bërë këtë gjë, sepse Bibla na thotë ta bëjmë.

Apostulli Jakob e paralajmëron kishën të mos i kushtonin vëmendje të veçantë njerëzve që vishnin rroba të shkëlqyeshme për në sinagogë, apo t'u jepte atyre vendet më të mira. Ai tha se nëse njerëzit sillleshin në këtë mënyrë dhe donin trajtim të veçantë, ata po bënin diskriminime dhe kishin motive të gabuara. Ai tha se ne as nuk duhet të përpiqemi ta praktikojmë besimin e Zotit tonë Jezu Krisht së bashku snobizmin (shihni Jak 2:1-4). Me fjalë të tjera, ne duhet t'i trajtojmë të gjithë njerëzit si të denjë për respekt.

Jezusi i dha fund dallimit midis njerëzve dhe tha se të gjithë jemi një në Të (shihni Gal 3:28). Ne thjesht duhet të shikojmë njerëz me vlerë, jo njerëz të zinj, të kuq apo të bardhë, jo markat e rrobave të tyre, stilin e flokëve, makinën që ngasin, profesionet apo titujt e tyre - thjesht njerëz për të cilët Jezusi vdiq.

Një Mësim nga Kafeneja

Unë besoj se të gjithë duhet t'i marrim në shqyrtim kufijtë tanë përfshirës dhe t'i zgjerojmë ata. Duhet t'i zgjerojmë mjaftueshëm sa për të përfshirë të gjithë llojet e njerëzve. Kohët e fundit kam qenë me Paul Scanlon, një pastor në Birmingham të Anglisë, dhe

po pinim kafe në një kafene bashkë me disa të tjerë. Më kujtohet se pashë stilin e flokëve të një vajze që po na shërbente si kamariere dhe të jem e singertë, ishte absolutisht gjëja më e çuditshme që kam parë ndonjëherë. Ajo e kishte rruar kokën, përveç pjesës së mesit që quhet Mohawk dhe e kishte lyer me ngjyrë të zezë, blu, të kuqe dhe të bardhë. Ajo kishte vënë vathë në hundë, gojë, buzë dhe një numër të madh nëpër veshë. Më kujtohet se ndihesha paksa e sikletosur, sepse ajo nuk ishte aspak si unë. Ishim kaq të ndryshme, sa që nuk më vinte ndër mend të thoja asgjë që kishte të bënte me të. Thjesht doja të porosisja kafen time dhe të përpiqesha të mos ia ngulja sytë asaj.

Paul, nga ana tjetër, filloi bisedën me të dhe gjëja e parë që i tha ishte: "Më pëlqejnë flokët e tu. Si ia bën t'i mbash kështu lart?". Ai e vazhdoi bisedën me të dhe tensioni papritur u largua. Shumë shpejt të gjithë filluam të ndiheshim rehat dhe unë vura re se të gjithë po bashkoheshim në bisedë dhe e përfshimë atë në rrethin tonë. Atë ditë mësova një mësim shumë të madh - që unë nuk jam aq "moderne" sa më pëlqen të mendoj se jam. Kam akoma disa mendime prapanike fetare me të cilat duhet të merrem dhe më duhet të kaloj në një nivel të ri që t'i bëj të gjithë njerëzit, përfshirë edhe ata që janë pak ndryshe, të ndihen rehat dhe të përfshirë.

Ndoshta, për vajzën në kafene, unë isha ajo e pazakonta dhe e ndryshmja. Përse e vendosim gjithmonë veten si standard për atë që është e pranueshme dhe supozojmë se kushdo që është ndryshe duhet të ketë problem? Cili është stili i duhur i flokëve, apo i veshjeve? Një ditë fillova të mendoj se si është dukur Moisiu kur u kthye nga mali Sinai, ku kaloi dyzet ditë e net duke marrë Dhjetë Urdhërimet prej Perëndisë. Vë bast se flokët i kishte të ngatërruara; mjekra kishte nevojë për një shkurtim të mirë; dhe rrobat e sandalet ishin paksa të pista.

Unë e di se Gjon Pagëzori ishte disi i çuditshëm. Ai jetonte vetëm në shkretëtirë, vishej me lëkura kafshësh dhe ushqehet me mjaltë

e karkaleca. Kur dilte nga shkretëtira, ai thërriste me zë të lartë: "Pendohuni, sepse mbretëria e Perëndisë është afër"!

Bibla na mëson se duhet të kemi kujdes se si i trajtojmë të huajt sepse, pa e ditur, mund të jemi duke mikpritur engjëjt (Heb 13:2). Aty thuhet se duhet të jemi të sjellshëm, të përzemërt, miqësorë dhe të hirshëm me ta dhe të ndajmë të mirat e shtëpive tona. Shumë njerëz në shoqërinë e sotme, madje as nuk u flasin të huajve, jo më të tregohen miqësorë.

E di, e di; ju ndoshta po thoni: "Joyce, jetojmë në një botë të ndryshme sot! S'i dihet se me kë të bie të flasësh!". E kuptoj se ju duhet të përdorni urtësi, por mos e lejoni frikën t'ju bëjë armiqësorë dhe të ftohtë. Kur shihni një person të ri që ka ardhur në kishë, punë, shkollë ose në lagje fare mirë mund ta përshëndesni!

Sigurisht që mund t'i flisni gruas së moshuar që është ulur tek zyra e mjekut ndërsa prisni të thërriteni në takimin tuaj. Ajo duket kaq e vetmuar; përse të mos i jepni për dhjetë minuta vëmendjen tuaj në mënyrë të pandarë dhe ta lini të tregojë për veten e saj. Ndoshta nuk do ta shihni asnjëherë tjetër, por ajo nuk do t'ju harrojë. Oh, dhe meqë ra fjala, Perëndia do ta vlerësojë atë që bëni për të. Po, ishte diçka e vogël, por ju e përfshitë atë!

Pas këtij kapitulli do të lexoni një kapitull të shkruar nga një i ftuar, Paul Scanlon, i cili tregon përvojën e tij të përpjekjeve për shndërrimin e kishës së tij nga një kishë e vdekur e fetare në një kishë të mbushur me dashuri dhe rigjallërim. Historia e tij mund të na mësojë shumë dhe të na detyrojë t'i bëjmë vetes disa pyetje të vështira për t'iu përgjigjur. Nëse një rigjallërim i vërtetë vjen në kishën tuaj, a do të ngazëlloheshit apo do të largoheshit, sepse shumica e pjesëmarrësve do të ishin si Jamie ose shumë më keq? Ata mund të vijnë prej strehëzave dhe nuk kanë erë të mirë, mund të vijnë era alkool ose ndonjë tjetër erë të pakëndshme. Njerëzit e lënduar nuk kanë gjithmonë paraqitjen më të mirë dhe mund të mos vijnë erë e mirë. Ndonjëherë ia arrijnë, por jo gjithmonë dhe

ne duhet të pushojmë së gjykuari nga kapaku dhe të fillojmë të lexojmë librin. Jini të gatshëm të shihni përtej paraqitjes së njeriut dhe të zbuloni brendësinë e tyre.

Dilni Jashtë Zonës Suaj të Rehatisë

Të dilni jashtë zonës suaj të rehatisë për të bërë dikë tjetër të ndihet mirë është një prej mënyrave se si t'u tregosh njerëzve dashurinë e Perëndisë. Shumë të krishterë kanë shumë dëshirë të luten për

Të dilni jashtë zonës suaj të rehatisë për të bërë dikë tjetër të ndihet mirë është një prej mënyrave se si t'u tregosh njerëzve dashurinë e Perëndisë.

rigjallërim; ata madje qajnë ndërsa luten për të gjithë "shpirtrat e humbur në botë", por të jem e sinqertë, disa prej këtyre njerëzve do të largoheshin nëse rigjallërimi vjen me të vërtetë në kishën e tyre sepse ai do të ngatërronte mënyrën e tyre normale të jetës dhe kjo gjë do të ishte diçka e papëlqyeshme.

Kohët e fundit kam predikuar në një kishë ku të gjithë pacientët me karrige me rrota nga shtëpitë lokale të të moshuarve ulen në rreshtin e parë. Duke qenë se isha folësja, më vunë në rreshtin e parë, por karriget me rrota ishin radhitur para rreshtit të parë. Personi që u ul para meje i vinte erë vërtet e keqe dhe mua nuk m'i duron shumë stomaku erërat e këqija. (Kur i kishim fëmijët të vegjël, sa herë që Dave ishte në shtëpi, u ndërronte pelenat me erë të keqe).

Ndërsa qëndroja e ulur aty, njoha humorin e Perëndisë; Ai më kishte ulur tamam aty ku dëshironte ... po bëhesha gati për t'u ngritur e t'i predikoja kishës një mesazh dashurie dhe përfshirjeje! M'u desh të lutesha shumë ndërsa po prisja të flisja dhe duhet të jem dukur

shumë frymërore sepse e mbaja hundën sa më lart që mundja, kështu me siguri është dukur sikur po shikoja drejt qiellit. E dija se Perëndia i kishte rregulluar punët që unë të ulesha aty dhe në fakt unë *duhej* të isha aty. Ishte shumë mirë që unë të përjetoja atë që do t'ju thoja të tjerëve të bënin. Jo gjithmonë duhet të ndihemi rehat kudo që shkojmë! Ai njeri ndoshta nuk kishte dikë që ta lante rregullisht dhe nuk mund të bënte asgjë në lidhje me erën e keqe. Meqë ra fjala, kjo mund të jetë një shërbesë e mirë për dikë që po kërkon të shërbejë. Shkoni në një shtëpi lokale të moshuarish dhe ofroni vullnetarisht të ndihmoni në higjienën e pacientëve!

Jamie Përpiqet Përsëri

Ndërsa e mbyllim këtë kapitull, më lejoni të përfundoj historinë e Jamie-t. Pas përvojës së saj të trishtueshme me kishën, ajo u zotua që kurrë të mos e bënte më këtë gjë (të shkonte kishë). Ajo vajti në punë të hënën, sigurisht në gjendje depresioni, kur një prej kolegeve e vuri re dhe e pyeti se çfarë kishte. Jamie zakonisht e mbante çdo gjë përbrenda, por ajo ishte kaq e lënduar, saqë filloi të qante. Kolegia, Samantha, i kërkoi menaxherit ta merrnin pushimin e drekës më herët dhe e çoi Jamie-n në dhomën e punonjësve në përpjekje për ta ndihmuar të ndihej më mirë. Pasi Jamie i hapi zemrën Samanthës, madje i tregoi edhe përvojën e tmerrshme në kishë, Samantha e ftoi në shtëpinë e saj për darkë për të vazhduar më tej bisedën. Ajo mbrëmje ishte jetë-ndryshuese për Jamie-n.

Samantha ishte një e krishterë e vërtetë - dua të them nga ai lloj që me të vërtetë kujdeset dhe dëshiron të ndihmojë. Ajo filloi të takohet me Jamien dy herë në javë dhe filloi jo vetëm të kujdesej për të, por gradualisht filloi t'i mësonte rreth Jezusit dhe se sa shumë Ai e donte atë. Pas rreth tre muajsh, Samantha i kërkoi Jamie-t ta provonte edhe një herë vajtjen në kishë dhe të merrte pjesë me të

në shërbesën e së dielës. Jamie nuk ishte shumë entuziaste, por ndihej se i detyrohej Samanthës pas gjithë asaj kohe që ajo po kalonte me të.

Vizita e Jamie-t në Resurrection Church (Kisha e Ringjalljes) ishte mjaft e ndryshme nga përvoja në kishën e mëparshme. Ajo u prit ngrohtësisht dhe iu dha një karrige afër foltores, sepse ishte e ftuar. Çdo gjë në shërbesë dukej se ishte vetëm për të. Ajo kuptoi gjithçka, sepse kishte lidhje me jetën reale. Këngët që këndonin kishin kuptim dhe secila prej tyre e bënte të ndihej më mirë. Pas shërbesës, ajo u ftua për kafe dhe përfundoi duke takuar disa njerëz të cilët u bënë miqtë e saj më të afërt. Në këtë kishë, kishte njerëz nga të gjitha moshat dhe kulturat. Disa vishnin kostume e kollare, ndërsa të tjerë vishnin xhinse e bluza pambuku. Gjithkush ishte i lirë të ishte vetvetja.

Jamie ia dha jetën Jezusit dhe nuk mungon më në kishë. Tani është martuar, ka dy fëmijë dhe e gjithë familja e saj është pjesë e shërbesës brenda-qytetit, e cila u shërben njerëzve që jetojnë në rrugë. Jamie-t i pëlqen ta bëjë këtë gjë, sepse e kupton se ajo shumë lehtë mund të kishte qenë një prej tyre!

A nuk do të ishte tragjike nëse Jamie do t'i kishte dhënë fund jetës, siç mendonte atë ditë që pati përvojën e trishtuar në kishë? Unë e urrej faktin që njerëzit e provojnë kishën duke menduar se janë duke provuar Perëndinë dhe pastaj heqin dorë prej Tij, sepse kisha që ata provuan nuk e përfaqësoi Atë siç duhet. Le të sigurohemi që në mesin tonë të përfshijë të gjithë llojet e njerëzve. Mos përjashtoni asnjë për shkak se ata nuk janë si ju. Të gjithë kemi njerëz që i konsiderojmë si miq të ngushtë dhe kjo nuk është e gabuar. Edhe Jezusi kishte tre prej dymbëdhjetë dishepujve me të cilët Ai kalonte më shumë kohë sesa me të tjerët. Por, Ai kurrë nuk shpërfilli njeri, as nuk i bëri të ndihen më pak se plotësisht të vlefshëm.

REVOLUCIONARI I DASHURISË

Pastor Paul Scanlon

Kisha lokale është ideja më e mirë që Perëndia ka pasur ndonjëherë! Ne jemi bashkësia "parapagesë" e Perëndisë, jemi rrjedhja e Tij, shprehja e Tij, buzëqeshja e Tij dhe adresa e Tij në qytet. Mjerisht, shumë kisha nuk e kuptojnë këtë gjë dhe rrjedhimisht miliona njerëz fare pranë shtëpisë së Zotit vdesin në hidhërim në shtëpitë e tyre, pa e njohur kurrë Jezusin për shkak të maskës së fesë dhe mosrealitetit që shumë kisha veshin.

Kalimi

Dhjetë vite më parë kisha jonë kaloi një transformim ekstrem dhe dhimbja ishte torturuese. Ne e quajtmë "kalimi" ynë dhe historia e atij procesi është shkruar në një libër me të njëjtin titull, libër i cili e tregon historinë tonë në mënyrë të detajuar. Madhësia mesatare e kishave në Mbretërinë e Bashkuar, aty ku gjendemi ne, është njëzet persona dhe 98 përqind e popullsisë jo vetëm nuk shkon në kishë, por, përkundrazi, është "anti-kishë". Kështu, sipas standardeve britanike, ne ishim një kishë mjaft e madhe, me më shumë se 450 pjesëmarrës në atë kohë, me një ndërtesë pothuajse të paguar. Ne ishim të afërt me njëri-tjetrin, të lumtur dhe të begatë. Dëgjonim predikime madhështore dhe ishim një kishë me shumë talente muzikore dhe krijuese. Megjithatë, pavarësisht këtyre gjërave, na mungonte diçka shumë e madhe. Diçka shumë themelore mungonte, por askush nuk dukej ta vinte re.

Ne ishim bllokuar në një cikël të pafundtë të përkujdesjes ndaj asaj që mund të përshkruhet si "të krishterë me mirëmbajtje të lartë,

të mbi-ushqyer dhe të pa-ushtuar fizikisht". Të krishterët me mirëmbajtje të lartë janë një prej sekreteve më të mira që djalli ka në neutralizimin e kishës. Këta janë njerëzit më të këndshëm që do të takoni ndonjëherë dhe aty qëndron problemi! Asnjë prej këtyre njerëzve nuk ishte i pakënaqur apo me "zemër të keqe", apo qëndrim jo të mirë. Ndërsa shikoj prapa, do ta kisha preferuar këtë gjë, sepse do ta kishte bërë më të lehtë punën time për t'i bindur njerëzit për rimodelim.

Pastorët në mbarë botën nuk kanë fjalë të përshkruajnë çfarë u mungon kishave e shërbesave të tyre dhe ata nuk duan të duken të shqetësuar apo negativë duke e thënë këtë gjë. Ashtu si djali në historinë *The Emperor's New Clothes* (*Rrobat e Reja të Perandorit*), i cili vuri në dukje atë që ishte aq e qartë për të gjithë njerëzit rreth perandorit: perandori nuk kishte veshur rroba.

Kur të gjithë njerëzit janë kaq të lumtur, të dashur, miqësorë dhe të bekuar, kush është ai që dëshiron të japë lajmin se jemi duke vdekur? Por nga fundi i vitit 1998, unë u bëra ai njeri, dhe për herë të parë në njëzet vjet, mu desh t'i drejtohesha me gisht kishës tonë dhe t'i thoja: "Ne jemi të zhveshur, rehat, të angazhuar, të sigurt dhe të parëndësishëm"-dhe kjo më përfshinte edhe mua. Nuk ishte e lehtë për ne ta shihnim këtë gjë sepse, si shumë kisha, ne e kishim teologjinë dhe fjalët për të arritur të humburit, por në të vërtetë nuk po arrinim asnjë. Ne luteshim për të humburit, predikonim dhe këndonim për të humburit, madje edhe qanim për ta, por asnjë i humbur nuk po shpëtohej. Ishim kthyer në një klub fetar të përqendruar në vetvete dhe në rehatinë dhe bekimin tonë kishim humbur zemrën e Perëndisë për të tjerët që ende ishin të humbur e të lënduar.

Në Janar të vitit 1999, predikova një mesazh të titulluar: "Po Largohemi nga 99 në '99" duke iu referuar Jezusit, i cili e përshkroi veten si bariu që e lë shumicën -të 99-për atë që është ende i humbur. Shpjegova se ata që tashmë gjenden në kishë nuk mund

të ishin përparësia jonë e parë, por se të tjerët duhet të jenë prioriteti ynë. Këtu unë zbulova zemërimi i një të krishteri të lënë pas dore nuk krahasohet me vetë ferrin! U habita nga reagimi i njerëzve të mirë e të mbushur me Frymë, të cilët, kur erdhi puna e shtytjes, nuk mund ta përcillnin idenë se kisha jonë e bukur mund të dyndej nga një fluks mëkatarësh të pistë.

Gjatë përpjekjeve të mia të vazhdueshme që anëtarët e klubit tonë të rehatshëm dhe ekskluzivë t'i ktheheshin punës për shpëtim jetësh, nisa një shërbesë autobusi në 1999. Se si Perëndia më tha ta bëja këtë është një histori më vete. Por, mjafton të them se ishte aq e pazakontë saqë më bindi që ishte "ide e Perëndisë", sepse gjëja e fundit për të cilën kisha nevojë ishte thjesht një ide e mirë.

E pra, brenda disa javësh ne po sillnim me autobus me qindra mëkatarë të pistë. Këta njerëz të pafë, shpesh të ashpër, të vrazhdë dhe të paparashikueshëm, e shkatërruan klubin tonë të bukur. Anëtarët tanë të respektueshëm, i quanin këta "njerëzit e autobusit" dhe i shikonin si kërcënim të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së kishës. Çdo ditë merrja letra të pakëndshme, shpesh të këqija e kërcënuese dhe telefonata nga njerëz që i doja, dhe të cilët jam i sigurt se më donin mua, por që thjesht nuk e kuptonin këtë gjë. Fëmijët që vinin me autobus akuzoheshin se na prishnin shkollën e së dielës dhe prindërit e tyre akuzoheshin se prishnin shërbesën kryesore, zakonisht nga pirja e duhanit, fjalët e ndyra, dhe më e keqja nga të gjitha, prisni ta dëgjoni këtë, që guxonin të uleshin aty ku anëtarët tanë prej një kohe-të-gjatë uleshin zakonisht.

Drejtuesit më vinin radhë-radhë për të më thënë dhe për të më bindur të ndaloja, por tashmë ishte tepër vonë. Zemra e Perëndisë për të humburit e kishte gjetur zemrën time dhe unë po bëhesha plotësisht i paarsyeshëm. Për gati dy vjet durova vetminë, izolimin dhe sulmet më të mëdha personale që kam përjetuar ndonjëherë. Ajo që e bëri durimin shumë më të vështirë ishte se gjithçka ishte zjarr miqësor nga njerëz që duket qartë se e kishin harruar faktin

se edhe ata dikur ishin duke u mbytur në det, por dikush erdhi për t'i kërkuar.

Kur e gjithë kjo nuk arriti të më kthente mendjen, erdhi "turma profetike". Këta ishin njerëzit e ashtuquajtur profetikë mes nesh. Ata filluan të linin takime me mua dhe shpesh vinin në grupe për të ndarë se çfarë u kishte thënë Perëndia të më thonin. Mesazhi i tyre ishte: "Nëse nuk ndalon, kisha jonë do të ndahet, ti dhe familja jote do të vuani, drejtuesit do të largohen, financat do të bien dhe dëshmia jonë në këtë vend do të dëmtohet". Por për mua, thjesht sepse çmimi do të ishte shumë i lartë, nuk do të thoshte se Perëndia po më thoshte "Mos e bëj". Nëse Ai po më dërgonte mesazhe, Ai thjesht po më tregonte se nëse e bëja, ja si do të ishte përmbledhja e kostove. Përgjigjja e vetme që mund të jepja ishte se isha dakord me ta, sepse tashmë të gjitha këto gjëra po ndodhnin. Shumë njerëz po largoheshin dhe, pa ofertat e tyre, financat tona po binin me dhjetëra mijëra dollarë në muaj. Dalëngadalë po i zëvendësonim numrat e të larguarve, por me njerëz të varfër-dhe të varfrit jo vetëm që nuk kanë para, por janë edhe të shtrenjtë për t'u arritur dhe të shtrenjtë për t'u mbajtur.

Ta bësh kishën lokale të arrijë komunitetet e tyre, për mua, është ende beteja më e madhe me të cilën përballet kisha në të gjithë botën sot. Dhe nëse kjo gjë është e vërtetë, atëherë lëkundja më e madhe e kishës ende nuk ka ardhur. Ndoshta, si pastorë, ne duhet të jemi të gatshëm të humbasim qindra, për të fituar mijëra dhe madje mijëra, për të fituar miliona.

Unë e dua kishën lokale. Kam frekuentuar të njëjtën kishë për më shumë se tridhjetë vjet, njëzet e gjashtë prej të cilave me kohë të plotë në shërbesë. Por, ndonëse e dua shumë kishën, refuzoj të vdes në rehatinë e të krishterit të butë. Unë kam vendosur të jetoj i plotë dhe të vdes bosh. Nuk mund ta bëj këtë gjë mes katër mureve të kishës lokale, dhe po kështu as ju.

Në ditët e hershme të shërbesës, Jezusi shkoi në një qytet të

quajtur Kapernaum. Njerëzit e donin Atë; ata mrekulloheshin nga mësimet dhe fuqitë e Tij mbi demonët dhe sëmundjet. Ata e donin kaq shumë saqë ditën që Ai do të largohej nga qyteti, Luka na tregon se njerëzit iu afruan dhe u përpoqën ta mbanin që të mos largohej (shihni Luka 4:42).

Përgjigjja e Tij ndaj përpjekjeve padyshim bindëse të tyre për ta mbajtur, është mahnitëse dhe e thellë. Mahnitëse në thjeshtësinë e saj dhe e thellë për shkak të mprehtësisë që Ai tregon në lidhje me përparësitë e Tij dhe forcën që e shtynte. Jezusi i pa të gjithë ata njerëz të bekuar në sy dhe tha: "Më duhet ta shpall lajmin e mirë të mbretërisë së Perëndisë edhe në qytete të tjera, sepse për këtë jam dërguar". A e kuptuat! Jam dërguar për të shkuar te të tjerët, të tjerët, të tjerët! (shihni Luka 4:43). E gjithë kjo është për të tjerët.

Nëse do të mund të prisnit Perëndinë, Ai do të rridhte për të tjerët. Por nëse do të mund të prisnim kishën, do të rridhnim ne. Ne rrjedhim bekimin, rehatinë dhe gëzimin tonë. Natyrisht, ka edhe përjashtime, por përjashtimet janë shumë të rralla për të besuar se jemi duke e mbajtur peshoren në favor të të tjerëve. Për breza të tërë, kisha, ashtu si njerëzit në Kapernaum, është përpjekur ta mbajë Jezusin për veten e vet. Për breza me radhë, Jezusi është përpjekur të largohet nga të krishterët e rehatshëm për të vazhduar të arrijë të tjerët. Ky keqkuptim themelor mbi gjënë më të rëndësishme të Perëndisë, e ka bërë kishën të dështojë së ndikuari botën e lënduar.

Ne jemi bekuar për të qenë bekim; ne jemi shpëtuar për të kërkuar e shpëtuar të tjerët. Ne jemi shëruar për të shëruar, falur për të falur dhe na është dhënë dashuri për t'u bashkuar në Revolucionin e madh të Dashurisë së Perëndisë. Nuk është për mua, ne, jona apo imja. Gjithmonë ka qenë për të tjerët.

Apostulli Pal ka thënë se edhe ngushëllimi që marrim prej Perëndisë nuk na përket vetëm ne: "Bekuar qoftë Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i përdëllimeve dhe Perëndia i gjithë ngushëllimit, që na ngushëllon në gjithë shtrëngimin tonë që,

nëpërmjet ngushëllimit me të cilin ne jemi ngushëlluar nga Perëndia, të mund të ngushëllojmë ata, që janë në çfarëdo shtrëngimi. Sepse, ashtu si ndër ne teprojnë vuajtjet e Krishtit, po ashtu, me anë të Jezu Krishtit, tepron edhe ngushëllimi ynë" për *të tjerët* (2 Kor 1:3-5).

Edhe problemet tona nuk na përkasin ekskluzivisht vetëm ne; brenda tyre gjendet fara e ngushëllimit, shpresës dhe frymëzimit të një personi tjetër. Bekimi im nuk është bekimi im; mëshira ime nuk është mëshira ime; hiri im nuk është hiri im; dhe në fund të fundit edhe jeta ime nuk është jeta ime. Të gjitha këto i përkasin të tjerëve, dhe unë e ti kemi qenë njëherë këta të tjerë.

Është jashtëzakonisht e dhimbshme të shikosh njerëz të mirë, që i doni, me të cilët keni "jetuar jetën" për njëzet vjet, të largohen nga kisha. Ndonjëherë, dhimbja e ndarjes nga njerëzit me të cilët do të plakeshim është si dhimbjet e lindjes. Natyrisht, në atë kohë është e vështirë të shohësh ndonjë gjë të mirë në diçka kaq të keqe, por çdo gjë nga ku nuk mund të largohemi është vendi ku ndalojmë, dhe nëse ndalojmë, asnjëherë nuk do ta dimë se çfarë mund të kishte qenë. Perëndia nuk i detyron kurrë njerëzit ngurrues të lëvizin; ne duhet të vendosim të lëvizim përpara. Në çdo dhimbje gjendet një farë, dhe fara ime ishte kisha e re në të cilën po shndërroheshim, një kishë jetë-ndryshuese.

Në fund të vitit 1998, e drejtova kishën në projektin më të madh të ndërtesës, që ne, dhe ndoshta çdo kishë në vendin tonë në historinë e kohëve të fundit, kishte tentuar ndonjëherë, një auditor me dymijë vende. E bëra këtë nga bindja se nëse e ndërtoja, të humburit do të vinin. Sa mirë do të ishte sikur ata të kishin ardhur më parë, sepse në kohën kur kryem shërbesën tonë të parë në ndërtesën e re, kisha jonë ishte zvogëluar në rreth 300 njerëz. Më duhet t'ju them se nuk ka rëndësi se sa krijues je me karriget, hapësira që mund të vendosësh midis tyre është e kufizuar, në mënyrë që njerëzit të mos ndihen sikur nuk janë në të njëjtën dhomë! Treqind në një hapësirë dymijë vendesh dukej e tmerrshme,

veçanërisht kur e kishim ndërtesën me gjashtëqind vende përballë vendit të parkimit të makinave.

Kjo ndodhi në Janar të vitit 2000 dhe atë ditë Perëndia më dha një fjalë nga historia e Isakut që rihapte pusët e atit të tij (shihni Zan 26). Isaku lëvizi nga dy pusët e para që hapi sepse filistenjtë i kishin mbushur me dhe. Ai i quajti ato *Esek* dhe *Sitnah*, që do të thonin "kundërshtim" dhe "rezistencë". Ai lëvizi dhe hapi një pus të tretë, por kësaj radhe asnjë nuk kundërshtoi e as nuk e mbushi me dhe. Ai e quajti pusin e tij të tretë *Rehoboth*, që do të thotë "vend", duke thënë "Tani Zoti na ka vënë larg dhe ne do të kemi mbarësi në këtë vend". Në atë shërbesë të parë në auditorin dymijë vendesh, hodha vështrimin tek treqind njerëzit e lodhur e të goditur dhe u predikova një mesazh të titulluar "Pusi Numër Tre do të Jetë Vërshues". Pas gati dy vitesh kundërshtimesh dhe rezistence, unë besoja se koha e Rehobothit tonë kishte ardhur. Tani, vite më vonë, me një kishë me mijëra veta, Rehobothi ynë ka ardhur me të vërtetë.

Gjatë orëve të fundit të jetës, ndërsa qëndronte në gjykatën e Pilatit, Jezusit iu dha mundësia e lirisë duke iu ofruar turmës së bashku me një njeri të quajtur Baraba. Ishte zakon që për festë të lirohej një i burgosur sipas kërkesës së njerëzve. Baraba ishte një vrasës i dënuar më parë dhe udhëheqës rebel. Jezusi nuk ishte dënuar për asgjë e gjithçka që kishte bërë ishte të ndihmonte njerëzit. Megjithatë, për habi, turma thirri që të lirohej Baraba dhe Jezusi të kryqëzohej. E vërteta është se bota gjithmonë do të preferojë një rebel mbi një revolucionar. Fjalori e përkufizon rebelin si "dikush që i reziston ose kundërshton ndaj një qeverie ose sundimi". Por një revolucionar është "dikush që rrëzon një qeveri apo rend social në favor të një sistemi të ri".

Ky libër flet për Revolucionin e Dashurisë, jo për një rebelim dashurie. Ne nuk po rebelojmë kundër botës; ne po mundohemi ta revolucionarizojmë atë. Perëndia e deshi kaq shumë botën, sa që Ai na dërgoi një alternativë, jo një ultimatum. Udhëheqësi ynë, Jezu

Krishti, është një revolucionar, jo një rebel; Ai fiton duke zëvendësuar, jo duke dënuar. Kjo bëhet sfida jonë. Nëse kisha duhet ta dojë botën, ne duhet të gjejmë mënyra të reja për të dashur të padashurit dhe për të përfshirë të përjashtuarit pa qenë paragjykses. Duhet të jetojmë "prapa vijave të armikut", jo si një lëvizje e rezistencës, por si një lëvizje zëvendësuese. Ne jemi shoqëria alternative e Perëndisë.

Kohët e fundit, ndërsa po udhëtoja në një aeroport të Shteteve të Bashkuara, vura re një grua të moshuar me shkop që po mendohej t'i vendoste gjërat e saj në rripin e kontrollit të sigurisë. Agjenti i sigurisë ishte i ashpër dhe ndonëse e vinte re mundimin dhe stresin e saj, nuk e ndihmonte aspak. Në mënyrë instiktive, unë fillova të kapja sendet e saj dhe t'i vendosja në rripin lëvizës. Pastaj dola në anën tjetër dhe prita bashkë me të për ta ndihmuar t'i merrte të gjitha sendet e saj. Kurrë nuk do ta harroj mënyrën se si ajo më pa dhe me një buzëqeshje lehtësuese më tha: "Shumë faleminderit; mirësia jote e kompensoi sjelljen e keqe të atij burrit". Ajo zonjë, i dha fjalë bindjes sime më të thellë në lidhje me kishën: kisha është faktori kompensues i Perëndisë për botën e lënduar.

Të kompensosh do të thotë "të kthesh, të zvogëlosh ose të balancosh efektet e këqija të humbjes, vuajtjes ose dëmit duke ushtruar një forcë ose efekt të kundërt". Ne jemi efekti i kundërt i Perëndisë; ne balancojmë dhimbjen dhe vuajtjen në komunitetet tona. Si ambasadorë dhe tregtarë të dashurisë dhe shpresës, ne i sjellim buzëqeshje botës së stresuar e të munduar. Kompensimi nuk e ndryshon atë që ka ndodhur, por mund të zvogëlojë efektin e saj. Revolucioni i Dashurisë është pjesë e planit madhështor kompensues të Perëndisë për një botë që ka harruar si të buzëqeshë.

Mjedisi ynë natyror nuk është kisha; është bota - jo klubi i rehatshëm por oqeani i rrezikshëm. Ne jemi lindur të lulëzojmë në vështirësitë dhe armiqësinë e një bote të thyer. Ashtu si peshqit, të cilët ia dalin më mirë në ujë, ne ia dalim më mirë në mes të një bote

të humbur, sepse, ashtu si peshku, jemi bërë të qëndrojmë gjithmonë në atë mjedis natyror. Hiqeni peshkun nga uji dhe ai do të vdesë. Hiqeni lulen nga toka dhe ajo do të vdesë. Hiqeni kishën nga bota dhe ne do të vdesim. Peshqit nuk e ndiejnë lagështinë, sepse uji është shtëpia e tyre, e megjithatë, shumë të krishterë kanë një reagim të stërmadh alergjik ndaj mjedisit të tyre natyror. Ne jemi si peshqit që thahen me peshqir në bregdet! Një imazh qesharak, e di, por megjithatë shumë grafik dhe i përshtatshëm.

Bibla shpesh e portretizon kishën në një mjedis armiqësor. Ne përshkruhem si kripa në një botë të kalbur, si drita në errësirë, si dele mes ujqërve, si të huaj dhe emigrantë larg vendit tonë. Ne jemi bërë të lulëzojmë në armiqësi. Ne jemi kisha, e vetmja pjesë e qiellit, e ndërtuar për të pasur sukses në një botë të helmuar nga ferri. Ne jemi ushtria revolucionare e Perëndisë, dërguar për të filluar një Revolucion Dashurie - dhe ky revolucion duhet të fillojë në ju dhe në mua sot!



KAPITULLI

9

Bëjini Njerëzit të Ndihen të Vlefshëm

Le të ndjekim, pra, ato që ndihmojnë për paqen dhe për ndërtimin (ndërtimin dhe zhvillimin) e njëri-tjetrit.

Romakëve 14:19

Një nga mënyrat më të thjeshta për të mbushur me karburant një Revolucion Dashurie është të vendosësh t'i bësh të tjerët të ndihen të vlefshëm. Nënë Tereza ka thënë: "Të jesh i padëshiruar, i padashur, i lënë pas dore, i harruar nga kushdo, mendoj se është një uri shumë më e madhe, një varfëri shumë më e madhe se një person që nuk ka asgjë për të ngrënë", dhe unë kam zbuluar se shumica e njerëzve që ne takojmë apo jemi në kontakt në jetën tonë të përditshme, nuk e kanë ndjenjën e vlerës së tyre të pafundme si fëmijë të Perëndisë. Mendoj se djalli punon shumë për t'i bërë njerëzit të ndihen të zhvlerësuar dhe pa vlerë, por ne mund ta neutralizojmë efektin e gënjeshtreve dhe shpifjeve të tij duke i ngritur lart, inkurajuar dhe ndërtuar njerëzit. Një mënyrë për ta bërë këtë gjë është nëpërmjet një komplimenti të sinqertë, i cili është një prej dhuratave më të vyera në këtë botë.

Një nga mënyrat më të thjeshta për të mbushur me karburant një Revolucion Dashurie është të vendosësh t'i bësh të tjerët të ndihen të vlefshëm.

Shumica e njerëzve janë të shpejtë për ta krahasuar veten me të tjerët, dhe duke bërë këtë, ata shpesh nuk arrijnë të shohin aftësitë dhe vlerat e tyre. Ta bësh një njeri të ndihet i vlefshëm nuk është një gjë e shtrenjtë dhe nuk duhet të harxhosh shumë kohë. Gjithçka që duhet të bëjmë është ta heqim veten jashtë mendimeve tona për një kohë të mjaftueshme sa të mendojmë për dikë tjetër dhe pastaj të gjejmë diçka inkurajuese për të thënë. T'i bësh njerëzit të ndihen të vlefshëm nuk kushton aspak para, por u jep atyre diçka kaq të vlefshme, saqë asnjë shumë parash nuk mund ta blejë. Një kompliment i singertë mund të duket si një gjë e vogël, por ai jep një fuqizim të jashtëzakonshëm.

Unë besoj në pasjen e qëllimeve, dhe ndërsa po punoja me Perëndinë për të zhvilluar zakone të mira në fushën e inkurajimit të të tjerëve, e sfidova veten t'i jap komplimente të paktën tre personave çdo ditë. Ju rekomandoj të bëni diçka të ngjashme që do t'ju ndihmojë të bëheni një inkurajues agresiv.

Mos Harro të Harruarit

Shpesh njerëzit ndihen të vetmuar dhe të harruar. Ata ndihen sikur punojnë shumë por askush nuk i vë re apo nuk kujdeset për ta. Më kujtohet një grua që më tha se gjatë shumicës së jetës së saj, ajo ishte ndierë si e padukshme. Më kujtohet dhimbja në fytyrën e saj ndërsa ajo kujtonte mënyrën se si prindërit e saj e shpërfillnin. Ajo ndihej e izoluar dhe tmerrësisht e vetmuar, gjë e cila e bënte të ndihej e padëshiruar. Prindërit e saj ishin të rinj kur ajo lindi; ata nuk ishin gati për të pasur fëmijë dhe ishin shumë egoistë e të

përqendruar tek vetja. Ata nuk i dhanë asaj aspak dashuri apo mbështetje emocionale. Ajo tha se e kaloi fëmijërinë dhe adoleshencën e vetme në dhomën e saj, duke lexuar.

Përshkrimi i fëmijërisë së kësaj gruaje dhe ndjenja e padukshmërisë ishte kaq e trishtueshme, dhe më bëri të mendoj se sa shpesh i kam bërë unë njerëzit të ndihen të padukshëm, thjesht sepse kam qenë e përqendruar në atë që po bëja, ose në qëllimin që po përpiqesha të arrija, saqë nuk kam kaluar kohë për të dalluar praninë e tyre. Unë kam personalitet të tipit A, i cili është shumë i përqendruar dhe i vendosur për të arritur qëllimet e jetës. Unë arrij të përmbush shumë gjëra, por më është dashur të mësoj që gjatë procesit të mos lëndoj njerëz të tjerë. Askush nuk arrin të ketë sukses pa ndihmën e shumë njerëzve të tjerë të përkushtuar dhe të mos tregosh vlerësim, të mos japësh meritë aty ku duhet, është një tragjedi e tmerrshme, një lloj sjelljeje me të cilën Perëndia nuk është i kënaqur.

Gjërat e Thjeshta Mund të Jenë Madhështore

Në Bibël, Perëndia flet shpesh për përgjegjësitë tona ndaj të shtypurve, vejushave, jetimëve dhe të huajve. Ai përmend ata që janë të vetmuar dhe ata që ndihen të lënë pas dore, të harruar dhe të zhvlerësuar. Ai kujdeset shumë për të shtypurit dhe të uriturit. Njerëzit mund të jenë të uritur në shumë mënyra. Ata mund të kenë mjaft ushqim për të ngrënë, por janë të uritur për inkurajim ose ndonjë fjalë që t'i bëjë të ndihen të vlefshëm. Perëndia ngre lart ata që janë përulur me pikëllim, Ai mbron të huajin dhe mbështet jetimin dhe vejushën (shihni Psa 146:7-9). Si e bën Ai këtë gjë? Ai vepron nëpërmjet njerëzve! Ai ka nevojë për njerëz të përkushtuar dhe të dorëzuar të cilët jetojnë për t'i bërë të tjerët të ndihen të vlefshëm. Nënë Tereza e përkushtoi jetën për t'i bërë të përjashtuarit të ndihen të dashur dhe të vlefshëm. Gjërat që ajo bëri ishin të thjeshta, zakonisht ishin gjëra

të vogla, e megjithatë ato ishin gjëra të mëdha. Ajo tha: "Mos mendoni se dashuria, për të qenë e sinqertë, duhet të jetë e jashtëzakonshme. Ne kemi nevojë për dashuri të palodhur".

Ne Jemi të Adoptuar

Një varg biblik që më ka inkurajuar shumë është Psalmi 27:10 i cili thotë: "Edhe sikur babai im dhe nëna ime të më braktisin, Zoti do të më pranonte [adoptonte si fëmijën e Tij]".

Nëna ime kishte shumë frikë nga babai im, kështu ajo nuk mund të më shpëtonte nga llojet e ndryshme të abuzimit që ai kreu kundër meje. Unë ndihesha shumë e vetmuar, e harruar dhe e braktisur në makthin tim. Më në fund vendosa se askush nuk do të më ndihmonte, prandaj vazhdova t'i "mbijetoj" rrethanave të mia derisa të isha në gjendje të largohesha. Kam kuptuar se turma njerëzish, me të cilët hasemi çdo ditë, janë duke u përpjekur të mbijetojnë derisa dikush t'i shpëtojë - dhe ky dikush mund të jeni ju ose unë.

Bibla thotë se në dashurinë e Perëndisë, Krishti "na zgjodhi [në fakt na mori për veten e Tij si të Tijtë] në të përpara themelimit të botës" (Ef 1:4). Në dashuri, Ai planifikoi të na adoptonte si fëmijët e Tij. Këto fjalë të bukura i sollën shumë shërim shpirtin tim të plagosur. Perëndia adopton të braktisurin dhe të vetmuarin dhe Ai i ngre lart e u jep vlerë. Ai vepron nëpërmjet Fjalës së Tij, nëpërmjet Frymës së Shenjtë dhe nëpërmjet njerëzve të drejtuar nga Fryma, të cilët jetojnë për të ndihmuar të tjerët.

Nënë Tereza ndiente se çdo njeri që ajo takonte ishte "Jezusi i maskuar". Vetëm përpikuni të imagjinoni se sa ndryshe do t'i trajtonim njerëzit nëse me të vërtetë i shihnim ata sipas mënyrës së saj. Jezusi tha se, nëse ia bëjmë të mirën ose të keqen "më të vegjëlve", ia kemi bërë Atij (shihni Mt 25:45). Me fjalë të tjera, Ai e konsideron trajtimin që ne i bëjmë të tjerëve, si personale. Nëse

dikush fyen, shpërfill, injoron ose zhvlerëson një prej fëmijëve të mi, unë do ta merrja si fyerje personal. Kështu, pra, përse është kaq e vështirë të kuptojmë se Perëndia ndihet në të njëjtën mënyrë? Prandaj, le të përpiqemi t'i ndërtojmë njerëzit, ta bëjmë çdonjërin që takojmë të ndihet më mirë dhe t'u shtojmë vlerë jetëve të tyre.

Filloni me një Buzëqeshje

Buzëqeshja është fillimi i dashurisë. Ajo nënkupton pranim dhe miratim. Ne duhet të mësojmë t'i buzëqeshim kujtdo dhe kur ta bëjmë këtë, jo vetëm ata do të ndihen më mirë, por edhe ne do të ndihemi më mirë.

Zakonisht, unë mendoj thellë dhe për këtë arsye mund të dukem shumë intensive. Gjithashtu mbaj shumë përgjegjësi dhe, nëse nuk jam e kujdesshme, mund të më bëjë të dukem e zymtë. Po mësoj të kaloj kohë t'u buzëqesh njerëzve, t'i pyes si janë dhe të gjej diçka miqësore për t'u thënë. S'ka dyshim se nëse jemi tepër të zënë për të qenë miqësorë, atëherë e kemi humbur drejtpeshimin dhe i jemi drejtuar shkatërrimit të marrëdhënieve. Marrëdhëniet përbëjnë një pjesë të madhe të jetës dhe me të vërtetë kam parë se Bibla është një libër që flet për marrëdhëniet. Ajo pasqyron marrëdhënien tonë me Perëndinë, me vetveten dhe me njerëz të tjerë.

Është e mahnitshme se si buzëqeshja dhe përshëndetja miqësore i çliron njerëzit. Këto janë dy prej shumë mënyrave që ne mund t'u japim të tjerëve kudo që shkojmë. Ju mund të jeni duke menduar, *Mirë, por unë nuk jam kështu. Unë jam shumë e rezervuar dhe private. Preferoj të mos përfshihem aq shumë me njerëzit, veçanërisht me ata që nuk i njoh*. Nëse ndiheni kështu, ju kuptoj, sepse edhe unë kam qenë kështu, derisa pashë çfarë thotë Bibla në lidhje me inkurajimin, ndërtimin, lartësimin dhe t'i bësh njerëzit të ndihen të vlefshëm. Kam mësuar se fakti që unë mund të mos kem dhunti

të natyrshme në një fushë, nuk do të thotë se nuk mund të mësoj se si ta bëj atë gjë.

Për vite të tëra, e kam justifikuar veten nga të mos qenit miqësore, duke thënë: "Nuk është në natyrën time, unë jam vetmitare", por kam kuptuar se "vetmitari" është thjesht një justifikim për të shmangur çështjen shpesh të ngatërruar të të qenit vulnerabël. Në fund të fundit, mendojmë ne, *Si do të ndihem nëse unë u buzëqesh njerëzve, por ata nuk ma kthejnë buzëqeshjen?* Do të ndihem e refuzuar dhe kjo gjë nuk është asnjëherë e mirë. Shumë prej nesh kalojnë shumë kohë në jetë duke u përpjekur të shmangin refuzimin, sesa përpiqen për të zhvilluar marrëdhënie të mira e të shëndetshme. Po sikur të përpiqem të bëj biseda miqësore me një të huaj ndërsa pres në zyrën e doktorit dhe duket qartë se ai ose ajo do të qëndrojë vetëm? Papritmas, ndihem e turpëruar dhe e zënë ngushtë, kështu në vend që të provoj "shansin", mund të qëndroj e izoluar për të mbrojtur veten. Kur kjo gjë ndodh, ne humbasim mundësinë për t'i prekur njerëzit me dashurinë e Perëndisë nëpërmjet një buzëqeshjeje ose një fjale miqësore. Kur ne i japim buzëqeshjet tona, mund të bëjmë dikë tjetër të buzëqeshë dhe kjo është një prej dhuratave më të mira që mund të japim.

Të jesh pjesë e Revolucionit të Dashurisë, kërkon përpjekje dhe praktikë. Kërkon të jemi të gatshëm të ndryshojmë disa prej rrugëve tona dhe të fillojmë t'i kërkojmë Perëndisë të na tregojë rrugët e Tij. A mund ta imagjinoni Jezusin të ngrysur, jo-miqësor dhe shpërfillës ndaj njerëzve, thjesht që të mos ndihej i refuzuar apo që ndoshta të mos i vinte re, sepse ishte tepër i zënë me punët e Tij? Sigurisht, e dimë se Jezusi asnjëherë nuk do të vepronte kështu dhe ne duhet të marrim vendimin se edhe ne nuk do të veprojmë kështu. Filloni të buzëqeshni më shumë, madje mund të përpiqeni të buzëqeshni kur jeni vetëm dhe do të shohësh se do t'ju bëjë të ndiheni më të lehtë dhe të qeshur. Apostulli Pal u tha atyre që u shërbente, që ta përshëndesninin njëri-tjetrin me një puthje të shenjtë

(shihni Rom 16:16), gjë që ishte e zakonshme në ato ditë. Unë thjesht po ju kërkoj një buzëqeshje!

Mos u Shqetësoni Nëse Nuk Vjen Natyrshëm

Në fund të këtij kapitulli, do të lexoni një kontribut të John Maxwell ndaj këtij libri, një folës ndërkombëtar, autor mbi temën e udhëheqjes dhe një miku ynë. Në mënyrë të habitshme, gjatë qëndrimit për pak minuta në praninë e John-it, të gjithë ndihen të vlefshëm. Unë dhe ai kemi folur për këtë aftësi të madhe të tij në këtë fushë dhe ai menjëherë pranon se babai i tij ka pasur të njëjtin ndikim tek ai. John, jo vetëm që ka pasur një shembull të mirë gjatë rritjes së tij, por ai madje ka dhuntinë (talentin, aftësinë) e inkurajimit që i është dhënë nga Perëndia.

Bibla flet për dhuntinë e inkurajimit (shihni Rom 12:8) dhe thotë se njerëzve të cilëve u është dhënë kjo dhunti, duhet ta përqafojnë atë me zell e me gëzim, me padurim e lumturi. Ashtu si unë kam dhuntinë e komunikimit, e cila më aftëson të flas në mënyrë efektive pa shumë përpjekje, disa njerëz kanë dhuntinë e inkurajimit. Ata i inkurajojnë të tjerët pa u përpjekur shumë; për ta, kjo gjë vjen natyrshëm. Edhe pse disa njerëz mund ta zhvlerësojnë dhuntinë e inkurajimit, unë mendoj se ajo është një prej dhuntive më të nevojshme në botë.

Është e mrekullueshme të njohësh ose të rrish pranë njerëzve të tillë, por edhe njëherë, unë ju bëj thirrje të mos tërhiqeni nëse inkurajimi nuk ju vjen natyrshëm. Unë kam dhuntinë e dhënies dhe më kujtohet se kur isha fëmijë, doja shumë të thurja plane se si do t'i jepja dikujt një dhuratë që do ta bënte atë njeri të lumtur. Jo gjithkush mund ta ketë dhuntinë frymërore të të dhënit (e cila gjithashtu renditet tek Rom 12, së bashku me inkurajimin e të tjerëve), por çdonjëri udhëzohet të japë dhe ta bëjë këtë gjë me qëllim.

Ec Përpara dhe Qesh

Shumica prej nesh kanë dëgjuar të paktën diçka rreth vlerës së të qeshurës në shëndetin tonë fizik dhe psikologjik. Buzëqeshja është porta e së qeshurës, që është diçka që duhet ta bëjmë shpesh dhe me qëllim.

Bibla thotë se një zemër e gëzuar është si ilaç (shihni Fja 17:22). Një prej gjërave më të mrekullueshme që kam vënë re në lidhje me shërbesën time të mësimdhënies, është se unë jam shumë komike. E quaj këtë gjë të mrekullueshme, sepse në atë që unë do ta quaja "jetë normale", njerëzit nuk do të më përshkruanin si të tillë. Unë kam kuptuar se meqë është Fryma e Shenjtë që flet nëpërmjet meje, Ai sigurisht që e njeh vlerën e humorit dhe efektin shërues që ai sjell.

Perëndia dëshiron që ne të qeshim dhe që të bëjmë edhe njerëz të tjerë të qeshin. Kjo nuk do të thotë që të gjithë do të bëhemi lolo apo të qeshim në kohë të papërshtatshme, por sigurisht që mund të ndihmojmë njëri-tjetrin ta marrë jetën me zemër të qeshur. Të gjithë do të ishim shumë më mirë në qoftë se do të mësonim të qeshnim me veten tonë ndonjëherë, në vend që të jemi tepër seriozë.

Tre herët e fundit që kam veshur pantallona të bardha, më është derdhur kafeja sipër tyre. Tani që unë ose duhet të mendoj se jam një duartharë që nuk mban dot asgjë dhe të filloj të zhvlerësoj veten, ose mund të bëj një shaka për këtë gjë dhe të përpiqem më fort që herën tjetër të qëndroj e pastër. Për vite të tëra kam dëgjuar se si njerëzit e zhvlerësojnë veten verbalist me fjalët që thonë për çdo gabim që bëjnë dhe unë besoj se kjo gjë e dëshpëron Perëndinë. Në qoftë se e dimë vlerën tonë në Krishtin, ne *asnjëherë* nuk duhet të themi gjëra për veten tonë që zhvlerësojnë atë që Perëndia ka krijuar.

Pse të mos e bëjmë zakon të ndihmojmë njerëzit të kuptojnë se të gjithë bëjmë gabime pa kuptim dhe se mund të zgjedhim të qeshim ose të mërzitemi me to? Jepuni njerëzve leje që të mos jenë të përkryer! Bota është e mbushur me presion për të

përmbushur dhe shkëlqyer, por kur nuk e arrijmë këtë gjë, na duhet një fjalë mirësie që na bën të ndihemi të pranuar dhe të vlerësuar.

Kur gjendeni mes njerëzve që gabojnë, menjëherë kujtojeni atyre pikat e forta që ata kanë ose diçka mahnitëse që ju keni parë ta bëjnë kohët e fundit. Dy bijat e mia janë të dyja të mrekullueshme, nëna të përkushtuara. Kur ndihen keq për ndonjë gjë që nuk e kanë bërë ashtu siç duhet, unë iu kujtoj se janë nëna të mrekullueshme dhe theksoj se sa e rëndësishme është kjo gjë. Ne duhet të vlerësojmë çdo gjë të mirë që njerëzit bëjnë. Djalli punon jashtë orarit dhe përpiket t'i bëjë njerëzit të ndihen dështakë, prandaj ne duhet të punojmë po aq shumë për t'i bërë ata të ndihen të suksesshëm.

Asgjë nuk e kthen një situatë të keqe përmbys më shpejt se sa qeshja. Ne e mbysim "fëmijën e vogël" brenda nesh shumë herët në jetë. Fëmijët nuk duket se mërzhiten shumë kur u bie diçka, kur u rrobat pis, kur pengohen ose bien, madje as kur bëjnë ndonjë gabim. Ata zakonisht e gjejnë mënyrën të vazhdojnë të qeshin dhe të argëtohen për sa kohë i lejojnë të rriturit. Jezusi tha se ne nuk mund të hyjmë në jetën e mrekullueshme që Perëndia na premton nëse nuk vijmë si fëmijë të vegjël (shihni Luka 18:17), prandaj ju rekomandoj fuqishëm ta ndihmojmë njëri-tjetrit në këtë aspekt.

Mua më pëlqen shumë të qëndroj pranë njerëzve që nuk vendosin presion mbi mua për të qenë e përsosur. Perëndia na do pa kushte dhe kjo do të thotë se Ai na pranon ashtu siç jemi dhe pastaj na ndihmon të jemi gjithçka që mund të jemi. Buzëqeshja është një shenjë pranimi. T'i ndihmosh njerëzit të qeshin me veten është një mënyrë për të thënë: "Të pranoj, me gabime e me të gjitha".

Të durosh dobësitë e njëri-tjetrit është një mënyrë e thjeshtë për të treguar dashurinë. Apostulli Pal i kishte mësuar njerëzit të inkurajonin dhe të ndërtonin njëri-tjetrit dhe ai shpesh u kujtonte atyre të vazhdonin në këtë mënyrë. "Prandaj ngushëlloni (këshilloni, ndërtoni) një tjetër dhe të udhëzoj (fuqizoni dhe ndërtoni) njëri-tjetrit, ashtu siç po bëni" (1 The 5:11). Vetë Fryma e Shenjtë është

Ai që jeton në ne, ecën përkrah nesh në jetë dhe na ngushëllon, na inkurajon dhe na ndërton. Ai na nxit të bëhemi gjithçka që mund të jemi. Kur gabojmë, Ai nuk na dënon; Ai na shtyn përpara.

Mungesa e inkurajimit shkakton depresion, dëshpërim, dështim e divorc dhe i pengon njerëzit të arrijnë potencialin e tyre në jetë. Të gjithë kemi nevojë të inkurajohemi. Edhe një herë dua të theksoj faktin se inkurajimi i thjeshtë është një prej mënyrave kryesore që mund t'i japë jetë një Revolucioni Dashurie në shoqërinë tonë.

Nxirrni në Pah Pozitiven

Perëndia filloi të më tregonte se një mënyrë që unë mund të tregoja se e doja burrin tim ishte thjesht të mos përmendja gabimet e vogla që ai bënte - gjëra të tilla si p.sh. kur nuk fikte dritën e dhomës, ose kur nuk zëvendësonte letrën higjienike. Ndoshta ai harronte të bënte diçka që i kisha kërkuar të bënte - si të më çonte çantën e punës lart në zyrë që unë të mos e mbaja vetë në mëngjes duke u përpjekur të balancoja edhe filxhanin e kafesë. Të gjithë bëjmë njëqind gjëra të tilla të vogla me të cilat irritojmë njëri-tjetrin, por ne mund të zgjedhim t'i lëmë të kalojnë dhe të kujtojmë se të gjithë bëjmë gabime dhe do të donim që njerëzit të mos na i kujtonin vazhdimisht.

Nëse me të vërtetë ju duhet të vini në dukje një çështje, atëherë patjetër që duhet ta bëni, por shumë marrëdhënie përçahen për shkak se dikush e kthen në një çështje shumë të madhe diçka të vogël, e cila në fund të fundit nuk ishte me të vërtetë e rëndësishme. Njerëzit shkatërrohen dhe me të vërtetë dobësohen sa herë që u kujtohet diçka që nuk e kanë bërë siç duhet. Kam kaluar shumë vite duke "përmendur" gjërat që më irritonin mua me shpresë se njerëzit nuk do t'i bënin më, por kam parë se komentet e mia thjesht kanë krijuar presion dhe i ka bërë ata të mos ndihen rehat në praninë time. Kam parë se lutja dhe theksimi i pozitives janë shumë më efektive.

Kur ne i ngremë lart pikat e forta të njerëzve dhe gjërat që ata i

bëjnë drejt, ata motivohen për të mposhtur dobësitë dhe gabimet e tyre. Unë jam befasuar kur kuptova se sa sfidë e madhe ishte në fillim kur vendosa të mos flisja për diçka që më irritonte, por thjesht t'i lija gjërat të shkonin. Tani kam arritur në një pikë ku e kuptoj se irritimi për gjëra të vogla është problem më i madh sesa vetë gjërat. Përse drita e harruar ndezur në dhomë duhet të më iritojë? A i harroj unë ndonjëherë dritat ndezur? Natyrisht që po.

Një ditë, këto kohët e fundit, i fola Dave-it sepse ishte ulur në fund të krevatit të rregulluar dhe u largua pa e rregulluar. Ai më pa i tronditur dhe më tërhoqi vëmendjen se isha unë ajo që në fakt ishte ulur në krevat, jo ai! E habitshme! Isha kaq e sigurt që ishte Dave-i sa tërësisht harrova se isha *unë* pala fajtores! Ky shembull tregon se si një frymë gabime-gjetëse mund të na verbojë të shohim gabimet tona dhe na shtyn të akuzojmë të tjerët.

Tregoni dashuri duke theksuar gjërat pozitive tek njerëzit. Çuditërisht, nuk do të na duhet të përpiqemi shumë për të gjetur gjërat negative që bëjnë. Këto gjëra duket se shndrisin si drita të kuqe. Por ne duhet të përpiqemi dhe në mënyrë të qëllimshme të shohim gjëra pozitive - ose të paktën derisa të formojmë zakone të reja!

Siç sugjerova pak më parë, filloni me qëllimin për të nxitur ose komplimentuar tre njerëz çdo ditë, patjetër. Në fund të ditës, si një metodë llogaridhënie, pyesni veten se cilët ishin ata. Kur numri tre të bëhet i natyrshëm, rriteni qëllimin në gjashtë, pastaj 10 dhe deri atëherë, do t'ju bëhet e natyrshme do të inkurajoni këdo që takoni në jetën e përditshme.

Komplimenti juaj nuk është e thënë të jetë diçka e madhe. Gjëra të vogla si "Kjo ngjyrë të shkon me të vërtetë shumë", "Më pëlqen modeli i flokëve të tu", "Shumë këmishë e bukur", "Ti më jep siguri", "Ti punon shumë", "Të vlerësoj shumë" ose "Jam e lumtur që të kam mike" janë shumë efektive dhe kuptimplote. Ndërsa jepni dhe theksoni pozitiven, do të ndiheni më të lumtur. Pra, ju jo vetëm që po jepni, por në të njëjtën kohë edhe po merrni përfitimin.

REVOLUCIONARI I DASHURISË

John C. Maxwell

Inkurajimi Ndryshon Gjithçka

Inkurajimi është i pabesueshëm. Ndikimi i tij mund të jetë i thellëgati mrekullibërës. Një fjalë inkurajimi i mësuesit ndaj një fëmije mund të ndryshojë jetën e tij. Një fjalë inkurajimi i një partneri mund të shpëtojë martesën. Një fjalë inkurajimi i drejtuesit mund të frymëzojë një person për të arritur potencialin e tij. Ashtu siç thotë Zig Ziglar: "Asnjëherë nuk i dihet se kur një moment dhe disa fjalë të singerta mund të kenë ndikim në një jetë". T'i inkurajosh njerëzit do të thotë t'i ndihmosh të fitojnë guximin të cilin nuk do ta përftonin ndryshe - kurajo për të përballuar ditën, për të bërë atë që është e drejtë, për të ndërmarrë rreziqe, për të sjellë ndryshim. Dhe zemra e inkurajimit është të komunikosh vlerat e një njeriu. Kur i ndihmojmë njerëzit të ndihen të vlefshëm, të aftë dhe të motivuar, shpesh i shohim jetët e tyre të ndryshojnë përgjithmonë. Dhe ndonjëherë i shikojmë që vazhdojnë përpara për të ndryshuar botën.

Nëse jeni prind, keni përgjegjësinë të inkurajoni anëtarët e familjes suaj. Nëse jeni drejtues i një organizate, mund të rrisni efektivitetin e ekipit tuaj në mënyrë dramatike në përpjestim me sasinë e inkurajimit që u jepni njerëzve të cilët drejtoni. Si mik, keni privilegjin të ndani fjalë inkurajuese që mund të ndihmojnë dikë të ngulmojnë në kohë të vështira ose të përpiqen për të bërë gjëra të mëdha. Si i krishterë, keni fuqinë të përfaqësoni Jezusin duke i dashur të tjerët dhe duke i ngritur lart me një fjalë inkurajimi.

Bashkohuni me Klubin

Asnjëherë mos e nënvlerësoni fuqinë e inkurajimit. Në vitet 1920, mjeku, këshilluesi dhe psikologu George W. Crane filloi mësimdhënien e psikologjisë sociale në Northwestern University në Çikago. Edhe pse i ri në mësimdhënie, ai ishte një studiues i mprehtë i natyrës njerëzore dhe besonte fuqishëm në anën praktike të studimit të psikologjisë për studentët e tij.

Në klasat e para ku ai dha mësim kishte edhe studentë të mbrëmjes të cilët ishin më të mëdhenj se mosha mesatare e studentëve të kolegjit. Këta burra të rinj e gra të reja punonin ditë pas dite në dyqane, zyra dhe fabrika të Çikagos dhe po përpiqeshin të përmirësonin veten e tyre duke marrë pjesë në klasat gjatë mbrëmjes.

Një mbrëmje, pas mësimit, një grua e re e quajtur Lois, e cila ishte transferuar në Çikago nga një qytet i vogël në Wisconsin për të punuar ai nëpunëse shërbimi civil, ndau me Crane-in se ndihej e izoluar dhe e vetmuar.

"Nuk njoh asnjë, me përjashtim të disa vajzave në zyrë", - u ankua ajo. "Natën, shkoj në dhomë dhe u shkruaj letra miqve të mi. Gjëja e vetme që më mban të jetoj nga dita në ditë është shpresa që të marr një letër prej tyre".

Crane-i, kryesisht në përgjigje të problemit të Lois-it, formoi atë që ai e quajti Klubi i Komplimenteve, të cilin ia njoftoi klasës së tij javën pasuese. Kjo do të ishte një prej detyrave të para praktike që ai do t'u jepte studentëve të tij atë semestër.

"Duhet ta përdorni psikologjinë tuaj çdo ditë, në shtëpi, në punë, në makinë apo autobus", - u tha Crane-i atyre. "Muajin e parë, detyra juaj me shkrim do të jetë Klubi i Komplimenteve. Çdo ditë duhet t'u bëni një kompliment të sinqertë tre personave të ndryshëm. Mund ta rrisni këtë numër nëse dëshironi, por për të marrë notën në këtë kurs, duhet t'u keni bërë komplimente të paktën tre personave të

ndryshëm për tridhjetë ditë ... Pastaj, në fund të eksperimentit tridhjetë-ditor, dua që të shkruani një temë ose detyrë mbi përvojat tuaja." - vazhdoi ai. "Përfshini ndryshimet që keni vënë re tek njerëzit rreth jush, si edhe opinionin tuaj të tjetërsuar mbi jetën."¹

Disa studentë të Crane-it e kundërshtuan këtë detyrë. Disa u ankuan se nuk dinin çfarë të thonin. Të tjerë kishin frikën e refuzimit. Dhe disa mendonin se do të ishte e pandershme t'i bëje kompliment dikujt që nuk të pëlqente. "Supozoni se takoni dikë që nuk ju pëlqen?" - pyeti njëri. "A nuk do të ishte e pasinqertë të lavdëroje armikun tënd?"

"Jo, nuk është mungesë sinqeriteti të komplimentosh armikun tënd", - u përgjigj Crane, - "sepse komplimenti është një shprehje e sinqertë lavdërimi për një veçori ose meritë objektive që meriton vlerësim. Do të shikoni se askujt nuk i mungon tërësisht merita apo virtyti ...".

"Lavdërimi juaj mund ngrejë lart moralin e shpirtave të vetmuar që janë pothuajse gati të heqin dorë nga lufta për të bërë vepra të mira. Ju nuk e dini se kur komplimenti juaj i rastësishëm mund të arrijë një djalë apo një vajzë, një burrë apo një grua, në një pikë kritike kur ai/ajo është gati të heqë dorë".²

Studentët e Crane-it zbuluan se komplimentet e tyre të sinqerta patën një ndikim pozitiv tek njerëzit rreth tyre dhe kjo përvojë pati një ndikim akoma më të madh tek vetë studentët. Lois filloi të lulëzonte dhe u kthye në një person të dashur e të shoqërueshëm që ndriçonte dhomën ku hynte. Një studente tjetër që ishte gati të linte punën si sekretare juridike për shkak të një shefi veçanërisht të vështirë, filloi t'i bënte komplimente atij, edhe pse në fillim e bënte duke shtrënguar dhëmbët. Në fund, vrazhdësia e tij ndaj saj jo vetëm që ndryshuan, por ndryshoi edhe irritimi i saj ndaj tij. Madje ata arritën deri aty sa ta pëlqenin me të vërtetë njëri-tjetrin dhe u martuan.

Ndoshta, Klubi i Komplimenteve i George Crane-it na tingëllon pak qesharak sot. Por parimet e tij janë po aq të shëndosha sot siç

ishin më 1920. Në fund të fundit, Crane po mësonte atë që unë e quaj Parimi i Ashensorit: Në marrëdhëniet tona, ne mund t'i ngremë njerëzit lart ose t'i ulim poshtë. Ai po përpiquej t'u mësonte studentëve të tij të ishin proaktivë. Crane ka thënë: "Bota është e uritur për vlerësim. Ajo është e uritur për komplimente. Por dikush duhet të fillojë ta rrokullisë topin duke folur i pari dhe duke i thënë diçka të këndshme shokut të tij".³ Ai u bashkua me ndjenjën e Benjamin Franklin, i cili besonte: "Ashtu siç duhet të japim llogari për çdo fjalë të padobishme-po kështu duhet edhe për çdo heshtje të padobishme".

Pesë Gjëra që Çdo Inkurajues Duhet të Dijë rreth Njerëzve

Ju keni fuqi të jashtëzakonshme për të ndikuar në jetët e njerëzve rreth jush. Inkurajimi juaj mund të jetë ndryshim-sjellës në ditën, javën, madje edhe jetën e dikujt, duke e dërguar atë person në një drejtim krejtësisht të ri.

Është e vështirë të inkurajoni nëse nuk e dini se çfarë i inkurajon ata. Kështu, bëhuni studiues i njerëzve dhe mësoni se çfarë i nxit ata. Mësoni se çfarë i ngre ata lart. Për t'ju ndihmuar, filloni duke përqafuar këto pesë gjëra që unë di në lidhje me njerëzit:

1. Gjithkush dëshiron të jetë dikush.

Çdo njeri dëshiron të mbështetet. Çdo njeri dëshiron ta duan. Çdo njeri dëshiron që të tjerët të mendojnë mirë për të. Gjithkush dëshiron të jetë dikush. Kjo është e vërtetë si për më të voglin e fëmijëve, ashtu edhe për të moshuarin e të rriturve.

Si mund t'i ndihmosh të tjerët të ndihen se janë dikushi? Duke i parë ata si të "10-tës" (vlerësimi maksimal). Unë besoj, në shumicën e rasteve, njerëzit i përgjigjen pritshmërive tona ndaj tyre. Nëse mendon më të mirën për ta, përgjithësisht ata të japin më të mirën.

Nëse i trajton si të "10-tës", ata do të përgjigjen si një i "10-tës". Nëse e trajton dikë si të ishte i "2-shit", ai do të përgjigjet si të ishte "2-shit". Njerëzit kanë nevojë për njohje dhe afirmim. Kjo është një dëshirë e thellë njerëzore dhe ne mund t'i ndihmojmë njerëzit të bëhen të mëdhenj, thjesht duke u treguar se si besojmë në ta.

2. Askush nuk do t'ia dijë sa shumë di ti derisa të kuptojnë se sa shumë dashuri ke për ta.

Njerëzit nuk duan t'ia dinë se sa të zgjuar jemi. Nuk duan t'ia dinë se sa frymërorë jemi. Nuk duan t'ia dinë se sa diploma kemi apo sa pasuri kemi mbledhur. Gjëja e vetme që ata me të vërtetë duan t'ia dinë është nëse ne i duam sinqerisht për ta. Ne duhet t'u tregojmë të tjerëve dashurinë e Perëndisë nëpërmjet jetëve tona.

E kam mësuar këtë mësim nga Kati Hutchison, mësuesja ime e klasës së dytë në shkollën e së dielës. Ajo ishte e mrekullueshme. Ajo më donte mua dhe unë e dija këtë gjë. Kur isha e sëmurë dhe mungoja në kishë, ajo më vinte për vizitë atë javë.

"Oh, Johnny, më mori malli për ty se s'të pashë të dielën e shkuar në kishë" - thoshte ajo. "Doja të dija si po ia kaloje". Ajo më jepte një monedhë pesë-centëshe të cilën unë e mendoja të vlefshme sa një milion dollarë dhe thoshte: "Shpresoj të vish në shkollën e së dielës të dielën e ardhshme sepse na mungove shumë. Në fakt, kur të vish në klasë, dua të sigurohem të të shoh, prandaj kur të ngrihem për të dhënë mësim, a mund ta ngresh dorën dhe të më përshëndesësh?" (Në klasën e saj ishin pothuajse 50 fëmijë!) "Kur të të shikoj, do të të buzëqesh dhe do të ndihem më mirë dhe do të jap mësim më mirë".

Kur vinte e diela, unë shkoja sido që të ndihesha. E përshëndesja me dorë. Ajo buzëqeshte, tundte kokën dhe jepte mësim. E dija sa shumë ajo kujdesej për mua dhe kjo gjë më bënte të ndihesha se mund të bëja gjithçka.

3. Çdokush në trupin e Krishtit i përket kujtdo në trupin e Krishtit.

Si të krishterë, shumë njerëz përpiqen t'ia dalin vetë. Ata bëhen indiferentë ndaj të tjerëve dhe presin që edhe të tjerët t'ia dalin vetë gjithashtu. Por kjo nuk është mënyra se si trupi i Krishtit duhet të funksionojë.

Kur një i krishterë përpiket t'ia dalë vetëm, ai është si muratori i një historie komike që kam lexuar një herë. Atij i duhej të lëvizte rreth treqind kile tulla nga maja e një ndërtese katërkatëshe në trotuar poshtë. Fjalët në vijim, thuhet se janë fjalët e tij të marra nga formulari i kërkesës së sigurimit:

Do të duhej shumë kohë për t'i çuar tullat poshtë me duar, kështu që vendosa t'i vija në një fuçi dhe t'i ulja me një rrotull që e kisha lidhur në majë të ndërtesës. Pasi e lidha litarin për siguri në nivelin e tokës, vajta në majë të ndërtesës, e lidha litarin rreth fuçisë, e ngarkova fuçinë me tulla dhe e lashë varur në anë të tarracës gati për zbritjen mbi trotuar.

Atëherë zbrita në trotuar dhe zgjidha litarin, duke e shtrënguar fort për të ulur fuçinë poshtë me ngadalë. Por duke qenë se unë peshoj vetëm 70 kile, ngarkesa treqind kilëshe më ngriti nga toka kaq shpejt, sa që nuk pata kohë të mendohesha e ta lëshoja litarin.

Ndërsa po kaloja midis katit të dytë dhe të tretë, u takova me fuçinë që po zbriste poshtë. Kjo shpjegon të nxirat dhe gërvishtjet në pjesën e sipërme të trupit tim.

U mbajta fort tek litari derisa arrita në majë, ku dora m'u ngjesh me forcë tek rrotulla. Kjo shpjegon thyerjen e gishtit tim.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, fuçia goditi trotuarin me zhurmë dhe fundi i fuçisë u shkëput nga fuçia. Duke qenë se pesha e tullave u largua, fuçia e zbrazët peshonte rreth njëzet kile, kështu trupi im prej 70 kilesh filloi të zbriste shpejt poshtë. U takova me fuçinë bosh që po ngjitej lart. Kjo shpjegon thyerjen e kyçit tim.

Duke u ngadalësuar paksa, vazhdova zbritjen dhe u ula mbi një pìrg tullash. Kjo shpjegon ndrydhjen e kurrizit tim dhe thyerjen e klavikulës. Në këtë pikë, e humba fare mendjen dhe e lëshova litarin. Fuçia bosh erdhi dhe u shemb mbi mua. Kjo shpjegon dëmtimet në kokë.

Dhe në lidhje me pyetjen e fundit në formularin tuaj të sigurimit-çfarë do të bënit nëse e njëjta situatë shfaqet përsëri? Ju lutem kini parasysh se unë nuk do të përpiqem më ta bëj të gjithë punën vetëm.⁴

Në kuptimin frymëror, kjo është ajo që ndodh kur njerëzit mbeten të shkëputur nga trupi i Krishtit. Perëndia nuk krijoi asnjë prej nesh të ecte i vetëm. Ne kemi për qëllim të inkurajojmë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin. Si vëllezër dhe motra, duhet ta ndërmarim udhëtimin së bashku.

4. Çdokush që inkurajon dikë ndikon në shumë njerëz.

Shumë njerëz më kanë ndihmuar dhe inkurajuar gjatë rrugës së jetës sime. Tani, në moshën gjashtëdhjetë e një vjeçare, shikoj prapa dhe habitem se sa bujarë dhe të mirë kanë qenë të tjerët me mua.

Një prej këtyre njerëzve që ka bërë këto gjëra për mua, kur unë isha në klasën e shtatë, ishte një njeri i quajtur Glen Leatherwood, një tjetër mësues i mrekullueshëm i shkollës së të dielës. Ne ishim një grup i sertë: gjithmonë luanim, përdridheshim, flisnim, ngacmoheshim- bënim gjithçka tjetër përveç të dëgjonim. Por ne e dëgjonim Glen-in sepse ai jetonte duke na dashur dhe inkurajuar.

Një ditë, zëri i tij filloi të dridhej dhe çdo fëmijë u kthye duke parë Glen-in dhe ai na shikonte ne dhe filluan t'i rridhnin lotë.

"Menjëherë pas mësimit" - tha ai, "dua të takohem me Steve Benner, Phil Conrad, Junior Fowler dhe John Maxwell vetëm një moment. Kam diçka të mrekullueshme për t'ju thënë".

Pas mësimit, kur u takuam, ai na tha: "Çdo të shtunë pasdite,

unë lutem për çdo djalë të grupit tim. Mbrëmë, ndjeva se Perëndia më tha se ju të katërt do të thirreni në shërbesë dhe unë doja të isha i pari t'ju thoja. Gjithashtu doja të isha i pari që të shtrija duart mbi ju dhe të lutem për ju".

Glen-i shtriu duart mbi kokat tona dhe më dha atë që unë e kam konsideruar gjithmonë si shugurimin tim të parë zyrtar në shërbesë. Dhe ai kishte të drejtë. Ne të katër patëm shërbesën e pastorit.

Shumë vite më vonë, shkova të vizitoja Glen-in dhe e pyeta se sa njerëz të shkollës së tij të së dielës, kishin kaluar në shërbesë gjatë viteve. Ai më tha se nuk ishte i sigurt, por dinte me siguri për tridhjetë prej tyre.

Pyes veten se sa kisha kanë përfituar nga dashuria dhe inkurajimi që ai u tregoi çdo vit një tufë djemve të klasës së shtatë. Në sa jetë njerëzish kanë ndikuar fjalët e tij inkurajuese? Ndoshta nuk do ta di derisa të shkoj në qiell. Por, mund t'ju them këtë gjë: Çdokush që inkurajon dikë, ndikon mbi shumë njerëz.

5. Perëndia i do të gjithë.

Shumë të krishterë kanë tendencën të jenë tepër përzgjedhës në lidhje me kë do të ndihmojnë ose kë do të inkurajojnë. Ata kërkojnë njerëz në ngjasim me veten e tyre. Disa madje besojnë se duhet vetëm ata individë që besojnë atë që besojnë ata dhe mendojnë ashtu si ata. Kjo nuk është mënyra e duhur. Sigurisht nuk është mënyra se si Jezusi vepronte.

Vite më parë, jam hasur me një histori që fliste për dikë që ra në një gropë dhe nuk mund të dilte jashtë - dhe se si të tjerët e trajtuan atë person:

Një njeri subjektiv kaloi dhe tha: "E ndjej dhimbjen tënde".

Një njeri objektiv kaloi dhe tha: "Epo, është logjike që dikush do të binte në këtë gropë".

Një farise tha: "Vetëm njerëzit e këqij bien në gropë".

Një matematikan llogariti se si kishte rënë njeriu në gropë.
Një gazetar i lajmeve donte një histori ekskluzive mbi njeriun në gropë.

Një fundamentalist tha: "E meriton të jesh në gropë".

Një kalvinist tha: "Nëse do të ishe i shpëtuar, nuk do të kishe rënë kurrë në atë gropë".

Një armenian tha: "Ishe i shpëtuar e megjithatë re në atë gropë".

Një karizmatik tha: "Thjesht shpall që nuk je në gropë".

Një realist kaloi dhe tha: "Kjo me të vërtetë që është gropë".

Një gjeolog i tha të vlerësonte shtresat shkëmbore që gjendeshin në gropë.

Një punonjës i taksave e pyeti nëse po i paguante taksat e gropës.

Një inspektor i zonës e pyeti nëse kishte leje ta gërmonte atë gropë.

Një njeri vetë-keqardhës tha: "Nuk ke parë asgjë derisa të shikosh gropën time".

Një njeri optimist tha: "Gjërat mund të ishin edhe më keq".

Një njeri pesimist tha: "Gjërat do të bëhen më keq".

Jezusi, kur e pa atë njeri, zgjati krahun, e kapi prej dore dhe e nxori nga gropa.

Jezusi erdhi për të vdekur për njerëzit. Ai ishte dhe është i pranishëm në jetën e njerëzve. Edhe ju, edhe unë duhet të përfshihemi në jetën e njerëzve. Duhet të kemi gjithmonë parasysh se Perëndia i do të gjithë njerëzit dhe ne duhet t'i trajtojmë të tjerët në të njëjtën mënyrë si Jezusi do t'i trajtonte. Duhet t'i inkurajojmë të jenë ata njerëz që Perëndia i krijoi të jenë.

Unë besoj se thellë-thellë, të gjithë duan të bëhen inkurajues dhe kushdo që e njeh Jezusin, dëshiron të bëhet më shumë si Ai - madje edhe njeriu më negativ. Përse e them këtë? Sepse unë besoj se të

gjithë duam të kemi një ndikim pozitiv tek jetët e të tjerëve. Ne dëshirojmë t'u shtojmë vlera njerëzve të tjerë dhe jo t'ua prishim ato.

Prandaj, ju lutem më lejoni të jem inkurajuesja juaj. Ju mund të sillni një ndryshim. Ju mund t'u shtoni vlera njerëzve të tjerë. Ju mund ta përfaqësoni mirë Jezusin dhe një ditë të dëgjoni fjalët: "Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik". Të gjithë mund të bëhen inkurajues. Nuk ju duhet të jeni të pasur. Nuk është e nevojshme gjeni apo të jeni shumë karizmatikë dhe nuk është e domosdoshme që ju vetë t'i keni të gjitha gjërat në rregull. Ju vetëm duhet të kujdeseni për njerëzit dhe të jeni të gatshëm të filloni. Nuk ju duhet të bëni ndonjë gjë të madhe ose spektakolare. Gjërat e vogla që mund t'i bëni çdo ditë kanë potencialin të kenë një ndikim shumë më të madh se sa mund të imagjinoni.

- Vini në dukje dikë që po bën diçka të drejtë.
- Jepini dikujt një kompliment të sinqertë.
- Ndhmoni dikë në nevojë.
- Afrojini dikujt një shpatull për të qarë.
- Festoni me dikë që ia del mbanë.
- Jepini dikujt shpresë.

Ju mund ta bëni këtë gjë. Veproni tani. Dhe mos e harroni këtë citim që e kam dashur gjithmonë: "Unë pres që të kaloj nëpër këtë botë vetëm një herë. Prandaj, çdo të mirë që mund të bëj, ose çdo mirësi që mund të tregoj ndaj çdo krijese tjetër, le ta bëj tani. Të mos e shtyj apo ta neglizhoj, sepse nuk do të kaloj më në këtë rrugë".⁵



KAPITULLI

10

Vepra Agresive Mirësie

Dhe le të kujdesemi për njëri-tjetrin,
për t'u nxitur për dashuri dhe vepra të mira.

Hebrenjve 10:24

A je ulur ndonjëherë me bashkëshortin/en, me një pjesëtar të familjes ose me ndonjë mik dhe të keni diskutuar për mënyrat se si mund të jeni bekim për të tjerët? Guxoj të them se shumë prej jush nuk e kanë bërë këtë dhe vetëm para rreth tre vjetësh as unë nuk e kisha bërë. Tani, ashtu siç e përmenda në kapitullin 6, për mua këto biseda janë të këndshme dhe shumë të dobishme. Të gjithë gëzohemi kur me qëllim mendojmë dhe bisedojmë për mënyrat se si të ndihmojmë të tjerët. Nuk do të ketë asnjë Revolucion Dashurie nëse nuk i bëjmë gjërat me qëllim që të ndihmojnë të tjerët. Ne duhet të kemi synime dhe të përpiqemi që t'i përmbushim ato.

Kur vendosa që dashurinë për të tjerët ta bëja temën e jetës sime, unë kisha uri për mënyra të ndryshme se si të tregoja dashuri. Dashuria nuk është një teori apo një bisedë e thjeshtë; ajo është

veprim (shiko 1 Gjoni 3:18). Sigurisht që mund të duam njerëzit me fjalë dashurie që inkurajojnë dhe shprehin se sa të vlefshëm ne mendojmë se ata janë, ashtu siç e theksova në kapitullin më parë, por gjithashtu kemi nevojë të japim burimet tona të kohës, energjisë, pronave dhe financave për të dashur të tjerët.

Ju mund të jeni të bindur se nuk keni asgjë për të dhënë. Ndoshta jeni në borxhe, po bëni të pamundurën për të paguar faturat - dhe mendimi për t'u dhënë të tjerëve është pothuajse irritues për ju ose ndoshta ju bën të ndiheni të trishtuar sepse dëshironi të jepni, por nuk dini si ta bëni. Realisht ekzistojnë mijëra mënyra që mund të jepni dhe të shpërndani dashuri nëse dëshironi t'i zbuloni në mënyrë agressive.

Vëpro ashtu siç Flet

Besoj se t'u thuash njerëzve se çfarë duhet të bëjnë dhe të mos u japësh asnjë informacion se si të veprojnë, është një gabim shumë i madh. Shumë njerëz flasin për dashurinë, por thjesht e folura nuk i lë njerëzit domosdoshmërisht me ndonjë ide konkrete mbi mënyrën se si të tregojnë dashuri në mënyra praktike. Sapo përfundova leximin e një libri të tërë mbi dashurinë. Libri kishte 210 faqe dhe ishte i mbushur me mësim rreth mënyrës se si Jezusi tha një urdhërim të ri që duhet të zbatojmë, që është të duam njëri-tjetrin ashtu siç Ai na deshi ne dhe se nëpërmjet asaj dashurie, bota do të mund ta njihte Atë (shiko Gjoni 13:34-35). Por nuk gjeta asnjë ide praktike apo mendim krijues rreth mënyrës se si do të dukej realisht në jetën e një individi. Autori në mënyrë të përsëritur tregonte se dashuria për njëri-tjetrin është gjëja më e rëndësishme që mund të bëjmë, por sinqerisht mund të them se, nëse i gjithë libri i tij do të ishte gjithë njohuria që unë do të kisha për dashurinë, atëherë nuk do të kisha asnjë ide se si të filloj ta bëj

këtë gjë. Unë mendoj se njerëzit duan të bëjnë atë që është e drejtë, por ata kanë nevojë për dikë që t'i udhëheqë duke i drejtuar në drejtimin e duhur.

Jezusi nuk foli vetëm për dashurinë, por kini parasysh se Veprat 10:38 thotë se Ai zgjohej çdo ditë dhe dilte duke bërë vepra të mira dhe duke shëruar të gjithë ata që ishin të munduar dhe pushtuar nga djalli. Dishepujt e Tij e panë Atë çdo ditë teksa ndihmonte njerëzit, i dëgjonte, apo edhe se si Ai ndërpriste planet e Tij me qëllim që të ndihmonte ndonjë që vinte tek Ai dhe kishte nevojë. Ata e panë që Ai sigurohej që të kishin gjithmonë para të hequra mënjane për të ndihmuar të varfërit. Gjithashtu ishin dëshimtarë se si Ai ishte i shpejtë në falje dhe se si tregojte i duruar me të dobëtin. Ai ishte plot mirësi, i përlur dhe jepte kurajo dhe kurrë nuk u dorëzua për askënd. Jezusi nuk foli thjesht vetëm për të dashur të tjerët; Ai i tregoi gjithsecilit përreth Tij se si të donin. Fjalët tona janë të rëndësishme, por veprimet tona kanë më shumë peshë sesa fjalët tona.

Fjalët tona janë të rëndësishme, por veprimet tona
kanë më shumë peshë sesa fjalët tona.

Problemi Ynë më i Madh

Problemi i vetëm më i madh që kemi në krishtërim, është se ne dëgjojmë njerëzit teksa na tregojnë se çfarë të bëjmë - dhe madje edhe ne u themi të tjerëve se çfarë të bëjnë - dhe pastaj dalim nga godinat e kishave tona apo studimet Biblike dhe nuk bëjmë asgjë. Nuk ka rëndësi se çfarë *mendojmë* se dimë. Prova e asaj që dimë qëndron në atë se çfarë bëjmë. Jezusi tha se do të na njohin nga frytet tona (shiko Mat. 12:33), që do të thotë se njerëzit mund të

shohin se kush jemi në të vërtetë përbrenda nga ajo se çfarë prodhojmë me jetët tona dhe nga sjellja jonë.

Unë duhet që në mënyrë konstante të pyes veten: "Çfarë po bëj realisht për të treguar dashuri?" Sipas apostullit Pal ne mund të mashtrohemi nga njohuritë. Mund të verbohemi nga krenaria e asaj që dimë deri në atë pikë sa të mos shohim kurrë se në të vërtetë nuk po praktikojmë asnjë prej tyre. Pali u tha korintasve se thjesht njohuria i bën njerëzit që të fryhen nga krenaria, ndërsa dashuria (dhembshuria, vullneti i mirë dhe bujaria) i drejton, i ndërton dhe i inkurajon njerëzit që të rriten në plotësinë e shtatit të tyre (shiko 1 Kor. 8:1). Të gjithë duhet të sigurohemi që të mos ketë asnjë boshllëk mes asaj që themi dhe asaj që bëjmë. Nuk është çudi që bota i akuzon shumë të Krishterë për hipokritë, pasi në të vërtetë ata janë të tillë.

Për shumë vjet shkoja në një kishë që fliste për misionet njëherë në vit në "E Diela e Misioneve". Nuk mbaj mend ndonjëherë të kem dëgjuar ndonjë gjë për të shkuar tek të varfrit dhe të shtypurit në qytetin tonë. Shumica e predikimeve që dëgjoja ishin rreth besimeve doktrimore dhe jo rreth aspekteve praktike të krishtërimit dhe mënyrës se si duhet të sillesha në komunitetin tim. Doktrina e shëndoshë është e rëndësishme, por është po kaq e rëndësishme të kuptoj se si të jetoj jetën time të përditshme. Kisha ishte e mbushur me thashetheme, përçarje dhe me njerëz që rivalizonin për pozitë në kishë. Në shumë mënyra, ne nuk kishim asnjë ndryshim në sjellje me pjesën tjetër të botës; ne thjesht shkonim në kishë. Përfundimisht më kërkuan që të largohesha nga kisha sepse isha shumë radikale dhe entuziaste rreth dhuntive të mbinatyrshe të Perëndisë që kisha zbuluar se ishin të disponueshme për të krishterët. Unë isha bërë një e krishterë e ekzaltuar, entuziaste dhe më thanë që thjesht po tregohesha emocionale dhe duhej që të qetësohesha.

Pastaj shkova në një kishë tjetër ku edhe këtu njerëzit ishin entuziastë për ato gjëra të cilat unë i ndieja fuqishëm. Ata ishin

shumë të përfshirë në ndarjen e dëshmimeve me të tjerët për shpëtimin nëpërmjet Jezu Krishtit. Isha e entuziazmuar dhe doja thellësisht t'i shërbeja Perëndisë, kështu që organizova një grup grash dhe dëlnim çdo të premte për të shpërndarë fletushka mbi ungjillin. Këto ua shpërndanim njerëzve ndërsa ata dëlnin nga dyqani i ushqimeve dhe i vendosnim në fshirëset e xhamave të makinave të parkuara në parking. Brenda pak javësh, kishim shpërndarë dhjetë mijë broshura të vogla që përmbanin mesazhin e ungjillit. Unë gjithashtu prisja në shtëpinë time dhe zhvilloja një studim biblik çdo të martë në mbrëmje.

Po rritesha në Perëndinë dhe isha kaq e kënaqur që po i shërbeja Atij, por një ditë drejtuesit e kishës më thirrën në një takim dhe më thanë se isha rebeluar pasi kisha organizuar gratë që të shpërndanin fletushka pa marrë më parë lejen e tyre. Ata gjithashtu njoftuan Dave dhe mua se Dave-i duhej që të drejtonte studimin biblik në vendin tim. Ajo kishë përfundimisht u venit deri në atë pikë, sa që tani nuk ekziston thjesht se ata përpiqeshin që të kontrollonin njerëzit dhe për ta arritur këtë, shpesh shtypnin ato dhunti që Perëndia kishte dhënë.

Më pas, për më shumë vite se ç'do të doja të kujtoja, shkova në një kishë tjetër që mësonte gjëra të mira, por për të qenë e sinqertë, ndërsa kthej kokën mbrapa, pashë shumë pak dashuri të vërtetë atje. Ajo kishë bënte shumë pak ungjillizim dhe kishte një buxhet për ungjillizim në botë që ishte i vogël dhe në fund u fashit. Aty kishte gjithashtu drejtues që ishin egoistë, të mbushur me krenari, xhelozë, madje edhe të frikësuar nga suksesi i tjetrit; disa ishin kontrollues dhe tmerrësisht të papjekur. Irritohem sa herë mendoj që harxhova kaq shumë nga jeta ime duke u përfshirë në diçka kaq të vetëkontrolluar. Kisha në përgjithësi dhe kishat lokale në veçanti, janë të thirrura për ungjillizim, jo vetë-ungjillizim. Misioni i Kishës është të jetë një dëshnimtar në komunitetet, qytetet, kombet dhe në botë (shiko Veprat 1:8).

Kisha duhet të funksionojë në mënyrë agresive në realitetin e dashurisë që Bibla qartësisht e përkufizon si duruese, mirëdashëse, përlulëse, gëzim në suksesin e të tjerëve, jo egoiste, bujare, gjithmonë duke besuar më të mirën, e shpejtë në falje, më e mëshirshme sesa gjykuese, e dashur, me vepra të mira dhe ndihmuese ndaj të varfërve, vejushave, jetimëve, fëmijëve pa baba, të uriturve, të pastrehëve dhe të shtypurve. Dashuria jep jetën e vet për të mirën e të tjerëve. Në fakt, dashuria duhet të përfshihet në mënyrë aktive, ndryshe ajo vdes. Ajo duhet të lulëzojë dhe të rritet!

Çfarë do të Bësh me Zemrën tënde të Dhembshurisë?

Tek Letra e Parë e Gjoni 3:17 bëhet një pyetje e rëndësishme: "Dhe, nëse njëri ka të mirat e botës dhe sheh të vëllanë e tij në nevojë dhe e mbyll zemrën e tij para tij, si qëndron në të dashuria e Perëndisë?" Me fjalë të tjera, në këtë varg thuhet se ne mund të vendosim të hapim ose mbyllim zemrat tona të dhembshurisë kur shohim një nevojë, por nëse vendosim t'i mbyllim në mënyrë të përsëritur, dashuria e Perëndisë nuk mund të qëndrojë e gjallë dhe të qëndrojë në ne. Thelbi i natyrës së dashurisë kërkon që ajo të jetë vepruese sepse është një gjë e gjallë. Perëndia është dashuri!

Gjoni bëri një koment të papritur dhe serioz kur tha se "Ai, që nuk ka dashuri, nuk e ka njohur Perëndinë sepse Perëndia është dashuri" (1 Gjoni 4:8). Ne mund të marrim një edukim të shpejtë në atë se si dashuria duhet të duket në jetën e përditshme duke studiuar hapat e Jezusit. Ose ashtu siç ka thënë dikush: "Ndoshta ne mund të mësojmë më shumë duke studiuar ndalesat e Jezusit." Ai gjithmonë kishte kohë për njerëzit! Ai gjithmonë kujdesej! Pavarësisht se ku ishte duke shkuar, Ai ndalonte të ndihmonte ata që kishin nevojë.

Le të Bëhemi Praktikë

Kam pyetur qindra persona që të ndajnë me mua mënyra praktike që ata besojnë se mund të tregojmë dashuri. Kam lexuar libra, kam kërkuar në Internet dhe jam bërë agresive në udhëtimin tim për të gjetur mënyra krijuese me qëllim që këtë temë të dashurisë për njerëzit ta bëja pjesë të jetës sime të përditshme. Dëshiroj të ndaj me ju disa nga gjërat që kam mësuar, por gjithashtu ju inkurajoj që të jeni krijues dhe pastaj t'i ndani idetë tuaja me të tjerët. Mund të vizitoni www.thelovereolution.com e cila është faqja zyrtare për Revolucionin e Dashurisë dhe aty do të mund të lexoni të gjitha faqet e rrjetit social të Revolucionit të Dashurisë, grafika, shkarkime dhe shumë mjete të tjera që mund të përdorni për të ndihmuar avancimin e kësaj lëvizjeje. Ju mund t'i ndani idetë e juaja me të tjerët si edhe të keni mundësinë që të mësoni prej tyre. Mos harroni . . . ju jeni revolucioni i dashurisë! Pa pjesëmarrjen tuaj aktive, kjo nuk do të funksionojë.

Më poshtë janë disa ide që kemi grumbulluar nga njerëz të ndryshëm dhe gjetëm se:

- Kur duket qartë që ti dhe dikush tjetër dëshironi të njëjtin vend parkimi, lejoje personin tjetër që ta zërë dhe bëje këtë me një buzëqeshje në fytyrë.
- Kosit barin e komshiut që është i thyer në moshë ose pastroji borën me lopatë në dimër.
- Pastroji shtëpinë një personi që është i thyer në moshë ose ofro t'i bësh pazarin e ushqimeve.
- Ofroi ta marrësh me makinën tënde dikë që nuk ka mundësi transporti për në kishë ose në ndonjë takim tjetër, edhe nëse nuk i bie nga rruga jote.
- Dëgjoje dikë me të vërtetë, pa e ndërprerë.
- Tregohu shofer i sjellshëm.

- Mbaj një derë të hapur për një të huaj dhe lëre atë që të kalojë përpara teje.
- Nëse ke një karrocë me ushqime dhe personi mbrapa jush ka dy, atëherë lejoje atë të kalojë i pari.
- Kujdesu për një fëmijë që ka vetëm një prind me qëllim që t'i japësh kohë atij prindi të qëndrojë pak vetëm ose të përfundojë një projekt në qetësi.
- Ftoje dikë që nuk ka familje në qytet të vijë në shtëpinë tënde për pushime.
- Dërgo kartolina dhe/ose lule për të treguar mirënjohje.
- Jepi një nëne të vetme para për të nxjerrë fëmijët e saj për drekë.

Kjo funksionon!

Një prej ideve që morëm ishte: "Në mënyrë të fshehtë paguaj darkën e dikujt në restorantin ku po ha edhe ti." Dave dhe unë e bëjmë këtë shpesh dhe kemi patur rezultate të këndshme. Një natë pamë dy gra të moshuara në një restorant një mbrëmje. Ato ishin veshur mirë dhe dukeshin shumë mirë. Ne e ndiemë se kishim dëshirë që t'ua paguanim darkën dhe e bëmë këtë gjë nëpërmjet kamarierit. I thamë që të dilnim ne të parët dhe pastaj t'u thoshte atyre se dikush dëshironte t'i bekonte me ushqimin që hëngrën. Sigurisht, ato e pyetën se kush kishte paguar dhe kamarieri u tregoi gjithashtu se unë kisha një shërbesë në televizion dhe se thjesht kishim dashur të shihnim një buzëqeshje në fytyrat e tyre.

Pas disa muajsh, ne ishim në të njëjtin restorant dhe një nga gratë u afrua tek ne dhe na pyeti nëse e mbanim mend. Duhet t'i jemi dukur të pasigurtë, kështu që ajo menjëherë na e kujtoi incidentin dhe na tha se atë natë kur i paguam darkën, kishte qenë ditëlindja e saj dhe se sa kuptimplotë ishte për të që dikush bënte

diçka të tillë. Ajo tha se kishte kërkuar programin tim në televizion dhe vazhdonte ta shikonte që nga ajo ditë. Ne jo vetëm që ishim të gëzuar se i bëmë ato të lumtura, por u bekuam edhe më shumë që Perëndia na kishte përdorur ne në ditëlindjen e saj. Kështu tani ajo po merr mësim të rregullta nga Fjala e Perëndisë nëpërmjet programit tonë televiziv dhe vetëm Perëndia e di se cilat do të jenë frytet e kësaj. Pra, një veprim i vogël mirësie dhe një investim i vogël financiar, jo vetëm që solli gëzim, por edhe e prezantoi atë me Fjalën e Perëndisë.

Një sugjerim tjetër që morëm ishte: "Paguaj ushqimet e dikujt në dyqanin e ushqimeve." Djali ynë më tregoi një histori që më preku në zemër dhe më bëri krenar që isha nëna e tij. Ai ishte bashkë me gruan e tij tek dyqani i ushqimeve dhe vuri re një grua që dukej e lodhur, e stresuar dhe sikur nuk kishte shumë para. Ajo po zgjidhte sipas listës dhe dukej se kujdesej shumë ndërsa vendoste artikujt në kosh. Ai thjesht iu afrua asaj, i dha një kartëmonedhë njëqind dollarëshe, i tha që të merrte gjërat që i nevojiteshin dhe u largua. Një herë lexova se dashuria pret në hije për një mundësi që të shprehë vetveten, të hedhë hapin dhe të bëjë punën, pastaj menjëherë tërhiqet mbrapsht në hije për të pritur mundësinë tjetër. Mendoj se është një mendim i bukur, apo jo? Shpesh kërkoj ata njerëz që duken të dekurajuar dhe u jap diçka monetare me një mesazh të thjeshtë: "Perëndia të do." Shumë herë as që i them gjë rreth Perëndisë, thjesht i tregoj karakterin e Tij! Njëherë pashë një vajzë të re gjatë pushimit tek një dyqan Starbucks ku punonte. Ajo ishte ulur vetëm në tavolinë dhe dukej shumë e lodhur. I zgjata pesëdhjetë dollarë dhe i thashë: "Thjesht dua të të bekoj. Vë bast që punon vërtet shumë dhe dua që ta dish se e vlerësoj." Ajo më pa e tronditur dhe pastaj më tha: "Kjo është gjëja më e bukur që dikush ka bërë për mua ndonjëherë."

Them se as që e kemi idenë se sa shumë njerëz ecin mes nesh çdo ditë, që ndihen të vetmuar ose të parëndësishëm dhe kanë

pasur pak ose aspak përvojë me dashurinë pa kushte. Ata nuk janë mësuar që të marrin diçka "falas" apo të marrin ndonjë gjë që nuk e kanë fituar apo merituar. Mendoj se duke bërë gjëra të thjeshta për njerëzit, thjesht për të qënë një bekim dhe për asnjë arsye tjetër, atëherë kjo ka për të qënë një mënyrë mahnitëse për të treguar dashurinë e Perëndisë.

Mos harro të bësh mirë

Hebrenjve 13:16 na nxit "mos harroni të bëni bamirësi dhe t'u jepni ndihmë të tjerëve [kishës, si një manifestim dhe provë e miqësisë] sepse Perëndisë i pëlqejnë flijime të tilla." Megjithëse ky varg flet veçanërisht për t'i bërë këto gjëra për ata që janë në kishë, pika që dua të nënvizoj është se të jetosh në këtë lloj mënyre bujarie është të kënaqësh Perëndinë. Ekzistojnë shumë shkrime të tjera që na tregojnë që të jemi të mirë me gjithsecilin, jo vetëm me ata që ndajmë të njëjtat mendime apo që janë në kishën tonë. Për shembull, 1 Selanikasve 5:15 na nxit që: "gjithmonë të ndjekim të mirën edhe ndaj njëri-tjetrit, edhe ndaj të gjithëve."

Më lejoni t'ju inkurajoj të mendoni gjëra që mund t'i bëni për njerëzit që ju shërbejnë në mënyra të tilla si, për shembull: ata që grumbullojnë plehrat ose shpërndajnë postën për ju. Këta janë njerëz që janë në jetët tona gjatë gjithë kohës, por ne rrallë mendojmë se çfarë janë ato punë për ata. Sigurisht që nuk dëshiroj që të mbaj erë të keqe dhe të mbledh plehra gjithë ditën.

Dikur vajza ime shkroi një letër vlerësimi për mbledhësit e plehrave dhe u bëri një dhuratë për të shkuar për drekë. Mendoj se këto gjëra jo vetëm që bekojnë njerëzit, por shpesh mund të jenë edhe shtangëse, sepse ato pothuajse nuk ndodhin kurrë. Bota është e mbushur me njerëz të cilët punojnë shumë në punëra që nuk janë fort të kënaqshme dhe askush nuk i vë re.

Dikur pashë një grua që pastronte banjot në një qendër tregtare ku unë bëj pazarin dhe i dhashë disa para dhe i thashë: "Dukesh që punon shumë dhe mendova se mund të të hyjë në punë një bekim." I buzëqesha dhe u largova menjëherë. Pas pak minutash, ajo më gjeti tek dyqani i këpucëve dhe më shprehu mirënjohjen e saj dhe më tregoi se si ky veprim mirësie e kishte ngritur atë lart shpirtërisht.

Ajo më tregoi se në të vërtetë punonte shumë dhe ndjehej se askush nuk e vinte re këtë fakt. Keni për t'u mahnitur se çfarë do të ndodhë në zemrat tuaja nëse e bëni zakon të dalloni ata të cilët zakonisht nuk dallohen. Perëndia është i ndërgjegjshëm për ta dhe Ai do të kënaqet nëse e bëni veten tuaj partnerin e Tij në këtë përpjekje.

Praktiko Kortezinë e Thjeshtë

Kur kërkuam të na thonin ide që tregojnë dashuri tek të tjerët, një person shkroi: "Gjithmonë thuaj 'të lutem' dhe 'faleminderit'". Këto janë dy format e thjeshta të kortezisë dhe sigurisht të qenit i sjellshëm dhe jo i pasjellshëm është një mënyrë për të treguar mirësi dhe respekt për të tjerët. Dëshiroj që veçanërisht t'ju inkurajoj që të jeni të sjellshëm në shtëpi me familjen tuaj. Unë gjithmonë përpiqem që të kujtohem t'i them Dave-it "faleminderit" kur ka bërë diçka të cilën ia kam kërkuar. Është shumë e rëndësishme që të dashurit tanë të mos i marrim kaq lehtë. Sjelljet e mira në publik duhet të jenë një rrjedhë e asaj që ne normalisht bëjmë në shtëpi pas dyerve të mbyllura.

Dashuria nuk sillet në mënyrë të pahijshme sipas 1 Korintasve 13:5. Mënyra e pahijshme zakonisht vjen nga egoizmi dhe një mënyrë për ta luftuar atë është përdorimi i sjelljeve të mira gjatë gjithë kohës. Shoqëria jonë është e mbushur me sjellje të këqija,

ashpërsi dhe mizori, por kjo nuk tregon karakterin e Perëndisë. Jezusi tha se Ai "nuk është i ashpër, i rëndë, i mprehtë apo rëndues" (Mt. 11:30) dhe ne duhet të ndjekim shembullin e Tij.

Sigurisht duhet ta bëjmë zakon që të falenderojmë dhe të shprehim mirënjohjen tonë. Në disa vende Bibla na tregon se duhet të "jemi mirënjohës dhe ta shprehim falenderimin tonë". Ne mund të mendojmë se jemi njerëz falenderues dhe mirënjohës, por ajo që është në zemër në të vërtetë del nga gojët tona (shiko Mt. 12:34). Nëse me të vërtetë jemi mirënjohës, falenderimi duhet të na vijë natyrshëm.

Koha është një dhuratë e madhe - Jep talentin tënd

Cilido qoftë talenti yt i caktuar, ofrojë atë si dhuratë dhe jo të dëshirosh apo presësh gjithmonë që të paguhesh për të. Për shembull, nëse je fotograf, ofro të marrësh përsipër fotot e martesës falas për një mik apo dikë që nuk ka buxhet të mjaftueshëm.

Nëse je parukier, shko në një qendër të pastrehësh dhe qeth personat një herë në muaj ose edhe më shpesh nëse do.

Një mikesha ime është piktore dekoruese dhe kohët e fundit ajo kalon tre ditë duke lyer falas në një shtëpi që shërben për gratë e reja që janë të shqetësuara.

Perëndia i ka dhënë secilit nga ne aftësitë dhe ne duhet t'i përdorim ato për të përfituar nga njëri-tjetri.

Në kapitullin 3 përmenda atë gruan që kishte pak para, por që dëshironte të mbështeste financiarisht misionet. Ajo e bëri këtë duke shitur prodhimet që piqte vetë për të fituar para për misionet. Historia e saj thekson faktin se, nëse do të refuzojmë të ndenjurin duar-kryq, do të jemi në gjendje të gjejmë diçka që mund ta bëjmë. Dhe kur përfshihet çdo njeri, atëherë nuk do të jetë e largët koha që e mira në botën tonë do ta mundë të keqen.

Vendos disa Synime

Le të vendosim synimet! Unë jam një mbështetëse e fortë në vendosjen e synimeve dhe hartimin e një plani për t'i arritur ato. Ju mund t'i sugjeroni pastorit tuaj që kur të gjithë të largohen nga kisha të dielën, të bien dakord për të bërë një vepër të thjeshtë mirësie brenda tre orëve. Thjesht imagjinoje se çfarë ka për të ndodhur nëse kjo fillon në mbarë botën!

Në këtë kapitull kam nënvizuar disa nga mënyrat e panumërta se si mund të tregojmë dashuri për të tjerët - ide që shpresoj se do t'ju ndihmojnë të kuptoni ato lloj gjëra që mund të bëni. Të thuash se nuk mund të bëjmë asgjë, është thjesht e pavërtetë. Ne mund të gjejmë justifikime, por justifikimet nuk janë asgjë më shumë sesa një mënyrë për të mashtruar veten dhe për të justifikuar faktin që nuk bëjmë gjë. Keni për t'u ringjallur si asnjë herë më parë nëse në mënyrë agresive do të shkoni tek të tjerët. Miliona njerëz në botë ndiejnë se nuk kanë asnjë qëllim dhe kërkojnë vullnetin e Perëndisë për jetët e tyre dhe jetojnë në konfuzion.

Le të mos i harrojmë fjalët e Jezusit: "Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur ju, ashtu dhe ju ta doni njëri-tjetrin" (Gjoni 13:34). Pa dyshim, ky është qëllim ynë dhe vullneti i Perëndisë për jetët tona.



KAPITULLI

11

Dallo se Çfarë Nevoje Kanë Njerëzit dhe Bëhu Pjesë e Zgjidhjes

...të gjithëve u bëra gjithçka...

1 Korintasve 9:22

Pali tha se megjithëse ishte i lirë në çdo mënyrë nga kontrolli i kujtdo, ai ishte bërë shërbëtor për gjithsecilin. Kjo është një deklaratë shumë mahnitëse nëse e mendon në të vërtetë. Ai ishte kaq i lirë sa të bëhej shërbëtor, pa pasur frikë se mund të abuzonin me të. Ai e dinte se për të pasur jetën e vërtetë, duhet të jepte të tijën. Ai vendosi të jetonte për t'u shërbyer të tjerëve dhe për t'i bërë ata të lumtur. Në jetën e tij të përditshme, ai ndiqte shembullin që Jezusi i kishte dhënë.

Pali vazhdoi më tej duke thënë se ai u bë Jude me Judenjtë, si një nën ligj me ata që janë nën ligj dhe iu bë të dobtëve si një i dobët (shiko 1 Kor. 9:22). Me fjalë të tjera, ai e bëri veten ashtu si njerëzit kishin nevojë që ai të ishte. Ai bëri çfarëdo që mundi për t'i fituar ata në Krishtin dhe për t'u treguar dashuri. Pali ishte shumë i arsimuar, por jam e sigurt se kur ishte me njerëz të pa-arsimuar, ai

asnjëherë nuk foli për diplomat apo mbajti ndonjë diskutim mbi gjithçka që dinte. Ai nuk bëri shfaqje për të treguar se sa i arsimuar ishte. Në fakt, deklarata e mëposhtme tregon përlulësinë e tij dhe vendosmërinë për të mos i bërë kurrë të tjerët të ndihen të vegjël. Në fakt ai shkroi: "Sepse e vendosa që të mos di tjetër gjë ndër ju (të mos shpreh asnjë njohuri tjetër ndër ju), veç Jezu Krishtit dhe atë të kryqëzuar" (1 Kor. 2:2).

Kur Pali ishte me njerëz, ai duhej t'i dëgjonte ata dhe të kalonte kohë duke mësuar më shumë rreth tyre. Unë besoj se kjo është diçka që të gjithë kemi nevojë ta bëjmë dhe e di nga përvoja se duke bërë këtë, marrëdhëniet do të rriten në mënyra të mahnitshme. Ne duhet t'i njohim njerëzit. Duhet të gjejmë se çfarë u pëlqen dhe çfarë nuk u pëlqen, çfarë dëshirojnë ose çfarë nuk dëshirojnë, çfarë kanë nevojë dhe se cilat janë kërkesat e tyre për të ardhmen. Nëse ata janë të dobët në një fushë dhe ne jemi të fortë në atë fushë, atëherë duhet të sigurohemi që të mos krenohemi për aftësitë tona.

Gjej Mënyra për të Ndihmuar Njerëzit të Ndihen Mirë për Vetën e tyre

Unë jam shumë e disiplinuar në zakonet e të ngrënit dhe kohët e fundit kalova një javë me dikë që vërtet ka probleme në këtë drejtim. Personi ma theksonte herë pas here se sa e disiplinuar isha dhe se sa e padisiplinuar ishte ajo. Sa herë që ajo më përmendte këtë fakt, unë e ç'vlerësoja aftësinë time për të disiplinuar veten duke i thënë: "Edhe unë kam pika të dobëta. Edhe ti do ta kalosh këtë ndërsa vazhdon të lutesh dhe të përpiqesh."

Ka qenë një kohë në jetën time kur nuk kam qënë kaq e ndjeshme ndaj ndjenjave të mikeshës sime. Ndoshta mund t'i kisha bërë një predikim të tërë rreth përfitimeve të disiplinës dhe rreziqeve të mbingrënies dhe mosushqimit të duhur. Megjithatë, nuk do të

kisha pasur sukses; vetëm sa do të bëja që mikesha ime të ndihej në faj dhe e imponuar. Unë i thoja vetëm atëherë kur më kërkonte që të ndaja me të idetë që të mund ta ndihmoja, por duke u kujdesur që qëndrimi im të mos e bënte të ndihej se unë kisha gjithçka në rregull dhe ajo ishte një rrëmuje e vërtetë. Kam zbuluar se një mënyrë për të dashur njerëzit është t'i ndihmosh të mos ndihen më keq rreth gjërave për të cilat tashmë ndihen keq.

Nënshtimi dhe përlësia janë dy nga aspektet më të bukura të dashurisë. Pali tha se dashuria nuk mburret dhe nuk e mban veten me të madhe (shiko 1 Kor 13:4). Përlësia shërben dhe gjithmonë bën atë që i ngre të tjerët lart.

Bibla na mëson që të kemi të njëjtin qëndrim dhe mendje përlësie si të Jezusit (shiko Filip. 2:5). Ai ishte një me Perëndinë, por e largoi Vetën nga të gjitha privilegjet dhe u përl për t'u bërë një qenie njerëzore me qëllim që Ai të vdiste në vendin tonë dhe të merrte ndëshkimin që ne meritonim si mëkatarë (shiko Fil 2:6-9). Ai kurrë nuk i bëri njerëzit që të ndiheshin keq pasi nuk ishin në nivelin e Tij, por Ai u përl në nivelin e tyre. Edhe Pali bëri të njëjtën gjë. Edhe ne duhet që të ndjekim këta shembuj biblikë.

Të Gjithë Duam Gjëra të Ndryshme

Ne të gjithë jemi ndryshe dhe secili nga ne ka nevoja të ndryshme. Ju nxis që më mirë të lodheni pak dhe të kuptoni atë që njerëzit kanë vërtet nevojë sesa, thjesht t'u jepni atyre atë që ju dëshironi t'u jepni. Ndoshta ju mund t'u jepni njerëzve lehtësisht fjalë inkurajimi, kështu synoni të inkurajoni gjithsecilin. Kjo është e mirë, sepse gjithsecili ka nevojë për fjalë inkurajimi, por ato fjalë mund t'ua jepni atyre njerëzve që vërtet duan që dikush t'i kuptojë se në një farë mënyre, kanë nevojë për ndihmë praktike. Ata mund të jenë tre muaj mbrapa në pagimin e qerasë dhe në vend që t'i inkurajoni se Perëndia

do të sigurojë, ata për momentin kanë nevojë që ju t'i ndihmoni duke u paguar qeranë. Nëse nuk jeni në gjendje për t'i ndihmuar financiarisht, çka është e kuptueshme, atëherë është gjithmonë mirë që të paktën ta merrni në konsideratë që të bëni diçka të prekshme që të shkojë së bashku me fjalët kur situata është serioze.

Ndoshta dëshironi që të kaloni kohë me njerëzit. Ju pëlqen t'u shkoni për vizitë, t'i merrni në telefon dhe të bisedoni ose të ftoni miq në shtëpinë tuaj për të ngrënë - pra, në këtë mënyrë përpiqeni t'u jepni kohë në këto mënyra. Po në rastet kur po i kushtoni kohë njerëzve që realisht kanë nevojë për më shumë kohë që të qëndrojnë vetëm dhe të çlodhen. Ata do të bekohen nëse u jepni atyre një dhuratë për të dalë për drekë ndërsa kujdeseni për fëmijët e tyre, dhe kështu vazhdoni të përpiqeni për t'u dhënë atë gjë që ju sjell kënaqësi.

Disa njerëz janë shumë të detajuar. Ata mendojnë dhe flasin me detaje të hollësishme. Ata mund të dërgojnë e-maile shumë të gjatë ose lënë mesazhe zanore që duket se janë pa fund. Disa njerëz kanë frikë madje edhe të lexojnë e-mailet apo të dëgjojnë mesazhet nga këta njerëz shumë të detajuar, sepse e dinë se po t'i dëgjojnë, do t'u kushtojë shumë kohë. Nëse ata që janë të prirur ndaj detajeve bëjnë vetëm atë që i kënaq ose atë që u pëlqen, atëherë ata do të gjejnë disa njerëz që do t'i shmangin.

Madje edhe në komunikim, duhet të kuptojmë se çfarë duan njerëzit dhe jo thjesht të flasim dhe shkruajmë në mënyrat që na kënaqin ne. Nëse ke një mik të cilit i pëlqejnë detajet, jepi atij gjithçka mendon. Nëse nga ana tjetër miqtë tuaj preferojnë anën tjetër, atëherë jepuni atyre "vetëm fakte".

Mua më pëlqen të bëj dhurata, kështu që zakonisht bëj ato që tregojnë dashuri. Dikur kam pasur një ndihmëse e cila nuk dukej se i pëlqente shumë dhuratat e mia. Kjo gjë më bezdiste në të vërtetë, sepse ajo dukej mosmirënjohëse, por kur e njoha më mirë ajo më tregoi se gjëja më e rëndësishme për atë ishte të dëgjonte fjalë që

tregonin dashuri. Unë dëshiroja t'i jepja asaj dhurata, sepse kjo ishte më e lehtë për mua sesa t'i thoja fjalë që ajo dëshironte të dëgjonte. Unë tregoj vlerësim për punën e vështirë që bën dikush, duke u dhënë gjëra, por ajo kishte nevojë që unë t'i tregoja asaj shpesh se sa mirë punonte dhe se sa shumë e vlerësoja. Ajo kishte nevojë për përqafile apo për t'i rrahur shpatullat. Nëpërmjet dhuratave unë po përpiqesha vërtet shumë që t'i tregoja asaj dashuri, por çuditërisht ajo nuk ndihej e dashur. Mendoj se kjo ndodh më shpesh nga sa e kuptojmë, sepse nuk kërkojmë të dimë mjaftueshëm rreth njerëzve me qëllim që të jemi në gjendje që t'u japim atë për të cilën kanë vërtet nevojë. Ne thjesht duam t'u japim atë që duam t'u japim, sepse është më e lehtë për ne.

Kur presim që gjithsecili të jetë i njëjtë, përfundojmë duke i vënë njerëzit nën presion për të qenë dikush që ata nuk e njohin. Perëndia në mënyrë të hirshme siguron për çdo nevojë që kemi. Ai vendos njerëzit e duhur në jetët tona me dhuntitë e duhura. Sikur të mund t'i shihnim dhe t'i vlerësonim njerëzit për atë që ata janë.

Studioi Njerëzit

Studimi i njerëzve për të më ndihmuar në lidhje me atë që duan nga unë ishte një përvojë që më hapi sytë. Për shembull, bashkëshorti im ka nevojë për respekt dhe të dijë se unë e ndiej se ai po bën një punë të mirë duke u kujdesur për mua. Ai ka nevojë për një atmosferë paqeje për të jetuar. Atij i pëlqejnë të gjitha llojet e sporteve dhe ka nevojë për kohë që të luajë golf dhe të shohë sporte me top. Nëse i jap këto gjëra, ai është më i lumturi.

Nga ana tjetër, mua më pëlqejnë shërbimet me vepra dashurie. Për mua do të thotë shumë kur dikush bën diçka për mua që do të ma bëjë jetën më të lehtë. Bashkëshorti im pothuajse gjithmonë pastron kuzhinën pas darkës në mënyrë që unë të mund të ulem

dhe të pushoj. Nëse ai më shikon të përpiqem që të bëj diçka që duket e vështirë për mua, si për shembull ngritjen e ndonjë objekti të rëndë, ai menjëherë më thotë që ta ul poshtë dhe e bën ai për mua. Këto gjëra më bëjnë të ndihem e vlerësuar dhe e dashur. Duke kuptuar se çfarë ka nevojë tjetri dhe gadishmëria për ta dhënë atë ka përmirësuar në mënyrë të ndjeshme marrëdhënien tonë.

Vajza ime, Sandra, ka nevojë për kohë cilësore dhe fjalë inkurajuese. Vajza tjetër, Laura, ka nevojë për fjalë inkurajimi, por kalimi i kohës me mua nuk është edhe aq i rëndësishëm për të. Të dyja vajzat më duan shumë, por ato e tregojnë në mënyra të ndryshme. Sandra më telefonon pothuajse çdo ditë dhe ajo dhe familja e saj shpesh drekojmë bashkë. Laura nuk merr edhe aq shpesh në telefon dhe nuk e shikoj aq shpesh sa Sandrën, por ajo më ndihmon të kujdesem për nënën time të moshuar dhe tezen, duke u blerë ushqimet dhe duke i ndihmuar me çështjet bankare dhe pagesën e faturave, edhe pse ajo ka katër fëmijë në shtëpi dhe gjyshja e bashkëshortit të saj jeton me ta.

Unë kam dy djem dhe që të dy janë të mrekullueshëm, por janë shumë të ndryshëm. Njëri më telefonon çdo ditë dhe më tregon se më do; tjetri nuk është se më telefonon aq shpesh, por dashurinë e tij e tregon në mënyra të tjera. Sa herë që i kërkoj secilit prej tyre që të bëjë ndonjë gjë për mua, ata ose e bëjnë vetë ose gjejnë mënyrën që ajo gjë të bëhet. Ajo që dua të them është se fëmijët tanë janë të gjithë të ndryshëm, por të gjithë të mrekullueshëm.

Mua gjithashtu më është dashur t'i studioj fëmijët e mi dhe të mësoj se çfarë ka nevojë secili prej tyre nga unë në mënyrë që t'ua jap. Njërit i pëlqejnë dhuratat, tjetrit koha që kaloj me të, tjetri ka nevojë për fjalë inkurajuese, ndërsa tjetri mund të ketë nevojë për t'i treguar vlerësim. Ende vazhdoj të mësoj gjatë gjithë kohës, por tani të paktën po përpiqem t'i kënaq *ata* më tepër sesa veten time.

Të gjithë kemi një "gjuhë dashurie", një term ky i popullarizuar nga Dr. Gary Chapman dhe i shpjeguar në librin e tij *Pesë Gjuhët e*

Dashurisë. Gjuha e dashurisë së një personi është mënyra që ai ose ajo shpreh dhe merr dashuri. Ashtu siç e përmenda, gjuha ime e dashurisë është veprat e shërbimit, ndërsa për vajzat e mia është koha cilësore. Kur njerëzit flasin me ne me anë të gjuhës sonë specifike të dashurisë, ata ndihen të dashur. Zakonisht përpiqemi t'u japim njerëzve atë që kanë nevojë - t'u flasim në gjuhën tonë të dashurisë, por ky mund të jetë një gabim i madh. Nëse ata nuk kanë nevojë për atë që ne kemi nevojë, atëherë pavarësisht se sa shumë përpiqemi, ata përsëri nuk do të ndihen të dashur.

Gjithashtu po mësoj se pavarësisht se sa shumë dua diçka, personi që pres të ma japë mund të mos jetë i pajisur për të ma dhënë atë, të paktën jo në atë moment. Kam kaluar shumë vite e dekurajuar dhe e zhgënjyer, derisa përfundimisht mësova të lutem dhe t'i besoja Perëndisë të më jepte atë që më nevojitej nëpërmjet njerëzve që Ai zgjidhte. Ndërkohë, unë përpiqem të bëj atë që është e drejtë dhe shikoj që gëzimi rritet jo se marr çdo gjë që dëshiroj, por duke u dhënë të tjerëve atë që ata dëshirojnë. Jo gjithmonë, (madje as zakonisht) i gëzohem pjesës sakrifikuese, por më pëlqen kënaqësia e brendshme kur e di se po bëj atë që Perëndia dëshiron që të bëj.

A i keni studiuar njerëzit në jetën tuaj për të kuptuar se çfarë kanë nevojë nga ju dhe pastaj të keni qenë të gatshëm për t'ua dhënë? A i keni pyetur ndonjëherë se për çfarë kanë nevojë? Ka ardhur koha që të pushojmë së jetuari në mënyrë egoiste dhe duke bërë thjesht ato gjëra që janë të rehatshme për ne. Duhet t'i njohim njerëzit që Perëndia ka vendosur në jetët tona dhe t'i hyjmë punës për t'u shërbyer për të mirën e tyre më tepër sesa tonën.

Plotëso Nevojat e të Tjerëve

Bibla na mëson se po të jemi të fortë në besim ne duhet të durojmë dështimet e të dobtëve dhe jo të jetojmë për të kënaqur veten.

Duhet ta bëjmë praktikë të kënaqim dhe të bëjmë të lumtur fqinjët për të mirën e tyre, t'i ngremë moralisht, t'i forcojmë dhe t'i ndërtojmë (shiko Rom. 15:1-2). Kjo është një këshillë e mrekullueshme, por *ne* zakonisht bëjmë të kundërtën. Duam që të tjerët të jetojnë për të na bërë ne të lumtur dhe për të *na* kënaqur. Rezultati është se pavarësisht çfarë njerëzit bëjnë, ne nuk do të jemi kurrë të gëzuar dhe kënaqur.

Mënyrat e njeriut nuk funksionojnë. Ato nuk na japin atë që ne vërtet duam dhe kemi nevojë, por mënyrat e Perëndisë funksionojnë. Nëse veprojmë ashtu siç na udhëzon Ai, mund të bëjmë disa sakrifica, por në fund do të kemi një lloj gëzimi që nuk mund të gjendet asgjekund, përveçse në qendër të vullnetit të Perëndisë.

A doni të jeni të singertë dhe ta pyesni veten, ndoshta mund të jetë e vështirë për t'u përgjigjur, por kjo do t'ju vendosë ballë për ballë me gjendjen ku ju jeni në gjithë temën e dashurisë për njerëzit e tjerë?

- Sa shumë bëni për njerëzit e tjerë?
- A po përpiqeni të kuptoni se çfarë duan dhe kanë nevojë njerëzit me qëllim që t'i ndihmoni?
- A po përpiqeni sinjerisht të njihni njerëzit në jetën tuaj në mënyrë reale?
- Sa realisht i njihni njerëzit në familjen tuaj?

Ndërsa u përgjigjesha këtyre pyetjeve para pak vjetësh, mbeta e tmerruar nga niveli i egoizmit në jetën time, edhe pse kisha qenë një shërbyese e krishterë për shumë vite. E vërteta filloi të më hapte sytë për arsyen se përse isha ende e palumtur dhe e paplotë, edhe pse kisha të gjitha arsyet për të qenë vërtet e gëzuar. E vërteta ishte se isha egoiste dhe egocentrike dhe kisha nevojë të ndryshoja. Këto ndryshime nuk erdhën lehtë apo në mënyrë të shpejtë, as nuk janë plotësuar, por, ndërsa punoj çdo ditë, po përmirësohem dhe jam më e lumtur se kurrë ndonjëherë.

Mësoni të Dëgjoni

Një herë vendosa në mendjen time se do i shpallja luftë egoizmit dhe dëshiroja që të isha pjesë e Revolucionit të Dashurisë. Kisha nevojë të gjeja mënyra krijuese për të qenë bekim. Duke qenë se njerëzit janë të ndryshëm dhe kanë nevojë për gjëra të ndryshme, m'u desh të filloja të trajnoja veten për të dëgjuar realisht atë që ata më tregonin. Kuptova se nëse dëgjoja dikë për një kohë shumë të gjatë, atëherë mund të largohesha duke pasur njohurinë për diçka për ta, për të bërë për ta ose për t'u lutur për ta, nëse do të doja me të vërtetë. Justifikimi "Nuk e di çfarë të bëj" është i vjetër dhe duhet të hidhet në kosh të plehrave. Nëse vërtet duam të japim, mund t'i gjejmë mënyrat. Mos harro, "Indiferenca sjell justifikime, por dashuria e gjen një rrugë!"

"Indiferenca sjell justifikime, por dashuria e gjen një mënyrë!"

Besoj se kjo çështja e dëgjimit është një pjesë e madhe e mësimi të të dashurit të njerëzve sipas mënyrës që ata kanë nevojë të duhen. Për një javë mbani shënim ato gjëra që njerëzit ju thonë në bisedat e përgjithshme se ata duan, kanë nevojë apo pëlqejnë. Lutuni për këtë listë dhe kërkojini Perëndisë që t'ju pajisë të bëni ndonjë prej tyre ose nëse keni dëshirë për të bërë ndonjë prej tyre, atëherë bëjeni direkt. Nuk besoj se keni nevojë për një fjalë të veçantë nga Perëndia për të filluar të bekoni njerëzit. Nëse atë për të cilën ata kanë nevojë është shumë për ju që ta bëni vetëm, atëherë ju të sugjeroj që të bashkoheni me disa njerëz të tjerë dhe kështu t'i plotësoni nevojat si grup. Nëse një mikeshë juaj përmend se ajo ende vazhdon të flejë në kolltuk, edhe pse ka një vit që është futur në apartamentin e saj të ri, sepse nuk ka qenë në gjendje të përballojë blerjen e një dhome gjumi, atëherë do të jetë një gjë e

mirë që këtë ta merrni në konsideratë si një projekt në grup.

Një miksha ime po më tregonte për një të ri në kishën e saj, i cili i kishte dhëmbët shumë të deformuar. Ai i kishte aq keq, sa që refuzonte të buzëqeshte, sepse kishte turp që të tjerët t'ia shihnin. Unë u mbusha me dhembshuri kur e dëgjova këtë histori dhe ne mundëm që në mënyrë anonime të siguronim që dhëmbët e tij të drejtoheshin. Kjo i ndryshoi jetën. Sa shpesh dëgjojmë gjëra të tilla, kemi dhembshuri dhe ikim tutje, madje pa pyetur nëse mund të bëjmë ndonjë gjë për të ndihmuar ose jo? Mendoj se kjo ndodh më shumë se shpesh. Ne thjesht kemi nevojë të mësohemi dhe të ritrajnohemi. Kemi nevojë të formojmë zakone të reja. Në vend që të marrim me mend se nuk ka asgjë që mund të bëjmë, duhet që të paktën të mendojmë. Mos harro, 1 Gjoni 3:17 thotë: "Dhe, nëse njëri ka të mirat e botës dhe sheh të vëllanë e tij në nevojë dhe e mbyll zemrën e tij para tij, si qëndron në të dashuria e Perëndisë?"

Njëherë dëgjova mikeshën time që kishte nevojë për produkte të trajtimit të lëkurës. Unë kisha një set tepër, kështu që ia fala asaj. Nëna ime përmendi se i kishte mbaruar parfumi, kështu që i bleva asaj një të tillë. Tezes sime i pëlqen shumë të shkojë tek Starbucks*, kështu që i sigurova një mundësi për të shkuar. Ju lutem më kuptoni se nuk po i ndaj me ju këto gjëra për ndonjë arsye, por vetëm që t'ju jap disa ide rreth mënyrave që mund të tregoni dashuri për njerëzit në botën tuaj. Jam e sigurt se ju keni shumë ide të tuajat, kështu që ju lutem mos harroni të shkoni në faqen e Love Revolution (Revolution Dashurie) dhe shkruajini me qëllim që të mund të na frymëzoni.

Sa herë që veprojmë për të përmirësuar jetën e një personi tjetër apo kundër padrejtësisë, japim një valë shpresë në atë që duket se është shoqëri e pashpresë. Ne mund ta mundim të keqen me të mirën, kështu që le të jemi të ashpër në vendosmërinë tonë për të vepruar në këtë mënyrë.

*Zinxhir i famshëm kafenesh.



KAPITULLI

12

Dashuria Pa Kushte

Dashuria nuk është e verbër - ajo shikon shumë, jo pak.

Rabbi Julius Gordon

Një nga gjërat më të bukura që thuhet në Bibël është se kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne (shiko Rom. 5:8). Ai nuk priti derisa ta meritonim dashurinë e Tij; Ai na do pa kushte. Për të qenë e sinqertë, kjo është e vështirë për shumë prej nesh për ta kuptuar sepse ne jemi mësuar që çdo gjë në jetë duhet ta fitojmë ose meritojmë.

Perëndia është i pasur në mëshirë dhe me qëllim përmbushjen e dashurisë së madhe, të mrekullueshme dhe të pamasë me të cilën Ai na do, Ai e dha jetën e Tij për ne falas (shiko Ef. 2:4). *Kjo është dashuri revolucionare!* Dashuria e vërtetë, revolucionare duhet të japë veten, pasi ndryshe nuk mund të kënaqet kurrë duke bërë më pak.

Është dashuria pa kushte e Perëndisë që na tërheq drejt Tij dhe është dashuria jonë pa kushte kundrejt të tjerëve në emrin e Tij që do të tërheqë të tjerët drejt Tij. Ai dëshiron që ne të duam njerëzit

në vend të Tij dhe ta bëjmë këtë në të njëjtën mënyrë si Ai, nëse Ai do të ishte këtu në trup. *Ai dëshiron të jetojmë Revolucionin e Dashurisë.*

Ti mund ta kujtosh historinë që tregova në kapitullin gjashtë për babain tim dhe për mënyrën se si Përendia e udhëzoi Dave-in dhe mua që të kujdeseshim për të, edhe pse realisht ai nuk e meritonte. Duke i treguar dashurinë pa kushte të Perëndisë, kjo papritur zbuti zemrën e tij të fortë dhe ai u pendua për mëkatën e tij dhe pranoi Jezusin si Shpëtimtarin e Tij.

Dashuria njerëzore e shikon të pamundur që të dojë pa kushte, por ne kemi dashurinë e Perëndisë në ne si besimtarë në Jezu Krishtin dhe mund ta lejojmë këtë dashuri që të rrjedhë lirshëm, pa kushte. Dashuria e njeriut dështon, por ajo e Perëndisë, jo. Nganjëherë shoh se edhe pse nuk mund ta dua një person me forcën time njerëzore, jam në gjendje ta dua atë me dashurinë e Perëndisë.

Dikush që më lëndoi në mënyrë të përsëritur për vite, kohët e fundit më pyeti se si ndihesha për të. A e doja atë? Sinqerisht isha në gjendje që të thoja se, edhe pse nuk kisha ndjenjat më të thella për të, që do t'i kisha nëse gjërat do të kishin qenë ndryshe, unë i doja ata si fëmijë të Perëndisë dhe mund t'i ndihmoja në nevojën e tyre.

Dashuria e vërtetë e Perëndisë nuk varet nga ndjenjat; ajo bazohet në vendim. Unë do të ndihmoj këdo që ka nevojë për ndihmë, vetëm jo kur ndihma ime do t'i lëndojë ata. Ata nuk ka pse ta meritojnë. Në fakt, ndonjëherë mendoj se, sa më pak ta meritojnë, aq më e bukur dhe ndikuese është. Është absolutisht çliruese të jesh në gjendje t'i duash njerëzit pa pyetur nëse e meritojnë.

Falja

Nuk mund të pyetet...thjesht shumë për të pyetur. Si mund ta falte Bill Ebarb personin që me gjakftohtësi vrau vëllain e tij. Bill Ebarb dhe Charles Manuel ishin dy të huaj, jetët e të cilëve do të bashkoheshin përgjithmonë në një fraksion sekonde - momenti kur Charles tërhoqi këmbëzën dhe vrau vëllain e Billit, John. Që nga ai moment, Bill-i nuk mund të mendonte gjë tjetër veçse hakmarrje.

Zemra e Bill-it ishte e mbushur me urrejtje dhe inat dhe ai ishte i bindur se asnjë ndëshkim nuk do të mund ta fshinte humbjen e tij. Pas vrasjes së John-it, nuk kishte ditë që Billi të mos mendonte për vrasësin. Urrejtja e madhe po e hante të gjallë. Ky fiksion i kushtoi Billit vendin e punës dhe martesën. Ai e dinte se nëse do të vazhdonte në këtë rrugë shkatërruese, kjo së shpejti do t'i kushtonte jetën.

Këtu Bill përjetoi një ndryshim në jetën e tij që ishte shumë më i fuqishëm sesa dita kur humbi vëllain. Billi përjetoi faljen e Krishtit. Kjo ishte diçka e mbinatyrshme dhe përtej çdo faljeje që një qenie njerëzore mund të tregojë. Perëndia largoi urrejtjen - ai largoi inatin.

Zemra e Bill-it u transformua në mënyrë të mrekullueshme, aq sa ai filloi të mendonte të pamundurën. Ai kuptoi se nëse Zoti mund ta falte atë për të gjitha ato gjëra që ai kishte bërë në jetën e tij, atëherë edhe ai mund ta falte Charles. Dhe ai duhej t'i tregonte Charles se ai e kishte falur atë për vrasjen e vëllait të tij. Në fillim ky ishte një veprim bindjeje, por më pas u bë një çështje zemre. Dhe kështu në ditën e tetëmbëdhjetë vjetorit të vdekjes së John-it, Bill-i dhe Charles ishin ulur përbri njëri-tjetrit në një takim që konfirmoi atë që Perëndia tashmë kishte bërë në dy jetët e tyre. Perëndia i kishte çliruar këta dy

burra nëpërmjet fuqisë së faljes.

Statistikat¹ flasin:

- Falja ul stresin. Mjekimi i urrejtjes mund të sjellë të njëjtat dhimbje - tendosje të muskujve, rritjes së presionit të gjakut, djersitje të shpeshta - në trupin tuaj si një moment i ngarkuar me stres.
- Zemra juaj do të përfitojë nëse jeni në gjendje të falni. Në një studim u vu re lidhja mes faljes dhe përmirësimit në rrahjet e zemrës dhe presionit të gjakut.
- Në një studim të fundit u vu re se gratë që ishin në gjendje të falnin bashkëshortët e tyre dhe të tregoheshin zemërbutë ndaj tyre, i zgjidhnin konfliktet në mënyrë më efektive.

Dashuria njerëzore varet nga ndjenjat. Ne i duam njerëzit sepse ata janë treguar të mirë me ne, na kanë ndihmuar ose na kanë dashur të parët. Ata na bëjnë të ndihemi mirë për veten tonë ose na i bëjnë jetën tonë më të lehtë dhe kështu u themi se i duam. Ose i duam ata sepse duam që të na duan. Por kjo lloj dashurie bazohet në atë që ata bëjnë dhe nëse pushojnë së vepruari, atëherë ndoshta ne do të pushojmë së dashuri ata. Kjo lloj dashurie vjen e shkon; është e nxehtë dhe pastaj e ftohtë. Kjo është ajo lloj dashurie që përjetojmë në botë. Shumë martesë dhe marrëdhënie personale bazohen në këtë lloj dashurie. I pëlqejmë akulloret sepse kanë shije të mirë dhe i duam njerëzit sepse ata na japin dhurata të bukura për Krishtlindje.

Dashuria e Perëndisë është tërësisht ndryshe - nuk bazohet mbi asgjë tjetër veçse te Perëndia Vetë. Dhe kur pranojmë Krishtin si Shpëtimtarin tonë, dashuria e Perëndisë derdhet në zemrat tona nga Fryma e Shenjtë (shiko Rom. 5:5). Kur bëhemi partnerë me

Perëndinë, Ai pret që të jemi përfaqësuesit e Tij në Tokë dhe Ai na pajis me dashurinë që na nevojitet për të bërë punën që na ka kërkuar të bëjmë. Kur dashuria njerëzore përfundon, që shpesh ndodh, dashuria e Perëndisë është ende në gjendje për të përfunduar atë që duhet të bëhet.

Unë nuk e doja babain tim si mund ta dojë një vajzë, sepse ai kurrë nuk ishte një baba për mua. Por unë kisha dashurinë e Perëndisë dhe isha në gjendje që të vendosja totalisht larg ndjenjave, se do ta trajtoja mirë kur të plakej dhe se do të isha e mëshirshme me të. Realisht unë ndjeja dhembshuri për të, sepse ai e shkoi dëm gjithë jetën e tij dhe ishte plot me kujtime për të cilat i vinte keq.

Shpesh dëgjojmë histori mahnitëse faljeje. Dëgjova një herë për një adoleshent i cili po pinte dhe shkaktoi një aksident ku aksidentoi për vdekje bashkëshorten e dikujt dhe fëmijën e saj. Burri e dinte se Perëndia dëshironte që ai ta falte atë djalosh që shkaktoi aksidentin dhe, nëpërmjet shumë lutjesh, ai ishte në gjendje që të lejonte dashurinë e Perëndisë që të derdhej nëpërmjet tij. Ky njeri ishte një revolucionar dashurie!

Duhet të mësojmë të shikojmë më tepër atë që njerëzit i kanë bërë vetes së tyre sesa atë që na kanë bërë ne. Zakonisht, kur dikush lëndon dikë tjetër, ai ose ajo ndoshta ka dëmtuar veten e tij ose të saj, të paktën në të njëjtën masë dhe ndoshta po vuan si rezultat i kësaj. Kjo është ekzaktesisht ajo që Jezusi bëri kur tha: "At, të lutem fali sepse nuk dinë ç'po bëjnë" (Luka 23:34).

Dashuria e llojit të Perëndisë nuk mund të rrokët me mendje; është çështje zemre. Dukej mjaft e paarsyeshme për Perëndinë që të më kërkonte të kujdesesha për babain tim - por në fund të fundit, dashuria është shumë e paarsyeshme, apo jo? Nuk ka arsye për Perëndinë që të na dojë ndërsa ne mëkatojmë dhe e injorojmë atë totalisht, por ja që Ai na do.

Mëshira triumfon mbi gjykimin

Është e lehtë të gjykosësh një person ose situatë dhe të shpërndash vetëm atë që është e merituar, por mëshira është më e madhe se kaq. Është një gjë e lavdishme për dikë që të injorojë një lëndim. Për të ndihmuar njerëzit e vendeve të botës së tretë, unë nuk mund të shikoj faktin se shumë prej tyre adhurojnë idhujt, apo kafshët, apo diellin, ose madje edhe demonët. Unë mund të them thjesht: "Pa dyshim që ata po vdesin urie - ata i kanë kthyer shpinën Perëndisë." Por ndoshta unë do të isha në të njëjtën situatë në të cilën ndodhen ata nëse do të kisha lindur aty ku janë ata. Duhet të mos harrojmë: "Nëse nuk do të ishte për hirin e Perëndisë në jetën time, unë mund të isha një prej tyre".

Është e lehtë për disa njerëz fetarë që të shohin një homoseksual i cili është i prekur nga AIDS dhe të mendojnë, *Ai e meriton*. Po a është kjo mënyra se si Perëndia e shikon njeriun? Ose a shikon Perëndia "pse-në" e vërtetë prapa "çfarë"? Perëndia dëshiron të prekë atë njeri me shpengim për aq kohë sa ky njeri merr frymë dhe Ai mund të më përdorë mua ose ty për ta bërë këtë gjë. Kjo nuk do të thotë që të përqafojmë mëkatën e personit, por ne duhet të përqafojmë *njeriun* dhe t'i ndihmojmë ata kur kanë nevojë duke u siguruar ilaçe, strehë dhe fjalë të mira, që t'u mundësojmë atyre të gjejnë shpresë tek Perëndia.

Mëshira dhe dhembshuria janë dy prej cilësive më të bukura të dashurisë dhe, në fakt, nuk ka dashuri të vërtetë pa këto të dyja. Duke qenë se unë isha e detyruar të fitoja çdo gjë që kisha gjatë tridhjetë viteve të para të jetës sime, unë nuk isha aq e madhe sa t'u jepja njerëzve atë për të cilën kisha punuar, kur më dukej se ata nuk kishin bërë ndonjë gjë për të ndihmuar veten e tyre. Për të mësuar dallimin mes dashurisë njerëzore dhe dashurisë së Perëndisë që ishte vendosur tek unë, më kushtoi kohë. Mëshira nuk mund të fitohet apo meritohet. Pali u shkroi Kolosianëve dhe u tha që të

"vishnin dashurinë" (shiko Kol. 3:14). Mua më pëlqen shprehja "vishni", që do të thotë që të bësh diçka me qëllim, pa u varur nga ndjenjat apo arsyetimi. Unë kam mësuar mësimet e mrekullueshme jete nisur nga kjo shprehje e vogël.

Ndërsa shkruaj këtë, është mes i pasdites dhe jam akoma me pizhame. Dave-i sapo më telefonoi dhe dëshiron të vijë të më marrë për të parë një shfaqje me makina Mustang. Mund t'ju siguroj se shkuarja në një shfaqje makinash do të jetë një vepër dashurie. Nuk dua të bëhem gati dhe të vishem, për më tepër po më pëlqen gjithë kjo që po bëj e veshur me pizhame, por do të ngrihem. Në të njëjtën mënyrë, ne të gjithëve na dalin përpara mundësi të panumërta për të zgjedhur të japim dashuri pakushte.

Nëse nuk mësojmë të jetojmë përtej ndjenjave tona, nuk kemi për të qenë kurrë në gjendje që të duam njerëzit me dashurinë e Perëndisë apo të ndihmojmë njerëzit në nevojë të botës. A jeni të gatshëm të vishni mëshirën? A jeni të gatshëm të vishni dashurinë? Nëse jeni duke luftuar me ndjenjat, atëherë kjo mund t'ju pengojë për të bërë gjënë e drejtë. Pyeteni veten: "Çfarë do të bënte Jezusi në këtë situatë?" E di me siguri se nëse Dave-i do të ishte lodhur me mua, une nuk kisha për të qenë personi që jam sot. Ai dëgjoi zemrën e tij, jo emocionet dhe këtë po ju inkurajoj ta bëni edhe ju.

Dashuria nuk Ikën Thjesht Tutje

Të doni njerëzit nuk do të thotë që t'i lejoni ata të përfitojnë nga ju. Nuk do të thotë t'i mbani në kurriz ndërsa ata nuk bëjnë asgjë. Bibla na thotë se Perëndia ndreq dhe disiplinon të gjithë ata që Ai i do (shiko Heb. 12:6). Ndreqja nuk është ndëshkim; është të stërvitesh në sjelljen e drejtë. Nganjëherë kjo stërvitje kërkon ndalimin e bekimeve, por Perëndia gjithmonë do të plotësojë nevojat tona më kryesore kur i thërrasim Atij. Bibla thotë se ne

mund t'i kalojmë provat e të gjitha llojeve dhe, nëse kemi nevojë për urtësi, mund t'i kërkojmë Perëndisë i cili është dhurues dhe na jep të gjithëve lirshëm dhe se Ai do të na ndihmojë pa na fajësuar apo gjetjen e fajit (shiko Jakobi 1:1-5). Ky është një mendim i bukur!

Unë mund të mos i blej një të droguari një makinë të re, pasi e di që gjasat janë që ai ta shesë për të blerë drogë, por mund ta ushqej dhe mund t'i jap një vend ku të bëjë një dush dhe t'i jap shpresë për një jetë të re. Mund t'i tregoj se Perëndia e do atë dhe dëshiron që ta ndihmojë dhe mund të mos e gjykoj, pasi, nëse e gjykoj, atëherë unë nuk do të jem në gjendje ta dua atë.

Shpesh, kur njerëzit na lëndojnë apo janë të vështirë për t'i duruar, ne menjëherë duam që thjesht t'i largojmë nga jetët tona. Po sikur Perëndia të dëshironte që në vend të kësaj të ndërtonim një marrëdhënie me ta? Është shumë herë më e lehtë për ne që thjesht të largohemi, apo t'i shmangim nga jeta njerëzit e vështirë, por kjo nuk është gjithmonë ajo që Perëndia dëshiron. Duhet të mësojmë se si duket dashuria në çdo situatë dhe ta zbatojmë atë, pa iu dorëzuar ndjenjave ose mungesës së tyre.

Një prej pyetjeve që më drejtojnë më shpesh është: "Sa gjatë duhet të qëndroj me këtë person?" Kjo është një pyetje që vetëm zemra jote mund t'i përgjigjet. Perëndia është i vetmi që kupton të gjithë situatën nga të dyja anët dhe Ai do të të drejtojë në vendimet e tua nëse vërtet dëshiron të bësh vullnetin e Tij dhe jo tëndin. Mos harro: T'i bashkohesh revolucionit të dashurisë do të thotë të jesh gati dhe i gatshëm të duash të tjerët edhe kur duket e pamundur.

Kur diskutoj dashurinë pa kushte me njerëzit, një pyetje tjetër më vjen gjithmonë në mendje: "A mos duhet të vazhdoj të jap pavarësisht se çfarë bëjnë njerëzit?" Përgjigjja e kësaj pyetje është jo.

Le të supozojmë se një pjesëtar i familjes ka pasur një problem me drogën ose alkoolin për shumicën e jetës së tij ose të saj dhe mbi të gjitha është shumë i papërgjegjshëm. Familja shpenzon kohë, para dhe mund të jashtëzakonshëm për ta ndihmuar atë, por ai

gjithmonë kthehet në zakonet e tij të vjetra dhe në mënyrën e tij të jetesës. Kjo është ajo lloj situatë kur armiku përdor dobësinë e këtij pjesëtari të familjes për ta shpërqëndruar dhe vjedhur forcën nga ata që e duan dhe që janë përpjekur ta ndihmojnë. Nganjëherë duhet të ballafaqohemi me faktin se, pavarësisht se sa duam të ndihmojmë dikë, kjo nuk ka për të funksionuar kurrë, nëse ata nuk duan që të ndihmohen. Në fakt, shumë shpesh, pas vitesh të tëra vazhdimësie në përpjekje për ta ndihmuar, zakonisht në një sakrificë të madhe personale, familja duhet të refuzojë vazhdimin e dhënies së ndihmës. Ky nuk është një vendim që mund të merret shpejt ose lehtë, por shpesh duhet të merret.

Nganjëherë si të krishterë, ne akuzohemi se nuk praktikojmë në të vërtetë dashurinë e Krishtit kur del një situatë e tillë. Dëgjojmë gjëra të tilla si: "Si mund të thuash të duam njerëzit kur ti as që ndihmon të afërmit e tu?" Megjithëse është e vështirë, gjëja më e dashur që mund të bësh, është të jesh i drejtpërdrejtë dhe të thuash: "Nëse vërtet dëshiron që ndonjëherë të përballesh me çështjet e tua dhe të marrë ndihmën e vërtetë, thjesht më thuaj", por sigurisht që e di se nuk mund të vazhdoj t'i mundësoj atij ose asaj që të vazhdojë një mënyrë jetese shkatërruese.

Nuk duhet të lëmë një të dashurin tonë në telashe që të ketë uri apo i sëmurë pa i dhënë ndihmë, por gjithashtu nuk duhet ta lejojmë atë të vjedhë paqen tonë apo thjesht të na përdorë. Të duash njerëzit nuk do të thotë që të bësh për ta atë që ata duhet të bëjnë për veten e tyre.

Mëshira i ndihmon ata që nuk e meritojnë ndihmën, por dashuria pa kushte nuk synon të lejojë njerëzit që të jenë të papërgjegjshëm ndërsa ne paguajmë për ta. Mëshira u jep shumë mundësi dhe dashuria pa kushte asnjëherë nuk dorëzohet. Ajo lutet dhe është gati të largojë hijet dhe të ndihmojë dhe kur të jetë kështu atëherë kjo do të bëjë dallimin e vërtetë.

Perëndia dëshiron dashurinë e Tij që të rrjedhë nëpërmjet nesh

dhe tek të tjerët. Ne kemi nevojë të mësojmë të duam veten tonë në mënyrë të ekuilibruar, pasi duhet të duam veten tonë ose në të kundërt nuk do të kemi dashuri për të dhënë. Kemi nevojë të marrim dashurinë e Perëndisë dhe ta lejojmë që të na shërojë. Mos harroni se nuk mund të japim diçka që nuk e kemi. Por nuk duhet të ndalojmë këtu! Perëndia na shëron dhe kështu ne duhet të sjellim shërim për të tjerët. Perëndia dëshiron që ne të kthehemi nga ata që janë shpëtuar drejt atyre që po shpëtojnë të tjerët. Dashurisë njerëzore gjithmonë i vjen fundi por faleminderit Perëndisë që dashuria e tij nuk mbaron. Perëndia na premtoi se dashuria e Tij nuk shteron!



KAPITULLI

13

Dashuria nuk Mban Shënim Gabimet

Dashuria nuk gëzohet me padrejtësinë, por gëzohet me të vërtetën, i duron të gjitha, i beson të gjitha, i shpreson të gjitha, mban çdo gjë.

1 Korintasve 13:6-7

A je llogaritar i mirë? A mban shënim me saktësi dhe të detajuara të gjitha gjërat e gabuara që të janë bërë? Për gjatë shumë viteve, sa herë që unë dhe Dave grindeshim, unë gërmoja në dosjet e mia të mendjes dhe filloja të nxirrja të gjitha ato gjëra që ai kishte bërë për të cilat unë ndjeja se ishin gabim. I kujtoja gabimet e së kaluarës dhe ai çuditej se si i mbaja mend shumë prej tyre, sepse kishte shumë kohë që kishin ndodhur. Më kujtohet një herë kur më tha: "Ku i ruan gjithë këto materiale?" Ndërsa unë kapesha pas gjërave gjatë viteve, Dave ishte i shpejtë në të falur dhe e mbyllte këtu.

Perëndia dëshiron që mbi të gjitha ne të duam njëri-tjetrin, por kjo është e pamundur pa faljen totale. Nuk mund t'i duam në të vërtetë ata me të cilët jemi të inatosur apo mbajmë mëri. Pali u shkroi Korintasve dhe u tha: "Dashuria (dashuria e Perëndisë në ne) nuk kërkon të sajat, nuk pezmatohet, nuk llogarit të keqen [nuk e vë re një gabim për të cilën ka vuajtur]" (1 Korintasve 13:5b).

Besoni më të Mirën

Nëse duam të duam njerëzit, duhet të lejojmë Perëndinë që të na transformojë në atë mënyrë që të mendojmë për njerëzit dhe gjërat që ata bëjnë. Mund të besojmë më të keqen dhe mund të jemi dyshues për çdo gjë që të tjerët bëjnë dhe thonë, por dashuria e vërtetë gjithmonë beson më të mirën. Ajo që mendojmë dhe besojmë është një zgjedhje. Rrënja e shumicës së shqetësimeve tona në jetë është se nuk kontrollojmë ose disiplinojmë mendimet tona. Duke mos zgjedhur disiplinimin e mendimeve tona, automatikisht zgjedhim të besojmë më të keqen për dikë ose të dyshojmë.

Profeti Jeremia u kërkoi njerëzve këtë: "Deri kur do të mbeten të ty mendimet e mbrapshta?" (shih Jer. 4:14). Mendimet që ata zgjedhën të mendonin ishin lënduese për Perëndinë.

Kur zgjedhim të besojmë më të mirën, jemi në gjendje të lejojmë çdo gjë që mund të jetë e dëmshme për marrëdhëniet e mira. Unë kam kursyer shumë energji që mund të ishte përdorur nga inati thjesht duke i thënë vetes: "Edhe pse ajo që thonë ose bëjnë ata më lëndon, unë zgjedh të besoj se zemra e tyre ishte e drejtë". Vazhdoj të flas me veten time derisa ndjenjat e inatit fillojnë të ikin. Them gjëra të tilla si: "Nuk e besoj se ata vërtet e kuptuan se si veprimet e tyre ndikuan tek unë. Nuk besoj se u përpoqën që të më lëndonin me qëllim. Thjesht nuk e kuptojnë se si tingëllon kur e thanë atë. Ndoshta nuk ndihen mirë fizikisht sot ose ndoshta kanë ndonjë problem personal që i bën të jenë të pandjeshëm për mënyrën se si po sillen.

E di nga përvoja se mbajtja shënim në mendje e lëndimeve, helmon jetët tona dhe nuk e ndryshon në të vërtetë personin tjetër. Shpesh humbasim gjithë ditën duke u inatosur me dikë që as që e kupton se ka bërë diçka që na shqetësoi. Ata po shijojnë ditën e tyre, ndërsa ne harxhojmë kot tonën.

Nëse do të mbajmë shënim, përse të mos mbajmë gjërat e mira

që njerëzit na thonë dhe jo gabimet e tyre?

Shembuj Mbajtje Shënimesh Negative:

Dave gjatë gjithë kohës shikon sport dhe ai e di që mua nuk më pëlqen të shikoj sport.

Dave më korrigjon në detajet kur jam duke treguar ndonjë histori.

Kur kam nevojë për mirëkuptim, Dave përpiket që të më japë këshilla.

Në dyzet e dy vjet martesë, mund të numëroj me gishtat e njërës dorë se sa herë Dave më ka sjellë lule.

Dave planifikoi të luante golf me shokët e tij dhe as që më pyeti se çfarë do të bëja unë apo nëse kisha ndonjë plan.

Shembuj Mbajtje Shënimesh Pozitive:

Dave është gjithmonë i gatshëm që të më falë shpejt kur bëj ndonjë gabim.

Dave më jep liri të plotë që të jem vetvetja.

Dave kujdeset për veten. Ai nuk është ai lloj personi që bën rrëmujë dhe ta pastrojnë të tjerët më pas.

Dave më thotë çdo ditë se më do dhe shpesh edhe disa herë në ditë.

Dave më bën komplimente në lidhje me veshjen dhe pamjen e jashtme.

Dave më blen çdo gjë që dua dhe që ne mund ta përballojmë.

Dave është gjithmonë i gatshëm të më çojë kudo që dua të shkoj.

Dave është shumë i qëndrueshëm në emocionet e tij. Ai rrallë mund të inatoset.

Dave më mbron shumë. Unë ndihem e sigurt kur jam me të.

Është e lehtë të dallohet se lista pozitive është më e gjatë se ajo negative dhe e imagjinoj se ka për të qenë kështu për shumë njerëz nëse do të gjejnë kohën të ulen dhe t'i shkruajnë gjërat e mira. Duhet të dallojmë dhe festojmë të mirën në botë dhe tek njerëzit,

sepse ne e mposhtim të keqen me të mirën. Duke menduar dhe folur për të mirën tek njerëzit do të na bëjë që të mos i dallojmë fare ato gjëra që dikur na shqetësonin vërtet.

Mos e Trishto Frymën e Shenjtë

Ne realisht mund ta bëjmë Frymën e Shenjtë që të ndihet i trishtuar nëpërmjet zemërimit tonë, inatit, mosfaljes, hidhërimit, zënkave dhe zilisë. Bibla na nxit që të largojmë vullnetin e sëmurë, mërinë dhe poshtërsinë. Mua më trishton të mendoj se mund ta trishtoj Frymën e Shenjtë të Perëndisë. Kur kujtoj se sa shpejt mërzhitesha dikur, e di se e kam trishtuar Atë dhe nuk dua ta bëj këtë gjë sërish. E vetmja mënyrë që të mund ta shmang, është të jem agresive për largimin e ndjenjave të sëmura ndaj të tjerëve, sa herë që ato të dalin. Ne duhet të jemi të dobishëm, ndihmues dhe të mirë me njëri-tjetrin, ta falim njëri-tjetrin menjëherë dhe pa kushte, ashtu si Perëndia na fali ne në Krishtin (shiko Ef. 4:30-32).

Inati ynë e trishton Frymën e Shenjtë jo vetëm se Perëndia dëshiron që të duam njëri-tjetrin, por sepse Ai e di sa sa negativisht kjo ndikon tek ne, dhe Ai dëshiron që të gëzojmë një jetë në liri. Ne duhet të jemi imitues të Perëndisë dhe të ndjekim shembullin e Tij. Ai është i ngadalshëm në zemërim, ka shumë mëshirë dhe është i shpejtë në të falur. Inati ynë nuk promovon drejtësinë që Perëndia na thërret të jetojmë.

Ashtu si dashuria e vërtetë nuk ka asgjë të përbashkët me atë se si ne ndihemi, as falja e vërtetë nuk ka. Të dyja varen nga vendimi që marrim dhe jo nga ndjenja që kemi. Kam mësuar se nëse zgjedh të fal, ndjenjat e mia bëhen një me vendimin. Falja ndaj të tjerëve më mundëson të flas me ta dhe jo t'i largoj ata nga jeta ime. Kjo më jep mundësi që të lutem për ta dhe t'i bekoj në vend që të bëj gjëra negative apo të këqija. Ne i kushtojmë vëmendje të madhe ndjenjave

tona. Duhet të kujtojmë se ndjenjat janë të paqëndrueshme dhe ndryshojnë shumë. Ajo që nuk ndryshon është dashuria.

Krijoni Tolerancë për Njëri-tjetrin

Nëse vërtet e duam njëri-tjetrin, atëherë ne ta durojmë njëri-tjetrin dhe sigurojmë pranim për njëri-tjetrin (shiko Ef. 4:1-2). Të sjellësh tolerancë nuk do të thotë të justifikosh sjelljen e gabuar të njerëzve. Nëse është e gabuar atëherë është gabim dhe injorimi apo anashkalimi i saj nuk zgjidh gjë. Por të sjellësh tolerancë për njëri-tjetrin do të thotë që të lejojmë njëri-tjetrin që të jemi pak më pak se të përsosur. Duhet të përcjellim mesazhe të tilla me fjalët dhe sjelljen tonë, si: "Unë nuk do të të mohoj ty për këtë që bërë; unë nuk do të dorëzohem. Do të eci me ty për ta ndrequr këtë dhe do të besoj në ty."

Unë u kam treguar fëmijëve të mi se edhe pse mund të mos pajtohem gjithmonë me çdo gjë që bëjnë, gjithmonë do të përpiqem t'i kuptoj dhe kurrë nuk do të pushoj së dashuri ata. Dua që ata ta dinë se mund të mbështeten tek unë për të qenë një mbështetëse në jetën e tyre.

Perëndia di gjithçka për gabimet tona dhe sërish na zgjedh ne. Ai i di gabimet që bëjmë përpara se t'i bëjmë dhe logoja e Tij për ne është: "Unë do të të lejoj ty që të jesh jo i përsosur!" Ai premtoi se nuk do të na braktisë apo harrojë kurrë (shiko Heb. 13:5).

Dave më lejon që të jem kjo që jam, edhe pse çdo gjë e imja është më pak se e përsosur. Ai kurrë nuk më bën presion që "O të ndryshoj, o s'ka!" Unë kurrë nuk kam frikë se mos refuzohem nga ai ngaqë nuk jam një grua e përkryer. Ka gjëra në familjen tonë për çdo person dhe marrëdhënie të tjera të ngushta që ne urojmë të ishin ndryshe, por kur e duam vërtet dikë, ia pranojmë të gjitha. Pranojmë të mirën dhe jo të mirën. E vërteta është se thjesht nuk

ka njerëz të përsosur. Nëse presim përsosjen, atëherë gjithmonë do të përgatitemi për zhgënjim dhe madje hidhërim. Toleranca për njëri-tjetrin na e bën jetën shumë më të lehtë dhe ç'është më e rëndësishme ajo tregon bindjen tonë ndaj Perëndisë.

Kur njerëzit të bëjnë diçka të cilën ti nuk e kupton, në vend që të përpiqesh t'i kuptosh, thuaji vetes: "Ata janë qenie njerëzore." Jezusi e njohte natyrën e qenieve njerëzore dhe rrjedhimisht Ai nuk tronditej kur ata bënin gjëra të tilla që Ai nuk dëshironte që ata t'i kishin bërë. Ai sërish e deshi Pjetrin, edhe pse Pjetri e mohoi që e njohte Atë. Ai vazhdoi t'i i donte dishepujt e Tij, edhe pse ata nuk ishin në gjendje të qëndronin zgjuar dhe të luteshin me Atë në momentin e Tij të agonisë dhe vuajtjes. Ajo që njerëzit bëjnë nuk ka për të na ndaluar së dashuri ata, nëse e kuptojmë më parë në kohë se ata nuk do të jenë të përsosur dhe të përgatitemi të tolerojmë atë tendencë njerëzore që kemi të gjithë.

Jo vetëm që nuk duhet të mbajmë shënim ato që të tjerët bëjnë gabim, por nuk duhet gjithashtu të mbajmë shënim as ato që besojmë se i bëjmë mirë. E menduara me të madhe për veten tonë është ajo që na shkakton të jemi të paduruar dhe të pamëshirshëm ndaj njerëzve. Apostulli Mateu tha se kur bëjmë një vepër të mirë, nuk duhet ta lejojmë dorën e djathtë të dijë se çfarë bëri dora jonë e majtë (shiko Mat. 6:3). Për mua kjo do të thotë se nuk duhet të meditoj mbi atë që besoj se ishin vepra të mira ose se sa të mira janë cilësitë e mia. Thjesht kam nevojë të përqëndrohem të tregoj dashuri për çdo njeri që takoj. Ky është fokusi kryesor i Revolucionit të Dashurisë!

Dashuria Mbulon Mëkatet

Apostulli Pjetër tha se mbi gjithçka, duhet të shfaqim dashuri të vazhdueshme dhe të pafund për njëri-tjetrin pasi dashuria mbulon

një shumicë mëkatesh (shiko 1 Pjetri 4:8). Dashuria nuk është se mbulon thjesht një gabim, ajo mbulon një shumicë. Dashuria e Perëndisë për ne jo vetëm që mbuloi mëkatet tona, por realisht pagoi çmimin për t'i larguar ato plotësisht. Dashuria është një pastrues i fuqishëm. Dua të vini re se Pjetri tha që ta bëjmë këtë, pra, të duam, mbi çdo gjë tjetër.

Pali kishte të njëjtin mesazh për Kolosianët, duke i nxitur ata që mbi gjithçka të vishnin dashurinë (shiko Kol. 3:14). Gjithnjë e më shumë shikojmë në Bibël kujtesën e vazhdueshme për të dashur njëri-tjetrin dhe për të mos lejuar asgjë që të na pengojë.

Kur Pjetri e pyeti Jezusin se sa herë duhej që ta falte vëllain e tij për të njëjtin lëndim, Jezusi i tha që të vazhdonte ta falte sa të mundej (shiko Mt. 18:21-22). Pjetri sugjeroi shtatë herë dhe unë shpesh pyes veten nëse ai tashmë ishte tek gjashta dhe kështu atij i mbetej vetëm një përpjekje tjetër. Nëse duam t'i bashkohemi Revolucionit të Dashurisë, duhet të kuptojmë se do të na kërkohet shumë falje. Në fakt, ndoshta ka për të qenë pjesë e përvojës sonë të përditshme. Disa nga gjërat që duhet të falim mund të jenë të vogla dhe mjaft të lehta, por zakonisht ajo e madhja vjen më pas dhe ne fillojmë të mendojmë nëse vërtet mund t'ia dalim. Thjesht mos harroni se Perëndia asnjëherë nuk na thotë që të bëjmë diçka pa na dhënë aftësinë për ta bërë. Ne mund të falim çdo njeri për çdo gjë nëse do të lejojmë atë dashuri të Perëndisë që të rrjedhë nëpërmjet nesh.

Kur mbulojmë gabimet e të tjerëve, bekohemi dhe kur i zbulojmë, mallkohemi. Një aspekt i mbulimit të fajit të dikujt është ta mbash atë në mënyrë private. Mos jini të shpejtë për t'ju treguar të tjerëve atë që dini rreth fajeve të dikujt tjetër. Mbajini sekretet e njerëzve ashtu siç do të donit që edhe ata t'i mbanin tuajat. Në Bibël shohim një moment të regjistruar kur Noeu u deh dhe u shtri lakuriq në çadrën e tij. Një nga bijtë e tij e përhap lakuriqësinë e tij duke u treguar edhe dy vëllezërve të tij dhe ai mori mallkimin mbi jetën e tij që nga ajo ditë dhe në vazhdim. Dy bijtë e tjerë të

cilëve u tregoi ngjarjen, ecën mbrapsht deri tek çadra në mënyrë që të mos shihnin lakuriqësinë e babait të tyre dhe më pas e mbuluan. Bibla na tregon se ata u bekuan (shiko Zan. 9:20-27). Lakuriqësia e Noeut i referohet gabimit të tij në gjykim, fajit të tij, mëkatit të tij. Ashtu siç shihet kaq qartë në këtë histori, duhet të mbulojmë njëri-tjetrin dhe jo të nxjerrim fajet e njëri-tjetrit.

Jezusi na dha udhëzime mbi mënyrën se si të veprojmë kur një vëlla na bën një të keqe (shiko Mt. 18:15-17). Ai tha se gjëja e parë që duhet bërë është të shkoni vetëm tek ai dhe të flisni vetëm me të. Nëse kjo nuk funksionon, merrni dy ose tre të tjerë me vete me shpresën se ai do të vijë në vete dhe do të pendohet. Nëse do të ndjekim këto udhëzime të thjeshta, do të shmangim një numër të madh shqetësimesh. Nuk mund të them se sa herë vijnë tek unë njerëz për të zgjidhur gjërat që duhet t'i trajtojnë privatisht, gjëra që duhet të jenë mes tyre dhe personit që ata mendojnë se u ka bërë keq. Mos kini frikë nga ballafaqimi me dikë nëse vërtet ndieni se duhet. Nganjëherë mënyra më e lehtë për të falur është ta nxjerrësh çështjen jashtë dhe ta diskutosh. Lëndimet e fshehura janë si infeksione të pamjekuara. Ato përkeqësohen në mënyrë të heshtur deri sa infektojnë një pjesë të tërë dhe ne sëmuremi. Duhet ta pastrojmë plagën menjëherë, para se të jetë shumë vonë.

Bibla na tregon historinë e një burri të quajtur Jozef, të cilin vëllezërit e shitën si skllav. Kur vëllezërit e Jozefit zbuluan pas disa vitesh se ai ishte gjallë dhe përgjegjës për furnizimin me ushqim që atyre u duhej me ngulm, ata u frikësuan shumë. Ata kujtuan se sa keq e kishin trajtuar Jozefin, po kështu edhe ai, por ai zgjodhi që të mos ia tregonte askujt. Ai foli me ta më vete dhe thjesht u tha se ai nuk ishte Perëndia dhe hakmarrja i takonte Perëndisë dhe jo atij. Ai i fali ata, u tha të mos kishin frikë dhe vazhdoi që të siguronte për ta dhe për familjet e tyre. Pa dyshim që Jozefi ishte një udhëheqës i fuqishëm i cili gëzonte respekt kudo që shkonte. Ai e dinte fuqinë e dashurisë dhe rëndësinë e faljes totale!

Fshijini të Gjitha Shënimet

Përse nuk nxirrni jashtë të gjitha listat e së kaluarës që keni mbajtur për çdo njeri dhe t'i shënoni: "U pagua plotësisht"? "Lum njeriu të cilit Zoti nuk do t'ia llogarisë mëkatin" (Rom. 4:8). Kjo nuk do të thotë se Perëndia nuk e shikon mëkatin. Kjo do të thotë se për shkak të dashurisë, Ai nuk ia llogarit këtë mëkatarit. Dashuria mund të dallojë se është bërë një faj dhe e fshin atë para se të lëshojë rrënjë në zemër. Dashuria nuk e regjistron apo mban shënim gabimin; në këtë mënyrë mëria nuk ka mundësi që të rritet.

Disa prej nesh shqetësohen për kujtesën tonë, por në të vërtetë ndoshta do të na bëjë mirë sikur të harrojmë disa gjëra. Mendoj se shpesh harrojmë atë që duhet të kujtojmë dhe kujtojmë atë që duhet të harrojmë. Ndoshta një nga gjërat më të perëndishme që mund të bëjmë ndonjëherë në jetë është të falim dhe harrojmë. Disa njerëz thonë: "Unë do ta fal atë, por nuk kam për t'ia harruar." E vërteta e këtij qëndrimi është se, nëse kapemi fort pas kujtesës, nuk po falim në të vërtetë. Ju mund të pyesni: "Si mund të harrojmë gjërat që na kanë lënduar?". Përgjigja është se duhet të *zgjedhim* të mos mendojmë për to. Kur këto gjëra vijnë në mendje, duhet të largojmë mendimet dhe të zgjedhim të mendojmë rreth atyre gjërave që do jenë në të mirën tonë.

Fshirja e të gjitha shënimeve do të sjellë rezultate të mira. Do të çlirojë presionin dhe do të përmirësojë cilësinë e jetës suaj. Intimiteti mes jush dhe Perëndisë do të rregullohet dhe gëzimi e paqja do të rriten. Edhe shëndeti mund t'ju përmirësohet sepse një mendje dhe zemër e qetë dhe e pashqetësuar janë jeta dhe shëndeti i trupit (shiko Fjalët e Urta 14:30). Mëria ngre mure. Dashuria ngre ura!



KAPITULLI

14

Mënyra Praktike për të Treguar Dashurinë

Prediko ungjillin gjatë gjithë kohës dhe
kur të jetë e nevojshme përdor edhe fjalët.

Shën Francis i Asisit

Ky libër do të ishte i padobishëm nëse nuk do të ofroja mënyra praktike me qëllim që të fillonit menjëherë të tregonit dashuri. Ashtu siç e kam thënë edhe më parë, dashuria nuk është një teori apo bisedë e thjeshtë - ajo është veprim. Si Revolucionarë të Dashurisë, ne në mënyrë të vazhdueshme duhet të kërkojmë mënyra më të mira dhe të reja për të sjellë dashuri në këtë botë.

Më lejoni t'ju kujtoj se pavarësisht se çfarë kemi ose bëjmë, nëse nuk kemi dashuri, atëherë nuk kemi asgjë dhe nuk jemi gjë (shih 1 Kor. 13:1-3). Kjo është detyruese për të ardhmen e shoqërisë që ne të fillojmë të tregojmë dashuri në mënyrë agresive. Njerëzit sot janë të dëshpëruar të dinë nëse Perëndia ekziston ose jo, cili është qëllimi i tyre në këtë botë dhe përse bota është kaq e mbushur me ligësi, nëse Perëndia ekziston vërtet. Besoj se nëse do të mund të shikojnë dashurinë në veprim, atëherë kjo do t'u japë përgjigje pyetjeve të

tyre. Perëndia është dashuri dhe Ai ekziston dhe një mënyrë kryesore se si Ai e zbulon veten e Tij është nëpërmjet njerëzve të Tij.

Pavarësisht se çfarë kemi ose bëjmë, nëse nuk kemi dashuri, atëherë nuk kemi asgjë dhe nuk jemi gjë

Bota ka nevojë të shohë cilësitë e dashurisë së jetuar. Ata kanë nevojë të shohin durim, mirësi, jo egoizëm dhe gadishmëri për të falur. Ata kanë nevojë të shohin njerëzit të sakrifikojnë për të ndihmuar të tjerët që janë më pak me fat. Të prekesh nga dashuria është si të strukesh para zjarrit, mbështjellë me një batanije të ngrohtë dhe të butë. Është një ndjenjë që nuk ka të krahasuar. Dhe ne kemi fuqinë që këtë dhuratë t'ua japim të tjerëve!

Jini të Duruar

Cilësia e parë e dashurisë, radhitur në mësimin e Palit tek 1 Korintasve 13, në Bibël, është durimi. Pali shkruan se dashuria i duron të gjitha dhe është e durueshme. Dashuria është vuajtje e gjatë. Ajo mbetet e njëjtë dhe konstante kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç do të dëshironit të shkonin.

Unë jam praktikuar për të qenë e duruar me nëpunësit të cilët janë të ngadaltë, që nuk i gjejnë çmimet e artikujve, që u mbaron kaseta e regjistrimit ose që sorrollaten në telefon për të qetësuar ndonjë klient të irrituar ndërsa unë qëndroj para tij në pritje për të më ndihmuar. Kam pasur disa raste kur shitës të tillë realisht më kanë falenderuar që isha e duruar. Jam e sigurt se ata durojnë shumë abuzim nga klientët e zhgënjyer, të paduruar dhe jo të dashur dhe unë kam vendosur se nuk dua t'i shtoj këtij problemi; dua që të jem pjesë e përgjigjes. Sigurisht, të gjithë jemi në nxitim dhe duam

të mbarojmë punë shpejt, por duke qenë se dashuria nuk kërkon të vetën, duhet të mësojmë se si ndihet nëpunësi, para se si ndihemi ne. Kohët e fundit, një shitëse më kërkoi ndjesë që po punonte aq ngadalë dhe unë i thashë se nuk po bëja ndonjë gjë tjetër të rëndësishme që të mos prisja. E pashë që u qetësua dhe e kuptova se sapo i kisha treguar asaj dashuri.

Ne inkurajohemi në Bibël që të jemi shumë të duruar me gjithsecilin, gjithmonë duke kontrolluar nervat (shiko 1 The. 5:14). Kjo nuk është e mirë vetëm për dëshminë tonë para njerëzve të tjerë, por është gjithashtu mirë edhe për ne. Sa më të duruar të jemi, aq më pak stres do të kemi! Pjetri na tha se Zoti është jashtëzakonisht i duruar me ne sepse është dëshira e Tij që asnjë prej nesh të mos humbasë (shih 2 Pjetri 3:9). Kjo është e njëjta arsye pse duhet të jemi të duruar me njëri-tjetrin dhe veçanërisht me ata në botë që po kërkojnë Perëndinë.

Pali i tha Timoteut që shërbëtorët e Zotit duhet të jenë mësues të aftë dhe të përshtatshëm, të qetë, të gatshëm për të vuajtur, të mirë dhe të duruar me gjithsecilin (shiko 2 Tim. 2:24). Ne u japim mësim njerëzve çdo ditë me anë të veprave tona. Mësimi nuk realizohet vetëm me fjalë - veprimi është shpesh edhe më i efektshëm. Të gjithë kemi ndikim dhe duhet të jemi të sigurt se si e përdorim atë. Nuk më sjell ndonjë të mirë mua ose emrit të Krishtit, nëse var në qafë diamantin e rremë me Jezusin dhe pastaj tregohem e paduruar dhe jo e dashur me shitësin. Për të qenë e sigurtë, kam parë shumë të kësaj kategorie këto njëzet vitet e fundit, aq sa më ngjallin neveri.

Nuk duhet të mbajmë varur simbolet tona të besimit të krishterë nëse nuk jemi të përgatitur të jetojmë sipas tyre. Prova që tregon marrëdhënien time me Perëndinë nuk është një slogan i ngjitur në makinë apo bizhuteritë e krishtera, ose regjistri i vajtjes sime në kishë. Nuk është as se sa vargje kam mësuar përmendësh apo se sa e madhe është biblioteka ime personale e krishterë me libra, DVD

dhe CD. Prova e krishtërimit tim shihet në frytet e Dashurisë Revolucionare.

Ju nxis që të luteni rregullisht dhe do të jeni në gjendje që t'i qëndroni me moral të lartë çfarëdo që të vijë. Më besoni, gjërat që kanë aftësinë t'ju mërzhisin do të vijnë, por nëse do të jeni të përgatitur më parë, atëherë do të jeni në gjendje që të qëndroni të qetë ndërsa i përballoni këto gjëra. Shfaqja e qëndrueshmërisë në ndjenjat dhe temperamentin tonë është shumë e rëndësishme. Shumë njerëz në botë janë shpërthyes, kur gjërat nuk u shkojnë siç duan ata. Singerisht besoj se një nga mënyrat që ne mund të sjellim ndikim është të jemi të duruar, kur gjërat shkojnë keq.

Para pak javësh, predikova mbi durimin dhe falenderimin pavarësisht rrethanave. Kisha dhënë tre konferenca kryesore shtesë në gjashtë javë, vetëm që të përmbushja disa përkushtime të tjera dhe ai sesioni i mëngjesit të së shtunës, ishte i vetmi i atij zinxhiri përkushtimesh. Në të vërtetë, mezi po prisja që të shkoja në shtëpi herët atë ditë, të haja ndonjë gjë të mirë, të dilja me Dave-in për të bërë pazar, të bëja një dush të nxehtë në shtëpi, të haja akullore dhe të shihja ndonjë film të mirë. E shikon që po përgatisja veten që ta shpërbleja për punën time të lodhshme! Kisha një plan të mirë për veten time!

Hipëm në avion për t'u kthyer në shtëpi dhe fluturimi ishte llogaritur që të ishte vetëm tridhjetë e pesë minuta. Mezi po prisja ... dhe pastaj diçka shkoi keq. Dera e avionit nuk po mbyllej plotësisht, kështu që pritëm për rreth një orë e gjysmë, ndërsa po rregullonin derën. Dëgjoja zëra që thoshin se mbase edhe mund të mos ketë fluturim atë ditë dhe ndoshta do siguronin makina me qera dhe do shkonim me makina në shtëpi. Nuk mund t'jua përshkruaj se sa e vështirë ishte për mua që të isha e duruar. Thjesht të mbyllja gojë ishte një arritje e madhe për mua. Kisha predikuar për durimin, por kisha harruar të lutesha që nëse do të vihesha në provë, ta kaloja provën për mrekulli.

A keni pasur ndonjëherë ndonjë rast kur keni dëgjuar një predikim të madh që me të vërtetë ju nevojitej dhe pastaj ta shihnit veten në provë menjëherë në jetë? Mirë atëherë, provojeni të predikoni dhe atëherë do ta shihni se sa shpejt do viheni në provë! E kuptoj se jo gjithmonë mund të jemi të duruar, por mund ta dispiplinojmë veten për të qenë të duruar. Unë nuk mund të bëj gjë për mënyrën se si ndihem ndonjë herë, por mund ta kontrolloj se si sillem dhe po kështu edhe ju. Mund t'ju siguroj se nuk kisha durim, ndërsa prisja në avion, por vazhdoja të lutesha, *Oh Perëndi, më ndihmo që të jem e qetë që të mos bëhem dëshmitare e mjerë e asaj që sapo përfundova së predikuari*. Perëndia më ndihmon dhe kur gjërat nuk shkojnë gjithmonë ashtu si unë i dua. Në këtë rast ne arritëm në shtëpi duke pasur kohë të mjaftueshme që të bëja të gjitha gjërat që kisha planifikuar.

Kur ta gjeni veten në situata të vështira, bëni një përpjekje për të ruajtur paqen dhe do të shihni se Perëndia do të punojë në emrin tuaj. Kur Izraelitët ishin në mes të Detit të Kuq dhe ushtrisë së Egjiptit, Moisiu tha: "Zoti do të luftojë për ju dhe ju do të rrini të qetë" (Eksodi 14:14).

Kaloni Kohë

Koha është komoditeti më i vlefshëm që shumë prej nesh kemi. Kur u kërkojmë njerëzve që të na japin nga koha e tyre, duhet të kuptojmë se po u kërkojmë një dhuratë të vlefshme dhe duhet ta vlerësojmë shumë kur e marrim. Njerëzit shpesh më kërkojnë kohën time dhe fatkeqësisht unë nuk mund t'ua jap atë të gjithëve. Nëse do të përpiqesha, jo vetëm që do të thahesha, por nuk do të kisha kohë të përfundoja atë që Perëndia më ka dhënë të bëj gjatë jetës sime në Tokë.

Nuk mund t'i them "po" çdo njeriu, por as që duhet t'i themi

"jo". Ju rekomandoj që të jepni pak nga koha juaj sepse është një mënyrë për të treguar dashuri. Kohët e fundit fola në një kishë në Tenesi, si një nder për një mikeshën time dhe, ndërsa qëndroja aty, ndjeva që Zoti po më shtynte t'ua ktheja ofertën që ata mblodhën për mua atë natë për të ndihmuar të varfërit në qytetin e tyre. E kuptova menjëherë se Perëndia dëshironte që të jepja kohën time dhe paratë e mia falas. Ai dëshironte që të mos merrja asgjë prej tyre përveç gëzimit të të dhënit, që ishte më shumë se mjaftueshëm. Shikoj që Perëndia më provon mua në këtë mënyrë disa herë çdo vit dhe jam e kënaqur për këtë sepse nuk dua kurrësi që të më bëhet zakon se duhet të marr diçka nga çdo gjë që bëj për të tjerët.

E pranoj se është më e vështirë për mua që të jap kohën time, sesa paratë, apo ndonjë gjë tjetër që kam. Në këtë pikë, kam jetuar dy të tretat e jetës sime dhe e kuptoj se ajo që më ka mbetur, duhet të jetë e përqendruar dhe me qëllim. Nisur nga domosdoshmëria, unë e ndiej më të nevojshme të them "jo" më shpesh, por përsëri them "po" kur mundem, pasi e di se koha ime është një dhuratë e vlefshme dashurie.

Kur dikush të ndihmon të lëvizësh, të ka dhënë dhuratën më të vlefshme të kohës. Kur fiton vëmendjen e dikujt, ata të nderojnë dhe tregojnë dashuri. Sa herë që pyesim: "A mund të bësh diçka për mua?" ne po kërkojmë gjënë më të vlefshme që një person ka sepse po u kërkojmë një pjesë nga koha e tyre.

Mendoni për kohën tuaj. Sigurohuni që të jepni sa më shumë me qëllim që të zhvillonin një marrëdhënie intime me Perëndinë dhe sigurohuni që një pjesë të saj t'ua jepni njerëzve të Tij si demonstrim të dashurisë së Tij. Tommy Barnett, pastori kryesor i Asamblesë së Parë të Perëndisë në Feniks, një prej kishave që po rriten më shpejt në Amerikë, tha: "Jeta është diçka që ne po e humbasim në mënyrë konstante." Kjo është arsyeja që ne duhet të marrim çdo gjë që bëjmë me seriozitet. Kur njerëzit thonë se nuk kanë asgjë për të dhënë, ata harrojnë se, për sa kohë jemi gjallë, kemi diçka për të

dhënë: kohën tonë.

Duke qenë se koha është një komoditet kaq i vlefshëm, duhet ta japim atë me qëllim dhe në mënyrë të zgjuar. Mos i lejoni njerëzit që t'ju vjedhin kohën, mos e kaloni kohën kot dhe kurrë mos thoni: "Po përpiqem të shtyj pak kohën." Shihni cilat janë prioritetet e tua dhe përkushtojani kohën atyre gjërave. Perëndia dhe familja duhet të jenë në krye të listës suaj. Gjithashtu ju keni nevojë për kohë që të kujdeseni për veten tuaj. Keni nevojë të punoni, të pushoni dhe të luani me qëllim që të jeni njeri i ekuilibruar. Gjithashtu duhet të kaloni kohë duke ndihmuar të tjerët që kanë nevojë për ju.

Nëse mendoni se nuk keni kohë për të bërë çdo gjë, por vazhdoni t'u jepni të tjerëve, ju inkurajoj të bëni atë që Perëndia i tha Tommy Barnettit të bënte. Ai i tha atij që të përdorte më zgjuarsitë tridhjetë minutëshat e tij. I tregoi se kishte disa gjysmë-orësha të lirë. Pastor Barnett thotë se, nëse do t'i tregosh atij se çfarë bën me gjysmë-orëshat e tu, ai mund të të tregojë se si është e gjithë jeta jote. Çfarë bën gjatë tridhjetë-minutëshit që nga puna në shtëpi çdo ditë? Çfarë bën me tridhjetë-minutëshin kur pret në zyrën e doktorit? Po për tridhjetë-minutëshin kur pret që të të vijë ushqimi që porosite në një restorant? A të mbetet kohë në këto gjysma ore që të tregosh dashuri për dikë? A mund t'i përdorësh ato minuta për të inkurajuar dikë me telefon ose letër? A mund të lutesh për ndonjë? A mund të lutesh se çfarë mund të bësh për dikë? Përdore kohën për të menduar në mënyrë krijuese për atë që duhet të japësh.

Ti mund të shkruash një libër në ato gjysma ore. Mund të fitosh një shpirt. Mund të marrësh një vendim të rëndësishëm në një gjysmë ore. Një gjysmë ore mund të bëjë dallimin mes një shtëpie të pastër dhe një të qelbur. Gjysma-orët e tua janë të rëndësishme dhe ndoshta ti ke shumë të tilla, nëse fillon t'i dallosh. A mos po them se ti duhet të bësh diçka çdo sekondë të jetës sate? Jo, nuk

po them këtë. Në fakt, ti ndoshta mund të vendosësh që një gjysmë ore ta kalosh duke pushuar dhe nëse e bën këtë, nuk ka asgjë të keqe, por të paktën e ke përdorur atë me qëllim dhe nuk e ke kaluar kot duke mos bërë gjë.

Mos harro se çdo ditë që kalon nuk kthehet kurrë mbrapsht. Investo, mos harxho.

Duaj me Mendimet, Fjalët dhe Pasurinë e Tënde

Fuqia e mendimeve: Një grua ndau me mua këtë histori për të treguar fuqinë e mendimeve:

Gjatë Krishtlindjes ngjita lart në dhomën e gjumit një lule fikus që të liroja vendin për pemën e Krishtlindjes. Aty ishte një degë e vogël me disa gjethe poshtë degëve të tjera. Ajo nuk dukej mirë dhe po prishte gjithë formën e fikusit.

Sa herë që zgjohesha në mëngjes e shihja fikusin në dritare dhe mendoja: "*Do ta pres atë degë.*" Sa herë që i kaloja pranë fikusit mendoja: "*Ajo degë nuk duket në rregull, do ta heq ndonjë ditë.*"

Koha kaloi. Fikusin e zbrita sërish në dhomën e ndenjjes. Unë vazhdoja të kisha një mendim negativ sa herë që më vinin sytë atje. E gjithë kjo zgjati rreth një muaj e gjysmë.

Një mëngjes kalova pranë tij dhe pashë që çdo gjethe e asaj dege të vogël ishte zverdhur. Në gjithë fikusin nuk mund të gjeje asnjë gjethe të zverdhur. M'u ngjeth trupi dhe i tregova bashkëshortit. Ai më pa dhe tha: "Sigurisht që jam i kënaqur që ke menduar gjëra të mira për mua."

Atë degë e preva që atë ditë!

Gjithmonë kam pasur një marrëdhënie të vështirë me vjehrrën time. Sigurisht që asnjëherë nuk mendoja se unë kisha

ndonjë faj - unë, kaq e ëmbël dhe e mirë! Vendosa që ky do ishte një eksperiment me vlerë. Sa herë që mendoja për vjehrrën time, vendosa që ta bekoja, pra të mos mendoja siç mendoja më parë, por vetëm ta bekoja!

Ajo rrallë më telefonon ose është e interesuar që të flasë me mua. Por brenda pesë ditësh, ajo më telefoni tre herë! Po prit pak! Të gjitha ishin biseda miqësore! Vetëm vitin e kaluar as gjashtë herë nuk më kishte telefonuar!

Gruaja që përmenda më sipër porositi seritë e mia të mësimi mbi fuqinë e mendimeve dhe tha: "Tani kam kujdes se çfarë mendoj për njerëzit."

Ne mendojmë mendime të panumërta rreth njerëzve të tjerë, por duhet ta bëjmë këtë me më shumë përgjegjësi. Unë besoj se mendimet funksionojnë në botën shpirtërore dhe megjithëse ato nuk mund të shihen me sy, unë besoj se mendimet tona ndjehen nga njerëzit e tjerë. Ashtu si fikusi që po ndikohej negativisht nga mendimet negative të gruas, ashtu edhe njerëzit besoj se ndikohen nga mendimet tona.

Ajo që mendojmë rreth njerëzve, jo vetëm që ndikon në ta, por gjithashtu ndikon edhe në mënyrën se si i trajtojmë kur jemi rreth tyre. Nëse mendoj me vete se sa shumë nuk më pëlqejnë disa persona dhe në mendjen time kaloj të gjitha gabimet që kanë bërë, atëherë kur t'i shikoj, do t'i trajtoj sipas imazhit që kam formuar në mendjen time.

Një ditë po bëja pazar me vajzën time e cila në atë kohë ishte adoleshente. Ajo kishte shumë puçrra në fytyrë atë ditë dhe flokët i kishte të shpupuritura. Më kujtohet se sa herë e shikoja mendoja me vete: "*Sigurisht që nuk dukesh shumë bukur sot*". Ndërsa dita po kalonte vura re se ajo dukej e depresuar, kështu që e pyeta se çfarë kishte. Ajo u përgjigj: "*Thjesht më duket se dukem shumë e shpifur sot*." Perëndia atë ditë më mësoi një mësim rreth fuqisë së

mendimeve. Ne mund të ndihmojmë njerëzit me mendimet e mira, të dashura dhe pozitive, po nga ana tjetër, mund edhe t'i lëndojmë ata me mendimet e liga, jo të dashura dhe negative.

Ju inkurajoj që të merrni një person në ditë si një projekt lutjeje dhe të praktikoni të menduarit me qëllim të mendimeve të mira për ta. Gjatë ditës bëni disa ushtrime mendimesh ku të meditoni mbi fuqitë e këtij personi, çdo cilësi të mirë që mund t'ju vijë në mendje, çdo nder që ju kanë bërë dhe çdo gjë komplimentuese që mund të mendoni rreth pamjes së tyre të jashtme. Ditën tjetër praktikojeni me një person tjetër dhe vazhdoni të mbani në rotacion njerëzit e rëndësishëm në jetën tuaj derisa të keni krijuar një zakon të të menduarit të gjërave të mira.

Duaji njerëzit, me anë të mendimeve tuaja dhe ndërsa vepron kështu, do t'i ndërtoni ata dhe do t'u jepni forcë jetëve të tyre.

Fuqia e Fjalëve Kemi diskutuar se si të mund të përdorim fjalët për të ndërtuar të tjerët dhe për t'i inkurajuar dhe ngritur shpirtërisht, por dua që këtë çështje ta kthejmë në mënyrën për të dashur njerëzit. Të gjithë kemi aftësinë të përdorim fjalët për të treguar dashuri ndaj të tjerëve. Dje takova një agent shitjesh të pasurive të paluajtshme që kishte sy të bukur blu, kështu që i thashë asaj se kishte sy shumë të bukur. Mund t'ju them se kjo e bëri që të ndihej mirë për veten e saj. Dhe kjo kërkoi vetëm një moment të vogël kohe dhe pak përpjekje. Pashë një agjente tjetër e cila nuk ishte aq tërheqëse dhe i thashë se ishte shumë e bukur dhe ajo gjithashtu m'u përgjigj në mënyrë shumë të sjellshme dhe të mirë. Unë përdora fjalët e mia për të ndërtuar dy njerëz dhe e gjitha ndodhi përgjatë një aktiviteti të rregullt pune. Si Revolucionarë Dashurie ne duhet të përdorim fuqinë e fjalëve përgjatë çdo dite për të dashur dhe inkurajuar ata që janë përreth nesh.

Bashkëshorti im u kthye dje nga loja e golfit dhe brenda pesë minutash ai më kishte thënë se më donte dhe se dukeshat bukur

dhe se sa shumë që kisha punuar. Kisha rreth shtatë orë që kisha punuar mbi këtë libër dhe po bëhesha gati për një pushim, kështu që fjalët e tij të ëmbla më bënë që të ndihesha e dashuruar dhe e vlefshme. Natën e kaluar dolëm për darkë me djalin tonë, gruan e tij dhe foshnjën e tyre. Unë i thashë Nikolës se ajo ishte një bashkëshorte dhe nënë e mirë. Pikërisht pak para kësaj pashë që djali im i pëshpëriti në vesh se e donte. Këto janë ato lloj gjërash që duhet t'i themi njëri-tjetrit gjatë gjithë ditës, si një mënyrë për të shprehur dashurinë dhe frymëzuar sigurinë.

Fuqia e jetës dhe vdekjes është tek gjuha. Ky është një mendim i mahnitshëm. Ne kemi autoritetin t'u flasim të tjerëve dhe vetes sonë jetën ose vdekjen. Ajo që u themi të tjerëve, ka ndikim edhe në jetët tona. Bibla thotë: "Vdekja dhe jeta janë nën pushtetin e gjuhës; ata që e duan do të hanë frytet e saj" (Fjalët e Urta 18:21).

Fjalët janë mbajtësit e fuqisë dhe ato mund të mbajnë fuqi krijuese ose shkatërruese, si ta zgjedhim ne. Zgjidhni me kujdes fjalët tuaj dhe flisni me kujdes. Ato mbajnë mesazhe që mund ta vendosin jetën në alarm. Me fjalët tona ne ndërtojmë ose shkatërrojmë imazhin e një personi para nesh. Ne mund të rrënojmë reputacionin e dikujt me anë të fjalëve, kështu që kini kujdes se çfarë thoni për njerëzit e tjerë. Mos helmoni qëndrimin që një person ka për tjetrin.

Le të imagjinojmë se fjalët tuaja mbahen në një magazinë dhe çdo mëngjes ju shkonin atje dhe kontrolloni raftet duke përzgjedhur fjalët që do të merrni me vete atë ditë ndërsa dilni në botën që ju rrethon. Ndoshta tashmë je i dini se cilët do të jenë disa nga njerëzit që do të takoni kështu që ju mund të përzgjidhni më parë fjalët të cilat do t'i bëjnë ata të ndihen të dashur dhe do t'u japin siguri. Merrini fjalët me vete për secilin që do të jeni gjatë ditës dhe përgatituni në zemër për të qenë bekim për çdonjërin prej tyre, duke i dashur ata me ato që thoni.

Unë dua që çdo ditë të shikoj se sa njerëz mund të ngre lart me

fjalët e mia. Sigurisht që kam harxhuar shumë fjalë në jetën time duke folur në erë, duke bërë gjëra të padobishme që, ose nuk sollën gjë, ose që i bënë njerëzit të ndihen keq. Mua më vjen keq për ato fjalë të harxhuara kot dhe tani përdor fjalët e mia për të zhbërë atë që kam bërë në të kaluarën.

Gjuha është një organ shumë i vogël, por mund të nisë zjarre shkatërruese, nëse nuk do të tregohemi të kujdesshëm. Mbreti David lutej rregullisht për fjalët e gjuhës së tij. Ai tha: "Do të kujdesem për sjelljen time që të mos kryej mëkate me gjuhën time" (Ps. 39:1). Ai u lut që fjalët e gojës së tij dhe meditimi i zemrës së tij të ishin të pranueshme dhe të pëlqyeshme për Perëndinë (shih Ps. 19:14). Ai e dinte mirë fuqinë e gjuhës dhe kuptoi se kishte nevojë për ndihmën e Perëndisë për të qëndruar në shinat e duhura. Ne duhet të ndjekim shembullin e Davidit për këtë gjë.

Fuqia e Pasurisë Ne të gjithë kemi pasuri. Disa kanë më shumë se të tjerët, por të gjithë kemi diçka që mund ta përdorim si një bekim të dukshëm për të tjerët. Mendimet dhe fjalët janë të dyja të mrekullueshme dhe ato na ndihmojnë të tregojmë dashuri, por edhe pasuria dhe të mirat materiale bëjnë të njëjtën gjë dhe për disa njerëz kjo është shumë e rëndësishme.

Bibla thotë se nëse kemi dy xhaketa, duhet që njëren t'ia japim atij që nuk ka dhe i njëjti parim vlen edhe për ushqimin tonë (shih Luka 3:11). Kisha e hershme e krishterë, që e shikojmë në librin e Veprave, ishte një kishë shumë e fuqishme, e cila shtoej çdo ditë. Të gjitha llojet e shenjave të mbinatyrshme dhe çuditë dhe mrekullitë ishin normale në mes tyre. Fuqia e Perëndisë ishte me ta dhe ata tregonin dashuri për njëri-tjetrin me gjithë zemrën, mendjen, forcën dhe pasuritë e tyre.

"Dhe numri i madh i atyre që besuan ishte me një zemër të vetme dhe me një shpirt të vetëm; asnjëri nuk thoshte

se ç'kishte [në mënyrë ekskluzive] ishte e vetja, por të gjitha gjërat i kishin të përbashkëta."

Veprat 4:32

A jemi pronarë apo mbikqyrës? Çdo gjë që kemi vjen nga Perëndia dhe në të vërtetë gjithçka i takon Atij. Ne jemi thjesht mbikqyrës të pasurisë së Tij. Shumë shpesh kapemi shumë fort pas gjërave. Ne nuk duhet t'i shtrëngojmë ato fort, në mënyrë që, nëse Perëndia do t'i dojë ato, të mos e kemi të vështirë që t'i lëshojmë. Le të mos reshtim së kujtuari veten se pasuritë nuk kanë ndonjë vlerë të përjetshme. Ajo që mbetet është ajo që ne bëjmë për të tjerët. Pali u tha korintasve se dhuratat e tyre për të varfrit do të mbeten dhe jetojnë përgjithmonë në përjetësi (shiko 2 Kor. 9:9).

Perëndia dëshiron që ne të gëzojmë pasuritë tona, por Ai nuk do që këto prona të na bëjnë pronë të tyre. Ndoshta një pyetje me vend për t'ia drejtuar rregullisht vetes do të ishte: "A i kontrolloj unë pasuritë apo mos pasuritë më kontrollojnë mua?" A jeni në gjendje që të përdorni atë që ju keni për të bekuar njerëzit, apo ju duket e vështirë që t'i lëshoni gjërat... madje edhe ato gjëra që nuk i përdorni?

Mua shpesh më bëjnë dhurata parfume dhe duke qenë se së fundmi kisha ditëlindjen, në raftin tim kisha shumë parfume. Një ditë ndjeva një nxitje për të bekuar një mikeshën time e cila më kishte bërë një nder dhe u kujtova se asaj i pëlqente shumë një prej parfumeve të mi të veçantë që unë përdorja. Sigurisht që unë kisha një locion të ri për trupin dhe sigurisht që ishte më i shtrenjtë në raftin tim. M'u desh që të bëja një bisedë të shkurtër me veten, por pas pak minutash isha në gjendje që ta hiqja nga rafti, ta fusja në një kuti për dhurata dhe pastaj në duart e saj. Kjo e gëzoi atë pa masë dhe gjithçka që më kushtoi ishte një objekt që unë zotëroja, i cili mund të zëvendësohej.

Unë ju lutem të filloni të përdorni pasuritë tuaja për të treguar

dashuri për njerëzit në mënyra të prekshme. Dhuratat janë një mënyrë e mrekullueshme për të treguar dashuri. Për shembull, njëherë një mikesha ime më tha se dhuratën për ditëlindjen time nuk e kishte ende gati, pasi nuk ishte përgatitur. Kur e mora më në fund, u çudita kur pashë një pikturë ku ishte pikturuar qeni im, një pikturë që mund ta shikoj dhe kënaqem për shumë vite. Unë jam e bekuar me atë pikturë, por edhe më e bekuar nga përpjekjet që ajo bëri për ta përfunduar për mua.

Të gjitha dhuratat janë të mira, por sa më shpejt që të mundeni, bëni një përpjekje të veçantë për të çuar diçka në duart e dikujt që ju e dini se ata e dëshirojnë fort. Thjesht fakti që ju keni dëgjuar aq sa të kuptoni se ata pëlqejnë dhe duan atë gjë të caktuar, do t'i bekojë ata pa masë. Një mikesha ime kishte një qen shumë të veçantë që ngordhi, ndërsa ishte akoma këlysh. Ajo ishte shumë e mërëzitur dhe nuk kishte parë që të blinte një qen tjetër, kështu që unë mundesha t'i blija një të tillë dhe ia bëra surprizë. Nëse ne i kërkojmë Atij, Perëndia do të na mundësojë të sigurojmë për njerëzit si një mënyrë për t'u treguar atyre dashuri. Ai gjithmonë na siguron me shumicë që të mbajmë dhe të gëzojmë dhe shumë për të dhënë, vetëm nëse nuk kapemi fort pas tyre dhe kërkojmë mundësira për të dhuruar.

Nganjëherë unë vazhdoj e flas për atë që e quaj një papërmbajtje në të dhënë. Unë kam dëshirë që të jem bekim dhe dua të përdor pasuritë e mia si një mënyrë e efektshme për të treguar dashuri, kështu që i hedh një sy shtëpisë sime, sirtarëve, dollapëve dhe bizhuterive për të gjetur gjëra që mund t'i jap. Asnjëherë nuk dal duarbosh. Më habit fakti se si tundohej t'i mbaj ato gjëra, edhe pse ndonjë prej tyre mund të mos e kem përdorur për dy ose tre vjet. Thjesht na pëlqen që të mbajmë gjëra! Po sa më mirë do të ishte sikur pasuritë tona t'i përdorim për të bekuar dikë dhe për t'i bërë të ndihen të dashur dhe të vlefshëm.

Nëse keni vështirësi për të dalluar se çfarë duhet të jepni,

kërkojini Perëndisë t'ju ndihmojë dhe shpejt do të gjeni se keni një pasuri me gjëra që mund t'i përdorni për të treguar dashuri ndaj njerëzve të lënduar. Ndërsa përdorim atë që kemi për qëllim të mirë, dashuria gjithmonë do të rritet dhe gjërat e tjera na shtohen, ndërsa e tregojmë veten tonë se jemi administratorë të mirë të pasurive të Perëndisë.

[Mos harro] këtë: Ai që mbjell me kursim,
do të korrë po me kursim; dhe ai që mbjell me
bujari edhe do të korrë me bujari.
Secili le të japë si ka menduar në zemër, as me keqardhje,
as me detyrim, sepse Perëndia do (Ai kënaqet, vlerëson
mbi çdo gjë dhe nuk është i gatshëm të braktisë apo të
bëjë pa) një dhurues të gëzuar (të lumtur, "i gatshëm" të
japë [ku zemra është në dhurimin e tij]).

2 Korintasve 9:6-7

Kur të jeni në shtratin e vdekjes, nuk keni për të pyetur për gjendjen në llogarinë e bankës apo për një inventar të pasurive tuaja. Ju do të dëshironit të rrethoheshit nga familjarë dhe miq që ju duan. Filloni të ndërtoni tani këto marrëdhënie duke përdorur të gjitha burimet tuaja për të treguar dashuri për njerëzit.

REVOLUCIONAR DASHURIE

Pastor Tommy Barnett

Revolucion, emër **1**: veprim i një trupi qiellor që rrotullohet në një orbitë, **2**: cikël, **3**: rotacion, **4**: një ndryshim i papritur, rrënjësor dhe tërësor; veçanërisht rrëzimi i një qeverie dhe zëvendësimi me një tjetër nga tubuesit.

Çdo përkufizim fjalori mbi revolucionin është i zbatueshëm për ftesën tuaj personale që të mund të bëhesh pjesë e Revolucionit të Dashurisë që Perëndia po përhap nëpër gjithë botën

Në fakt, fjalori e përkufizon një revolucionar si dikë që angazhohet në një revolucion, ose një përkrahës ose mbrojtës të doktrinave revolucionare. Revolucioni i Dashurisë është në të vërtetë një doktrinë revolucionare, sepse bota e shikon dashurinë si diçka që duhet ta marrë dhe ta ketë, ndërsa Jezusi po përpiqet të revolucionarizojë të menduarit tonë dhe veprimet tona për të përkufizuar dashurinë si diçka që rrjedh nëpërmjet nesh dhe që ne duhet ta japim.

Kështu, ti je i ftuar që të marrësh pjesë në një rreth unik të dashurisë! Një rreth që vetëm zgjerohet nga qendra dhe perimetri rrethon një synim: të duam dhe inkurajojmë njerëzit të ndjekin Jezu Krishtin, ndërsa kërkojmë të mirëpresim botën në familjen e Perëndisë.

Rrethi ynë radikal i dashurisë dhe inkurajimi përfshin të pastrehët, viktimat e fatkeqësive natyrore dhe njerëzore, viktimat e abuzimit dhe marrëdhënieve abuzuese, gratë që përballen me çështje të abortit dhe lëndimeve nga lidhjet, ata që janë keq ekonomikisht ose të papunë, abuzues substancash dhe turma e atyre, lëndimet e të cilëve janë shumë të mëdha për t'u numëruar! Shumë shpesh në

të kaluarën, kishat i kanë konsideruar këta njerëz si mbetje të njerëzimit, ndërsa ne i konsiderojmë ata si thesaret e ardhshme për mbretërinë e Perëndisë.

Revolucioni i Dashurisë është i thjeshtë: ai fillon me secilin prej nesh, teksa zgjerojmë rrethin e dashurisë për të përfshirë ata që janë rreth nesh të cilët na lëndojnë. Për shumë vite, kishat e kanë vënë theksin tek programet për të sjellë njerëz të rinj. Numri i programeve ka qenë alarmant dhe ato kanë ardhur dhe shkuar pa pasur sukses në sjelljen e zgjerimit. Ndryshe nga kjo, sferat e ndikimit të kishave shpesh janë bërë rrathë që po zvogëlojnë madhësinë. Vlerësimi i programeve mbi njerëzit nuk ka përmbushur sfidën e Jezusit, i cili tha se ne duhet të duam njëri-tjetrin.

Sfida e Revolucionit

Cikli, rrethi ose Revolucioni i të jetuarit si Jezusi për njerëzit e tjerë është një sfidë që apostulli Pal e shtroi para nesh: "Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij të dashur, dhe ecni në dashuri sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e tij për ne si blatë dhe flijim Perëndisë si një parfum erëmirë" (Ef. 5:1-2).

Kjo është thirrja e Revolucionit të Dashurisë: të ecim në dashuri, jo thjesht të vendosim për të dashur. Shumë njerëz e dinë që është gjë e drejtë të duash, por si po e zgjeroni rrethin tuaj të dashurisë? Kjo ndodh çdo ditë.

Të gjithë kemi një rreth ndikimi dhe të gjithë i përkasim një rrethi. Shumica prej nesh kënaqet në një rreth miqsh. Cila është përmasa e rrethit tënd? Sa i hapur ose i mbyllur është ai? Takoj shumë njerëz me qëllime të mira, të cilët duken se nuk e kanë idenë e përmasave të vogla të rrethit të tyre. Nëse jetojmë sipas "mentalitetit të Krishtit" dhe mendja e Krishtit është brenda nesh, atëherë secili rreth nuk duhet të përjashtojë askënd dhe të përfshijë të gjithë.

Për mua e rëndësishme dhe që përkufizon rrethin tim personal

është çështja e mëkatarëve, për të cilët jam sfiduar t'i sjell në rrethin tim. Më duket e lehtë që urrejtjen për mëkatin ta përziej me mëkatarin, që më bën ta urrej mëkatarin, sepse nuk duroj dot mëkatin. Kam mësuar se Perëndia kërkon që unë të urrej mëkatin, por të dua mëkatarin. Nganjëherë, qëndrimi ynë ndaj mëkatit mund të jetë si një takim me një gjarpër të rrezikshëm me zile që qëndron para një fëmije. Gjarpri është mbështjellë dhe në pozicion sulmi. Ne e urrejmë gjarpurin, por duam fëmijën dhe duam të shpëtojmë fëmijën nga dhëmbët e vdekjes së mundshme.

Ne jemi të detyruar që të paralajmërojmë njerëzit për pasojat e mëkatit, por gjithashtu duhet të lëvizim drejt dhembshurisë së Zotit për të përfshirë mëkatarët në rrethin tonë të dashurisë. Për më tepër, shumica e mëkatarëve janë të ndërgjegjshëm për pasojat negative të zgjedhjeve të gabuara në jetën e tyre. Dhe ata nuk kanë nevojë për dikë tjetër që t'u afrohet dhe t'i dënojë. Shumë tashmë janë torturuar nga besimi se kisha, pa përmendur Perëndinë, nuk do t'i pranojë ata për shkak të mënyrës së tyre të jetesës, varësisë, jobesnikërisë dhe gabimeve të mëdha.

Njerëzit në udhëheqje shpesh na pyesin se përse kisha jonë në Feniks dhe Qendra e Ëndrrave në Los Anxhelos qëllimisht punon me personat e shkelur, të urreyer dhe të padëshiruar. Ata kanë bërë zgjedhje jo të drejta. Kurrë nuk kam dyshuar se Perëndia synon që gjithsecili të jetë në rrethin e Tij të dashurisë.

Nëse jemi ata që themi se jemi, përfaqësues të vërtetë të Jezu Krishtit, atëherë askush nuk mund të përjashtohet. Kjo përfshin njerëz të doktrinave, denominacioneve dhe përvojave të ndryshme. Ne duhet të jemi inkurajues, lajmëtarë të shpresës që i drejton njerëzit drejt dashurisë pa kushte të Perëndisë dhe pastaj të bëhemi tregues i saj drejt tyre.

Unë nuk jam përgjegjës për ata që më përjashtojnë apo përfshijnë. Unë jam përgjegjës për veten time dhe për ata që përjashtoj. Jezusi në atë deklaratë universale, kur e kishin varur në kryq, tha: "Atë, fali

ata sepse nuk dinë ç'bëjnë" (shih Luka 23:34). Rrethi i tij përfshinte ata që e kryqëzuan. Madje edhe kritikët që e tallën dhe e pështynë dhe në mënyrë mizore i ofruan uthull, kur u kërkoi ujë, përfshihen në rrethin e Tij të dashurisë.

Rrethi ynë ekziston për të përfshirë edhe ata që na kanë bërë keq. Unë kam mësuar që të mos zihem me njerëzit e rrethit tim. Nuk ka asnjë betejë. Unë jam i mbrojtur për aq kohë sa i përfshij të gjithë në rrethin tim të dashurisë. Në këtë mënyrë nuk do të lëndohem.

Ju nuk mund të bëni shumë miq, por në rast se keni një armik, atëherë do ta takoni atë armik kudo që të shkoni. Ju jeni të lidhur me atë që urreni. Duke pranuar gjithsecilin, ji filloni të perfeksionoheni në atë se çfarë është dashuria e Perëndisë. Kushdo që është jashtë rrethit tuaj të dashurisë, mund t'ju lëndojë, por kushdo që është brenda rrethit tuaj të dashurisë, nuk do t'ju lëndojë.

Standardi ligjor i fesë që disa shpesh e mbajnë me të madhe është i ngushtë dhe ekskluziv. Standardi i Revolucionit të Dashurisë është universal. Dashuria shëron! Dashuria ndërton! Dashuria ndriçon! Dashuria të ngre lart! Sa më i madh bëhet rrethi im i dashurisë, aq më e lumtur jam dhe mund të tregoj më shumë dashuri të Perëndisë për të tjerët.

Një Revolucion Dashurie në Veprim

Kur ne nisëm në fillim Qendrën e Ëndrrës në Los Anxhelos, qëllimisht shkuam në një zonë të padëshirueshme, saqë edhe qeveria, kishat dhe madje edhe policia, e ka braktisur si të pashpresë. Duke qenë se ne zmadhuam rrethin e dashurisë për të përfshirë anëtarët e bandave të gangsterëve, të arratisurve, të pastrehëve, prostitutave, kriminelëve të regjur dhe të rinjtë e mohuar, rrethi ynë i dashurisë është zmadhuar deri në atë pikë sa Qendrat e Ëndrrës përreth botës janë tek ata që janë të padëshirueshëm

dhe që nuk i duan, duke shfaqur dashurinë e Krishtit nëpërmjet veprave të shërbimit.

Çdo javë, qindra vullnetarë nga Qendra e Ëndrrave të Los Anxhelosit dalin në rrugët e një zone të caktuar të lagjeve (një nga qindra aspektet e Revolucionit të Dashurisë është të dalin nga Qendra) dhe thjesht u shërbejnë fqinjëve të tyre në mënyra të ndryshme. Është thjesht shërbim ndaj njerëzve që ata as që i njohin për të treguar dashurinë e Krishtit.

Dhe në një kohë kur krimi dhe degradimi shoqëror është rritur përgjatë qytetit të Los Anxhelosit, lagjja pranë Qendrës së Ëndrrave ka pasur një rënie të kriminalitetit prej 70 përqind dhe shumë të tjerë janë kthyer në besim te Krishti. Divizioni i mbrojtjes, një grup famëkeq i lagjes për korrupsion, krime dhe mëkate, tani është një shembull vezullues i njerëzve që ecin në dashurinë e Krishtit. Ky është një Revolucion Dashurie!

Falja dhe Dhënia

A jeni falur ju? Atëherë fali të tjerët. Dashuria fal dhe dashuria është për t'u dhënë.

Të japësh dashuri është një nga gjërat më të vështira. Në shumë mënyra është më e vështirë se të japësh para, pasi dashuria duhet të vijë nga një zemër e hapur. Nuk ka mundësi që thjesht ta bësh si një transaksion të ftohtë biznesi.

Por shumica prej nesh e keqkupton se çfarë është dashuria. Ne mendojmë se ajo është dika që mund ta marrim dhe mbajmë si dhuratë ose si diçka të marrë borxh. Por kjo nuk është ajo çka dashuria është në të vërtetë.

Dashuria është diçka që vetëm mund ta japësh, jo diçka që e mban si pronën tënde. Askush prej nesh nuk ka në pronësi dashuri, ne e përdorim dashurinë. Fjala biblike për dashuri është në mënyrën veprorë, që do të thotë se dashuria që nuk jepet, nuk është fare dashuri.

A keni takuar ndonjëherë ndonjë person i cili gjithmonë ka nevojë për dashuri, por asnjëherë nuk merr mjaftueshëm? Sa më shumë që fokusohen te dashuria që ndiejnë se e meritojnë, aq më pak dashuri iu duket se kanë. Ata janë kaq të përqendruar në mungesën e tyre, saqë mbushja me dashuri nuk është kurrë e mjaftueshme.

Kur ndihmojmë njerëzit e lënduar, ne takojmë njerëz gjatë gjithë kohës që na tregojnë se thjesht duan të duhen nga dikush. Kam zbuluar se e kundërta është e vërtetë: ne nuk kemi nevojë të duhemi aq shumë sa kemi nevojë të duam dikë.

Kur duam pa kushte, nuk mund të bëhemi kurrë të burgosurit e një burri apo gruaje. Por kur kërkojmë që dikush të na dojë, ne bëhemi skilevër të tyre dhe burgosemi lehtësisht nga mungesa e dashurisë së tyre për ne

Është më e Rëndësishme të Japësh sesa të Marrësh

Unë besoj se për njerëzit është më e rëndësishme që të tregojnë, sesa të marrin dashuri. Kur tregon dashuri, ajo hap rubinetin, nga i cili Perëndia derdh në mënyrë të vazhdueshme dashuri mbi ne; sa më shumë dashuri të tregosh, aq më shumë ke dhe është më e lehtë ta lësh rubinetin hapur dhe të rrjedhë tek të tjerët.

Sasia e dashurisë që ke ndikohet direkt nga sasia e dashurisë që ti jep. Është paradoks, por është e vërtetë: e vetmja mënyrë për t'u mbajtur tek dashuria, është ta lejosh atë të dalë.

E vetmja mënyrë për t'u mbajtur tek dashuria, është ta lejosh atë të dalë.

Nëse jep dashuri në mënyrë konstante, atëherë ti je gjithmonë i fokusuar në atë që duhet të japësh dhe ajo masë do të rritet. Edhe nëse askush nuk të do, ti do të kesh një masë të pafund dashurie

nëpërmjet Jezusit dhe jeta jote do të jetë e mbushur plot me dashuri.

Kur isha i ri, njerëzit i doja më pak sesa i dua tani. Por u përpoqa që të jepja dashuri dhe pashë që masa ime u zgjerua. Për atë kohë sa vazhdoj të përdor dashurinë që kam, Perëndia vazhdon të më japë dashuri edhe më të thellë.

Si i ri që isha, nuk është se i doja shumë fëmijët e vegjël, vetëm i pëlqeja. Por një ditë vendosa që t'i doja. Sot më mbushet zemra me dashuri për fëmijët e vegjël. Tani mund të them se i dua shumë fëmijët dhe kënaqem me ta dhe dua shumë t'i bekoj ata.

Sot e shijoj shumë jetën, por kur isha predikues i ri, nuk isha edhe atëherë i gëzuar. Sot kam njëzet herë më shumë gëzim sesa kisha para njëzet vjetësh. Unë vendosa në mendjen time që, ose do të isha i gëzuar, ose i zymtë dhe sigurisht që zgjodha gëzimin. Kam vënë re se më shumë gëzim më vjen kur vendosa që ta ndaja me të tjerët.

Mënyra se si Revolucioni i Dashurisë do ta përfshijë trupin e Krishtit është nëse i ndihmojmë njerëzit të shikojnë se, të ndjekësh nga pas dashurinë, është mënyra e gabuar për ta arritur atë. Ne duhet të ndihmojmë njerëzit, nëpërmjet shembullit tonë, që të kuptojnë se për të pasur dashuri, ata nuk duhet ta kërkojnë, por duhet ta japin.

Dashuria e vërtetë nuk vjen nga ndonjë person; ajo vjen nga Perëndia. Edhe dashuria ime për gruan time, Marja, është e pastër, sepse unë kam gjetur burimin. Ne mësuam se është bekim më i madh të japësh dashuri, sesa të marrësh dhe kur një burrë dhe një grua i japin dashuri njëri-tjetrit, ata do të kenë një martesë të mrekullueshme.

Kur trupi i Krishtit të mësojë të japë dashuri në mënyrë aktive ndaj botës së humbur dhe në lëngim, ne do ta zgjerojmë rrethin tonë të dashurisë dhe do të ndikojmë për mirë në shoqëri dhe do ta përmirësojmë atë.

A jeni gati për Revolucionin? Më poshtë po jap disa sugjerime për të vënë në zbatim dashurinë e Krishtit në versionin tuaj personal të Revolucionit të Dashurisë:

1. Flit dashuri. Dil hapur dhe thuaje.

Bëhu një "ujëvarë dashurie", gjithmonë i derdhur mbi njerëzit. Disa njerëz thonë: "Unë nuk jam gatuar në atë mënyrë." Nëse çdo besimtar do të thoshte më shumë "të dua", atëherë kjo do të ripërkufizonte marrëdhëniet e botës. Provoje! Nëse u thua njerëzve se i do, do të ta kthejnë mbrapsht. Kur thua me zemër fjalën "të dua", kjo të fuqizon në dashurinë e Krishtit.

2. Tregoje dashurinë me shkrim.

Unë mbaj dosjen "të dua" me të gjitha letrat e mira që marr. Ato kanë shumë kuptim për mua. Një letër e thjeshtë inkurajimi nga ju mund të jetë një gjë shumë e madhe për dikë tjetër. Ta shkruash dashurinë tënde e bën atë të përhershme dhe të qëndrueshme. Ajo mundet që të jetë edhe një mbrojtës jete për dikë, nëse po zhyten në dëshpërim. T'i shkruash dikujt një mesazh për dashurinë e Perëndisë, i inkurajon ata, të frymëzon ty dhe rrit ndërgjegjësimin për dashurinë e Perëndisë.

3. Rreziko duke bërë vepra të çmendura dashurie.

Kur shkojmë mbi e përtej asaj që të tjerët mund të presin nga ne për të shprehur dashurinë e Krishtit, përfundimet e atyre veprimeve të dashurisë shumohen në jetët e të tjerëve. Nganjëherë, kërkohet pak rrezik për të bërë pak më shumë - kjo është pjesë e Revolucionit të Dashurisë. Pyesni veten: "A mund të bëj pak më shumë nga sa po bëj tani për të dashur të tjerët?" Bëje jetën tënde që të mbahet mend; revolucionarët gjithmonë bëjnë gjëra të çmendura. Bëje një ditë të zakonshme të jetë e jashtëzakonshme, duke e lejuar dashurinë tënde të jetë e çmendur në shprehjen e saj të dashurisë së Perëndisë.

4. Dashuria është e gatshme të gëzohet dhe të qajë.

Shpesh të tregosh dashuri do të thotë të ndihmosh dikë i cili nuk është në humor të festojë. Është të ndash pikëllimin me dikë, ose të ecësh përgjatë luginës me ta, duke hedhur themele të thella të dashurisë dhe besimit. Jezusi shkoi në dasma dhe funerale. Ai e dinte se për çfarë kishin nevojë njerëzit në të dyja rrethanat. Ne duhet të ndajmë dashurinë e Perëndisë në të gjitha rrethanat, me qëllim që të jemi të qetë për të treguar dashuri për ata që gëzohen dhe për ata që vajtojnë.

5. Mëso të duash njerëz të ndryshëm në mënyra të ndryshme.

Njerëzit marrin dhe japin dashuri në mënyra të ndryshme, kështu që duhet të mësojmë të duam njerëzit në mënyra të ndryshme. Është jetike për secilin prej nesh të mësojë se si të japë dhe të marrë dashuri me ata që janë pranë nesh dhe është e detyrueshme që të mësojmë se si t'u japim dashuri atyre që janë në botë përreth nesh, veçanërisht ata që mund të mos marrin dashuri nga asnjë njeri tjetër. Studioji njerëzit dhe Fjalën e Perëndisë, shiko se si Jezusi i deshi njerëzit dhe do të mësosh t'u tregosh dashuri njerëzve të ndryshëm, në mënyra të ndryshme, duke e bërë gjithsecilin të ndihet mirë dhe t'i japë lavdi Perëndisë.

Dëshiron të jesh Revolucionar/e?

Pra, a do të vepresh si një revolucionar sot? A do të provojë secila dhe çdo ditë e jetës sate që tani e tutje se ti je pjesë e Revolucionit të Dashurisë? Çfarë është ajo gjë për të cilën ti do të mbahesh mend? Për zgjuarsi? Inteligjencë? Në fund, dashuria është ajo që ka rëndësi. Dashuria është ajo që na jep vlerë të përjetshme. Çdo njeri dëshiron të njihet si krijesë shpirtërore e krijuar në imazhin e Perëndisë dhe dashuria është e vetmja mënyrë për ta bërë.

Dashuro sikur dashuria të ishte pakufi dhe do ta shikosh se e

tillë është. Ti mund të mos duash dikë, kur e takon për herë të parë, por nëse i jep dashurinë që ke, atëherë ajo do të rritet.

Unë të sfidoj të jesh personi "më i dashurueshëm" që ke njohur ndonjëherë dhe mund të ta them paraprakisht se nëse do të duash gjatë gjithë kohës, atëherë depozita e dashurisë nuk ka për t'u tharë kurrë.

Pra, si thua? Rifutu në ushtrinë e Perëndisë, që Ai po ngre sot dhe shihemi në Revolucionin e Dashurisë!



KAPITULLI

15

A Kemi Nevojë për Rizgjim apo për Revolucion?

Gjithsecili mendon të ndryshojë botën, por askush
nuk mendon të ndryshojë vetveten.

Leon Tolstoi

Kur diçka rizgjohet, e vjetra është sjellë sërish në jetë, i rikushtohet vëmendje diçkaje. Kur shoqëria përjeton përtëritje të interesit fetar, ky quhet rizgjim. Fjalori i kolegjit Merriam-Webster e përkufizon fjalën rizgjim si "një takim ungjillor ose seri takimesh shumë emocionale." Gjatë gjithë jetës sime madhore si e krishterë, kam dëgjuar njerëz të flasin dhe luten për rizgjim. Por nuk jam e sigurt nëse rizgjimi është ajo që na nevojitet. Unë mendoj se kemi nevojë për diçka më radikale. Mendoj se kemi nevojë për një Revolucion. Fjalori Webster e përkufizon fjalën *revolucion* si "një ndryshim të papritur, radikal ose të plotë."

Nganjëherë jemi më rehat kur ri-veshim gjërat e vjetra, sesa me ndryshimin radikal. Po a e kanë transformuar rizgjet e kaluar

kishën dhe botën? Sigurisht që ato kanë qenë me përfitim në kohën e tyre, por çfarë kemi nevojë sot në kishë, me qëllim që të bëhemi të efektshëm në botë? Çfarë na duhet për të qenë drita që Krishti na bën thirrje të jemi?

Në librin e tij *Mënyra Barbare*, Ervin McManus shkruan: "Le ta lëmë krishtërimin e sterilizuar dhe t'i kthehemi besimit të fuqishëm, të gjallë dhe të lashtë që zgjidhte revolucionin mbi kompromisin, rrezikun mbi sigurinë dhe pasionin mbi indiferentizmin dhe fetë e kota." Pasioni i Krishtit e çoi Atë deri në kryq. A do të na çojë pasioni ynë të paktën të sakrifikojmë disa nga mënyrat e vjetra, me qëllim që brezi i ardhshëm të mund të përjetojë fuqinë transformuese të Revolucionit të Dashurisë?

Jezusi ishte revolucionar dhe Ai sigurisht që nuk ishte avokat i traditës. Ai erdhi të sillte ndryshim dhe kjo nuk u erdhi për shtat fetarëve të kohës së Tij. Perëndia nuk ndryshon kurrë, por Ai i ndryshon të tjerët. Unë kam kuptuar se Atij i pëlqen krijueshmëria dhe gjërat e reja dhe Ai i mban gjërat e freskëta dhe të zjarra.

Disa kisha as që do ta marrin në konsideratë të ndryshojnë diçka të tillë të thjeshtë si stili i muzikës së tyre. Ata mund të këndojnë himne dhe të luajnë në organo, derisa të jenë gjallë. Ata e injorojnë faktin që bashkësia e tyre po tkurret në numër dhe që nuk po ndikojnë fare në komunitet. Ata duhet të shikojnë rreth e rrotull të dielën në mëngjes dhe të pyesin se përse gjithsecili në godinë është në moshë mesatare ose i moshuar. Ku janë të rinjtë? Ku është entuziazmi? Ku është jeta?

Para disa vitesh, ne filluam të përjetonim një rënie të lehtë në konferencat që realizojmë mes kombeve dhe vumë re se shumica e pjesëmarrësve ishin në moshë mesatare ose të moshuar. Djali ynë, i cili ishte njëzet e katër vjeç në atë kohë, filloi të na inkurajonte për të bërë disa ndryshime radikale në stilin e muzikës, ndriçimin, dekorin dhe mënyrës se si visheshim. Ai tha se brezi i tij kishte nevojë të madhe të njihej me ungjillin e Jezu Krishtit, por ishte i

pandjeshëm nga mënyra e vjetër e besimit, që i kishte dalë nami si parimor dhe i mërzitshëm. Për rreth një vit, Dave dhe unë nuk ndryshuam. Ne thonim atë që shumica e njerëzve thonë, kur nuk duan të ndryshojnë: "Perëndia nuk ndryshon." Gjithashtu ndienim se ajo që kishim bërë deri në atë pikë kishte funksionuar më së miri. Përse ta ndryshonim? Në të përfshihej shumë krenari dhe ishte e vështirë që të lejoje një njëzet e katër vjeçar i cili sapo kishte filluar të punonte me ne, të na tregonte se çfarë duhej të bënim. Por ndërsa viti kaloi, filluam të dëgjonim të rinj të tjerë dhe kuptuam se nuk kishim nevojë që të adhuronim metodat. Mesazhi ynë nuk do të ndryshonte, por paketimi me të cilën shërbehej, duhej të ndryshonte.

Bota ndryshon, njerëzit ndryshojnë, brezat e rinj mendojnë ndryshe nga të parët dhe ne duhet të mendojmë se si t'i fitojmë ata. Unë dëshiroja të shikoja të rinj në konferencat e mia, por nuk isha e gatshme që t'i takoja ata aty ku ishin. Por, pak nga pak, zemrat tona u hapën për të provuar gjëra të reja dhe pamë rezultate të mëdha. Jo vetëm që nuk humbëm njerëzit që kishim, por erdhën të rinj të tjerë dhe shumë prej tyre ishin të rinj në moshë dhe entuziastë. Nëse ne kemi urtësinë e brezit të vjetër dhe krijueshmërinë entuziaste të brezit të ri, atëherë kemi më të mirën e të dy botëve.

Një ditë zhvilluam një takim pune me ekipin tonë drejtues në zyrë. Djali ynë, i cili në mënyrë të vazhdueshme na kishte kërkuar ndryshim, pati një ide për diçka dhe unë nuk isha dakord me të. Ai vazhdoi të ngulmonte me të tijën, saqë unë i kërkoja të gjithëve se çfarë mendonin dhe ata të gjithë ishin dakord me mua. Kur arrita në atë pikë sa të gjithë në sallë ranë dakord me mua, djali ynë, Dan, tha: "Sigurisht që ata të gjithë janë dakord me ju, ata janë të gjithë mosha juaj." Atëherë unë nisa të kuptoj se i isha dorëzuar njerëzve si unë dhe duke bërë kështu, po bllokoja variacionin. Ne na nevojiteshin drejtues nga të gjitha moshat dhe jo thjesht njerëz që ishin të gjithë nga i njëjti brez.

Në një rast tjetër, Dan dëshironte të përdorte disa ngjyra në revistën

tonë mujore, të cilat nuk i kishim përdorur më parë. Mua nuk më pëlqyen dhe i thashë jo. Ai ishte agresiv në përdorimin e ngjyrave të reja dhe unë i thashë me zë të lartë: "Mua nuk më pëlqejnë dhe nuk kemi për t'i përdorur!" Ai tha: "Nuk e kisha kuptuar se ti je thirrur për t'i shërbyer *vetes tënde*. Po sikur të tjerët t'i pëlqejnë këto ngjyra?" Në atë pikë mua m'u hapën sytë. Kuptova se unë në zyrë kisha rregulla veshjeje që ishin ashtu siç i pëlqejta *unë* dhe se ne përdornim ngjyrat që unë pëlqejta në revistë, në reklama dhe në godinë. Ne kishim atë lloj muzike që *unë* pëlqejta. Më erdhi turp kur kuptova se sa shumë prej vendimeve të mia ishin rreth asaj që *unë* pëlqejta dhe që ndihesha rehat dhe jo ato që njerëzit kishin nevojë.

Dave-i dhe unë filluam të kuptonim se po adhuronim metodat dhe se ato metoda nuk kishin asnjë kuptim për Perëndinë. Ishte mesazhi i Tij që Ai dëshironte të përcillej dhe paketimi me të cilin vinte, sigurisht që mund të ndryshohej. Kështu që filluam të ndryshonim dhe vazhdojmë të jemi të hapur që nga ajo kohë. Ne kemi ndryshuar mënyrat e veshjes, duke i bërë më bashkëkohore. Ndryshuam ekipin e adhurimit për ta bërë të tillë që të mund të tërhiqnin më shumë të rinj. Unë vendosa të doja brezin aktual, aq sa të këndoja ato këngë që atyre u pëlqenin. Shkurtuam kohëzgjatjen e shërbesave, sepse e gjithë shoqëria jonë sot dëshiron të bëjë gjëra më të shpejta. Unë isha mësuar me shërbesa në kishë prej tre orësh, por jo çdo njeri është kështu, pra ne vendosëm që të zgjidhnim një rrugë të mesme. Ndryshuam ndriçimin për të qenë më agresivë. Madje morëm një makineri që krijon mjegull, që më thanë se krijon atmosferë. Unë ende mendoj se kjo vetëm sa i pengon njerëzit për të qenë në gjendje që të shohin qartë, por mund ta pranoj mjegullën, nëse kjo i bën ata të ndihen mirë për të dëgjuar mesazhin e ungjillit. Mos harro se Pali tha se ai u bë çdo gjë që duhej, për të fituar njerëzit për ungjillin e Jezu Krishtit (shiko 1 Kor. 9:2-22). Ai nuk adhuroi metoda dhe as ne nuk duhet.

Bibla thotë se në ditët e fundit do të përjetojmë një kishë që do

jetë egoiste dhe egocentrike. Njerëzit do të jenë të përdalë në moral dhe do të mbajnë një lloj besimi, por do të mohojnë fuqinë e ungjillit (shih 2 Tim. 3:1-5). Ne duhet të shohin fuqinë e Perëndisë në kishat tona. Kemi nevojë të shohim jetë të ndryshuara, të shëruara, ndërtim dhe shpengim. Kemi nevojë të shikojmë dashurinë e Perëndisë të rrjedhë lirshëm. Kemi nevojë të shikojmë një Revolucion dhe unë jam e vendosur të jem pjesë e tij!

Mund ta them me sinjeritet se shumë prej ndryshimeve që kemi bërë në konferencat tona nuk janë medoemos ato që unë pëlqeja. Por po mësoj më shumë çdo ditë se dashuria kërkon që të heqim dorë nga mënyrat tona dhe të kuptojmë se cilat janë mënyrat e Perëndisë për stinën aktuale. Shumë nga ndryshimet kanë qenë vërtet një sakrificë për mua personalisht, por në zemrën time e di se të gjitha ato që kemi bërë kanë qenë gjërat e duhura. Mund të duket marrëzi, por ka qenë një kohë kur me të vërtetë mendoja se Perëndia nuk ka për të bekuar asnjë, nëse ata do të ishin në një platformë në përpjekje për të udhëhequr njerëzit të veshur me xhinse. Pastaj po mendoja seriozisht për atë që Moisiu mund të kishte veshur, kur shkoi në mal për të marrë Dhjetë Urdhërimet dhe më në fund kuptova se sa e marrë kisha qenë. Gjon Pagëzori ishte një njeri i çuditshëm në veshje. Ai kishte zakone të pazakonta ushqimi dhe adresa e tij ishte shkretëtira, por ai drejtoi një revolucion. Ai përgatiti udhën për Mesian. Ai nuk ishte fans i besimit të organizuar dhe shumicën e udhëheqësve fetarë të kohës së tij i quante pjellë nepërkash. Ai nuk i duronte dot njerëzit fetarë, të vetëshpallur të drejtë, të kohës së tij, që shkonin në tempull për t'u lutur por që nuk luanin as gishtin për të ndihmuar ndonjë në nevojë.

Perëndia shikon në zemër dhe ne kemi nevojë të mësojmë të bëjmë të njëjtën gjë. Ai nuk ishte i preokupuar për mënyrën se si dukej Moisiu ose Gjoni. Ai ishte i lumtur të gjente dikë që të mos kishte frikë të drejtonte një revoltë kundër besimit të vdekur dhe t'i udhëhiqte njerëzit në intimitet me Atë.

Dashuria Sakrifikon

Fjala sakrificë nuk është një fjalë që zakonisht na gëzon, sepse ajo do të thotë të heqim dorë nga diçka që mund të duam ta mbajmë. Në gjuhën e Dhjatës së Re (greqisht) fjala "sakrificë" do të thotë "një veprim ofrimi ose që ajo që është ofruar." Dashuria nuk kërkon të vetat (shih 1 Kor. 13:5). Dashuria shpesh kërkon që të sakrifikojmë mënyrën tonë të të bërit të diçkaje.

Në Dhjatën e Vjetër, "sakrifica" i referohet kafshëve të ofruara për mëkatin, por në Dhjatën e Re, ajo i referohet sakrifikimit të Krishtit në kryq. Dhjata e Re gjithashtu nxit besimtarët që "t'i paraqesin trupat tuaj si fli të gjallë, të shenjtë dhe të pëlqyeshëm për Perëndinë që është shërbesa juaj e mençur" (Rom. 12:1).

Arsyeja kryesore që ne nuk shikojmë aq shumë dashuri në botë sa duhet, është se njerëzve nuk u pëlqen të sakrifikojnë. Tendencat jonë natyrale është të mbajmë dhe jo të japim në mënyrë sakrifikuere. Ne mbrojmë zonën tonë të rehatit. Ne mund të japim, nëse është e lehtë ose e përshtatshme, por kur kërkohet sakrificë, prapësohemi. Sa nga mënyrat e juaja po i mbani fort pa pyetur ndonjëherë: "A mos ka vallë Perëndia një mënyrë ndryshe për mua që të bëj këtë?" Mbi të gjitha Bibla thotë se rrugët e Tij janë më të larta se rrugët tona (shiko Isa. 55:8).

Fatmirësisht, mund të formojmë zakone të reja dhe realisht të jetojmë një jetë sakrifikuere dhe të kënaqemi me të. Kur kujtohem të bëjmë mirë për të tjerët dhe refuzojmë të neglizhojmë të qenit bujarë, Bibla na thotë se Perëndia kënaqet me sakrifica të tilla (shiko Heb. 13:16). "Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindurin" (Gjoni 3:16). Dashuria duhet të japë dhe dhënia kërkon sakrificë!

Të gjithë kemi një mënyrë që na pëlqen të bëjmë gjërat dhe zakonisht mendojmë se mënyra jonë është mënyra e duhur. Një nga problemet e mëdha me besimin në përgjithësi, është se shpesh

ngecet në "mënyrat e vjetra" që nuk janë më të vërteta në shërbimin ndaj njerëzve, por që refuzon të ndryshojë. Ai refuzon të sakrifikojë mënyrat e veta.

Një mikesha ime, kohët e fundit më tha se ajo u kërkonte vajzave së saj adoleshente që të shkonin në kishë çdo të diel, por ato gjithmonë mërziteshin dhe mezi prisnin që shërbesa të përfundonte. Ato e pranonin se në mënyrë absolute nuk merrnin asgjë nga qëndrimi aty. Këto vajza ndoshta e duan Perëndinë, por nuk pajtohen me metodat e përdorura nga kisha. Ato i përjashtojnë një brezi të ri që i bëjnë gjërat në një mënyrë të re. Trishtueshëm, shumë fëmijë të rritur në kisha të Krishtera largohen nga çdo lloj besimi kur rriten. Ata mund të jenë të dekurajuar nga hipokrizia, të mërzitur nga rregullat dhe parimet ose të mërzitur deri në lot. Kisha nuk punoi për ata. Ata dëshironin diçka të përshtatshme dhe të fuqishme, diçka gazmore dhe aventurore, por ato përfunduan me një listë të gjatë të gjërave që nuk mund t'i bënin.

Tommy Barnet, bashkëthemelues i Qendrës së Ëndrrave në Los Angeles, zbuloi se shumë të rinj në atë zonë luanin me pedanë me rrota. Kur dëgjoi se një lojtar i famshëm në këtë pedanë do të vinte në këtë zonë për të xhiruar një film dhe kishin bërë një pistë 50,000 dollarë për filmin, ai u kërkoi atyre me guxim që ta merrte kisha kur të përfundonin xhirimet e filmit. Ata ia dhanë atij, u transportua në Qendrën e Ëndrrave dhe tani të shtunave, kushdo që ka ndjekur shërbesën atë javë, merr falas një biletë për të luajtur në pistë nëse duan. Gatishmëria e pastor Barnettit për të bërë diçka radikale dhe të re ka sjellë mijëra adoleshentë në Qendrën e Ëndrrave për të luajtur. Dhe shumë prej këtyre adoleshentëve përfundojnë duke pranuar Krishtin. Ai sakrifikoi traditat e vjetra, që mund të mos kenë lejuar diçka të tillë, me qëllim që të fitonte dashamirësit e këtij sporti me dashuri. Ai kuptoi dëshirën e tyre dhe i ndihmoi ta plotësonin. Ne nuk mund të presim të rinj, apo çfarëdo njerëzish për këtë qëllim, që të duan vetëm të lexojnë Biblën dhe të luten.

Njerëzit kanë nevojë të qeshin, të argëtohen, të bëjnë aventura dhe ata nuk ka pse të shkojnë në botë për ta bërë këtë.

Pastor Barnett tha se kur kori i tij prej dyqind zërash, i veshur në të bardhë, këndoi "Sa i madh je Ti", adoleshentët i zuri gjumi, kështu që kur ata i kërkuan atij nëse mund të këndonin sipas muzikës së tyre javën që vjen, ai u dha leje për këtë. Ndërsa i dëgjoi javën e ardhshme, ai kuptoi se ata kishin marrë një këngë rrok 'n'rolli dhe e kishin bërë këngë shpirtërore. Fillimisht ai mendoi: *Oh, jo! Çfarë bëra kështu?* Por ndërsa dëgjoi, ai kuptoi se bekimi i Perëndisë ishte në atë këngë. Është e mahnitshme ajo çfarë Perëndia do të përdorë, të cilën ne e refuzojmë. Perëndia shikon zemrën prapa gjithçkaje.

Unë besoj se duhet të mësojmë se vetëm mesazhi i ungjillit është i shenjtë, jo metodat që përdorim për ta prezantuar atë. Nëse nuk e mësojmë këtë, jemi në rrezik të bëhemi të papërshtatshëm për brezin aktual dhe mund t'i humbim ata. Ata kanë nevojë të madhe për të njohur dashurinë e Perëndisë dhe ne mund të duhet të sakrifikojmë mënyrat tona për të ndihmuar që ta bëjmë atë të ndodhë.

Kur bëmë ndryshimet në konferencat tona, a sakrifikuam atë që bashkësia aktuale dëshironte për hir të atyre që ne dëshironim të shikonim të vinin? A mos po tregoheshim të padrejtë ndaj atyre të cilët kishin qenë me ne për një kohë të gjatë? Nuk e besoj, sepse ata që janë më të pjekur shpirtërisht duhet të jenë gati dhe të vullnetshëm të sakrifikojnë për të parë të tjerët të njohin të vërtetën. Kur u shpjegova njerëzve se përse po bëja ndryshime, ata të gjithë shpërthyen në gëzim. Njerëzit duan të bëjnë atë që është e drejtë; ata thjesht kanë nevojë për mirëkuptim. Sigurisht, gjithmonë do të ketë njerëz që u rezistojnë ndryshimeve dhe këta njerëz mbeten mbrapa. Ata qëndrojnë aty ku janë, por Perëndia vazhdon të lëvizë para, me ose pa ata.

Kur flasim për nevojën për Revolucion Dashurie, po flasim për

ndryshim radikal në mënyrën se si e jetojmë jetën. Duhet të pyesim Perëndinë çdo ditë se çfarë mund të bëjmë për Atë dhe jo se çfarë mund të bëjë Ai për ne. Kujtdo që merr pjesë në Revolucionin e Dashurisë, do t'i kërkohet të bëjë sakrifica për hir të të tjerëve, por këto sakrifica gjithashtu do të sjellin një gëzim të ri. Fokusi ynë duhet të ndryshojë, nga vetvetja tek të tjerët. Ne duhet të mendojmë se çfarë mund të japim dhe jo se çfarë mund të marrim. Kur Jezusi udhëtoi me dishepujt e Tij, Ai u mësoi atyre rreth jetës. Unë besoj se ne kemi nevojë të dëgjojmë mesazhe nga foltoret tona se si të jetojmë jetën e përditshme në mënyrë të tillë që është e pëlqyeshme për Perëndinë, jo thjesht mesazhe mbi çështje doktrinare. Duhet të sigurohemi që mesazhet të jenë të përshtatshme për të gjitha brezat.

Ke kohë që ke njohur Krishtin dhe akoma dashuria e Tij është e burgosur në ty? Nëse është kështu, atëherë është koha që ta lejosh të dalë jashtë me guxim. Ne duhet të jemi kanale ku të rrjedhë dashuria e Perëndisë dhe jo rezervuarë. Ji çdo ditë i gatshëm për t'u përdorur nga Perëndia. Unë marr guximin që të të them një lutje që ta bësh lutjen tënde ditore: "Perëndi, më trego se çfarë mund të bëj për Ty sot."

Perëndia dëshiron që ne t'ia paraqesim veten tonë çdo ditë si një sakrificë të gjallë (shiko Rom. 12:1). Ai dëshiron që ne t'i ofrojmë Atij të gjitha aftësitë dhe burimet tona. Një Revolucion Dashurie do të kërkojë sakrifica në kohë, energji, financa, mënyrat tona dhe shumë gjëra të tjera, por të jetosh pa dashuri, është të sakrifikosh jetën që Jezusi vdiq për të na i dhënë.

Largohu prej atij Zakoni Fetar

A jeni të gatshëm të largoheni nga zakoni juaj fetar dhe të përfshihenit me njerëzit e vërtetë që kanë probleme reale? Çelësi i lumturisë nuk është t'ju duan; është të keni dikë që ta doni. Nëse

vërtet dëshironi të jeni të lumtur, të gjeni dikë që ta doni. Nëse dëshironi ta bëni Perëndinë të buzëqeshë, atëherë gjeni një person të lënduar dhe ndihmojeni.

Unë kam shkuar në kishë për tridhjetë vjet dhe nuk kam dëgjuar as edhe një predikim mbi përgjegjësinë time biblike për t'u kujdesur për jetimët, vejushat, të varfrit dhe të shtypurit. Jam tronditur kur më në fund kuptova se sa shumë vend zë në Bibël ndihma për të tjerët. Kam kaluar shumicën e jetës sime të Krishterë duke menduar se Bibla na flet mbi mënyrën se si Perëndia mund të më ndihmojë mua. Pa dyshim që nuk isha e lumtur.

Aktualisht po përgatitem për një udhëtim në Afrikë për të vizituar Etiopinë, Ruandën dhe Ugandën. E di që do të shoh se nevoja do të jetë më e madhe se çdo gjë tjetër që kam parë në ndonjë vend dhe jam gati dhe e etur të jap. Udhëtimi do të jetë një sakrificë në kohë, energji, rehati dhe financa por unë kam nevojë të shkoj. Unë kam nevojë të prek njerëz të lënduar. Unë kam nevojë t'i afrohem varfërisë dhe urisë. Dua t'i afrohem aq afër, sa të mos e harroj kurrë, kur të kthehem në shtëpi.

Do të mbaj në krahë foshnja që janë të keq-ushqyera dhe vuajnë nga uria dhe do të shoh dhimbjen në sytë e nënave të tyre që ekziston aty duke i parë t'u vdesin fëmijët dhe që nuk janë në gjendje të bëjnë asgjë për ta. Por sigurisht që unë do t'i ndihmoj disa prej tyre. Ndoshta nuk do të mund t'i ndihmoj të gjithë, por do të bëj aq sa mundem, sepse nuk mund ta pranoj që të mos bëj asgjë! Do të jem në gjendje që të vij sërish dhe do të ndaj përvojën me miqtë e mi dhe partnerët e shërbesës sonë mbi mundësitë se si të përfshihen dhe të ndihmojnë njerëzit e tjerë.

Njerëzit duan të ndihmojnë, por shumë prej tyre thjesht nuk dinë se çfarë të bëjnë. Ata kanë nevojë për dikë që ta organizojë këtë për ta. A keni aftësi drejtimi? Nëse po, përse të mos organizoni një fushatë për të varfrit në qytetin tënd, ose të nisni një mënyrë që ju dhe miqtë e tu t'u përfshihen në misionet për të varfrit dhe

të humburit kudo në botë? Një grup grash të cilat ishin të vendosura për të bërë diçka, grumbulluan "sende të ndryshme" nga fqinjët e tyre dhe të gjitha i shitën në një garazh të madh dhe të gjitha paratë ua shpërndanë për të ndihmuar të varfrit. Ato patën aq shumë sukses, saqë vazhduan ta bënin sërish dhe tani kanë një dyqan të madh që menaxhohet nga vullnetarët. Të gjitha prodhimet artizanale që shiten, jepen dhuratë dhe gjithë shuma e parave u jepet misioneve. Ato ishin në gjendje të jepnin gjashtëdhjetë e pesë mijë dollarë vetëm në një vit. (Sa për dijeni, shumica e grave janë mbi gjashtëdhjetë vjeç dhe unë jam kaq krenare për to që bëjnë një gjë të tillë kaq krijuese dhe të vlefshme. Ato kanë vendosur që vitet e tyre të fundit t'i kalojnë si vitet më të frytshme.)

Ji i vendosur që të ndihmosh dikë. Ji krijues! Udhëhiq një revoltë kundër jetesës sipas një zakoni fetar ku shkon në kishë, kthehesh në shtëpi dhe sërish shkon në kishë, por që realisht nuk po ndihmon askënd. Mos ngroh karriget e kishës dhe thjesht këndon himne. Përfshihu në dhënien e ndihmës për njerëzit e lënduar. Mos harro fjalët e Jezusit:

"Sepse pata uri dhe nuk më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe nuk më dhatë për të pirë, isha i huaj dhe nuk më pritët, i zhveshur dhe nuk më veshët, i sëmurë e në burg dhe nuk erdhët të më shihni."

Atëherë edhe ata do t'i përgjigjen duke thënë:

"Zot, kur të pamë të uritur ose të etur, ose të huaj ose të zhveshur, ose të sëmurë ose në burg dhe nuk të shërbyem?"

Atëherë do t'u përgjigjet atyre duke thënë: "Në të vërtetë ju them: për aq sa nuk ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre më të vegjëlve, nuk ma keni bërë as mua."

Mateu 25:42-45

KREDOJA JONË

Unë marr përsipër dhembshurinë dhe
dorëzoj justifikimet e mia.

Unë qëndroj kundër padrejtësisë
dhe **përkushtohem** të vë në jetë veprime
të thjeshta të dashurisë së Perëndisë.

Refuzoj të rri duarkryq. Ky është vendimi im.

UNË JAM REVOLUCIONI I DASHURISË

SHËNIME

Burimet statistikore në këtë libër

1. Çfarë Nuk Shkon në Këtë Botë?

1. "Help End Sex Trafficking!" <http://www.crisisaid.org/traffickstats.html>
2. "Hunger Facts: International," <http://www.bread.org/learn/hunger-basics/hunger-facts-international.html>

3. Asgjë e Mirë nuk Ndodh Rastësisht

1. "Forced to Flee: Uganda's Youth 'Night Commuters'," <http://www.theirc.org/where/page-28828228.html>
2. "Simple Statistics"

6. Të Mposhtësh të Keqen me të Mirë

1. "Widows in Third World Nations", <http://www.deathreference.com>
2. "Uganda, Ghana and Cote d'Ivoire—The situation of widows", <http://ifad.org/gender/learning/challenges/widows/55.htm>

7. Drejtësi për të Shtypurit

1. "Prostitution is not a choice, it is a lack of choices", <http://www.spokesmanreview.com/blogs/vox/media/Feb07voxpage2.pdf>

9. Bëjini Njerëzit të Ndihen të Vlefshëm

1. George W. Crane, *Dr. Crane's Radio Talks*, vol. 1 (Mellot, IN: Hopkins Syndicate, Inc., 1948), 7.
2. *Ibid.*, 8-9.
3. *Ibid.*, 16.
4. Burimi original i paditur.
5. Njihet si thënie e William Penn dhe Stephen Grellet.

12. Dashuria Pa Kushte

1. <http://preventdisease.com/home/weeklywellness203.shtml>

DY FJALË RRETH AUTORES

JOYCE MEYER është një nga mësueset kryesore praktike të Biblës në botë. Si autorja Nr.1 më e shitur e gazetës *New York Times* ajo ka shkruar më shumë se tetëdhjetë libra frymëzues, përfshirë këtu *Kurrë mos u dorëzo*, *Sekreti i kënaqësisë së vërtetë*, *100 mënyra për të thjeshtëzuar jetën tënde*, gjithë grupin e librave Beteja e mendjes, si dhe nismën e saj në gjininë e romanit me titullin *Qindarka dhe Çdo Minutë*, dhe shumë të tjerë. Ajo gjithashtu ka transmetuar mijëra mësim audio, dhe ka tashmë një bibliotekë të plotë në video. Programet radio-televizive të Joyce Meyer, *Të shijosh jetën e përditshme*® transmetohen në mbarë botën, ndërkohë që ajo udhëton shumë për të mbajtur konferenca. Joyce dhe bashkëshorti i saj, Dave, janë prindërit e katër fëmijëve të rritur dhe banojnë në St. Louis, Missouri.

Lutja e shpëtimit

Zoti të do dhe Ai dëshiron që të ketë një marrëdhënie personale me ty! Nëse ende nuk e ke pranuar Jezus Krishtin si shpëtimtarin tënd, mund ta bësh në këtë moment! Thjesht hapja zemrën tënde atij dhe thuaj këtë lutje:

“Atë, e di që kam mëkatuar ndaj Teje. Të lutem më fal. Më bëj të pastër. Unë të premtoj se do t'i besoj Jezusit, Birit Tënd. Unë besoj se Ai vdiq për mua. Ai mori mëkatin tim mbi vete, kur Ai vdiq në kryq. Unë besoj se ai është ringjallur prej të vdekurve. Unë ja dorëzoj jetën time Jezusit, në këtë moment.

Faleminderit Atë, për dhuratën tënde të faljes dhe të jetës së përjetshme. Të lutem, më ndihmo të jetoj për Ty! Në emër të Jezusit, Amen!”

Nëse ti lutesh me vërtetësi në zemrën tënde, Zoti të ka dëgjuar, të ka pastruar dhe të ka çliruar nga skllavëria e vdekjes shpirtërore. Merr një kohë për ti lexuar dhe studiuar këto vargje dhe kërkoji Zotit që të të flasë, ndërkohë që ti ecën me Të, përmes këtij udhëtimi të jetës tënde të re.

Gjoni 3:16

1 Korintasit 15:3-4

Efesianët 1:4

Efesianët 2:8-9

1 Gjonit 1:9

1 Gjonit 4:14-15

1 Gjonit 5:1

1 Gjonit 5:12-13

Lutju Atij dhe kërkoji të të drejtojë në një kishë, e cila bazohet fort mbi biblën.

Kështu, ti do të kesh mundësinë që të rritesh në marrëdhënien tënde personale me Jezus Krishtin. Zoti është gjithmonë me ty. Ai do të drejtojë ty ditë pas dite dhe do të tregojë sesi të jetosh jetën plot bollëk, që Ai ka rezervuar për ty.



Re-vo-lu-ci-on: një ndryshim i papritur, rrënjësor dhe tërësor nga mënyra se si bëhen gjërat zakonisht.

Revolucion. Vetë fjala nxit shpresë, ndez pasion dhe frymëzon besnikëri si asnjë fjalë tjetër në fjalorin njerëzor. Ai të sjell në mendje pamjet e një grupi shumë të vogël njerëzish të cilët nuk duan të jetojnë më siç kanë jetuar në të kaluarën.

“Unë besoj se ka ardhur koha për revolucionin tjetër botëror, më të madhin e të gjithëve.”, - thotë Joyce Meyer. “Ne nuk na duhet një revolucion i mbështetur në politikë, ekonomi apo teknologji; *çfarë na duhet është një revolucion dashurie.*”

Libri që po mbani në duar është i rrezikshëm — një manual revolucionari. Nuk është thjesht një thirrje për të vepruar; ai është një thirrje për të qenë ... për të *qenë* personi i cili ndihmon një *mik* në nevojë ... që praktikon agresivisht veprat e mirësisë.

Joyce Meyer nxjerr në pah se nëse jetojmë për veten tonë, asnjëherë nuk do të kënaqemi. Bibla na mëson se kur e japim veten tërësisht, ne marrim jo vetëm atë që kemi dhënë, por tepërcë dhe bekime.

Me kapitujt e kontribuesve të ftuar si Darlene Zschech nga *Hillsongs*, Martin Smith nga *Delirious?*, pastorët Paul Scanlon, Tommy Barnett dhe John Maxwell, REVOLUCIONI I DASHURISË strukturon një mënyrë të re jetese – një mënyrë që do të ndryshojë jetën dhe botën tuaj.

REVOLUCIONI I DASHURISË

Unë marr përsipër dhembshurinë
dhe **dorëzoj** justifikimet e mia.

Unë qëndroj kundër padrejtësisë
dhe **përkushtohem** të vë në jetë veprime
të thjeshta të dashurisë së Perëndisë.

Refuzoj të rri duarkryq. Ky është vendimi im.

UNË JAM REVOLUCIONI I DASHURISË